



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Mat

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË MAT

Tiranë, 2023

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	17
II. HYRJE	20
1. Objekti dhe Qëllimi i Auditimit	20
2. Identifikimi i çështjes.....	20
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	20
4. Përgjegjësitë e audituesve	21
5. Kriteret e vlerësimit	21
6. Standardet e auditimit	23
7. Metodot e auditimit	24
8. Dokumentimi i auditimit.....	25
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	26
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Mat	26
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	27
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	27
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	36
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	60
2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	77
2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....	183
2.6. Auditim mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)	188
2.7. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit	190
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	191
A. MASA ORGANIZATIVE	191
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI	201
C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS	202
E. MASA DISIPLINORE	207
F. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL	210
G. MASA ADMINISTRATIVE.....	210
V. ANEKSET	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Njësinë e Auditimit të Brendshëm	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi të ardhurat	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi pasqyrat financiare	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi prokurimet publike.....	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Lejet e Ndërtimit	Error! Bookmark not defined.
Anekset mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit	Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
ShA	Shoqëri Anonime
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Mat dhe Ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Mat nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 16 Akte Konstatimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se: - Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA-së për periudhën 2022, por në dosje administrohet vetëm VKB nr. 28, datë 26.03.2021 për miratimin e tavaneve përgatitore për PBA 2022-2024, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 34, pika 6. - Për hartimin e PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mat, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, shkronja “ç”; - Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 37, pika 1; - Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit; - Nuk dokumentohet në dosje dokumenti për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm; - Pjesë e dokumentacionit të Projekt-dokumentit të PBA 2022-2024 që duhet dërguar në MFE si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet <i>output</i>, të cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar. Këto formate duhen dërguar të printuara/nënshkruara nga Kryetari i NJVQV-së dhe DEMP (sipas rastit). Konkretisht në dosje mungon Formatu B2 dhe Formatu F16, gjithashtu formatet nuk rezultojnë të printuara sikurse përcaktohet në UMF nr. 7, datë 07.26.2021. pika 24, “Formatet e kërkuara për raportim”.	<i>Pika 2.2., faqe 36-60</i>	E lartë	1. Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik të Bashkisë Mat. 2. Bashkia Mat, të marrë masa për plotësimin e raporteve të monitorimit sipas kërkesave rregullatore.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	- Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, neni 23, pika 5, në fuqi deri më datë 12.06.2020, si dhe në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 13, pika 3, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020. Për vitin 2022 nga Bashkia Mat janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit 4 mujorin e parë me nr. 2226 prot, datë 26.05.2022, raporti i monitorimit për 8 mujorin 2022 me nr. 3897 prot, datë 16.09.2022 dhe për 12 mujorin 2022 me nr. 875 prot., datë 23.02.2023. Nga auditimi rezultoi se, raportet e monitorimit janë paraqitur në Këshillin Bashkiak në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”. Në dosjet të cilat përmbajnë raportet e monitorimit mungon Aneksi nr. 3, Aneksi nr. 4 dhe Aneksi nr. 5.			
2	Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 1,944,338 lekë. Konstatohet se detyrimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2022 nuk janë pasqyruar në Raportin e Monitorimit dërguar në MFE. Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Mat ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se: - Si rrjedhojë e Vendimit nr. 545 prot., të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “R.K.” në vlerën 1,790,338 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim, ndërkohë që në fund të vitit 2021, Bashkia Mat ka pasur disponibilitete në thesar, të cilat mund t’i përdorte për likuidimin e detyrimit ndaj subjektit të mësipërm; - Si rrjedhojë e Vendimit nr. 1116 të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “Z.P.M.” në vlerën 112,000 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Bashkia Mat i detyrohet subjektit “Z.P.M.” në vlerën 112,000 lekë. Për më tepër konstatohet se, në vitin 2022 ndaj këtij subjekti nuk është kryer asnjë likuidim, ndërkohë që rezulton se, në vitin 2021 Bashkia Mat ka kryer likuidime ndaj subjekteve të tjera për detyrime të krijuara nga vendimet gjyqësore, të cilat kanë dalë më vonë	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Titullari i Bashkisë Mat, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë mënyrën dhe kronologjinë e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin gjatë zbatimit të buxhetit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	në kohë në krahasim me vendimin e gjykatës për subjektin e mësipërm, pra pa e respektuar rradhën e likuidimit sipas paraqitjes së detyrimit; - Si rrjedhojë e Vendimit nr. 631 prot., datë 04.02.2019 të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit "F.E.G." në vlerën 42,000 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 janë kryer likuidime pjesore në vlerën 300,000 lekë, ndërkohë në fund të çdo viti buxhetor siç e kemi cituar edhe më sipër Bashkia Mat ka pasur fonde në dispozicion, të cilat mund t'i përdorte për likuidimin e detyrimeve për vendimet gjyqësore.			
3	Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 132,851,614 lekë dhe janë realizuar në vlerën 118,859,136 lekë ose 89%. Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk është planifikuar arkëtim, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime. Për vitin 2022 nuk është planifikuar arkëtim nga sektori i pyjeve dhe kullotave, tarifa e shkollimit apo të ardhura nga gjobat e policisë Bashkiake. Gjithashtu, nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar. Nuk ka dokumentacion nëse Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore të ketë dërguar kërkesë për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2022. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton që metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë.	<i>Pika 2.2., faqe 36-60</i>	E lartë	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë, me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.
4	Nga auditimi, rezultoi se nga inventari i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 764,697,889 lekë, objektet nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, si më poshtë: llog 210 "Toka troje terrene", elementë në vlerën neto 28,625,929 lekë; llog. 211 "Pyje, Kullota, Plantacione", elementë në vlerën neto 10,550,203 lekë; llog. 212 "Ndërtesa e konstruksione", 103 objekte me vlerën neto 758,603,832 lekë. Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.	<i>Pika 2.3., faqe 60-77</i>	E lartë	Bashkia Mat të marrë masa të menjëhershme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në AShK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
5	Aktivet Afatgjata Financiare në fund të viteve 2021 dhe 2022 rezultojnë në vlerën 0 lekë. - Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit,	<i>Pika 2.3., faqe 60-77</i>	E lartë	Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të “K.B.” ShPK, me NUIS L28201901K, e cila është shoqëri aksionare me objekt “<i>Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit</i>”. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 100,000 lekë. - Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “T.M.” Sh.A., me NUIS M27829901G, e cila është shoqëri aksionare me objekt “<i>Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim të tregjeve me qëllim tregtimin e produkteve bujqësore ose tregjeve të kafshëve</i>”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 30,211 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 30,211,950 lekë. - Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 13.86% të aksioneve të “<i>Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër</i>” Sh.A., me NUIS M.....1L, e cila është shoqëri aksionare me objekt “<i>Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve</i>”. Numri i aksioneve është 13,860 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 1,386,000 lekë. Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “<i>Pjesëmarrje në kapitalet e veta</i>”, në kundërshtim me Urdhërin nr. 64 datë 22.07.2014 i Ministrit të Financave, “<i>Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar</i>” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “<i>Aktivët Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale</i>” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “<i>Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje</i>”. Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 31,697,950 lekë dhe investori është Bashkia Mat. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivët Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 31,697,950 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.			dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar me vlerë kontabël 31,697,950 lekë në debi të llogarisë 26 “ <i>Pjesëmarrje në kapitalin e vet</i> ” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
6	Llogaria 401-408 “<i>Furnitorë e llogari të lidhura me to</i>” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 296,286,548 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 217,797,446 lekë, e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash, etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë. Këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, por mbi bazën e	Pika 2.3., faqe 60-77	E lartë	Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndojë shpenzimet e vitit pasardhës, Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, të marrin masa të menjëhershme për pagesën e faturave të palikuiduara në vlerën

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	planifikimit të pritshmërisë së të ardhurave. Në llogarinë 401-408 “ <i>Furnitorë e llogari të lidhura me to</i> ” janë regjistruar 57 fatura tatimore me vlerë 37,289,295 lekë për të cilat u ka kaluar afati 60 ditor për t’u paguar.			totale 37,289,295 lekë, si dhe të paraqesin në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojnë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për rradhën e pagesave.
7	Nga auditimi i llogarisë 401-408 “ <i>Furnitorë dhe llogari të lidhura me to</i> ”, u konstatua Vendimi nr. 631 datë 04.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për detyrimin që Bashkia Mat ka ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit, për vlerën 5,125,862 lekë. Ky vendim gjykate i vitit 2019, është regjistruar në shumën 42,000 lekë në llogarinë 401-408, duke e nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 5,083,862 lekë.	<i>Pika 2.3., faqe 60-77</i>	E lartë	Nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës dhe të ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 401-408 “ <i>Furnitorë dhe llogari të lidhura me to</i> ”, si dhe të merren masa që Drejtoria e Financës të rakordojë çdo muaj, në mënyrë sistematike, me Drejtorinë Juridike mbi balancat e llogarisë 401-408 “ <i>Furnitorë dhe llogari të lidhura me to</i> ”, në lidhje me detyrimet që vijnë nga vendimet gjyqësore.
8	Nga auditimi i llogarisë 466 “ <i>Kreditorë për mjete në ruajtje</i> ”, u konstatua se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “ <i>Kreditorë për mjete nën ruajtje</i> ” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës. Përfundimisht për vitin 2022, Llogaria 466 “ <i>Kreditorë për mjete nën ruajtje</i> ” është mbivlerësuar për 7,426,072 lekë, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.	<i>Pika 2.3., faqe 60-77</i>	E lartë	Nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “ <i>Kreditorë për mjete në ruajtje</i> ” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
9	Nga totali prej rreth 2123 pasuri që i janë transferuar Bashkisë Mat (490), përfshirë pasuritë e paluajtshme të ish-komunave Komsj (921), Baz (185), Ulëz (427) Rukaj (45) dhe Derjan (55), vetëm 69 pasuri janë certifikuar dhe regjistruar në ASHK. Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Mat nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37 të Ligjit nr. 20/2020 “ <i>Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë</i> ”.	<i>Pika 2.3., faqe 60-77</i>	E lartë	Bashkia Mat, në bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Dega Mat, të marrë masa për përditësimin e inventarit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik të gjendjes së pronës (evidentim në terren).
10	Bashkia Mat ka në inventar 35,160.43 ha pyje/kullota dhe nuk ka miratuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore, me qëllim mbrojtjen e fondit pyjor, rritjen e të ardhurave nga pyjet dhe nxitjen e investimeve, përfshirë përfitimin e fondeve IPA. Për lëndën drusore të sekuestruar në sasinë	<i>Pika 2.3., faqe 60-77</i>	E lartë	Bashkia Mat të marrë masa që të miratojë plane mbarështimi për ekonomitë pyjore si dhe të bëjë hyrje në magazinë lëndën drusore të sekuestruar, duke dokumentuar të

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	486.78 mst, konstatohet se nuk është bërë hyrje në magazinë e materialit drusor. Nga ana e bashkisë Mat ndonëse nuk ka “fletëhyrje”, administrohen vetëm disa fatura “fletë dalje” të parregullta, dorëzuar shkollave dhe kopshteve, pa nënshkrimet e magazinierit dhe pa firmë llogaritari, për pasojë nuk ka gjurmë auditimi mbi mënyrën e shpërndarjes së lëndës drusore nëpër shkolla, kopshte apo institucione të tjera në varësi të bashkisë.			gjithë procesin e shpërndarjes nëpër shkolla, kopshte dhe institucione të tjera.
11	Në 2 raste janë lidhur kontrata qiraje me subjekte që operojnë në fushën e HEC-eve, të cilët rezultojnë debitorë dhe nuk kanë përmbushur detyrimin e rehabilitimit të sipërfaqes që është hequr nga fondi pyjor, si vijon: - Kontrata e qirasë nr. 3598 prot., datë 23.08.2022 mes Bashkisë Mat dhe qiramarrësit “A.A.” ShPK është lidhur pa kryer shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, si dhe nuk është rehabilituar sipërfaqja pyjore 0.156 ha për HEC-et “Guri i Zi”, “Daznjanë” dhe “Shell”, sipas Urdhërit të Ministrit nr. 108 datë 12.04.2018. - Kontrata e qirasë nr. 1522 prot., datë 07.04.2023 mes Bashkisë Mat dhe qiramarrësit shoqëria “D.E.” ShPK, është lidhur pa kryer shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, si dhe nuk është rehabilituar sipërfaqja pyjore 0.156 ha. Për këtë subjekt, rezulton se i është dhënë me qira nën/ngastra pyjore 48/b, e cila nuk përfshihet në raportin teknik dhe në projektin e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit në bazë të Vendimit nr. 08 datë 10.11.2017. Për të dyja praktikat e mësipërme, nuk administrohet në dosje dokumentacioni i detyrueshëm, si leja e ndërtimit, hartat topografike etj.	Pika 2.3., faqe 60-77	E lartë	Bashkia Mat, të marrë masa për të lidhur me të gjitha subjektet që operojnë në fushën e HEC-eve një marrëveshje ku të përcaktohen kostot e pyllëzimit kompensues, vlera e së cilës të përfshihet si aneks i kontratave të qirave, duke monitoruar zbatimin e tyre. Në rast të moszbatimit të këtij detyrimi, Bashkia Mat të anulojë të gjitha kontratat e qirasë për subjektet që kanë shkelur kushtet, duke njoftuar Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si agjenci përgjegjëse për monitorimin e HEC-eve.
12	Nga auditimi i 23 procedurave me fond limit 2,311,627,866 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje të LPP, legjislacionit të fushës sipas natyrës së objekteve të prokuruar dhe akteve nënligjore, si më poshtë: ➤ Për aktivitetin e vitit 2019, nga auditimi i 7 procedurave me fond limit 28,760,314 lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë: - Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit, për vlerën totale të kontraktuar 15,620,358 lekë pa TVSh; - Në 6 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 25,734,200 lekë pa TVSh; - Në 6 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 26,225,923 lekë pa TVSh; ➤ Për aktivitetin e vitit 2020, nga auditimi i 4 procedurave, me fond limit 1,952,634,844 lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:	Pika 2.4., faqe 77-184	E lartë	Kryetari i Bashkisë Mat, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që: - Në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të mirëtrajnuar, të përdoren metodat e parashikuara me akte ligjore dhe eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike dhe minimizimin e shpenzimeve të cilat nuk janë të domosdoshme. - Në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	- Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh; - Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh; ➤ Për aktivitetin e vitit 2021, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit 74,420,064 lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë: - Në 2 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 31,481,275 lekë pa TVSh; - Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 57,761,516 lekë pa TVSh; ➤ Për aktivitetin e vitit 2022, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit 255,812,996 lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë: - Në 5 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 247,627,945 lekë pa TVSh; - Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 238,711,279 lekë pa TVSh; - Në 1 procedurë, u konstatuan probleme në lidhje me marrjen e mallit në dorëzim, i cili kishte mospërputhje me ST të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, për vlerën totale të kontraktuar 4,698,000 lekë pa TVSh;			- Të gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Mat dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë. - Të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës. - Të mbahet në vëmendje zbatimi i kontratës në zbatim të kuadrit rregullator të fushës. Mallrat dhe shërbimet e lidhura me to që do të furnizohen duhet të merren në dorëzim sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
13	Në katër raste, lejet e ndërtimit janë miratuar pa administruar dokumentacionin detyrues dhe pa marrë konfirmimin nga institucionet përgjegjëse të planifikimit të territorit, si më poshtë: - Për lejen e ndërtimit me nr. 100 datë 30.04.2019 për zhvilluesin “A.S.”, për objektin me funksion thertore rezultoi se mungon leja mjedisore, kartelat e pasurisë të janë parifreskuara, për të paktën 3 muajt e fundit nga aplikimi për leje; - Për lejen e ndërtimit me nr. 150, datë 02.08.2020 për zhvilluesin “O.N.”, për objektin “Strukturë 1 kat, me destinacion thertore”, me sipërfaqe ndërtimi 463.1 m², rezultoi se gjurma e ndërtimit bie mbi një objekt ekzistues me sipërfaqe 427 m², përfutur me leje legalizimi. Në	Pika 2.5., faqe 184-188	E lartë	Bashkia Mat, sektori i urbanistikës, të marrin masa që kartelat e pasurive të paluajtshme të jenë të rifreskuara, për të paktën 3 muaj para datës së aplikimit si dhe për lejet e ndërtimit në fushën e agroturizmit, të cilat prekin objekte ekzistuese, të verifikojë në terren procesin e shembjes.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	aplikimin nr. 212 datë 22.04.2021 “Për fillimin e punimeve”, nuk administrohet akti teknik për prishjen e objektit ekzistues, veprim në kundërshtim me pikën 8 të kushteve të lejes së ndërtimit; - Për lejen e ndërtimit me nr. 202, datë 12.05.2021 në emër të zhvilluesit I.M., për objektin me sipërfaqe totale ndërtimi 1003 m² rezultoi se nuk është dhënë konfirmimi për miratimin e lejes nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Agjencisë për Eficencën e Energjisë; - Për lejen e ndërtimit me nr. 309 datë 14.09.2022 për “B.M.” me sipërfaqe 1091 m² në emër të subjektit “V.” ShPK, rezultoi se subjekti nuk ka marrë miratimin paraprak të projektidesë nga komisioni vlerësues, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin. Planvendosja e objektit bujtinë bie pjesërisht mbi gjurmën e një objekt ekzistues.			
14	Në 3 raste, për lejet e ndërtimit me sipërfaqe mbi 250 m² për subjektet “O.N.”, “I.K.” dhe “A.S.” janë lëshuar certifikatat e përdorimit në mungesë të akteve të kontrollit, veprime në kundërshtim me nenin 42 pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”. Lëshimi i certifikatave të përdorimit pa akte kontrolli sjell si pasojë mungesën e verifikimeve nëse objekti ka respektuar kushtet e lejes dhe projektin përkatës të ndërtimit.	Pika 2.5., faqe 184-188	E lartë	Bashkia Mat, sektori i urbanistikës dhe IMTV, të marrin masa për kryerjen e akteve të kontrollit periodik për lejet e ndërtimit mbi 250 m ² , si parakusht për lëshimin e certifikatës së përdorimit.
15	Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Bashkia Mat, u konstatua se formimi arsimor i një inspektori nuk është konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Konkretisht nga të dhënat e marra nga drejtoria e burimeve njerëzore, është konstatuar se z. B.F. është diplomuar në Akademinë e Sigurisë dhe Rendit Publik dhe është emëruar si inspektori i IMTV. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, neni 11. Gjithashtu, puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m², të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijojnë aktivitetin e ndërtimit në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare, të ndaluara ose të mbrojtura. Mosmbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasojat jo vetëm në mbrojtjen e territorit, por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Mosmarrja e masave nga IMTV është në kundërshtim me përcaktimet e të Ligjit	Pika 2.6., faqe 188-190	E lartë	Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masa që plotësimi i pozicioneve të punës për inspektorët e IMTV-së, të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, lidhur me arsimin përkatës. Gjithashtu, nga Bashkia Mat, të merren masa që IMTV të bashkëpunojë rregullisht me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepelqtë apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare, pyje, lumenj apo zona të mbrojtura, si dhe të marrë masa për parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe monitorimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.			
16	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit, Bashkia MAT”, me vlerë 1,242,743,699 lekë me TVSh, fituar nga BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale 41,630,011 lekë .	Pika 2.4., faqe 77-184	E lartë	Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën 41,630,011 lekë (20,046,864 + 17,553,147+ 4,030,000) nga BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 848 prot, datë 19.02.2021, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”.
17	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të KUZ blloku “Drita 1”, “Drita 2” dhe Lagjia e re, qyteti Burrel”, me vlerë 86,104,998 lekë me TVSh, fituar nga BOE C. ShPK dhe K. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale 268,920 lekë .	Pika 2.4., faqe 77-184	E lartë	Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën 268,920 lekë nga BOE C. ShPK dhe K. ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 2875 prot, datë 10.07.2020, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”. Përsa i përket zërit “Shtresë çakulli, mbeturinë kave $t = 20 \text{ cm}$, përhapur e ngjeshur me makineri”, imazhet e vëna në dispozicion duhet të saktësohen nëse janë pjesë e planimetrisë së këtij projekti.
18	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës Mustafa Gjestila, Burrel”, me vlerë 117,440,762 lekë me TVSh, fituar nga OE U. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale 280,000 lekë .	Pika 2.4., faqe 77-184	E lartë	Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën 280,000 lekë nga OE U. ShPK.
19	Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksioni i gjimnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat”, me vlerë 113,018,902 lekë me TVSh, fituar nga BOE E.S. ShPK & B.I. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale 1,077,831 lekë .	Pika 2.4., faqe 77-184	E lartë	Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën 1,077,831 lekë nga BOE E.S. ShPK & B.I. ShPK.
20	Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Mat, gjendja e bizneseve debitore gjatë vitit 2022 për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, infrastrukturës arsimore, etj., është 409 subjekte, për vlerën 46,531,158 lekë. Për debitorët, konstatohet se nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për moslikuidim të detyrimit tatimor. Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, nga bizneset, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifa Vendore, janë dërguar njoftim detyrimet për subjektet debitorë dhe më pas janë dërguar disa shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, barrë hipotekore në pasuritë e paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Sektori i të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrimit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj.), për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Kadastrës/Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, por nuk ka pasur mbulim të mjaftueshëm në krahasim me numrin e debitorëve të rezultuar brenda vitit. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2022, ka marrë masa vetëm për “Njoftim dhe kërkesë për për pagesë debie” dhe “Bllokim i llogarive bankare”. Si rezultat i masave të marra është mbledhur borxhi në vlerën 11,085,638 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestro e mallrave të debitorëve e deri në kallëzim penal.			vlerën 46,531,158 lekë.
21	Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Mat dhe NJA, gjendja e familjeve debitoare gjatë vitit 2022 për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, si dhe tarifën e infrastrukturës arsimore, është 9,719 familje. Vlera debitoare totale për taksat dhe tarifatat për familjarët është 36,597,002 lekë. Vlera debitoare e krijuar gjatë vitit 2022 për taksat dhe tarifatat për familjarët është 13,533,270 lekë. Debia progresive në fund të vitit 2022 është 50,130,272 lekë.	<i>Pika 2.2., faqe 36-60</i>	E lartë	1. Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK Sh A., Mat (në rolin e agjentit tatimor) për taksat dhe tarifatat vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e përgjegjësisë ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifatat vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave. 2. Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 50,130,272 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.
22	Vlera debitoare gjithsej për taksën e tokës bujqësore, krijuar përgjatë periudhës deri në vitin 2022 është 2,397,189 lekë. Sipërfaqja e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore, detyrë e Specialistit të Kadastrës dhe Menaxhimit të Tokës. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermere që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës	<i>Pika 2.2., faqe 36-60</i>	E lartë	Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Tokës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren. Gjithashtu të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitore në vlera të konsiderueshme debitore. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë.			arkëtimin e vlerës 2,397,189 lekë .
23	Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Mat, u konstatua se nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje, të pajisura me leje legalizimi nga ZVASHK Mat konkretisht: Vlera debitore në datën 31.12.2021 është 2,726,502 lekë, nga të cilat krijuar në vitin 2022 në vlerën prej 307,827 lekë dhe vlera progresive deri në 31.12.2022 është 3,034,329 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Për debitorët e mësipërm nuk janë marrë masat e nevojshme të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, nenet 90-91. Theksojmë se nga sektori i urbanistikës janë bërë njoftimet për pagesën e taksës, por në vijimësi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e kësaj takse.	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale, në vlerën 3,034,329 lekë .
24	Nga auditimi i tarifës së pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fondet publike rezultoi se kanë kryer punime ndërtimi të subjekteve, nga të cilat 2 subjekte nuk kanë paguar detyrimin për vitin 2022. Konkretisht subjekti E. ShPK & E. ShPK për vlerën 150,000 lekë dhe 5.K. ShPK për vlerën 82,500 lekë, nga të cilët BOE E. ShPK & E. ShPK kanë paguar detyrimin në vitin 2023. Për subjektin 5.K. nuk ka dalë asnjë njoftim vlerësimi dhe nuk ekziston dokumentacion i cili të vërteton korespondencën midis sektorit të taksave e tarifave vendore dhe zyrës juridike. Për më shumë nuk dokumentohet puna e kryer në terren, nga strukturat e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 82,500 lekë.	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Sektori i taksave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit në vlerën 82,500 lekë nga subjekti 5.K. ShPK.
25	Nga auditimi i dokumentacionit për subjektet të cilat tregtojnë karburante dhe lëndë djegëse për konsumatorët fundorë, u konstatua se: 3 subjekte të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve gjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2022, nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, konkretisht: - J., është pajisur me licencë për periudhën 31.12.2020-31.12.2021, pa rinovuar licencën për vitet në vazhdim; - P.O., është pajisur me licencë për periudhën 31.12.2019-31.12.2020, pa rinovuar licencën më tej. - M.M., nuk rezultoi të jetë pajisur me licencë. - A.A. është pajisur me licencë, por nuk ka bërë pagesën e tarifës, sipas kuadrit rregullator të fushës.	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet sektorit të licencimit dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masat e nevojshme, për identifikimin dhe pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve dhe lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, subjektet të cilat nuk janë pajisur. Gjithashtu të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve J.; P.O.; M.M. dhe A.A. të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë kryer pagesën

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Për këto subjekte nuk administrohet dosje me dokumente, si dhe për ato subjekte që administrohen dosjet përkatëse, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e tyre për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit ose në të kundërt njoftimin e Inspektoratit përkatës, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Si pasojë e situatës së sipërpërmendur rezultojnë detyrime të papaguara në vlerën 1,500,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.			për tarifën përkatëse, në vlerën 1,500,000 lekë .
26	Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri në datën 31.12.2022 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 1,693,000 lekë, nga të cilat në vitin 2022 janë vendosur 1732 gjoba në vlerën 1,025,000 lekë. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse, gjithashtu nuk janë të kontabilizuara. Nuk rezulton në asnjë rast të jetë bërë kërkesë për titull ekzekutiv, sipas përcaktimit në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.201 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4.	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Titullari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrin masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 1,693,000 lekë , si rrjedhojë e gjobave të vendosura.
27	Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit në dispozicion, kryqëzimi i të dhënave me kontratat e qerave për sipërfaqet pyjore, ekstraktet e regjistrimit të subjekteve në QKB, licencimet nga ERE për subjektet me aktivitet prodhimin dhe tregëtimin e energjisë elektrike, u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme përllogaritjet e bëra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimeve (pastrim, gjelbërim, ndriçim) për subjektet “B. V.”, “Biznes i Madh” Nga ky vlerësim u konstatua se, për vitin 2022 është përllogaritur gabim ose janë përjashtuar nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit disa subjekte, konkretisht: për taksën e ndërtesës 3 subjekte “biznes i madh”, për tarifën e shërbimit 5 subjekte “biznes i madh” dhe 4 subjekte me aktivitet HEC për tarifën e shërbimit, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 4,154,110 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacioni (kontratë qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), duke kryer verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 4,154,110 lekë .
28	Nga auditimi i bërë në bazë të analizës së riskut, grupi i auditimit konstatoi se në regjistrin e bizneseve “VIP”, subjekti A. ShPK me aktivitet përpunim mineral kromi, ishte i përjashtuar nga taksa e ndërtesës dhe e truallit. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore, marrë nga Agjensia shtetërore e kadastrës Mat, rezulton se prona me nr. pasurie 240/1, ka një sipërfaqe totale truallit 154,000 m ² dhe sipërfaqe ndërtese 14,000 m ² , pra vlera për vitet 2016- 2017 duhet ishte 1,680,000 lekë dhe për vitet 2018 dhe 2019 detyrimi për taksën e ndërtesës duhet të ishte 1,400,000 lekë, pra në total 3,080,000 lekë, me një diferencë prej 2,200,000 lekësh të	Pika 2.2., faqe 36-60	E lartë	Sektori i taksave Bashkia Mat të sqarojë situatën ndërmjet Autoritetit kontraktor në rastin e mësipërm Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe subjektit A. ShPK, pasi të sqarohet situata se kujt i takon detyrimi për taksën e ndërtesës dhe truallit, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mat të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 24,542,000 lekë .

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	llogaritur me shumë nga sektori i taksave. Ndërsa taksa e truallit është llogaritur për 57,000 m², ndërkohë që duhet të ishte llogaritur për 154,000 m², nga viti 2016-2019 duhej llogaritur në total në vlerën 7,392,000 lekë, pra në total një diferencë prej 4,485,000 lekë më pak nga llogaritja e gabuar. Përsa i përket viteve 2020-2022, nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore shoqëria A. ShPK ka marrë njoftim vlerësimi dhe fatura për arkëtim, por pa përfshirë taksat e ndërtesës dhe atë të truallit. Sipas paketave fiskale 2020, 2021 dhe 2022, ku treguesit për nivelin e taksës sipas kategorive janë të përcaktuara, konkretisht shoqëria A. bën pjesë në Biznesin “VIP”, i cili e ka të përcaktuar nivelin e taksës së ndërtesës me 170 lekë për m², për taksën e pasurisë është përcaktuar 0.15 lekë m². Nga auditimi arrihet në konkluzion se për sa na është vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe i Tarifave në Bashkinë Mat, nga strukturat përgjegjëse të bashkisë Mat nuk dokumentohet korespondenca shkresore me Ministrinë e Energjitikës dhe Infrastrukturës (MIE) ku të saqrohet e gjithë situata e sipërpërmendur. Nga shqyrtimi i dosjes, rezultoi se nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore janë dërguar njoftime për vlerësim dhe fatura për arkëtim, pa llogaritur taksën e pasurisë, e cila nuk është e argumentuar. Nga grupi i auditimit u kërkua që të vihet në dispozicion një kopje e kontratës koncensionare e lidhur ndërmjet (MIE) dhe A., kontratë e cila nuk gjendej në dosjen e subjektit, kështu që në këto kushte grupi i auditimit i referohet Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 20, neni 22, pikat 1 dhe 6, VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2022” neni 4 pika 9 “a” neni 8 pika 2. Nga mospagesa e taksës së pasurisë, është krijuar detyrimi 10,472,000 lekë, vlerë e cila i përket periudhës 2016-2019 dhe detyrimi prej 14,070,000 lekë i cili është krijuar për periudhën 2020-2022. Në total, detyrimi nga mospagesa e taksës së pasurisë për vitet 2016-2022 rezulton të jetë 24,542,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ financiar për buxhetin e bashkisë Mat.			

1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinion i Pamodifikuar (Pakualifikuar) mbi Pasqyrat Financiare, me theksim çështjeje:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të Bashkisë Mat, për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **pamodifikuar/pakualifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Mat, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2022, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Mat, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **36,466,642** lekë për shpenzimet dhe **13,223,263** lekë për të ardhurat, sipas Aneksit PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

1. Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 31,697,950 lekë;
2. Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 7,426,072 lekë për vitin 2022;
3. Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, është pasqyruar më pak për vlerën 5,083,862 lekë.

II. Opinion i Kundërt për Përputhshmërinë:

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Mat, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Mat, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2019-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në

dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Mat, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “*Baza për Opinionin*”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për përputhshmërinë.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme¹ për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000) si më poshtë:

Nga auditimi i 23 procedurave me fond limit **2,311,627,866** lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje të LPP, legjislacionit të fushës sipas natyrës së objekteve të prokurara dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

➤ **Për aktivitetin e vitit 2019**, nga auditimi i 7 procedurave me fond limit **28,760,314** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit, për vlerën totale të kontraktuar 15,620,358 lekë pa TVSh;

- Në 6 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 25,734,200 lekë pa TVSh;

- Në 6 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 26,225,923 lekë pa TVSh;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2020**, nga auditimi i 4 procedurave, me fond limit **1,952,634,844** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh;

- Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2021**, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit **74,420,064** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 2 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 31,481,275 lekë pa TVSh;

- Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 57,761,516 lekë pa TVSh;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2022**, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit **255,812,996** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 5 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 247,627,945 lekë pa TVSh;

- Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 238,711,279 lekë pa TVSh;

- Në 1 procedurë, u konstatuan probleme në lidhje me marrjen e mallit në dorëzim, i cili

¹ ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme”

kishte mospërputhje me ST të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, për vlerën totale të kontraktuar 4,698,000 lekë pa TVSh;

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të investimeve, u konstatuan punime të pakryera në vlerën **43,256,762 lekë**, si më poshtë:

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt *“Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit, Bashkia MAT”*, me vlerë 1,242,743,699 lekë me TVSh, fituar nga BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **41,630,011 lekë**;

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: *“Ndërtimi i rrjetit të KUZ blloku “Drita 1”, “Drita 2” dhe Lagjia e re, qyteti Burrel”*, me vlerë 86,104,998 lekë me TVSh, fituar nga BOE C. ShPK dhe K. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **268,920 lekë**;

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: *“Rikonstruksioni i shkollës Mustafa Gjestila, Burrel”*, me vlerë 117,440,762 lekë me TVSh, fituar nga OE U. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **280,000 lekë**;

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: *“Rikonstruksioni i gjimnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat”*, me vlerë 113,018,902 lekë me TVSh, fituar nga BOE E.S. ShPK & B.I. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **1,077,831 lekë**.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Mat, gjendja e bizneseve debitore gjatë vitit 2022 për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, infrastrukturës arsimore, etj., është **409 subjekte**, për vlerën totale **46,531,158 lekë**, për të cilët konstatohet se nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për moslikuidim të detyrimit tatimor.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Mat:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar me UMFE Nr. 5, datë 21.02.2022, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të

rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 768/1 prot., datë 13.09.2023 “Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Mat”, i ndryshuar me shkresën nr. 768/2, datë 02.11.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Mat”, nga data 13.09.2023 deri në datën 17.11.2023, u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 për auditimin financiar dhe nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2022 për auditimin e përputhshmërisë nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., Përgjegjës Grupi;
2. S.D.,
3. R.L.,
4. K.H.,
5. R.A. dhe
6. E.R., anëtarë.

1. Objekti dhe Qëllimi i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Mat, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. A.M., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. D.R., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të

brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Mat, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

5. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
- Ligjet përkatëse “Për buxhetin vjetor” dhe Aktet Normative që ndryshojnë këto ligje.
 - Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”.
 - Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;
 - VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”;
 - Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
 - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
 - UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117, “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e prokurimeve publike:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, etj.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7. Metodatat e auditimit

Auditimi i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të

tjera shtetërore.

- **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- **Intervista**

- **Raporte dhe Informacione**

- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

8. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth qëndjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Mat

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Mati kufizohet në veri me bashkinë e Mirditës, në perëndim me bashkinë e Kurbinut, në jug-perëndim me bashkinë Krujë, në jug me bashkinë Klos dhe në lindje me Bashkinë Dibër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Burrelit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27,260 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron 38,615 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 493.5 km². Në bazë të të dhënave të censurit densiteti i popullsisë është 55.23 banorë/km² ndërsa në bazë të të dhënave të regjistrat civil, densiteti është 78.24 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e re shtrihet thuajse në të njëjtin territor me krahinën etnografike të Matit dhe ka terren kodrinor dhe malor. Ajo shtrihet në të dyja krahët e lumit Mat dhe pyjet zënë pjesën më të madhe të territorit të bashkisë së re. Shfrytëzimi i pyjeve për industrinë e drurit është aktualisht i kufizuar, paasi pyjet e vjetra janë dëmtuar rëndë nga prerjet pa kriter dhe një pjesë e madhe e sipërfaqes pyjore është aktualisht në fazë rigjenerimi.

Bashkia e re ka pjesë të saj parkun rajonal natyror Ulëz si dhe dy liqenet artificiale, U. dhe Shkopeti, të ndërtuara për prodhimin e energjisë elektrike.

Relievi dhe klima mesdhetare mjaft e favorshme, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe nga dimri relativisht i butë në luginën e Matit krijojnë kushte mjaft të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, frutikulturës dhe blegtorisë, përcakton si burime kryesore gjeneruese ekonomiko-financiare, bujqësinë dhe blegtorinë.

Qyteti i Burrelit u ndërtua i lidhur me industrinë e pasurimit të kromit, e cila është aktualisht në proces për riaktivizim. Gjithsesi kjo industri nuk është në gjendje të kthehet në burim të rëndësishëm punësimi për qytetin, që aktualisht ka rreth 11 mijë banorë.²



Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative aktuale është miratuar me Urdhërin nr. 664 prot., datë 28.09.2022, me nr. 4059 Prot., datë 28.09.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Bashkisë Mat”. Struktura organizative ka në përbërje 515 punonjës, në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë, të ndarë sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës.

² Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-mat/pasaporta-e-bashkise-mat/>

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësi	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Mat	Qyteti Burrel
Baz	Fshatrat: Baz, Fushë-Baz, Rreth Baz, Karicë, Drita
Derjan	Fshatrat: Derjan, Urxallë, Barbullej, Dukagjin, Gjoçaj, Lam i Madh, Zall Gjoçaj
Rukaj	Fshatrat: Bruç, Prellë, Rremull, Rukaj, Laç, Urakë
Macukull	Fshatrat: Macukull, Dej Macukull, Shëlli, Vig, Shqefën
Komsi	Fshatrat: Komsi, Kodër Qerre, Frankth, Selixë, German, Batër e Vogël, Batër e Madhe, Midhë, Fshati Burrel, Zall-Shoshaj
Lis	Fshatrat: Lis, Vinjoll, Gjalish, Burgajet, Zenisht, Shoshaj, Mallunxë
Ulëz	Fshatrat: Qyteti Ulëz, Kokërdhok, Stojan, Madhesh, Lundre, Bushkash

Kuadri ligjor:

Bashkia Mat e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuar në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Mat është z. A.M. dhe Këshilli Bashkiak i Matit përbëhet nga 21 anëtarë, të cilët janë mandatuar në zgjedhjet e datës 28 qershor 2023.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar se si sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, të mundësojnë ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ndikimin e tyre në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësive publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Mat, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1: “Angazhimi për integritet dhe vlerat etike”.

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, nëpërmjet të cilit sigurohet vendosja e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve. Në lidhje me këtë komponent rezultoi se:

- Me Urdhërin nr. 717 datë 24.11.2016 të Kryetarit të Bashkisë Mat, “*Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Mat dhe Njësie Administrative*”, është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Mat dhe me Urdhërin nr. 728 prot., datë 16.03.2018 është miratuar Kodi i Etikës, ku përcaktohen edhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion;
- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen;
- Rregullorja e Brendshme, në nenin 78 përcakton se ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke i'u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problematikave, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën;
- Marrëdhëniet e punës vlerësohen në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore edhe për punonjësit marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kod Pune;
- Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja dhe monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, në lidhje me “*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin*”.

Në lidhje me parimin 2: “*Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje*”.

- Për vitin 2022 nuk ka plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm;
- Për vitin 2022, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 muaj, Për vitin 2022, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar periodikisht dhe janë paraqitur pranë këshillit bashkiak si dhe në MFE. Ka raportime periodike vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak;
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, bashkia merr raportime në lidhje me vendimmarrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencionit;
- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti “*Bashki të Forta*”;
- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “*Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë*”.

Struktura Organizative e Bashkisë Mat, e ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi ka pasur disa ndryshime:

- Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe planveprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse;

- Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Në përcaktimin e pozicioneve nuk ka mbivendosje. Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike, ku nga grupi i auditimit është konstatuar se, rregullorja nuk reflekton ndryshimet në strukturë/funksione që ka pësuar Bashkia Mat përgjatë periudhës 2019-2022.

Në lidhje me parimin 4: “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

- Në Bashkinë Mat nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve;

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme;

- Për Bashkinë Mat, Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, si dhe Zëvendëskryetari për dy funksione (autorizuar nga Kryetari i Bashkisë), i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë, në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave.

Në lidhje me parimin 5: “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Në rregulloren e brendshme është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollit i institucionit rezulton se, për periudhën objekt auditimi është bërë delegim për miratimin e një leje ndërtimi.

Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS):

Për vitin 2022, Bashkia Mat ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik ku Kryetar i GMS është Kryetari i Bashkisë dhe me urdhërin nr. 735 datë 19.12.2019 për periudhën 2021-2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik ku kryetar i GMS është znj. F.B. zv/Kryetare e Bashkisë. Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij;

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij komponenti, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

Në lidhje me parimin 6: *“Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”.*

- Nga Bashkia Mat përcaktohen objektiva sasiorë (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Mat nuk ka plane operationale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Mat, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 *“Për financat e njësive të vetëqeverisjes vendore”*.

Në lidhje me parimin 7: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.*

- Në Bashkinë Mat nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut për vitin 2022 (është hartuar për vitin 2023), si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut;

- Bashkia Mat administron në formatin Excel regjistrin e riskut, ku jepet informacion mbi përshkrimin e riskut, risku para kontrollit, kontrollet ekzistuese, risku pas kontrolleve ekzistuese, nevoja për kontrolle shtesë, veprimet për të adresuar riskun dhe struktura përkatëse për të ndërmarrë këto veprime.

Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe të vendosë kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar.

- Në Bashkinë Mat, Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin excel dhe jo me program kontabiliteti. Duke qenë se nuk ka një sistem për hedhjen e të dhënave, e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të programit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike dhe hartimi i pasqyrave financiare. Edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Mat për të ardhurat dhe shpenzimet si dhe me Agjentët Tatimorë.

Në lidhje me parimin 8: *“Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim”.*

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarive mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, rryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.*

- Bashkia Mat në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni apo nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për t’i paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke mos përcaktuar detyrat me personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara. Bashkia Mat nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 10: *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.*

- Në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.);
 - Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ;
 - Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet, kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të pagesave, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA;
 - Në rregulloren e brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat;
 - Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar, në bazë të së cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet, si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë të urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale, të konfirmuara nga përgjegjësit materialë. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve;
 - Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhëri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimin për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimit, procesverbalet dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe janë kryer veprimet përkatëse në kontabilitet;
 - Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e thesarit për Bashkinë Mat, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjes së Bashkisë Mat të bërë me këta agjentë si: me DRT Dibër për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, me ASHK (ose ish-ZVRPP) për taksën e kalimit të pronësisë, me D.R.SH.T Rrugor për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, UKT;
 - Bashkia Mat në bashkëpunim me Degën e Thesarit Mat, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrollin e angazhimeve, menaxhimin e investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.
- Në lidhje me parimin 11:** *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.*
- Bashkia Mat nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Në rregulloren e brendshme nuk përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterët e bashkisë;
 - Në Bashkinë Mat nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish;
 - Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Sipas strukturës organike të miratuar, Sektori i Administrimit të zyrave me një ndalesë, sistemeve dhe IT, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta

specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga sektori i auditimit të brendshëm.

Në lidhje me parimin 12: *“Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.*

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesa të funksioneve. Konkretisht, në Drejtorinë e Shërbimeve Bashkiake, ku funksioni i monitorimit të projekteve është për drejtuesin e drejtorisë, por edhe për përgjegjësën e sektorit ose specialisti i sektorit të emergjencave civile dhe pronave, ka si detyrë: *“Të drejtojë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashkinë përkatëse dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes”*, ndërkohë që specialisti është niveli më i ulët në hierarkinë e kësaj drejtorie dhe nuk mund të ketë kompetenca drejtuese/organizuese;

- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme;

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listëpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, të cilat më pas kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: *“Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.*

Bashkia Mat disponon faqen e saj zyrtare në internet, <https://bashkiamat.gov.al>, ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, plani i prokurimeve, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Në lidhje me dëgjesat publike, për vitin 2022 rezultoi se janë bërë shpallje të dëgjesave publike për paketen fiskale dhe buxhetin e vitit 2023.

Në lidhje me parimin 14: *“Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor”.*

Në lidhje me parimin 15: *“Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”.*

- Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 164 *“Marrëdhëniet me publikun”*;

- Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Mat punonjësit punojnë me sistemet informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë elektronike/verbale;

- Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion, nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti;
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme, nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore lidhet me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet të hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave, ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.
- Në Bashkinë Mat mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH;
- Në Bashkinë Mat aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe janë pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë, efektiviteti i shërbimeve publike i shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

Në lidhje me parimin 17: *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.*

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve, nuk ka raporte apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga drejtuesit e programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre;
- Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga KLSH, nuk është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Titulli i gjetjes: Mangësi në drejtim të menaxhimit të riskut dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, duke mos zbatuar plotësisht Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga pyetësi i vetëvlerësimit dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

Mjedisi i Kontrollit: Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë edhe në Rregulloren e Brendshme. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

Menaxhimi i Riskut: Në Bashkinë Mat nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut për vitin 2022 (është hartuar për vitin 2023), si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.

Bashkia Mat administron Regjistrin e Riskut në formatin Excel, ku jepet informacion mbi përshkrimin e riskut, risku para kontrolli, kontrollet ekzistuese, risku pas kontrolleve ekzistuese, nevoja për kontrolle shtesë, veprime për të adresuar riskun dhe struktura përkatëse për të ndërmarrë veprime.

Aktivitetet e Kontrollit: Bashkia Mat nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT, për pasojë mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI, e miratuar nga Kryetari si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.

Informimi dhe Komunikimi: Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë së saj.

Monitorimi: Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Audit i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Mat.

Ndikimi/Efekti: Nga Bashkia Mat nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen pesë Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke riskuar sigurinë e arritjes së objektivave të bashkisë nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

Shkak: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të re për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Mat në lidhje me objektivat dhe ndarjen e detyrave për çdo punonjës dhe drejtori. Po ashtu, të marrë masa për zbatimin e programeve elektronike të licencuara për menaxhimin e financave të bashkisë, me qëllim mbrojtjen nga ndërhyrje të paautorizuara. Në veçanti, për menaxhimin e riskut të krijohet një plan menaxhimi i posaçëm lidhur me riskun e mashtrimit.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve për krijimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, që nga periudha e krijimit ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mat me Urdhërin nr. 70 prot., datë 22.02.2016,

i përbërë nga dy Specialist dhe një Përgjegjës Sektori, ku aktualisht përgjegjës i NJAB është emëruar z. G.H., me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë, me nr. 1340 prot., datë 23.03.2021, i cili është i pajisur me certifikatën e Audituesit. Struktura e njësive AB, në formë tabelore për periudhën e audituar është paraqitur në Aneksin AB1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësive të auditimit të brendshëm.

Vlerësimi i riskut nga NJAB, është paraqitur në Aneksin AB2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me funksionimin e NJAB është konstatuar se:

- Njësia e Auditit të Brendshëm, e përbërë nga dy punonjës, është në pamundësi për të ushtruar një punë audituese me efektivitet për të mbuluar fushat me risk të lartë të aktivitetit në Bashkinë Mat, si në numër auditimesh ashtu edhe në cilësi;
- Karta e Auditimit të NJAB nuk është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Mat, në kundërshtim me nenin nr. 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, si dhe në kundërshtim me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm;
- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komiteti i Auditimit të Brendshëm”;
- Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2022-2024, por ai nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6.;
- Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2022 edhe pse janë përgatitur rregullisht, nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.2.;
- Struktura e projekt raporteve dhe e raporteve përfundimtare të auditimit për vitin 2022 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11;
- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike, nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm në kundërshtim me Ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar nuk janë çelur as elektronikisht dhe as manualisht, për t’i shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditimit të Brendshëm, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.

Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm, planet strategjike dhe vjetore janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin Publik”, sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2022, është paraqitur në Aneksin AB3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi rezultoi se:

- Për vitin 2022, Sektori i AB ka planifikuar 5 auditime dhe janë realizuar 6 auditime të plota;
- Në lidhje me auditimin e veçantë të kryer për procedurën tenderuese “*Auditimin e objektivit “Blerje kamion spërkatës (autobot) dhe miniekskavator”*”, me nr. REF-02815-08-13-2021, grupi i auditimit nuk ka verifikuar nëse operatorët ekonomikë janë të skualifikuar ose jo nga procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, OE i shpallur fitues “T.” rezulton i skualifikuar (*trajtuar më gjerësisht në pikën e auditimit të procedurave të prokurimit*);

- Në rekomandimet e dhëna nga Auditimi i Brendshëm, konstatohet se janë dhënë vetëm rekomandime për masa organizative, nuk është rekomanduar asnjë masë disiplinore ndaj personave përgjegjës për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit në subjektet e audituara, si dhe për rekomandimet që janë dhënë me shpërblim dëmi nuk është marrë asnjë masë organizative për zbatimin e tyre, gjë që bie në kundërshtim me nenin 16, germa “e” të Ligjit nr. 114/2015, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

- Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditimit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Kjo ka sjellë që titullari i njësisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera, në kundërshtim me neni 6 germa “ç” e Ligjit nr. 114/2015, “*Për Auditimin e Brendshëm Publik*”.

Titulli i gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm Publik.

Situata: Njësia e Auditimit të Brendshëm, e përbërë nga dy punonjës, është në pamundësi për të ushtruar një punë audituese me efektivitet për të mbuluar fushat me risk të lartë të aktivitetit në Bashkinë Mat. Disa nga subjektet e audituara, pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna, nuk kanë paraqitur Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, nuk ka kryer sigurimin e cilësisë së punës. Në lidhje me auditimin e veçantë të kryer për procedurën tenderuese “*Auditimi i objektit “Blerje kamion spërkatës (autobot) dhe miniekskavator”*”, grupi i auditimit nuk ka verifikuar nëse operatorët ekonomikë janë të skualifikuar ose jo nga procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, OE i shpallur fitues “T.” rezulton i skualifikuar (trajtuar më gjerësisht në pikën e auditimit të procedurave të prokurimit).

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 4, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”; Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “*Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”, Kapitulli IV, pika 4.1.1. “*Planifikimi i një angazhimi auditimi*”, Kapitulli IV, pika 4.1.12., Hapi 11, Kapitulli VII, pika 7.1.1 “*Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet vetë nga NjAB*”.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Mospërmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për të plotësuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm me një numër punonjësish të mjaftueshëm për rritjen e numrit dhe cilësisë së auditimit. Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm të hartojë një regjistër të veçantë për operatorët ekonomikë të skualifikuar, duke rakorduar me të dhënat e Agjencisë së Prokurimit Publik.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore*”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në

vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).

Nga auditimi i procedurave të PBA-së për vitin 2022-2024 u konstatua se përgjithësisht janë realizuar fazat e përgatitjes buxhetore.

PBA për periudhën 2022-2024 është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendimin nr. 128 datë 17.12.2021 "*Për miratimin e Buxhetit Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024*", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1198/1, datë 22.12.2021.

Si fusha me prioritet për investime në bashkinë Mat janë konsideruar: Infrastruktura rrugore; Urbanistika; Furnizimi me ujë të pijshëm; Ujitja dhe Kullimi; Shërbimi zjarrfikës dhe Konviktet.

Financimi i buxhetit të Bashkisë Mat për vitin 2022, është realizuar nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen; Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitet 2022-2024, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor janë paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, referuar të cilit, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2022-2024, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se, ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Mat nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës), ka programe si, aparati, menaxhimi i mbetjeve, ndërmarrja e shërbimeve bashkiake, shërbimi zjarrfikës, për të cilat Bashkia Mat gjatë vitit buxhetor nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Këto diferenca në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë pasaktësi në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA krahasuar me planin e buxhetit vjetor.

Titulli i Gjetjes: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024.

Situata: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA-së për periudhën 2022, por në dosje administrohet vetëm VKB nr. 28, datë 26.03.2021 për miratimin e tavanëve përgatitore për PBA 2022-2024, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë në Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*", neni 34, pika 6.

- Për hartimin e PBA 2022-2024 janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mat, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*", neni 5, shkronja "ç";

- Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e Vetëqeverisjes Vendore*", neni 37, pika 1;

- Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

- Nuk dokumentohet në dosje dokumenti për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm;

- Pjesë e dokumentacionit të Projekt-dokumentit të PBA 2022-2024 që duhet dërguar në MFE si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet *output*, të cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar. Këto formate duhen dërguar të printuara/nënshkruara nga Kryetari i NJVQV-së dhe DEMP (sipas rastit). Konkretisht në dosje mungon Formatu B2 dhe Formatu F16, gjithashtu formatet nuk rezultojnë të printuara sikurse përcaktohet në UMF nr. 7, datë 07.26.2021. pika 24, "*Formatet e kërkuara për raportim*".

- Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, neni 23, pika 5, në fuqi deri më datë 12.06.2020, si dhe në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 13, pika 3, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 10, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, skronja “ç”; neni 33, pika 1, neni 34, pika 6, neni 35, pika 1, neni 37, pika 1, neni 39, pika 2 dhe neni 41, pika 3; Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, neni 23, pika 5 dhe Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020, neni 13, pika 3; Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore”, pika 29 dhe pika 38, shkronjat “a-h”.

Ndikimi/Efekti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerja e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Mat.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik të Bashkisë Mat.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe për shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me VKB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mat dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e

buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për periudhën 2022-2024, rezultoi se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Mat ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Dibër.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Mat dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e Bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Mat janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Mat, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Buxheti vjetor 2022 i Bashkisë Mat është miratuar me VKB nr. 130 prot., datë 27.12.2021 në vlerën 482,346 mijë lekë. Fondet që trashëgohen nga viti 2021 për t'u përdorur në vitin 2022 janë miratuar me VKB nr. 13 prot., datë 21.02.2022 ku përfshihen fondet nga Transferta e pakushtëzuar, transferta sektoriale, të ardhurat vendore si dhe një fond nga ambasada japoneze në shumën 9,918 mijë lekë për blerje makineri për menaxhimin e mbetjeve, ku shuma totale e fondeve që trashëgohen kap vlerën 59,508 mijë lekë.

Përsa i përket ndryshimeve në buxhet, rezultojnë si më poshtë:

- VKB nr. 12 prot., datë 21.02.2022, për një shtesë në buxhet në zërin investime në shumën 9,696 mijë lekë për objektin *“Rikonstruktion Qendra Shëndetësore në Bashkinë Mat”*, projekt i financuar nga H.A.P.;
- VKB nr. 36 prot., datë 21.02.2022, për një shtesë në buxhet në zërin investime në shumën 3,622 mijë lekë dhe shpenzime operative në shumën 584 mijë lekë, fonde të ardhura nga Këshilli i Qarkut Dibër për objektin *“Rikonstruktion rruga dhe sheshi i varrezave të dëshmorëve”*, në shumën 2,250 mijë lekë dhe fonde të trashëguara nga viti 2021 në shumën 1,956 mijë lekë;
- VKB nr. 47 prot., datë 26.04.2022, për një ndryshim në buxhet duke pakësuar fondin rezervë dhe duke shtuar shpenzimet operative në shumën 350 mijë lekë;
- VKB nr. 55 prot., datë 30.05.2022, për një ndryshim në buxhet duke pakësuar fondin e emergjencës dhe duke shtuar shpenzimet për investime në shumën 494 mijë lekë;
- VKB nr. 59 prot., datë 10.06.2022, për një ndryshim në buxhet duke pakësuar fondin rezervë dhe duke shtuar shpenzimet operative në shumën 120 mijë lekë;
- VKB nr. 71 prot., datë 27.07.2022, për një ndryshim në buxhet duke pakësuar fondin e kontigjencës dhe duke shtuar shpenzimet për investime në shumën 2,041 mijë lekë;
- VKB nr. 81 prot., datë 30.08.2022, për një ndryshim në buxhet duke pakësuar fondin rezervë dhe duke shtuar shpenzimet operative në shumën 120 mijë lekë;
- VKB nr. 83 prot., datë 30.08.2022, për një shtesë në buxhet për objektin *“Rikonstruktion Pallati i kulturës Shefqet Doda Burrel”*, projekt i ICTE Mat, në shumën 19,771 mijë lekë për Investime dhe 3,494 mijë lekë për shpenzime operative;
- VKB nr. 84 prot., datë 27.09.2022, për një shtesë në buxhet për paga me burim financimi transfertën sektoriale, për përballimin e rritjes së pagave në arsimin e mesëm dhe 9 vjeçar, në shumën 1,237 mijë lekë;
- VKB nr. 85 prot., datë 27.09.2022, për një ndryshim në buxhet në shumën 7,475 mijë lekë;

- VKB nr. 112 prot., datë 25.11.2022, për një shtesë në buxhet për blerje makineri, financim i ambasadës zvicerane në shumën 11,781 mijë lekë;
- VKB nr. 131 prot., datë 22.12.2022 për një shtesë në buxhet akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në shumën 10,000 mijë lekë dhe 1,480 mijë lekë për shpërblime në fund të viti.

Duke iu referuar të dhënave të pasqyruara në Anekset B2 dhe B3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki+Njësi Varësie për vitin 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 60,3517 mijë lekë. Gjithashtu, në Anekset B2 dhe B3 janë të pasqyruara edhe ndryshimet në buxhet sipas VKB-ve përkatëse.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mat, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull, sipas klasifikimit ekonomik. Gjatë gjithë periudhës së audituar, në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mat, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2022-2024, referuar akt-rekomandimeve me thesarin është paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku rezulton se për vitin 2022, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomikë është 95%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “*Transferta për buxhete familjarë dhe individë*”, duke vijuar me shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, kapitale të trupëzuara, mallra dhe shpenzime si dhe realizimin më të ulët e kanë Transfertat korrente të brendshme. Vihet re se për vitin 2022, artikulli 602 “*Transferta korrente të brendshme*” paraqitet 77%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomikë, ka realizimin më të ulët.

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit është paraqitur në Aneksin B5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku rezulton se fondet e shpenzuara nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara, në vlerën 375, 072 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Mat, ndjekur nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 231,639 mijë lekë dhe transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 194,052 mijë lekë.

➤ Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara:

Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2022, është realizuar në vlerën 375,072 mijë lekë ose 23.4% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës së kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë transfertat për familje dhe individë, pagat dhe fondet e shpenzuara për transferime korrente të brendshme.

➤ Transferta e kushtëzuar për Investime:

Buxheti nga transfertat e kushtëzuar për investime për vitin 2022, është realizuar në vlerën 710,799 mijë lekë ose 44.5% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022.

➤ Transferta e pakushtëzuar:

Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2022, është realizuar në vlerën 231,639 mijë lekë ose 14.5% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

➤ Të ardhurat e veta:

Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022, është realizuar në vlerën 177,828 mijë lekë ose 11% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative.

➤ Transferta e kushtëzuar specifike:

Buxheti nga transferata specifike për vitin 2022, është realizuar në vlerën 194,052 mijë lekë ose 12% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transferatës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore.

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:

Në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar fondi rezervë dhe i kontigjencës në shumën 5,000 mijë lekë, i cili është përdorur me Vendime të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

➤ Fondi Rezervë:

- VKB nr. 47 prot., datë 26.04.2022, shpenzime për pritje e përcjellje në shumën 350 mijë lekë;
- VKB nr. 59 prot., datë 10.06.2022, shpenzime për ndihma financiare për persona me probleme të rënda shëndetësore dhe vështirësi financiare, në shumën 120 mijë lekë;
- VKB nr. 66 prot., për pagesën e shpenzimeve të Vlerësuesit të aseteve të Klubit të Futbollit Burreli, në shumën 1,000 mijë lekë;
- VKB nr. 81 prot., datë 30.08.2022, shpenzime për ndihma financiare për persona me probleme të rënda shëndetësore dhe vështirësi financiare, në shumën 120 mijë lekë;
- VKB nr. 85 prot., datë 27.09.2022, shpenzime për Investime për Supervizim të Objektit “Rikonstruksion i shkollës Mustafa Gjestila” në shumën 410 mijë lekë.

➤ Fondi i kontigjencës:

- VKB nr. 71 prot., datë 27.07.2022, shpenzime për Investime për objektin “Rikonstruksion i shkollës Mustafa Gjestila”, në shumën 2,041 mijë lekë, bashkëfinancim i bashkisë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve;
- VKB nr. 85 prot., datë 27.09.2022, shpenzime për paga punonjësish, në shumën 900 mijë lekë për efekt të mosrealizimit të të ardhurave.

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:

- VKB nr. 15 datë 21.02.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 266 prot., datë 11.03.2022, në shumën 300 mijë lekë;
- VKB nr. 16 datë 21.02.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 267 prot., datë 11.03.2022, në shumën 300 mijë lekë;
- VKB nr. 38 prot., datë 29.03.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 430 prot., datë 12.04.2022, në shumën 100 mijë lekë;
- VKB nr. 59 prot., datë 10.06.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 725 prot., datë 27.06.2022, në shumën 120 mijë lekë;
- VKB nr. 69 prot., datë 08.07.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 939 prot., datë 15.08.2022, në shumën 300 mijë lekë;
- VKB nr. 79 prot., datë 30.08.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1035 prot., datë 22.09.2022, në shumën 200 mijë lekë;
- VKB nr. 81 prot., datë 31.08.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1036 prot., datë 22.09.2022 në shumën 120 mijë lekë;

- VKB nr. 85 prot., datë 27.09.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1120 prot., datë 12.10.2022 në shumën 80 mijë lekë;

- VKB nr. 149 prot., datë 22.12.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1570 prot., datë 30.12.2022 në shumën 200 mijë lekë.

Sa më sipër janë paguar nga fondi i emergjencave civile me grup 00 i Bashkisë, ndërsa më poshtë janë listuar pagesat e kryera me fondin e ardhur nga Ministria e Mbrojtjes për Emergjencat Civile .

- VKB nr. 96 prot., datë 27.10.2022, shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1332 prot., datë 01.12.2022 në shumën 300 mijë lekë;

- VKB nr. 97 prot., datë 27.10.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1333 prot., datë 01.12.2022 në shumën 300 mijë lekë;

- VKB nr. 98 prot., datë 27.10.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1334 prot., datë 01.12.2022 në shumën 7.5 mijë lekë;

- VKB nr. 99 prot., datë 27.10.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 133 prot., 1 datë 01.12.2022 në shumën 110.2 mijë lekë;

- VKB nr. 100 prot., datë 27.10.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1435 prot., datë 12.12.2022 në shumën 110.3 mijë lekë;

- VKB nr 101 prot., datë 27.10.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1434 datë 12.12.2022 në shumën 537.6 mijë lekë;

- VKB nr. 126 prot., datë 25.11.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1567 prot., datë 29.12.2022 në shumën 374.2 mijë lekë;

- VKB nr. 127 prot., datë 25.11.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1569 datë 29.12.2022 në shumën 936 mijë lekë;

- VKB nr. 148 prot., datë 22.12.2022 shpenzime për situata të vështira dhe fatkeqësi, ndihma financiare për familjet në nevojë, Urdhër shpenzimi nr. 1568 prot., datë 29.12.2022 në shumën 200 mijë lekë;

Shuma totale 2875.8 mijë lekë.

➤ Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Mat:

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Mat gjatë periudhës 2022 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ Realizimi i Investimeve:

Grupi i KLSH konstatoi se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara gjatë vitit 2022 paraqitet jo i mirë, konkretisht në masën 95%. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mat në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5, shkronja “a” dhe në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47.

Titulli i Gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga strukturat e Bashkisë Mat, rezultoi se për vitin 2022 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomikë është 95%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “*Transferta për buxhetet familjare dhe individë*”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, kapitale të trupëzuara, mallra dhe shpenzime si dhe realizimin më të ulët e kanë Transfertat korrente të brendshme. Vihet re se për vitin 2022, artikulli 602 “*Transferta korrente të brendshme*” paraqitet 77%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomikë, ka realizimin më të ulët. Niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara në vitin 2022 paraqitet jo i mirë, konkretisht në masën 95%. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Mat në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 5, shkronja “a” dhe në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 47.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 10, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 5, shkronja “a” dhe Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 47.

Ndikimi/Efekti: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Shkak: Mosrealizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrin masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

➤ Raportet e Monitorimit:

Titulli i Gjetjes: Raportet e monitorimit nuk janë të plota, pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018.

Situata: Për vitin 2022 nga Bashkia Mat janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit 4 mujorin e parë me nr. 2226 prot, datë 26.05.2022, raporti i monitorimit për 8 mujorin 2022 me nr. 3897 prot, datë 16.09.2022 dhe për 12 mujorin 2022 me nr. 875 prot., datë 23.02.2023. Nga auditimi rezultoi se, raportet e monitorimit janë paraqitur në Këshillin Bashkiak në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 “*Përmbajtja e raportit të monitorimit*” dhe Shtojcës 5 “*Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë*”, të UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*”. Në dosjet të cilat përmbajnë raportet e monitorimit mungon Aneksi nr. 3, Aneksi nr. 4 dhe Aneksi nr. 5.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*”, neni 48 dhe UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*”, pikat 10, 48 dhe 59.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 10, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, pikat 10, 48 dhe 59.

Ndikimi/Efekti: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Mat, të marrë masat që Raportet e monitorimit të plotësohen sipas Kuadrit rregullator të fushës, ku të jenë të pasqyruar Raporti i shpenzimeve sipas programeve, Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetorë, Raporti i realizimit të produkteve të programit, Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Mat, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2022 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik i tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2022, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale. Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 ka ardhur duke u rritur. Në Aneksin B6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit gjatë vitit 2022. Vlera në Aneksin B6 është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Mat ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

Nga auditimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr. 872 prot., datë 23.02.2023, rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mat ndaj palëve të treta raportuar në MFE është 20,575,921 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale, pasqyruar në Aneksin B7 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr. 486 në debi të llogarisë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2022”.

Sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 3.65% ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2022, ç’ka do të thotë se Bashkia Mat në fund të vitit 2022 rezulton në një situatë normale.

➤ Detyrimet nga vendimet gjyqësore:

Titulli i gjetjes: Likuidimi i detyrimeve si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 1,944,338 lekë. Konstatohet se detyrimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2022 nuk janë pasqyruar në Raportin e Monitorimit dërguar në MFE.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Mat ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se:

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 545 prot., të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “R.K.” në vlerën 1,790,338 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim, ndërkohë që në fund të vitit 2021, Bashkia Mat ka pasur disponibilitete në thesar, të cilat mund t’i përdorte për likuidimin e detyrimit ndaj subjektit të mësipërm;

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 1116 të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “Z.P.M.” në vlerën 112,000 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Bashkia Mat i detyrohet subjektit “Z.P.M.” në vlerën 112,000 lekë. Për më tepër konstatohet se, në vitin 2022 ndaj këtij subjekti nuk është kryer asnjë likuidim, ndërkohë që rezulton se, në vitin 2021 Bashkia Mat ka kryer likuidime ndaj subjekteve të tjera për detyrime të krijuara nga vendimet gjyqësore, të cilat kanë dalë më vonë në kohë në krahasim me vendimin e gjykatës për subjektin e mësipërm, pra pa e respektuar rradhën e likuidimit sipas paraqitjes së detyrimit;

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 631 prot., datë 04.02.2019 të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “F.E.G.” në vlerën 42,000 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 janë kryer likuidime pjesore në vlerën 300,000 lekë, ndërkohë në fund të çdo viti buxhetor siç e kemi cituar edhe më sipër Bashkia Mat ka pasur fonde në dispozicion, të cilat mund t’i përdorte për likuidimin e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pikat 8 dhe 60, UMF nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 10, datë 17.11.2023

Kriteri: UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pikat 8 dhe 60, UMF nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Mat.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës, mosplanifikimi në buxhet i likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mat, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë mënyrën dhe kronologjinë e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin gjatë zbatimit të buxhetit.

➤ Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor:

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Mat, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2022, ky afat

nuk është respektuar në 265 raste për vlerën 369,162,465 lekë, pasqyruar në Aneksat B8-B12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për llogarinë 602 kanë qenë 234 fatura për vlerën 46,219,909 lekë dhe për llogaritë 230-231 kanë qenë 31 fatura në vlerën 322,942,556 lekë.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk është respektuar rradha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë të likuidohet më parë, ilustruar me disa raste.

➤ Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

- Për detyrimin blerje materiale ndërtimi me fature tatimore nr. 65 prot., datë 25.11.2021 me Urdhër shpenzimin nr. 162 prot., datë 18.02.2022 ndërkohë që janë kryer likuidime përpara kësaj date për detyrime të krijuara në vitin 2020 pra shumë kohë më pas;

- Pagar Riparim kaldaja shkolla Derjan për OE E.E. në muajin Mars me faturën tatimore nr. 34, datë 15.02.2020 me urdhër shpenzimin nr. 280 prot., datë 15.03.2022 dhe Riparim ekskavatori për OE T. ShPK me faturën tatimore nr. 1113 prot., datë 15.09.2020 me Urdhër shpenzimin nr. 281 prot., datë 17.03.2022;

- Pagar Shërbime pjesë këmbimi OE "I.M." në muajin mars me faturë tatimore nr. 63 prot., datë 01.11.2021 me Urdhër shpenzimin nr. 265 prot., datë 15.03.2022. Ndërkohë paguar për shërbimin faturë e vitit 2020, "Riparim ekskavatori" në muajin prill për OE "T." ShPK me faturën tatimore nr. 1112 prot., datë 15.09.2020 me Urdhër shpenzimin nr. 474 prot., datë 26.04.2022;

- Pagar për detyrimin Rikualifikim sheshi Urban Lis & Komsj për OE 2. në muajin maj me faturë tatimore nr. 8 prot., datë 19.01.2022 me Urdhër shpenzimin nr. 552 prot., datë 12.05.2022. Ndërkohë paguar Shërbimi i pastrimit për OE A.G., faturë e cila i përket viti 2020 paguar në muajin qershor me faturën tatimore nr. 46 prot., datë 03.11.2020 me Urdhër shpenzimin nr. 717 prot., datë 24.06.2022;

- Pagar për detyrimin "Mirëmbajtje varrezash" për OE "M.M." në muajin korrik me faturë tatimore nr. 1 prot., datë 31.01.2022, me Urdhër shpenzimin nr. 822 prot., datë 08.07.2022 dhe faturë tatimore nr. 2 prot., datë 28.02.2022 me urdhër shpenzimin nr. 822 prot., datë 08.07.2022. Ndërkohë paguar për detyrimin "Shërbimi i pastrimit" për OE "A.G." faturë e vitit 2021, paguar në muajin tetor me faturën tatimore nr. 79 prot., datë 09.08.2021 me Urdhër shpenzimin nr. 1171 prot., datë 31.10.2022;

Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për vitin 2022, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Mat ka marrë 13 financime projektsh nga FSHZH/FZHR, të cilat janë paraqitur në Aneksin AB13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Sa i përket fondeve të alokuara nga Ministritë e Linjës Fonde të deleguara për vitin 2022 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2020, kanë vazhduar në vitin 2021 dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2022 ose janë në proces gjatë vitit 2022, rezulton se janë financuar 13 projekte investimi me vlerë kontrate 2,617,143,406 lekë, nga të cilat është likuiduar vlera prej 710,798,274.

- Për vitin 2020, Bashkia Mat ka lidhur kontratë për objektet "Mbikëqyrje ujësjellësi, ndërtim ujësjellësi Derjan, mbikëqyrje dhe rehabilitim i KUZ" në vlerën 761,504,037 lekë, nga të cilat për vitin 2020 janë likuiduar 279,047,824 lekë;

- Për vitin 2021, Bashkia Mat ka lidhur kontratë për objektet "Ndërtim Ujësjellësi Derjan Rukaj Loti II, Ujësjellësi Burrel faza I&II, Mbikëqyrje Ujësjellësi Derjan Rukaj loti II, Mbikëqyrje

Ujësja Burrel faza I faza II”, në vlerën 1,592,154,305 lekë, nga të cilat është likuiduar vlera prej 386,728,251 lekë;

- Për vitin 2022, Bashkia Mat ka lidhur kontratë për objektet “*Rikonstruktion shkolla Mustafa Gjestila, Rikonstruktion shkolla 28 Nëntori, Kolaudim Rehabilitim KUZ, Blerje Objekti Hotel Uzinës, Rikonstruktion i Godinave te NJVV*”, në vlerën 263,487,086 lekë, nga të cilat është likuiduar vlera prej 83,890,319 lekë;

- Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mosalokimit të fondeve nga ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Mat nga mosrealizmi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore;

- Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Mat dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Mat, z. A.M., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. D.R. me funksion ish Drejtor Ekonomik, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

2.2.6. *Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.*

➤ Struktura e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore:

Për vitin 2022, pranë Bashkisë Mat është krijuar dhe ka funksionuar Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si një nga strukturat kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Mat nga taksat dhe tarifatat. Ky sektor në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara. Ky sektor përgjatë periudhës 2022 ka pësuar 3 ndryshime në numër punonjësish dhe strukturë. Informacioni për punonjësit e sektorit të mësipërm, si dhe lëvizjet e tyre në detyrë janë paraqitur në Aneksin A1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Sektori i Taksave dhe i tarifave Bashkia Mat, për vitin 2022 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Mat nga taksat dhe tarifatat.

Veç Sektorit të taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Mat janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, të cilat janë paraqitur në Aneksin A2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifatat vendore, si dhe numri i tyre janë paraqitur në Aneksin A3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Veç taksave dhe tarifave të specifikuar në Aneksin 2A2 dhe A3, Bashkia Mat ka planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga disa lloje burimesh të ndryshme, si gjopa nga inspektorati i mbrojtjes së territorit, policia bashkiake, qira tokë bujqësore, pyjore, truall, ndërtesë, tregu industrial, lënda drusore etj., planifikimi dhe realizimi i të cilave është paraqitur në Aneksin A4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 132,851,614 lekë dhe janë realizuar në vlerën 118,859,136 lekë ose 89%.

Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk planifikohet vlerë për t'u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Për vitin 2022 nuk është planifikuar arkëtimi lidhur me sektorin e pyjeve dhe kullotave, tarifa e shkollimit apo të ardhura nga gjobat e policisë Bashkiake.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar. Nuk ka dokumentacion nëse Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore të ketë dërguar kërkesë për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2022.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 113, datë 06.12.2021 “*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mat*”, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”. Në kundërshtim me rregulloren e brendshme neni 90 pika e) “*Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit*”.

Evidenca e bizneseve për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Përsa i përket gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2022 rezultoi se:

Gjendja në fillim të vitit ka qenë 753 subjekte, ndërsa regjistrime të reja ka patur për 70 subjekte, aktivitete të mbyllura 71 subjekte dhe gjendja në fund të periudhës së vitit 2022 rezulton në një numër prej 752 subjektësh.

Titulli i gjetjes: Mangësi në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave.

Situata: Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 132,851,614 lekë dhe janë realizuar në vlerën 118,859,136 lekë ose 89%. Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk është planifikuar arkëtim, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Për vitin 2022 nuk është planifikuar arkëtim nga sektori i pyjeve dhe kullotave, tarifa e shkollimit apo të ardhura nga gjobat e policisë Bashkiake.

Gjithashtu, nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar. Nuk ka dokumentacion nëse Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore të ketë dërguar kërkesë për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2022.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton që metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 113, datë 06.12.2021 “*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mat*, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022” dhe me Rregulloren e brendshme neni 90 pika e) “*Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit*”.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mat*, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022” dhe me Rregulloren e brendshme neni 90 pika e) “*Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit*”.

Ndikimi/Efekti: Mosplanifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë, me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi z. E.B. me detyrë ish Përgjegjës i Taksave dhe i Tarifave Vendore për periudhën 22.11.2019-21.01.2022 dhe z. D.R. me detyrë drejtor Ekonomik, Përgjegjës për Sektorin e Taksave nga data 21.01.2022-31.12.2022.

Debitorët sipas kategorive:

➤ Biznesi dhe Institucionet:

Titulli i gjetjes: Debitorët “biznes” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifavat vendore, si dhe masat shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Situata: Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Mat dhe NJA, gjendja e bizneseve debitore gjatë vitit 2022 për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, infrastrukturës arsimore, etj., është 409 subjekte, për vlerën 46,531,158 lekë, si më poshtë:

7 subjekte “Biznesi VIP”, debitor në vlerën	8,159,543 lekë
39 subjekte “Biznesi i Madh”, në vlerën	16,727,915 lekë
289 subjekte “Biznesi i Vogël”, në vlerën	17,497,320 lekë
10 subjekte “Lojra Fati” në vlerën	5,000 lekë
1 subjekt “Kompani sigurimesh”, në vlerën	5,000 lekë
37 subjekte “Tregtar Ambulant”, në vlerën	1,302,865lekë
26 subjekte “Institucione”, në vlerën	2,116,600 lekë

Në mënyrë tabelore, debitorët janë paraqitur në Aneksin A6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për debitorët e mësipërm, konstatohet se nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për moslikuidim të detyrimit tatimor.

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore, nga bizneset, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifa Vendore, janë dërguar njoftim detyrimet për subjektet debitorë dhe më pas janë dërguar disa shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, barrë hipotekore në pasuritë e paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës/Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, por nuk ka pasur mbulim të mjaftueshëm në krahasim me numrin e debitorëve të rezultuar brenda vitit. Masat shtrënguese janë paraqitur në Aneksin A7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku rezulton se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2022, ka marrë masa vetëm për “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Bllokim i llogarive bankare”. Si rezultat i masave të marra është mbledhur borxhi në vlerën 11,085,638 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestro e mallrave të debitorëve e deri në kallëzim penal.

Sa më sipër, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, nenet 76 dhe 114; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, pikat 1 dhe 2, neni 9, pikat 1 dhe 2, neni 20, pika 1, neni 22, neni 22/5, neni 24, neni 27, pika 3, shkronja “c”, neni 34 dhe neni 35; Ligjin nr.

139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1/1.3, neni 27, pika 1, neni 35, pika 2 dhe neni 64; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, shkronja “a”, neni 7, pika 2, neni 12, pika 1, neni 14, neni 40 dhe neni 42, pika 2; VKB nr. 113, datë 06.12.2021.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, nenet 76 dhe 114; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, pikat 1 dhe 2, neni 9, pikat 1 dhe 2, neni 20, pika 1, neni 22, neni 22/5, neni 24, neni 27, pika 3, shkronja “c”, neni 34 dhe neni 35; Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1/1.3, neni 27, pika 1, neni 35, pika 2 dhe neni 64; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, shkronja “a”, neni 7, pika 2, neni 12, pika 1, neni 14, neni 40 dhe neni 42, pika 2; VKB nr. 113, datë 06.12.2021.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 46,531,158 lekë.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës, si dhe nivel i ulët i ndërgjegjësimit të bizneseve për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj.), për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 46,531,158 lekë.

Titulli i gjetjes: Debitorët “familjarë”, të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, si dhe puna e pamjaftueshme e agjentit tatimor UK Sha Mat.

Situata: Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Mat dhe NJA, gjendja e familjeve debitoare gjatë vitit 2022 për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, si dhe tarifën e infrastrukturës arsimore, është 9,719 familje, si më poshtë:

9,719 familje nga 4218 gjithsej të taksuara për Qytetin e Burrelit, ose 80% e tyre rezultojnë debitoare në një ose disa taksa/tarifa ose ndryshe vetëm 20% e familjeve i kanë likuiduar plotësisht detyrimet për taksat/tarifatat vendore;

904 familje nga 960 gjithsej të taksuara për NJA Derjan-Macukull, ose 94% e tyre rezultojnë debitoare në një ose disa taksa/tarifa;

500 familje nga 517 gjithsej të taksuara për NJA Ulëz, ose 96% e tyre rezultojnë debitoare në një ose disa taksa/tarifa.

925 familje nga 918 gjithsej të taksuara për NJA Rukaj, ose 99% e tyre rezultojnë debitoare në një ose disa taksa/tarifa;

1,149 familje nga 1,244 gjithsej të taksuara për NJA Lis, ose 92% e tyre rezultojnë debitoare në një ose disa taksa/tarifa;

1,255 familje nga 1,346 gjithsej të taksuara për NJA Koms, ose 93 % e tyre rezultojnë debitoare në një ose disa taksa/tarifa;

768 familje nga 859 gjithsej të taksuara për NJA Baz, ose 89% e tyre rezultojnë debitoare në një ose disa taksa/tarifa.

Numri i familjeve debitoare është paraqitur në Aneksin A8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit. Vlera e debisë nga familjet debitoare, është paraqitur në Aneksin A9 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, nga ku konstatohet se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA, vlera debitoare për taksat dhe tarifatat për familjarët është 36,597,002 lekë. Vlera

debitore e krijuar gjatë vitit 2022 për taksat dhe tarifat për familjarët është 13,533,270 lekë. Debia progresive në fund të vitit 2022 është 50,130,272 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB nr. 113, datë 06.12.2021 nenet 17, 19.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: VKB nr. 113, datë 06.12.2021 nenet 17, 19.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 50,130,272 lekë.

Shkak: Nga UK sha Mat nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore, si dhe nga Bashkia Mat nuk është marrë masë për gjobitjen në masën 50% të vlerës së pa arkëtuar të agjentit tatimor UK ShA.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK Sh A., Mat (në rolin e agjentit tatimor) për taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e përgjegjësisë ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

Rekomandimi 2: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 50,130,272 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.

➤ Familje debitore për taksën e tokës bujqësore:

Në mënyrë tabelore, vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është paraqitur në Aneksin A10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimit të taksës së tokës bujqësore.

Situata: Vlera debitore gjithsej për taksën e tokës bujqësore, krijuar përgjatë periudhës deri në vitin 2022 është 2,397,189 lekë. Sipërfaqja e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore, detyrë e Specialistit të Kadastrës dhe Menaxhimit të Tokës. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermere që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitore në vlera të konsiderueshme debitore. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë. Sa më sipër, janë veprime në kundërshtim me VKB nr. 113, datë 06.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, neni 7.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: VKB nr. 113, datë 06.12.2021, neni 7 . Për miratimin e paketës fiskale 2022.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 2,397,189 lekë.

Shkak: Keqmenaxhim dhe mos marrja e masave për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Tokës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit

të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren. Gjithashtu të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 2,397,189 lekë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi z. E.B. me detyrë ish Përgjegjës i Taksave dhe i Tarifave Vendore për periudhën 22.11.2019-21.01.2022, z. A.H., me detyrë përgjegjës në sektorin e tokës bujqësore dhe z. D.R. me detyrë drejtor Ekonomik, Përgjegjës për Sektorin e Taksave nga data 21.01.2022-31.12.2022.

➤ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale), objekt legalizimi.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Mat, u auditua i gjithë dokumentacioni për vitin 2022, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Mat, deri në datën 31.12.2022, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar lejet e legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Mat. Nga ZVASHK Mat, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Bashkisë Mat, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Mat, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ZVASHK Mat. Lista e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën e vitit 2022, janë paraqitur të përmbledhura në tabelën më poshtë, ndërsa në mënyrë analitike janë pasqyruar në Aneksat A11, A12 A13 dhe A14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Vlera totale e debitorëve për TNI deri në datën 31.12.2022:

Gjithsej progresive	Subjekte	
	Nr.	Vlera
Nga të cilat krijuar në 2022	8	307,827
Nga të cilat progresive deri në 31.12.2021	81	2,726,502

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale në territorin e Bashkisë Mat.

Situata: Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Mat, u konstatua se nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje, të pajisura me leje legalizimi nga ZVASHK Mat konkretisht:

Vlera debitoare në datën 31.12.2021 është 2,726,502 lekë, nga të cilat krijuar në vitin 2022 në vlerën prej 307,827 lekë dhe vlera progresive deri në 31.12.2022 është 3,034,329 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Për debitorët e mësipërm nuk janë marrë masat e nevojshme të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, nenet 90-91. Theksojmë se nga sektori i urbanistikës janë bërë njoftimet për pagesën e taksës, por në vijimësi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e kësaj takse.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, nenet 90-91.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 3,034,329 lekë.

Shkaku: Mosmarrja e masave shtrënguese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale, në vlerën 3,034,329 lekë.

- Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fondet publike.

Të dhënat për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fondet publike, është paraqitur në Aneksin A15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në lidhje me detyrime nga subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fondet publike.

Situata: Nga auditimi lidhur me tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fondet publike rezultoi se kanë kryer punime ndërtimi tetë subjekte, nga të cilat 2 subjekte nuk kanë paguar detyrimin për vitin 2022. Konkretisht subjekti E. ShPK & E. ShPK dhe 5.K. ShPK, kanë paguar detyrimin në vitin 2023. Përsa i përket subjektit 5.K. ShPK rezultoi të jetë debitor prej 82,500 lekësh nga mos pagesa e tarifës së pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit. Nga komunikimi verbal me sektorin e taksave, janë shprehur se për subjektin 5.K. nuk ka dalë asnjë njoftim vlerësimi, dhe nuk ekziston dokumentacion i cili vërteton korespondencën midis dy drejtorive, siç janë sektori i taksave dhe i tarifave vendore dhe zyrës juridike. Për më shumë nuk dokumentohet puna e kryer në terren, nga strukturat e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Mat në vlerën 82,500 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 113 datë 06.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, neni 18.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: VKB nr. 113 datë 06.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, neni 18.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 82,500 lekë.

Shkaku: Moszbatimi kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i taksave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e tarifës së, pastrim, gjelbërim, ndriçim në vlerën 82,500 lekë.

- Auditimi mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Mat.

Në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Mat, u vendosën në dispozicion të grupit të auditimit 12 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, si dhe regjistri i taksave dhe tarifave vendore (formati EXCEL) për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në tregtimin e karburanteve në Bashkinë Mat, për vitin 2022.

Të dhënat për subjektet të cilat tregtojnë karburante dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, janë paraqitur në Aneksin A16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në menaxhimin e të ardhurave nga tarifa e licencimit të subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit për subjektet të cilat tregtojnë karburante dhe lëndë djegëse për konsumatorët fundorë, u konstatua se:

2 subjekte të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve gjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2022, nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, konkretisht:

- J., është pajisur me licencë për periudhën 31.12.2020-31.12.2021, pa rinovuar licencën për vitet në vazhdim;
- P.O., është pajisur me licencë për periudhën 31.12.2019-31.12.2020, pa rinovuar licencën më tej.
- M.M., nuk rezulton të jetë pajisur me licencë.
- A.A. është pajisur me licencë, por nuk ka bërë pagesën e tarifës, sipas kuadrit rregullator të fushës.

Për këto subjekte nuk administrohet dosje me dokumente, si dhe për ato subjekte që administrohen dosjet përkatëse, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e tyre për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit ose në të kundërt njoftimin e Inspektoratit përkatës, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Si pasojë e situatës së sipërpërmendur rezultojnë detyrime të papaguara në vlerën 4,000,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2 dhe neni 5, shkronja “ç” pikat i-vi; Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3., shkronjat “a” dhe “b”, neni 35, pika 5, shkronja “c”; Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 29, pika 1, neni 69, pika 1 dhe neni 89, pikat 1 dhe 2; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 12 dhe 14; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, Kreu II, pikat 15.1. dhe 15.2.; VKM nr. 344, datë 19.04.2017; dhe VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, neni 25.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2 dhe neni 5, shkronja “ç” pikat i-vi; Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3., shkronjat “a” dhe “b”, neni 35, pika 5, shkronja “c”; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 29, pika 1, neni 69, pika 1 dhe neni 89, pikat 1 dhe 2; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 12 dhe 14; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, Kreu II, pikat 15.1. dhe 15.2.; VKM nr. 344, datë 19.04.2017; dhe VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, neni 25.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Mat në vlerën 7,900,000 lekë.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet sektorit të licencimit dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masat e nevojshme, për identifikimin dhe pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregimit të karburanteve dhe lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, subjektet të cilat nuk janë pajisur. Gjithashtu të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve J.; P.O.; M.M. dhe A.A. të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë kryer pagesën për tarifën përkatëse, në vlerën 1,500,000 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi, A.P. me detyrë përgjegjëse në drejtorinë e Shërbimeve.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga z. A.P. është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Dokumentet e licencimit të subjekteve për percaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës si dhe licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse.

Ne projekt raportin e hartuar nga grupi i auditimit janë nxjerrë disa mangësi mbi mosrespektimin dhe mos. Unë i kundërshtoj perfundimet e nxjerra nga grupi i auditimit të kontrollit të shtetit .

Me poshtë po japim në mënyrë të detajuar sqarimin për secilin pretendim të ngritur nga grupi i auditimit.

Ju vemë në dijeni se Bashkia Mat konkretisht Sektori Infrastruktures të cilët kanë si detyrë licencimin e subjekteve për tregtim për dhenien e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës si dhe licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse në territorin e bashkis Mat bazuar në vendim nr. 344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, “për percaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. Duke pasur parasysh se bashkia Mat ka ngritur komision për identifikimin si dhe për marrjen e masave për subjektet që nuk kanë licencë për shfrytëzimin e aktivitetit, si dhe është bërë e mundur bllokimi i llogarive të subjekteve të cilët ushtrojnë aktivitetin në mënyrë të jashtëligjshme si dhe janë njoftuar për bllokimin e tyre në rast moslekujdimi. Pretendimi juaj nuk qëndron.

Përsa i përket konstatimit tuaj pas shqyrtimit të dosjeve ku 9 licenca të dhëna duke filluar nga periudha 18.10.2019 deri në 31.12.2022, nuk është respektuar afati i vlefshmërinë e licencës për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve, konkretisht licenca nuk është dhënë për 5 vite , por për 1 -2.6 vite , në kundërshtim me percaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 20 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Konstatimi juaj në lidhje me afatin e licencave të dhëna nga bashkia Mat, nuk qëndron , pasi bazuar në nenin 20 “Autorizimet” të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 i ndryshuar , referuar nga ana juaj se :

Neni20,Autorizimet

2. Autorizimet për personat juridike, qe ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje. Ku në zbatim të përcaktimeve të kësaj dispozite , duke qenë se afati përcaktohet deri në 5 -vite , në interpretim të këtij përcaktimi konkludohet se afati mund të jetë 1-5 vite , duke qenë se si referencë përcakton fjalën “vite”, dhe jo siç interpretohet nga ana juaj se duhet të jetë domosdoshmërisht 5 – vite, pasi vet dispozita e lejon “deri në 5 -vite”, ku ligjëvendësi ka patur si qëllim që licenca të jepet për një afat edhe më pak se 5 vite , siç ka proceduar edhe bashkia në rastet që ju referoni.

Pretendimi juaj nuk qëndron .

Përsa i përket subjekti A.A. me nr NIPT L.....D me adresë rruga D. K. Burrel , i cili është i licënsuar me licencën nr.01.datë 20.09.2021 si Njësi të shitjes Lëndëve Djegëse, bazuar në vendim nr. 344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, “për percaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.”

Duke u nisur nga kjo subjekti A.A. nuk është debitor ndaj bashkisë Mat dhe nuk duhet të trajtohet si subjekt i licënsuar Stacioni i shitjes së karburanteve pasi ky subjekt në kërkesën e tij është shprehur për tu paisur me autorizim si Njësi të shitjes Lëndëve Djegëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në përgjigje të kundërshtimit tuaj theksojmë se, përsa i përket llogaritjeve të afateve për diferencën debitoare, merret në konsideratë pra do llogaritet, ndryshimet do të reflektohen në material.

Për këtë çështje observacioni meret në konsideratë.

Përsa i përket subjektit A.A. ju keni paraqitur licencën ku specifikohet se, licenca është dhënë për tregëtimin me pakicë të karburantëve për kategorinë e produkteve njësi shitjes lëndëve djegëse. Nga ana juaj nuk është përcjellë pranë grupit të auditimit asnjë dokumentacion ku të provojë të kundërtën lidhur me subjektin A.A.. Gjithashtu referuar dhe QKB-së ku thuhet se Objekti i aktivitetit: është tregtim me shumicë dhe pakicë i naftës dhe i gazit, dhe jo sikurse ju pretendoni.

Observacioni për këtë çështje nuk meret në konsideratë.

➤ Lidhur me debitorët nga të ardhurat e qirasë

Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore, rezultoi se janë lidhur 19 kontrata me afat nga 1 deri në 10 vite, nga të cilat 9 subjekte janë debitorë nga mospagesa e detyrimit vjetor të cilët duhet të paguanin sipas kontratave të qirasë. Në fund të vitit 2021 rezultoi se nga detyrimet e lëna nga grupi i KLSH-së janë 7 subjekte debitoare nga të cilët vetëm 1 subjekt ka paguar detyrimet dhe 6 prej tyre vazhdojnë mbeten debitorë. Debia progresive më 31.12.2022 është 958,350 lekë, përsa i përket pagesave nga ana e subjekteve janë kryer pagesa në vlerën 7,516,686 lekë dhe totali i debitorëve është në vlerën 7,891,215 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Të dhënat për subjektet të cilat tregtojnë karburante dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, janë paraqitur në Aneksin A17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

➤ Debitorët nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake Mat.

Situata: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri në datën 31.12.2022 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 1,693,000 lekë, nga të cilat në vitin 2022 janë vendosur 1732 gjoba në vlerën 1,025,000 lekë. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse, gjithashtu nuk janë të kontabilizuara. Nuk rezultoi në asnjë rast të jetë bërë kërkesë për titull ekzekutiv, sipas përcaktimit në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.201 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4.

Të dhënat për gjobat e Policisë Bashkiake, janë paraqitur në Aneksin A18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.201 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar, neni 30, pika 4, Ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar.

Ndikimi: Të ardhura të munguara në vlerën 1,693,000 lekë.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrin masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 1,693,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura. Të kërkohej lëshimi i titullit ekzekutiv për gjobat e vendosura.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi, z. D.K., Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.

Titulli i gjetjes: Përlllogaritje të gabuara/përrjashtim nga taksa e ndërtesës dhe tarifës së shërbimit të disa bizneseve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat.

Situata: Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit në dispozicion, kryqëzimi i të dhënave me kontratat e qerave për sipërfaqet pyjore, ekstraktet e regjistrimit të subjekteve në QKB, licencimet nga ERE për subjektet me aktivitet prodhimin dhe tregëtimin e energjisë elektrike, u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme përlllogaritjet e bëra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimeve (pastrim, gjelbërim, ndriçim) për subjektet “Biznes VIP”, “Biznes i Madh”

Nga ky vlerësim u konstatua se, për vitin 2022 është përlllogaritur gabim ose janë përrjashtuar nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit disa subjekte, konkretisht: për taksën e ndërtesës 3 subjekte “biznes i madh”, për tarifën e shërbimit 5 subjekte “biznes i madh” dhe 4 subjekte me aktivitet HEC për tarifën e shërbimit, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 4,154,110 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.

Të dhënat me subjektet debitore për të cilat është përlllogaritur gabim ose janë përrjashtuar nga disa taksa, janë paraqitur në Anekset A19, A20 dhe A21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2022”, neni 5 dhe neni 18.

Ndikimi: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 4,154,110 lekë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacioni (kontratë qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), duke kryer verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 4,154,110 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi z. E.B. me detyrë ish përgjegjës i taksave dhe i tarifave vendore për periudhën 22.11.2019-21.01.2022 dhe z. D.R., me detyrë ish drejtor Ekonomik, përgjegjës për sektorin e taksave për periudhën 21.01.2022-31.12.2022.

- Detyrimi i krijuar nga mospagesa e taksës së ndërtesës dhe truallit për subjektin A. ShPK përrjashtuar nga taksa:

Nga auditimi i bërë në bazë të analizës së riskut, grupi i auditimit konstatoi se në regjistrin e bizneseve “VIP”, subjekti A. ShPK me aktivitet përpunim mineral kromi, ishte i përrjashtuar nga taksa e ndërtesës dhe e truallit. Nga shqyrtimi i dosjes së subjektit A. ShPK, u konstatua se sektori i taksave dhe i tarifave vendore, me shkresën nr. 932 prot., datë 21.04.2016, i ka dërguar këtij subjekti njoftim vlerësimi për detyrimet mbi taksën e ndërtesës dhe të truallit.

Titulli i gjetjes: Përrjashtimi nga taksa e ndërtesës dhe e truallit e Subjektit A..

Situata: Me shkresën nr. 393 prot., datë 21.02.2017 nga sektori i taksave Bashkia Mat është bërë njoftim vlerësimi drejtuar subjekti A. ShPK, pa përfshirë taksën e ndërtesës dhe të truallit, ndërsa me shkresën nr. 1139 prot., datë 24.04.2017, ka dalë fatura për arkëtim lidhur me taksat ndërtesë/truall, taksa të cilat i përkasin vitit 2017.

Subjekti A. ShPK, me shkresën nr. 151/2 prot., i është drejtuar Bashkisë Mat me lëndën kthim përgjigje, ankim mbi llogaritjen e taksës, ku pretendon se taksa e pasurisë është një çështje e

sqaruar ndërmjet shoqërisë koncensionare dhe Bashkisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë taksë (Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar), i cili parashikon që taksa e pasurisë së paluajtshme paguhet nga pronari që e zotëron këtë pasuri.

Sipas pretendimit të shoqërisë koncensionare është vendosur që taksa për pasuritë e paluajtshme nuk mund të jetë detyrimi i shoqërisë A. ShPK

Me shkresën nr 157/5 datë 20.09.2018, drejtuar Bashkisë Mat, shoqëria A. thekson se e njëjta çështje është trajtuar dhe në Bashkitë e tjera, të cilat kanë dalë në konkluzionin që taksa mbi pasuritë nuk i përket shoqërisë A. por shtetit Shqiptar.

Sektori i taksave dhe i tarifave vendore në Bashkinë Mat, me shkresën nr. 1551 prot., datë 12.06.2018, ka dërguar pranë shoqërisë A. ShPK njoftim për detyrimet tatimore ku përfshihen dhe taksat ndërtesë/truall.

Nga sektori i taksave në Bashkinë Mat, është kërkuar që t’i vihet në dispozicion nga ana e shoqërisë A. ShPK një kopje e kontratës koncensionare që ata kanë me ministrinë përkatëse, kontratat e cila nuk është pjesë e dosjes, e cila mban korespondencën ndërmjet bashkisë dhe shoqërisë A. ShPK.

Me shkresën nr. 4427 prot., datë 03.12.2019, sektori i taksave Bashkia Mat ka dërguar pranë Ministrisë së Financave njoftimin për detyrimin tatimor për shoqërinë A. ShPK për vitet 2016-2019, detyrim për taksën e ndërtesës në vlerën 5,280,000 lekë dhe për taksën e truallit në vlerën 2,907,000 lekë.

Në përgjigje të shkresës së drejtuar nga ana e Bashkisë Mat pranë MFE, Drejtoria e përgjithshme rregullatore dhe e përputhshmërisë, drejtoria e koncensionave pranë MFE, me shkresën nr. 18094/1 datë 28.10.2019 ka sqaruar se në rastin e kontratave koncesionare detyrimet për taksat dhe tarifave vendore likuidohen nga pronari i këtyre pasurive të paluajtshme që është Autoriteti Kontraktues, Ministria përgjegjëse (MIE) që ka në fushën përgjegjësisë objektin e dhënies me qera të koncensionit, kur një gjë e tillë përcaktohet në kontratën koncesionare.

Për sa më sipër kanë rekomanduar që kërkesa të adresohet pranë autoritetit kontraktues përkatës i cili menaxhon këtë kontratë koncensionale. Nga ana tjetër sektori i taksave Bashkia Mat me shkresën nr. 2364/1 datë 12.12.2018, është shprehur se shoqëria A. është pajisur me certifikatë për vërtetim truall “Në përdorim” nga ZVRPP Mat.

Gjithashtu në përgjigje të kësaj shkrese, sektori i taksave është shprehur se ankimimi nga ana e shoqërisë A. merret në konsideratë pasi fatura për arkëtim për këto zëra i është dërguar MFE ku i është bërë me dije se shoqërisë koncensionare A. ShPK i lind detyrimi i pasurisë në vlerën 8,187,000 lekë.

Nga auditimi i dosjes së vënë në dispozicion nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore Bashkia Mat, rezultoi se për vitin 2019 ka dalë shkresa për njoftim vlerësimi, drejtuar subjektit A., me nr. 357 prot., datë 11.02.2019, pa përfshirë taksën e Truallit dhe të ndërtesës.

Po në vitin 2019 është dërguar faturë për arkëtim me shkresën nr. 411 prot., datë 11.02.2019 duke vazhduar në të njëjtën linjë si më lart, pa përfshirë 2 llojet e taksave truall/ndërtesë.

Për vitin 2020, me shkresën nr. 215 prot., datë 17.01.2020 ka dalë njoftim vlerësimi për detyrime tatimore nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore, pa përfshirë taksën e ndërtesës dhe të truallit.

Për vitin 2021, ka dalë shkresa nr. 187 prot., datë 13.01.2021, për njoftim vlerësimi tatimore për subjektin A. ShPK, në të cilën nuk është llogaritur Taksa e ndërtesës dhe e truallit.

Si më lart është vepruar dhe për vitin 2022 nga strukturat e Bashkisë Mat, Sektori i Taksave dhe i Tarifave Vendore ku me shkresën nr. 92 prot., datë 11.01.2022, është dërguar njoftim vlerësimi për detyrime, pa llogaritur detyrimin taksën e ndërtesës dhe taksën e truallit.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore, marrë nga Agjensia shtetërore e kadastrës Mat, rezulton se prona me nr. pasurie 240/1, ka një sipërfaqe

totale truallit 154,000 m² dhe sipërfaqe ndërtese 14,000 m², pra vlera për vitet 2016- 2017 duhet ishte 1,680,000 lekë dhe për vitet 2018 dhe 2019 detyrimi për taksën e ndërtesës duhet të ishte 1,400,000 lekë, pra në total 3,080,000 lekë, me një diferencë prej 2,200,000 lekësh të llogaritur me shumë nga sektori i taksave.

Ndërsa taksa e truallit është llogaritur për 57,000 m², ndërkohë që duhet të ishte llogaritur për 154,000 m², nga viti 2016-2019 duhej llogaritur në total në vlerën 7,392,000 lekë, pra në total një diferencë prej 4,485,000 lekë më pak nga llogaritja e gabuar.

Përsa i përket viteve 2020-2022, nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore shoqëria A. ShPK ka marrë njoftim vlerësimi dhe fatura për arkëtim, por pa përfshirë taksat e ndërtesës dhe atë të truallit.

Vlera debitore për periudhën 2016-2019, përcjellë nga sektori i taksave pranë MFE-së, është paraqitur në Aneksin A22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Sipas paketave fiskale 2020, 2021 dhe 2022, ku treguesit për nivelin e taksës sipas kategorive janë të përcaktuara, konkretisht shoqëria A. bën pjesë në Biznesin “VIP”, i cili e ka të përcaktuar nivelin e taksës së ndërtesës me 170 lekë për m², për taksën e pasurisë është përcaktuar 0.15 lekë m². Grupi i auditimit ka llogaritur detyrimin e krijuar për vitet 2020-2022 nga mospagesa e taksës së truallit dhe të ndërtesës, llogaritjet të cilat janë të pasqyruar në Aneksin A23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Konkluzion:

Nga auditimi arrihet në konkluzion se për sa na është vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe i Tarifave në Bashkinë Mat, rezultoi se nga strukturat përgjegjëse të bashkisë Mat nuk dokumentohet korespondenca shkresore me Ministrinë e Energjitikës dhe Infrastrukturës (MIE) ku të saqrohet e gjithë situata e sipërpërmendur. Nga shqyrtimi i dosjes, rezultoi se nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore janë dërguar njoftime për vlerësim dhe fatura për arkëtim, pa llogaritur taksën e pasurisë, e cila nuk është e argumentuar.

Nga grupi i auditimit u kërkua që të vihet në dispozicion një kopje e kontratës koncensionare e lidhur ndërmjet (MIE) dhe A., kontratë e cila nuk gjendej në dosjen e subjektit, kështu që në këto kushte grupi i auditimit i referohet Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 20, neni 22, pikat 1 dhe 6, VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2022” neni 4 pika 9 “a” neni 8 pika 2. Nga mospagesa e taksës së pasurisë, është krijuar detyrimi 10,472,000 lekë, vlerë e cila i përket periudhës 2016-2019 dhe detyrimi prej 14,070,000 lekë i cili është krijuar për periudhën 2020-2022. Në total, detyrimi nga mospagesa e taksës së pasurisë për vitet 2016-2022 rezulton të jetë 24,542,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ financiar për buxhetin e bashkisë Mat.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 9, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 20, neni 22, pikat 1 dhe 6; VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2022” neni 4 pika 9 “a” neni 8 pika 2.

Ndikimi: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 24,542,000 lekë.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Sektori i taksave Bashkia Mat të sqarojë situatën ndërmjet Autoritetit kontraktor në rastin e mësipërm Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe subjektit A. ShPK, pasi të sqarohet situata se kujt i takon detyrimi për taksën e ndërtesës dhe truallit, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mat të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 24,542,000 lekë.

Nga auditimi i taksave dhe i tarifave vendore rezultoi se:

Vlera debitore në fund të vitit 2021 ka qenë 74,987,543 lekë, si më poshtë:

- Nga Biznesi Vip: 5 subjekte për vlerën 5,114,318 lekë;
- Nga Biznesi i Madh: 59 subjekte për vlerën 13,890,241 lekë;
- Nga Biznesi i Vogël: 273 subjekte për vlerën 16,659,480 lekë;
- Nga Familjarët, (për taksa dhe tarifa vendore): 10,715 familje për vlerën 36,597,002 lekë;
- Nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale: 81 subjekte për vlerën 2,726,502 lekë;
- Nga Taksa e tokës bujqësore: 4,354 subjekte për vlerën 1,933,203 lekë.

Vlera debitore e krijuar gjatë vitit 2022 ka qenë 25,643,739 lekë, si më poshtë:

- Nga Biznesi Vip: 6 subjekte për vlerën 3,321,450 lekë;
- Nga Biznesi i Madh: 39 subjekte për vlerën 3,323,880 lekë;
- Nga Biznesi i Vogël: 220 subjekte për vlerën 4,737,024 lekë;
- Nga Familjarët, (për taksa dhe tarifa vendore): 7,453 familje për vlerën 13,533,270 lekë;
- Nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale: 7 subjekte për vlerën 264,129 lekë;
- Nga Taksa e tokës bujqësore: 3,827 subjekte për vlerën 463,986 lekë.

Vlera debitore në fund të vitit 2022 (progresive) ka qenë 95,968,225 lekë, si më poshtë:

- Nga Biznesi Vip: 7 subjekte debitorë për vlerën 8,159,543 lekë;
- Nga Biznesi i Madh: 39 subjekte për vlerën 16,727,915 lekë;
- Nga Biznesi i Vogël: 220 subjekte për vlerën 17,497,320 lekë;
- Nga Familjarët, (për taksa dhe tarifa vendore): 9719 familjar për vlerën 50,130,272 lekë;
- Nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale: 30 subjekte për vlerën 1,055,986 lekë;
- Nga Taksa e tokës bujqësore: 4017 subjekte për vlerën 2,397,189 lekë.

Llogaritjet e gabuara:

- Nga llogaritjet e gabuara për taksën e ndërtesës/tarifën e shërbimit për bizneset vip dhe biznes i madh rezultoi vlera debitore 4,154,110 lekë.

Përfundimi nga taksa e ndërtesës dhe truallit e subjektit A.:

Rezultoi në vlerën debitore 24,542,000 lekë.

Gjoha të Policisë Bashkiake:

Rezultoi vlera debitore 1,693,000 lekë.

Debitorë nga mospagesa e tarifës për autorizim tregëtimi të karburantit:

Rezultoi në vlerën 1,500,000 lekë.

Debitorët nga kontratat e qirasë:

Rezultoi në vlerën prej 7,891,215 lekë.

Tabela përmbledhëse e debitorëve është paraqitur në Aneksin A24, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

➤ Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese “Bashkia Mat”, për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 22.02.2022. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Mat, dhe nuk ka pasur në asnjë rast kontestimi.

➤ Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Bashkia Mat për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm përnjësinë shpenzuese Bashkia Mat, pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

➤ Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Mat për vitin ushtrimor 2022 me shkresën përcjellëse nr. 1394 prot., datë 30.03.2022 konfirmuar nga Dega e Thesarit Mat. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Mat dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

➤ Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin, bankat e nivelit të dytë dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës, sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2, me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj), për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës, i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

➤ Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitja e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për t’u siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen teste në regjistrimet e ditarëve kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmërinë e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë së një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti, duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit të Bashkisë.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin “Excel”.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj., por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël, deri në bilancin vërtetues, rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu, nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhërat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur “*të angazhimeve*” (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshëm për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Mat për aktivitetin ekonomiko-financiar për vitin ushtrimor 2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022, rezultoi se llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse, pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; Totali i Aktivit për vitin 2021 është në vlerën 3,085,185,949 lekë dhe për vitin 2022 është 3,731,573,540 lekë.

➤ Qasja dhe metodologjia e auditimit

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit 36,466,642 lekë për shpenzimet dhe 13,223,263 lekë për të ardhurat, sipas Aneksit PF1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkise Mat në 31.12.2022, sipas formatit F1, është paraqitur më poshtë:

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=	3,306,275,226 lekë.
- Aktivet	3,731,573,540 lekë
- Detyrimet	425,298,314 lekë
- Aktivet Neto	3,306,275,226 lekë

AKTIVET:

Aktivitet afatshkurta në datën 31.12.2022 janë në vlerën 515,087,568 lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 140,420,347 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 41,337,644 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 333,329,577 lekë

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, në shumën 140,420,347 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në shumën 48,451,610 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje”, në shumën 91,968,736 lekë.

Lëvizjet e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, janë paraqitur në Aneksin PF2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mat në 31.12.2022, paraqitet në vlerën 41,337,644 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 9,243,162 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 32,094,482 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -2,160,336 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 2,160,336 lekë. Lëvizjet e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, është paraqitur në Aneksin PF3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 10,223,421 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	10,223,421
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	
Gjendja në 31.12.2022	9,243,162

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 32,094,482 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	33,274,559
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	
Gjendja në 31.12.2022	32,094,482

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventareve. Për kryerjen e tyre është zbatuar UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Titullari i Bashkisë Mat ka nxjerrë Urdhërat e inventarizimit datë 19.10.2022, ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”

dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2022, mbështetur në UMF nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, nga titullari i Bashkisë Mat ka dalë urdhëri nr. 718 datë 19.10.2022, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2022 të Bashkisë Mat, përfshirë 7 Njësitë Administrative në territorin e Bashkisë Mat”.

Në përgjigje të urdhërit të inventarizimit, janë hartuar raportet e inventarizimit fizik për vitin 2022 nga anëtarët e komisioneve përkatës për aparatën e bashkisë, bordin e kullimit, zjarrfikëset, ndërmarrjen e rrugëve, shkollat, konviktet, si dhe për 7 Njësitë Administrative.

Në secilin raport inventarizimi janë përpiluar relacione për aktive të konstatuara për t’u nxjerrë jashtë përdorimit, në përputhje me UMF nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”:

Lëvizjet e klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”, janë paraqitur në Aneksin PF4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 ka qenë 74,355,304 lekë, e cila përbëhet nga një pjesë e debitorëve të trashëguar nga ish-komunat dhe debitorët e tatim taksave të krijuar ndër vite.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	66,299,999
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	47,558,869
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	39,503,564
Gjendja në 31.12.2022	74,355,304

Llogaria 429 “Paradhënie, deficite e qjoba”, në fund të vitit 2021 ka qenë 1774,523 lekë, e cila përbëhet nga shuma 17,1774,523 lekë të debitorëve, e krijuar nga rekomandimet e lëna nga KLSH dhe debitorë të tjerë nga ish-Bashkia Burrel.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	17,774,523
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	
Gjendja në 31.12.2022	17,774,523

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitorë)”, në fund të vitit 2022 ka qenë 241,199,750 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 241,199,750 lekë, përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe përbëhet nga:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	217,797,446
Paga personeli llog 42	16,979,740
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	759,919
Sigurime shoqërore llog.435	4,978,327
Sigurime shëndetësore llog.436	684,318
Totali	241,199,750

Aktivët Afatgjatë JoMateriale (AAJM):

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët afatgjatë jo materiale”, përbëhen nga llog. 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 40,008,269 lekë. Sipas llogarisë analitike, vlera e kësaj llogarie është 40,008,269 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	40,008,269
Shtesa gjatë vitit 2022(D)	
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	
Gjendja në 31.12.2022 (D)	40,008,269

Llogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto 40,008,269 lekë, dhe në fund të vitit 2021 në vlerën neto 40,008,269 lekë. Sipas inventarit kontabël, gjendja e kësaj llogaritje është në vlerën neto 40,008,269 lekë dhe përbëhet nga 20 projekte për investime të kryera.

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM):

Llogaritë e Klasës 21 “*Aktivet Afatgjata Materiale*”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, paraqiten në shumën 1,691,089,317 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera totale e AAM-ve ka qenë 1,578,150,375 lekë, me një shtesë në shumën 212,177,269 lekë, shtesa që kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje në Bashkinë Mat, si dhe pakësimet nga amortizimi dhe lëvizjet brenda aktiveve në shumën 103,596,716 lekë.

Nr. Llog.	Emërtimi	Gjendja më 31.12.2021	Shtesa	Pakësime	Gjendja më 31.12.2022
210	Toka, Troje, Terrene	27,399,128	1,226,801		28,625,929
211	Pyje, Kullota, Plantacione	10,550,203	838,800	838,800	10,550,203
212	Ndërtime e Konstruksione	726,748,559	68,518,417	36,663,144	758,603,832
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	757,535,292	113,538,660	40,768,970	830,304,982
214	Instalime dhe paisje	7,276,739	2,076,902	399,536	8,985,129
215	Mjete Transporti	37,687,511	17,529,600	16,857,502	38,559,609
218	Inventar Ekonomik	10,952,943	8,448,089	3,941,399	15,459,633
Shuma		1,618,158,644	212,177,269	99,469,351	1,731,097,586

1. Llogaria 210 “*Toka, troje terrene*”, është paraqitur në bilanc në vlerën 28,625,929 lekë. Kjo llogari ka pasur shtesë në vlerën 1,226,801 si pasojë e 1 shpronësimi.

Kjo llogari ka inventar kontabël, por jo inventar fizik.

Nr.	Objekti	Vlera e mbetur 31.12.2021	Shtesa 2022	Vlera e mbetur 31.12.2022
1	Rregullim Lulishtje shkolla Shlli	152,000		152,000
2	Shk,9-vjeç, ”M.Gjestila”	1,024,598		1,024,598
3	Shk,9-vjeç, ”31-Korriku”	1,024,599		1,024,599
4	Sporti	17,258,985		17,258,985
5	Kendi i lojrave	2,255,360	1,226,801	3,482,161
6	Toke per Varrezat	4,532,186		4,532,186
7	Shpronësim per varreza	1,151,400		1,151,400
Shuma		27,399,128	1,226,801	28,625,929

2. Llogaria 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, është paraqitur për vitin 2022 për vlerën 10,550,203 lekë. Vlera e llogarisë 211 është e pandryshuar nga viti 2021. Këto asete janë paraqitur në mënyrë analitike më poshtë:

Nr.	Objekti	Vlera e mbetur 31.12.2022
1	Nj ad Macukull(Total)	8,071,531
	Pyllezim me arvore	8,071,531
2	Nj ad Rukaj(Total)	1,365,712
	Pyje e kullota	1,365,712
3	NJ Ad Baz(Total)	1,112,960
	Sistemim gjelberim	1,112,860
Totali		10,550,203

Nga auditimi i llogarisë 210 “*Toka, troje terrene*” dhe llogarisë 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, ka rezultuar se nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”.

3. Llogaria 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”, cila pasqyron gjendjen e 108 aseteve për llogari të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2021 rezulton me një vlerë neto 726,748,559 lekë dhe në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë neto 758,603,832 lekë. Diferenca prej 31,855,273 lekë në

rritje vlere e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2022 nga viti 2021, vjen për shkak të kapitalizimit të investimeve të kryera në vitin 2022. Kapitalizimi për vitin 2022 është në vlerën 68,518,417 lekë për objektet si më poshtë:

- Konvikti Burrel	9,107,418 lekë
- Blerje godinë ish hoteli i uzinës	20,010,000 lekë
- Blerje godine ish reparti ushtarak shkolla profesionale	13,461,728 lekë
- Blerje godina sociale	12,882,249 lekë
- Ambulanca Shoshaj	2,822,602 lekë
- Qendra Shëndetsore Lis	7,550,077 lekë
- Ambulanca Zenisht	2,666,013 lekë

Amortizimi vjetor për këtë llogari ka qënë në vlerën 36,663,144 lekë.

Lëvizjet e llogarisë 212 “*Ndërtesa dhe Konstruksione*”, janë paraqitur në Aneksin PF5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

4. Llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, cila pasqyron gjendjen 157 aseteve për llogari të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2021 rezulton me një vlerë neto 757,535,292 lekë dhe në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë neto 830,304,982 lekë. Diferenca prej 72,769,690 lekë në rritje vlere e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2022 nga viti 2021, vjen për shkak të kapitalizimit të investimeve të kryera në vitin 2022. Kapitalizimi për vitin 2022 është në vlerën 113,538,660 lekë për objektet si më poshtë:

- Çezma Publike	1,016,787 lekë
- Rehabilitim Rrjeti Kuz	87,979,587 lekë
- Rikualifikim Sheshi Koms	3,633,757 lekë
- Rruga lidhëse Sheshi Koms	3,268,592 lekë
- Sifoni Karicë	1,012,228 lekë
- Rikualifikim urban sheshi Lis	5,169,102 lekë
- Diga Ujëmbledhësi Shoshaj	shtesë 11,444,083 lekë

Amortizimi vjetor për këtë llogari ka qënë në vlerën 40,768,970 lekë.

Lëvizjet e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, janë paraqitur në Aneksin PF6, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Titulli i gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në kontabilizimin e Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.

Situata: Nga auditimi, rezultoi se nga inventari i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 764,697,889 lekë, objektet nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, si më poshtë: llog. 210 “*Toka troje terrene*”, elementë në vlerën neto 28,625,929 lekë; llog. 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”, elementë në vlerën neto 10,550,203 lekë; llog. 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”, 103 objekte me vlerën neto 758,603,832 lekë. Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 17.11.2023

Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*”, pikat 1 dhe 2.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e titullit të pronësisë është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme; është pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre; ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një

dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, i cili vërteton pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave mbi një pasuri të paluajtshme.

Shkaku: Nga ballafaqimi i problematikës gjatë auditimit në terren, ka rezultuar se shkaqe të kësaj gjendjeje edhe pas 5 vitesh nga kryerja e këtij procesi janë: dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat; vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë; kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme/Agjencisë së Kadastrës, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa të menjëhershme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në AShK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

5. Llogaria 215 “*Mjete transporti*”, paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Mat në datën 31.12.2022, për shumën 38,559,609 lekë.

Kjo llogari është shtuar në vlerën 17,529,600 për blerjen e 4 mjeteve. Llogaria është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 7,397,502 lekë dhe mjete të transferuara institucioneve të varësisë në vlerën 9,460,000 lekë. Rritja neto e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” për vitin 2022 është në vlerën 87,098 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	37,687,511
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	17,529,600
Pakësimet gjatë vitit 2022 (K)	16,857,502
Gjendja në 31.12.2022	38,559,609

Lëvizjet e llogarisë 215 “*Mjete Transporti*”, janë paraqitur në Aneksin PF7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

6. Llogaria kontabël 218 “*Inventar ekonomik*”, përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Mat. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Mat, gjendja e llogarisë 218 në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 15,459,633 lekë. Krahësuar me vitin 2021, llogaria 218 “*Inventari ekonomik*” është rritur me vlerën 4,506,690 lekë.

Lëvizjet Llog. 218 “ <i>Inventar ekonomik</i> ” për vitin 2022, vlera në lekë	
Çelje në 01.01.2021	10,952,943
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	8,448,089
Dalje (K)	3,941,399
Gjendja në 31.12.2022	15,459,633

Llogaria 219 “*Amortizimi i AAGJM & AAJM*”: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Mat në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (1,028,309,244) lekë, që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar në datën 31.12.2022. Krahësuar me vitin 2021, llogaria 219 “*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*” paraqitet me shtesë prej (87,384,040) lekë, e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2022.

Lëvizjet e llogarisë 219 “*Amortizimi i AAGJM & AAJM*”, janë paraqitur në Aneksin PF8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*”.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Mat, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5%;
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi bazë grupimi) 20%;
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%;

- për mjetet e transportit 20%;
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15%.

Aktivet Afatgjata Financiare:

Titulli i gjetjes: Mangësi në kontabilizimin e llogarisë 26 “Aktivet Afatgjata Financiare”.

Situata: Aktivet Afatgjata Financiare në fund të viteve 2021 dhe 2022 rezultojnë në vlerën 0 lekë.

- Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të “K.B.” ShPK me NUIS L.....K, e cila është shoqëri aksionere me objekt “Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit”. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 100,000 lekë.

- Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “T.M.” Sh.A., me NUIS M.....G, e cila është shoqëri aksionere me objekt “Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim të tregjeve me qëllim tregtimin e produkteve bujqësore ose tregjeve të kafshëve”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 30,211 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 30,211,950 lekë.

- Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 13.86% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër” Sh.A., me NUIS M.....L, e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 13,860 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 1,386,000 lekë.

Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, në kundërshtim me Urdhërin nr. 64 datë 22.07.2014 i Ministrit të Financave, “Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 31,697,950 lekë dhe investori është Bashkia Mat.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 31,697,950 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 17.11.2023

Kriteri: Urdhëri nr. 64 datë 22.07.2014 i Ministrit të Financave, “Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformimi i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, gjendje kjo e nënvlerësuar me 31,697,950 lekë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar me vlerë

kontabël 31,697,950 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

4. Investimet:

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 1,485,388,386 lekë. Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 1,485,388,386 lekë, përkatësisht 0 lekë në llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 176,545,961 lekë në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Nga auditimi u verifikua se kjo llogari pasqyron vlerën reale të investimeve në proces. Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”.

Lëvizjet e llogarisë 231 “Investime në proces”, janë paraqitur në Aneksin PF9, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

PASIVET (DETYRIMET):

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të bilancit, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Mat më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	217,797,446	296,286,548	(78,480,102)
42	Detyrime ndaj personelit	16,979,740	15,737,293	1,242,447
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	759,919	911,221	(151,302)
435	Sigurime shoqërore	4,978,327	4,663,548	314,779
436	Sigurime shëndetësore	684,318	641,362	42,956
467	Kreditor të ndryshëm	0	20,605,519	(20,605,519)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	92,129,828	84,074,522	8,055,306

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 217,797,446 lekë, paraqet gjendjen e faturave të palikuiduara nga Bashkia Mat më 31.12.2022. Lëvizjet e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, janë paraqitur në Aneksin PF10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 217,797,446 lekë përbëhet nga 57 fatura tatimore të palikuiduara të cilat kanë kaluar afatin 60 ditore, në vlerën 37,289,295 lekë.

Titulli i gjetjes: Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara. Marrja e angazhimeve për kryerjen e shpenzimeve përtej kufirit të fondeve buxhetore të disponuara realisht, në llogarinë e thesarit.

Situata: Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 296,286,548 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 217,797,446 lekë, e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash, etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 85, pika 2 dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes,

paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 82-91.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, duke mbartur këto detyrime për periudhat e tjera kontabël të mëvonshme, denatyrin i buxhetit koherent dhe atij pasardhës.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoje shpenzimet e vitit pasardhës, Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, të marrin masa të menjëhershme për pagesën e faturave të palikuiduara në vlerën totale 37,289,295 lekë, si dhe të paraqesin në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojnë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Stoku i detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE është në vlerën 20,605,519 lekë dhe përbëhet nga 28 fatura tatimore.

Nga auditimi i llogarisë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” u vërtetua se faturat e palikuiduara të cilat janë nuk janë likuiduar brenda 60 ditëve janë në vlerën 37,289,295 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE në kundërshtim me UMFE nr. 37 datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”.

Detyrimet e prapambetura të cilat janë regjistruar në llogarinë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, janë paraqitur në Aneksin PF11, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”.

Situata: Nga auditimi i llogarisë 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”, u konstatua Vendimi nr. 631 datë 04.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për detyrimin që Bashkia Mat ka ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit, për vlerën 5,125,862 lekë. Ky vendim gjykatë i vitit 2019, është regjistruar në shumën 42,000 lekë në llogarinë 401-408, duke e nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 5,083,862 lekë.

Trajtuar qjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 61 dhe UMF nr. 5 datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”.

Ndikimi/Efekti: Mosregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës dhe të ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”, si dhe të merren masa që Drejtoria e Financës të rakordojë çdo muaj, në mënyrë sistematike, me Drejtorinë Juridike mbi balancat e llogarisë 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”, në lidhje me detyrimet që vijnë nga vendimet gjyqësore.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 16,979,740 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, të cilat janë paguar në muajin janar 2022 në shumën 16,979,740 lekë. Lëvizjet e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”, janë paraqitur në Aneksin PF12, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 759,919 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor, e paguar në janar 2022.

Lëvizjet e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, janë paraqitur në Aneksin PF13, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, paraqesin vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 4,978,327 lekë dhe 684,318 lekë.

Lëvizja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” dhe 436 “Sigurime shëndetësore”, janë paraqitur në Aneksin PF14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 91,968,736 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlëra e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Mat.

Detajet e llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, për të cilat ka kaluar afati i garancisë janë paraqitur në Aneksin PF15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Llog 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2022	54,128,551
Shtesa	38,442,680
Pakësime	597,994
Gjendja në 31.12.2022	91,973,237

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”.

Situata: Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, u konstatua se vlëra në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Përfundimisht për vitin 2022, Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” është mbivlerësuar për 7,426,072 lekë, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 1, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Ndikimi/Efekti: Mosregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet

për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Pasqyra e Performancës financiare (F2):

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Mat më datë 31.12.2022 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Mat, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave:

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	116,513,987	Aktrakordimi me Degën e Thesarit	117,592,592	1,078,605
Granti nga buxheti	458,537,095	Çelja e buxhetit nga MFE	458,537,095	0
Financim i pritshëm nga buxheti	241,199,750	Sipas llogarisë 7206	241,199,750	0
Totali i të ardhurave	816,250,832		817,329,437	1,078,605

Rakordimi i Shpenzimeve:

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2021	Detyrimet e vitit 2022	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	237,083,387	15,737,293	221,346,094	237,083,387
601	39,739,902	6,216,131	33,523,771	39,739,902
602	94,294,956	27,220,414	67,074,542	94,294,956
604	26,858,957		26,858,957	26,858,957
606	367,661,684		367,661,684	367,661,684
63				2,160,336
Totali	765,638,886	49,173,838	716,465,048	767,799,222

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2022

Pasqyra e flukseve monetare (F3):

Nr.	Përmbajtje	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
1	Veprimtaritë e shfrytëzimit	1,630,549,451	1,658,342,009
2	Veprimtaritë e investimeve	-792,383,542	-760,62,405
3	Transferta e të tjera	-813,383,396	-845,944,569
4	Teprica në fillim të vitit ushtrimor	115,592,834	63,657,799
5	Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor	140,420,347	115,592,834

Nga kontrolltet e kryera, rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2022, e paraqitur në këtë pasqyrë është 140,420,347 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre” e cila është 140,420,347 lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMFE nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare”, i ndryshuar.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4):

Nga verifikimi i kryer, rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në “Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në shumën 2,608,137,386 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

- Vlera prej 879,255,324 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101, “Fonde bazë”, të ndara 792.383.542 lekë për grante të brendshme kapitale, transferta të brendshme të AAGJ dhe dhuratat në natyrë në vlerën 86,957,157 lekë;

- Vlera prej 83,025,651 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor;

- Vlera prej 4,621,654 lekë përfaqëson nxjerrjet jashtë përdorimit;

Të gjitha këto vlera janë rakorduar edhe me pasqyrën nr. 7 gjendja dhe ndryshimi i AAGJ;

Vlera prej 61,464,284 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog. 85 dhe llog. 12.

- Nga auditimi, rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën “Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto” në shumën 1,956,709,769 lekë kuadrojnë me paraqitjen e tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto është paraqitur në Aneksin PF16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fondeve neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UMFE nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto”.

2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Në zbatim të kësaj pike, janë administruar evidencat:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Mat;
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastrë;
- Inventari i fondit pyjor;
- Kontratat e HEC-eve mbi fondit pyjor.

Sipas Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për bashkinë Mat, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 771, datë 14.11.2007 “Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Burrel, të qarkut Dibër”, i ndryshuar.

Titulli i gjetjes: Mosregjistrimi i pasurive të paluajtshme të bashkisë Mat dhe mungesa e përditësimit të inventarit të pasurive të paluajtshme.

Situata: Nga totali prej rreth 2123 pasuri që i janë transferuar Bashkisë Mat (490), përfshirë pasuritë e paluajtshme të ish-komunave Komsë (921), Baz (185), Ulëz (427) Rukaj (45) dhe Derjan (55), vetëm **69 pasuri janë certifikuar**. Sa më sipër janë paraqitur në Aneksin PF17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Me VKM nr. 806, datë 12.12.2022, Bashkisë Mat i është transferuar nga Ministria e Mbrojtjes pasuria “Shtëpia e ushtarakëve” zona kadastrale 1326, me sipërfaqe truall 1645 m² dhe sipërfaqe ndërtese 1153 m², e cila ende nuk është regjistruar në Zyrën Vendore të Kadastrës Burrel (ZVASHK). Për këtë arsye, sektorit të pronave i është kërkuar informacion mbi shkaqet e vonësive në regjistrim, për të cilën në datën 29.09.2023, Bashkia Mat i ka dërguar ZVASHK Burrel kërkesë për informacion. Nga ZVASHK Burrel nuk është kthyer përgjigje mbi arsyet e mosregjistrimit.

Nga verifikimi i deritanishëm i evidencave, rezultoi se inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Mat nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Nga auditimi, u konstatua se nga 490 pasuri të paluajtshme të Bashkisë Mat, për 192 pasuri rezulton se truall është shtetëror ndërsa objekti mbi truall rezulton privat, çka nënkupton se këto troje nuk i përkasin më bashkisë ose thënë ndryshe janë ndërtime pa leje që sipas Ligjit nr. 20/2020 janë në proces të kalimit të truallit në pronësi, përmes procedurës së legalizimeve. Për secilën nga këto pasuri, Bashkia Mat duhet të rakordojë me Zyrën Vendore të ASHK-së

për të konfirmuar statusin juridik përfundimtar të tyre (nëse janë kaluar në pronësi të privatëve përmes legalizimit ose privatizimit) dhe të përditësojë listën e inventarit. 12 pasuri, sipas Aneksit PF18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, rezultojnë të jenë zënë nga banorë për arsye strehimi.

Nga pasuritë e paluajtshme të regjistruara në kadastër, rezulton se nga Bashkia Mat është blerë pasuria “*Hoteli i ish-Uzinës së Ferokromit*”, me sipërfaqe 570 m² truall+ ndërtesë, në pronësi të shoqërisë “Z.G.”, në të cilën jetojnë 58 familje, pa titull pronësie. Me shkresat nr. 1329 datë 30.03.2020 dhe nr. 1328/1 datë 11.05.2022 dërguar në MFE, Bashkia Mat ka paraqitur kërkesën për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, për blerjen dhe rikonstruksionin e këtij objekti. Deri në vitin 2012, ky objekt ka qenë në pronësi të Shoqërisë “A.”, por meqenëse kjo shoqëri kishte detyrime financiare ndaj subjektit privat “Z.G.”, i ka transferuar këtij të fundit pronësinë e objektit, me vlerë kontabile të transferuar 20,010,000 lekë. Për blerjen e këtij objekti rezultojnë faktet si më poshtë:

- Bashkia Mat me VKB nr. 16 datë 08.04.2016 ka propozuar kalimin e objektit të ish-hotelit në fond publik banesash sociale dhe i ka kërkuar MFE alokimin e një fondi prej 93.2 milionë lekë për blerjen e objektit dhe rikonstruksionit të tij. Gjithashtu, Bashkia Mat ka propozuar që të ngrihet një grup pune për vlerësimin e objektit, në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave.

- Me shkresën nr. 1039 prot, datë 05.06.2020, nga Enti Kombëtar i Banesave është përcjellë raporti përmbledhës i vlerësimit, në përfundim të së cilit vlerësohet se kostoja e ndërtimit të dy pallateve 6-kate për strehimin e banorëve, në vlerën 203,900,000 lekë është më e ulët se kostoja e rikonstruksionit, përlllogaritur në vlerën 62,642,938 lekë me TVSh, duke lënë shënimin se për objektin duhet bërë një akt ekspertimi për qëndrueshmërinë. Për këtë të fundit, është bërë akt-ekspertiza nga Instituti i Ndërtimit ku është lënë rekomandimi se “*...struktura e objektit në gjendjen ekzistuese nuk i plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë sipas kushteve teknike në fuqi. Struktura duhet t’i nënshtrohet përforsimit dhe restaurimit të elementëve strukturorë në fuqi, duke u bazuar në një projekt përforsimi strukturor të detajuar për objektin. Gjithashtu të llogaritet qëndrueshmëria e objektit për aktivitetin sizmik të zonës*”.

- Me shkresën nr. 3980/1 datë 24.09.2021 përcjellë MFE-së, Bashkia Mat arsyeton se kostoja financiare e blerjes, përfshirë shpenzimet për rikonstruksionin dhe përshtatjen e objektit, nuk tejkalojnë kostot mesatare të ndërtimit për objekti të reja, sipas Udhëzimit nr. 3 datë 02.02.2016 për qytetin e Burrelit dhe rezulton me kursim mbi 98 milionë lekë.

Në përfundim, MFE me shkresën nr. 144/30 datë 28.07.2022 ka njoftuar Bashkinë Mat se projekti përkatës është miratuar për t’u mbështetur si fond banesash.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 3, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3.

Ndikimi/Efekti: Mospërditësimi i inventarit dhe mosregjistrimi i pasurive në pronësi të bashkisë, sjell riskun e zaptimit të këtyre aseteve, mosvënien në përdorim në funksion të komunitetit dhe potencialisht mungesë të ardhurash nga qiratë që mund të mblidhen nga këto pasuri.

Shkaku: Mungesë burimesh logjistike dhe njerëzore në bashkinë Mat, mos marrja e masave për përditësimin e inventarit si dhe mos rakordim me ZVASHK mbi statusin juridik të pasurive.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Mat, në bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të marrë masa për përditësimin e inventarit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik (evidentim në terren) të gjendjes së pronës.

Titulli i gjetjes: Mungesa e planeve të mbarështimit për menaxhimin e fondit pyjor dhe të dokumentacionit të administrimit të lëndës drusore të sekuestruar.

Situata: Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor rezultojnë se, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Mat nuk ka miratuar plane mbarështimi për pyjet. Bashkia Mat ka refuzuar procesin e regjistrimit fillestar të pasurive të tipit pyje dhe kullota dhe ngritjen e sistemit kombëtar të informacionit për pyjet, pasi sipas Bashkisë Mat, ky proces cënon sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullor duke u kaluar rrethëve fqinje si: Krujë, Kurbin, Mirditë dhe Dibër. Bashkia Mat ka në inventar 35,160.43 ha pyje/kullota, kurse në VKM-të e ndryshuara nr. 395, datë 13.05.2020 dhe nr. 684 datë 13.05.2020 rezultojnë një diferencë prej 995.19 ha kryesisht në:

1. Njësinë Administrative Ulëz, ekonomia pyjore Ulëz-Shkopet, Trodhen;
2. Njësinë Administrative Komsë, ekonomia pyjore Qafështamë-Ketë;
3. Njësinë Administrative Macukull, ekonomia pyjore Mbas Deje;
4. Njësinë Administrative Lis, ekonomia pyjore Balgjaj 1.

Referuar gjurmës së gjeoportalit ASIG për ndarjen e kufijve me rrethet fqinje është konstatuar se krahas fondit pyjor dhe kullor të cituar me lart, cënohet sipërfaqja e Liqenit Ulëz me rreth 300 ha dhe liqeni Shkopet cënohet në afërsi të digës me një sipërfaqe prej 20 ha. Për këtë arsye, Bashkia ka ngritur kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Apelit kundër Këshillit të Ministrave.

Për lëndën drusore të sekuestruar, përfshirë nga IKMT dhe institucione të tjera ligjzbatuese që i janë dorëzuar bashkisë Mat në sasinë 486.78 mst, nga auditimi konstatohet se nuk janë bërë hyrje në magazinë të materialit drusor, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”. Nga ana e Bashkisë Mat ndonëse nuk ka “fletëhyrje”, administrohen vetëm disa fatura “fletë dalje” të parregullta, dorëzuar shkollave dhe kopshteve etj., pa nënshkrimet e magazinierit dhe pa firmë llogaritari, për pasojë nuk ka gjurmë auditimi mbi mënyrën e shpërndarjes së lëndës drusore nëpër shkollë, kopshte apo institucione të tjera në varësi të bashkisë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 3, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 57/2020 “Për Pyjet” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, neni 27.

Ndikimi/Efekti: Plani i mbarështimit është dokumenti bazë për një ekonomi pyjore, mungesa e të cilit pengon analizën e gjendjes së pyjeve, përcaktimin e objektivave që duhet të realizohen, si dhe planifikimin e masave për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.

Shkaku: Moszbatimi i detyrimeve ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa që të miratojë plane mbarështimi për ekonominë pyjore si dhe të bëjë hyrje në magazinë lëndën drusore të sekuestruar, duke dokumentuar të gjithë procesin e shpërndarjes nëpër shkollë, kopshte dhe institucione të tjera.

Titulli i gjetjes: Lidhja e kontratave të qirasë për aktivitetet e “HEC”-ve në fondin pyjor.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në 2 raste janë lidhur kontrata qiraje me subjekte që operojnë në fushën e HEC-ve, të cilët rezultojnë debitorë dhe që nuk kanë përmbushur detyrimin e rehabilitimit të sipërfaqes të hequr nga fondi pyjor, si vijon:

1. Kontrata e qirasë nr. 3598 prot., datë 23.08.2022 mes Bashkisë Mat dhe qiramarrësit “A.A.” ShPK, është lidhur si shtesë e kontratës së qirasë nr. 3575 prot., datë 04.08.2021, në lidhje me shtyrjen e afatit. Në dosjen përkatëse është administruar një shkresë me nr. 3465 prot., datë 12.08.2022 ku subjekti informohet se bazuar në gjetjet e KLSH-së ka një detyrim në vlerën 2,596,350 lekë si dhe sipas verifikime të kryera në Zyrën e Taksave Vendore, rezultojnë se ka detyrime të pashlyera ndaj Bashkisë Mat.

Sa më sipër rezultojnë se Bashkia Mat ka vijuar me lidhjen e kontratës, pavarësisht se subjekti ka shkelur kushtet e kontratës, konkretisht;

- Kontrata e qirasë e datës 23.08.2022 është lidhur pa kryer shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse;

- Nga ana e subjektit nuk është rehabilituar sipërfaqja pyjore 0.156 ha për HEC-et “Guri i Zi”, “Daznjanë dhe “Shell”, sipas urdhërit të Ministrit nr. 108, datë 12.04.2018, që njëkohësisht, përbën edhe arsye për zgjidhjen e kontratës së amenduar nr. 3575 datë 04.08.2021 dhe asaj të rinovuar me nr. 3598 datë 23.08.2022, neni 12, ku përcaktohet se kontrata zgjidhet kur qiramarrësi që kryen veprimtarinë nuk e ka rehabilituar zonën pyjore në përputhje me planin e rehabilitimit.

Në kundërshtim me pikën 24 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 “*Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik*”, në dosje nuk administrohen:

- leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;
- kontrata/marrëveshja e lidhur me autoritetin përkatës për ushtrimin e aktivitetit sipas pikës 22 të këtij udhëzimi;
- projekti teknik dhe grafiku i punimeve të parashikuara;
- hartat topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastrale pyjorë dhe kullorë;
- leja e mjedisit/deklarata e ministrit të Mjedisit;
- leja e ndërtimit.

2. Me shkresën nr. 2500 prot., datë 09.06.2022, Shoqëria “D.E.” ShPK është njoftuar nga Bashkia Mat për përfundimin e kontratës së qirasë lidhur datë 08.05.2017 për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor publik për HEC “Antena” ndërtuar në ekonominë pyjore Koms, Qafshatë-Ketë 2 me afat kohor 5 vjeçar (08.05.2017-08.05.2022). Ndërsa, me shkresën nr. 3451 prot, datë 12.08.2022 ky subjekt është njoftuar se ka detyrime në vlerën 2, 279,980 lekë, konstatuar nga auditimi i KLSH-së si dhe nga verifikimi i sistemit të tatim taksave. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se:

- Me shkresën nr. 2500/1 prot., datë 21.06.2022 drejtuar Bashkisë Mat, shoqëria “D.E.” ShPK, shprehet se ka përfunduar punimet e HEC “Antena” dhe se ka patur ndryshim mes projektit dhe zbatimit, ku si rrjedhojë ka rezultuar se gjatësitë e kanaleve, rrugëve etj., janë 3.175 km dhe jo 5.921 km, sikurse ishte përcaktuar në kontratën e mëparshme. Mbi këtë arsyetim, subjekti ka kërkuar rivlerësimin e detyrimit të prapambetur nga 1,771,940 lekë që rezultonte nga 5.921 km në vlerën 1,335,090 lekë;

- Në datën 05.07.2022 është mbajtur procesverbali për vlerësimin e gjatësisë së veprave hidroteknike;

- Në datën 07.04.2023, me kontratën nr. 1522 prot., është rinovuar kontrata për një periudhë 10 vjeçare për dhënien me qira të një sipërfaqeje prej 4 km (nga 5.921 km), me tarifë 529,300 lekë nga 603,280 lekë, vlerësuar në kontratën e mëparshme.

Sa më sipër konstatohet se:

- Ndryshimi mes projektit dhe zbatimit përfundimtar i HEC “Antena”, sipas shkresës nr. 2500/1 datë 21.06.2022, i përket kuadrit rregullues të Ligjit nr. 8402 datë 10.09.198 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” dhe situacionet e punimeve të vulosura/firmosura sipas Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 dhe Udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011, “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” e për rrjedhojë nuk është tagër i Bashkisë Mat. Nëse përgjatë zbatimit rezultojnë devijime nga projekti i miratuar nga KKT, organ ky përgjegjës për lejet e ndërtimit të HEC-ve, çdo ndryshim projekti duhet të marrë miratimin nga KKT;

- Në kontratën e datës 07.04.2023, subjektit i është dhënë me qira nën/ngastra pyjore 48/b, e cila nuk është pjesë e raportit teknik të miratuar për dhënien në përdorim të fondit pyjor si dhe të projektit të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit, në bazë të vendimit nr. 08 datë 10.11.2017.

- Për të dyja praktikat e mësipërme, nuk administrohet në dosje dokumentacioni si leja e ndërtimit, hartat topografike etj.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 3, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 57/2020 “Për Pyjet”, VMK nr. 537 datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e kostove për pyllëzimin kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”, Udhëzimi nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”.

Ndikimi/Efekti: Cënimi i fondit pyjor nga mungesa e rehabilitimeve.

Shkak: Moszbatimi i detyrimeve ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa për të lidhur me të gjitha subjektet që operojnë në fushën e HEC-ve një marrëveshje ku të përcaktohen kostot e pyllëzimit kompensues, vlera e të cilës të përfshihet si aneks i kontratave të qirave, duke monitoruar zbatimin e tyre. Në rast të moszbatimit të këtij detyrimi, Bashkia Mat të anulojë të gjitha kontratat e qirasë për subjektet që kanë shkelur kushtet, duke njoftuar Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si agjenci përgjegjëse për monitorimin e HEC-eve.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë, shërbime dhe mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2019-31.12.2019:

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, nga Bashkia Mat, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej 30 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 51,949,627 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 49,393,178 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 2,556,449 lekë pa TVSh ose 5%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën më poshtë:

Procedura 01.01.2019-31.12.2019	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	30	51,949,627	49,393,178	2,556,449
Kërkesë për propozim	11	40,573,088	39,177,104	1,395,984
Negocim pa shpallje	2	1,452,250	1,444,098	8,152
Me vlerë të ulët	18	9,924,289	8,771,976	1,152,313
Sipas objekteve	30	51,949,627	49,393,178	2,556,449
Objekte në fushën e investimeve	-	-	-	-
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	30	51,949,627	49,393,178	2,556,449

U audituan gjithsej 7 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 28,760,314 lekë dhe vlerë të kontratave 28,104,200 lekë ose 55% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 15 OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar 5 OE/BOE. Me 1 OE kanë qenë 2 procedura, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë 5 procedura. Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Blerje automjet (fuoristrade) per sherbimin zjarrfikës	Kërkesë për propozim	C.	2,375,000	2,370,000
2	Blerje naftë	Me negociim pa shpallje	J.	1,042,528	1,042,528
3	Hidroizolim taraca e muzeut	Kërkesë për propozim	P.	1,889,000	1,878,277
4	Mirembajtje kanale vaditese	Kërkesë për propozim	A.	4,837,566	4,700,000
5	Mirëmbajtje objekte ndertimore dhe lysterje	Kërkesë për propozim	A.	5,700,000	5,613,842
6	Ushqime Kopshte	Kërkesë për propozim	S.T.	4,916,667	4,500,000
7	Blerje naftë	E hapur	J.	7,999,553	7,999,553
Totali				28,760,314	28,104,200

Procedurat e periudhës 01.01.2020-31.12.2020:

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, nga Bashkia Mat referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve janë kryer gjithsej 44 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 2,100,181,653 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 2,065,908,300 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 34,273,353 lekë pa TVSh ose 1.63%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2020-31.12.2020	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	44	2,100,181,653	2,065,908,300	34,273,353
E hapur	8	2,021,187,140	1,996,800,340	24,386,800
Kërkesë për propozim	17	59,438,856	46,334,070	13,104,786
Negociim pa shpallje	2	6,249,999	5,527,924	722,075
Shërbim Konsulence	1	6,666,665	6,620,000	46,665
Me vlerë të ulët	16	6,638,993	5,741,326	897,667
Sipas objekteve	44	2,100,181,653	2,065,908,300	34,273,353
Objekte në fushën e investimeve	6	1,954,992,520	1,947,109,069	7,883,451
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	38	145,189,133	118,799,231	26,389,902

U audituan gjithsej 4 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 1,952,634,844 lekë dhe vlerë të kontratave 1,944,781,239 lekë ose 92.9% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 9 OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar 5 OE/BOE dhe janë kualifikuar 4 OE/BOE. Me 1 OE ka qenë 1 procedurë, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë 4 procedura. Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Ndërtim i rrjetit të kuz Blloku Drita nr. 1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagjja e re, qyteti Burrel	E hapur	BOE C. & K.	71,820,319	71,754,165
2	Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësive administrative Derjan dhe Rukaj – Loti II	E hapur	BOE E. & E.	281,831,672	279,860,372
3	Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësive administrative Derjan dhe Rukaj - Loti I	E hapur	BOE E. & E.	561,354,044	557,546,953
4	Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat	E hapur	BOE L.O. & F.	1,037,628,809	1,035,619,749
Totali				1,952,634,844	1,944,781,239

Procedurat e periudhës 01.01.2021-31.12.2021:

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, nga Bashkia Mat referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve janë kryer gjithsej 42 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 137,111,377 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur 131,336,964 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga

fondi limit në shumën 5,774,413 lekë pa TVSh ose 4%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2021-31.12.2021	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	42	137,111,377	131,336,964	5,774,413
E hapur	3	44,250,623	42,463,943	1,786,680
E hapur e thjeshtuar	9	48,410,147	47,625,509	784,638
Kërkesë për propozim	8	26,565,252	24,575,435	1,989,817
Me vlerë të ulët	20	6,299,785	5,136,310	1,163,475
Negociim pa shpallje	1	3,252,237	3,250,767	1,470
Shërbim Konsulence	1	8,333,333	8,285,000	48,333
Sipas objekteve	42	137,111,377	131,336,964	5,774,413
Objekte në fushën e investimeve	3	31,666,666	29,893,154	1,773,512
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	39	103,153,044	101,443,810	1,709,234

U audituan gjithsej 6 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 74,420,064 lekë dhe vlerë të kontratave 72,012,597 lekë ose 54% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 12 OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar 6 OE/BOE dhe janë kualifikuar 6 OE/BOE. Me 1 OE ka qenë 4 procedurë, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë 2 procedura. Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Ndërtimi i Aneksit të Stadiumit"	E hapur	2.	30,000,000	28,230,508
2	Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Lis, Ambulancës Zenisht, dhe Ambulancës Mallunxë"	E hapur	C.	11,199,324	11,000,314
3	Rikonstruksion i godinave në pronësi për strehim social	E hapur	R.	10,699,138	10,640,108
4	Rehabilitimi i ambienteve të brendshme të konviktit faza II	E hapur	V.N.	9,337,199	8,980,900
5	Blerje kamion spërkatës (autobot) dhe minieskavator	E hapur	T.	9,932,167	9,910,000
6	Rehabilitimin e segmenteve të rrugës kryesore të fshatit Frankth, të rrugës të shkollës së fshatit Frankth, të rrugës fshatit Shëlli	Negociim pa shpallje	D.	3,252,237	3,250,767
Totali				74,420,064	72,012,597

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022:

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga Bashkia Mat referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej 38 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 281,948,057 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 276,357,925 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 5,590,131 lekë pa TVSh ose 2%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Gjithsej	38	281,948,057	276,357,925	5,590,132
E hapur	5	250,979,663	247,627,966	3,351,697
E hapur e thjeshtuar	6	18,051,598	16,160,942	1,890,656
Me vlerë të ulët	27	12,916,795	11,346,860	1,569,935
Sipas objekteve	38	281,948,057	276,357,925	5,590,132
Objekte në fushën e investimeve	4	199,921,330	196,641,614	3,279,716
Objekte në fushën e shërbimeve/blerje		82,026,727	79,716,311	2,310,416

U audituan gjithsej 6 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 255,812,996 lekë dhe vlerë të kontratave 252,325,966 lekë ose 90.7% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 12 OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar 6 OE/BOE dhe janë kualifikuar 6 OE/BOE. Me 1 OE ka qenë 4 procedurë, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë 2 procedura. Procedurat e zgjedhura për auditim janë paraqitur në tabelën më poshtë. Vlerat e paraqitura janë pa TVSh.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	Vlera e kontratës
1	Rikonstruksion Shkolla 9-vjecare “Mustafa Gjesta”, Burrel	E hapur	OE U.	100,192,723	98,447,456
2	Rikonstruksion i Gjymnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat	E hapur	BOE “E.S.” dhe “B.I.”	95,678,607	94,182,418
3	Blerje Naftë Diesel (D1) dhe Benzinë pa plumb	E hapur	OE R.	25,358,313	25,358,313
4	Blerje materiale të ndryshme ndërtimi	E hapur	BOE S. dhe S.G.	20,833,333	20,723,092
5	Shërbim mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të automjeteve	E hapur, M. Kuadër	I.M.	8,916,666	8,916,666
6	Blerje makinerie teknologjike për pastrim		L.	4,833,000	4,698,000
Totali				255,812,996	252,325,966

Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Mat për periudhën 01.01.2019-31.12.2022, janë paraqitur në Aneksat P1-P4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Procedurat e zhvilluara në total, sipas llojit janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Procedura 01.01.2019-31.12.2019	Nr.	Vlera e Fondit Limit	Vlera e Kontraktuar	Diferenca me Fondin Limit
Të hapura	16	2,316,417,426	2,286,892,249	29,525,177
Kërkesë për propozim	36	126,577,196	110,086,609	16,490,587
E hapur e thjeshtuar	15	66,461,745	63,786,451	2,675,294
Negociim pa shpallje	5	10,954,486	10,222,789	731,697
Shërbim Konsulencë	2	14,999,998	14,905,000	94,998
Me vlerë të ulët	81	35,779,862	30,996,472	4,783,390
Gjithsej	154	2,571,190,714	2,516,889,570	54,301,144

Procedurat e audituara, janë paraqitur të përmbledhura në tabelën më poshtë.

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	VL. kontratës
1	Blerje automjet (fuoristrade) për shërbimin zjarrefikes	Kërkesë për propozim	C.	2,375,000	2,370,000
2	Blerje naftë	Me negociim pa shpallje	J.	1,042,528	1,042,528
3	Hidroizolim taraca e muzeut	Kërkesë për propozim	P.	1,889,000	1,878,277
4	Mirëmbajtje kanale vaditese	Kërkesë për propozim	A.	4,837,566	4,700,000
5	Mirëmbajtje objekte ndërtimore dhe llyerje	Kërkesë për propozim	A.	5,700,000	5,613,842
6	Ushqime Kopshte	Kërkesë për propozim	S.T.	4,916,667	4,500,000
7	Blerje naftë	E hapur	J.	7,999,553	7,999,553
8	Ndërtim i rrjetit të kuz Blloku Drita nr. 1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagja e re, qyteti Burrel	E hapur	BOE C. & K.	71,820,319	71,754,165
9	Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj – Loti II	E hapur	BOE E. & E.	281,831,672	279,860,372
10	Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj - Loti I	E hapur	BOE E. & E.	561,354,044	557,546,953
11	Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat	E hapur	BOE L. & F.	1,037,628,809	1,035,619,749
12	Ndërtimi i Aneksit të Stadiumit	E hapur	2.	30,000,000	28,230,508
13	1. Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore Lis, Ambulancës Zenisht, dhe Ambulancës Mallunxë	E hapur	C.	11,199,324	11,000,314
14	Rikonstruksion i godinave në pronësi për strehim social	E hapur	R.	10,699,138	10,640,108
15	Rehabilitimi i ambienteve të brendshme të konviktit faza II	E hapur	V.N.	9,337,199	8,980,900
16	Blerje kamion spërkatës (autobot) dhe minieskavator	E hapur	T.	9,932,167	9,910,000
17	Rehabilitimin e segmenteve të rrugës kryesore të fshatit Frankth, të rrugës të shkollës së fshatit Frankth, të rrugës fshatit Shëlli	Negociim pa shpallje	D.	3,252,237	3,250,767
18	Rikonstruksion Shkolla 9-vjecare “Mustafa Gjesta”, Burrel	E hapur	OE U.	100,192,723	98,447,456
19	Rikonstruksion i Gjymnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat	E hapur	BOE “E.S.” dhe “B.I.”	95,678,607	94,182,418

Nr.	Objekti	Lloji i procedurës	OE fitues	Fondi limit	VI. kontratës
20	Blerje Naftë Diesel (D1) dhe Benzinë pa plumb	E hapur	OE R.	25,358,313	25,358,313
21	Blerje materiale të ndryshme ndërtimi	E hapur	BOE S. dhe S.G.	20,833,333	20,723,092
22	Shërbim mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të automjeteve	E hapur, M. Kuadër	I.M.	8,916,666	8,916,666
23	Blerje makinerie teknologjike për pastrim	E hapur e thjeshtuar	L.	4,833,000	4,698,000
Totali				2,311,627,866	2,297,223,981

Titulli i gjetjes: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2019-31.12.2022, janë konstatuar mangësi në hartimin e Fondit Limit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga AK.

Situata: Referuar të dhënave më sipër, për periudhën 01.01.2019-31.12.2022, janë realizuar gjithsej **154** procedura me fond limit **2,571,190,714** lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate **2,516,889,570** lekë pa TVSh, me një diferencë për vlerën **54,301,144** lekë ose ulje nga fondi limit në masën **2.11%**, nga të cilat:

Për vitin 2019 janë realizuar **30** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit **51,949,627** lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur **49,393,178** lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **2,556,449** lekë pa TVSh ose **5%**;

Për vitin 2020 janë realizuar **44** procedura me fond limit **2,100,181,653** lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate **2,065,908,300** lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **34,273,353** lekë pa TVSh ose **1.63%**;

Për vitin 2021 janë realizuar **42** procedura me fond limit **137,111,377** lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate **131,336,964** lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **5,774,413** lekë pa TVSh ose **4.2%**;

Për vitin 2022 janë realizuar **38** procedura me fond limit **281,948,057** lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate **133,942** mijë lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **5,590,132** lekë pa TVSh ose **1.98%**.

Referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut, nga **154** procedura me fond limit **968,088** mijë lekë, grupi i auditimit vlerësoi për auditim **23** procedura me fond limit **2,311,627,866** lekë ose **89.9%** e fondit limit total ose **91.27%** të vlerës totale të kontratave, nga të cilat:

Për vitin 2019, nga **30** procedura me fond limit **51,949,627** lekë pa TVSh, u audituan **7** procedura, me fond limit **28,760,314** lekë pa TVSh ose **55%** e vlerës së fondit limit të prokuruar. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej **15** OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar **5** OE/BOE. Me **1** OE kanë qenë **2** procedura, ndërsa me **1** OE të kualifikuar kanë qenë **5** procedura;

Për vitin 2020, nga **44** procedura me fond limit **2,100,181,653** lekë pa TVSh, u audituan **4** procedura, me fond limit **1,952,634,844** lekë pa TVSh ose **92.9%** e vlerës së fondit limit të prokuruar. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej **9** OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar **5** OE/BOE dhe janë kualifikuar **4** OE/BOE. Me **1** OE ka qenë **1** procedurë, ndërsa me **1** OE të kualifikuar kanë qenë **4** procedura;

Për vitin 2021, nga **42** procedura me fond limit **137,111,377** lekë pa TVSh, u audituan **6** procedura, me fond limit **74,420,064** lekë pa TVSh ose **54%** e vlerës së fondit limit të prokuruar. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej **12** OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar **6** OE/BOE dhe janë kualifikuar **6** OE/BOE. Me **1** OE ka qenë **4** procedurë, ndërsa me **1** OE të kualifikuar kanë qenë **2** procedura.

Për vitin 2022, nga **38** procedura me fond limit **281,948,057** lekë pa TVSh u audituan **6** procedura, me fond limit **255,812,996** lekë pa TVSh ose **90.7%** e fondit limit të prokuruar. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej **12** OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar **6**

OE/BOE dhe janë kualifikuar 6 OE/BOE. Me 1 OE ka qenë 4 procedurë, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë 2 procedura.

Nga auditimi i 23 procedurave me fond limit **2,311,627,866** lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje të LPP, legjislacionit të fushës sipas natyrës së objekteve të prokuruar dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

➤ **Për aktivitetin e vitit 2019**, nga auditimi i 7 procedurave me fond limit **28,760,314** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit, për vlerën totale të kontraktuar 15,620,358 lekë pa TVSh;

- Në 6 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 25,734,200 lekë pa TVSh;

- Në 6 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 26,225,923 lekë pa TVSh;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2020**, nga auditimi i 4 procedurave, me fond limit **1,952,634,844** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh;

- Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2021**, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit **74,420,064** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 2 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 31,481,275 lekë pa TVSh;

- Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 57,761,516 lekë pa TVSh;

➤ **Për aktivitetin e vitit 2022**, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit **255,812,996** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 5 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 247,627,945 lekë pa TVSh;

- Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 238,711,279 lekë pa TVSh;

- Në 1 procedurë, u konstatuan probleme në lidhje me marrjen e mallit në dorëzim, i cili kishte mospërputhje me ST të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, për vlerën totale të kontraktuar 4,698,000 lekë pa TVSh;

Vendosja e kriterëve të vlerësimit në mënyrë të paargumentuar apo të papërshtatshme dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, rrjedhimisht në mospërputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik, shkel qëllimin dhe parimet kryesore të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, siç është nxitja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së shoqërive të vogla e të mesme, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, etj., konkretisht neni 2 “*Qëllimi*”, pikat d) dhe dh); neni 3 “*Parime të përgjithshme*”, pikat 1 dhe 2; neni 41, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*”, pika 3; neni 76, neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, pika 4; neni 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pikat 1, 2 dhe 5; dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për*

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5;

Duke shpallur fitues OE/BOE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2. Vlerësimi i gabuar i ofertave, ka shkaktuar që AK Bashkia Mat, gjatë periudhës 2019-2022, të lidhë kontrata në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **2,267,479,957 lekë** pa TVSh.

Mangësitë në vendosjen e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave për procedurat e vitit 2020 dhe një pjesë të vitit 2021, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 20, 23, 24, 46, 47, 53, 55, 58 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61, aktualisht të shfuqizuara.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimet nr. 2, 5, 8, 11 dhe 16, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh); neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2; neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3; neni 76, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4; neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2.

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 20, 23, 24, 46, 47, 53, 55, 58 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61, aktualisht të shfuqizuara.

Shkaku: Mosvlerësimi i drejtë i kriterëve, kriterë jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe/ose aplikimi i kriterëve të rënduara, të cilat çojnë direkt ose indirekt në uljen e numrit të OE pjesëmarrës.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe jo në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST duke shkaktuar lidhje kontratash në kundërshtim me LPP dhe aktet nënligjore për vlerën totale **2,267,479,957 lekë** pa TVSh.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Mat, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të mirëtrajnuar, të përdoren metodat e parashikuara me akte ligjore dhe eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike dhe minimizimin e shpenzimeve të cilat nuk janë të domosdoshme.

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Mat, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Rekomandimi 3: Kryetari i Bashkisë Mat, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhëri prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Mat dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

Rekomandimi 4: Kryetari i Bashkisë Mat, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Rekomandimi 5: Nga strukturat e Bashkisë Mat të mbahet në vëmendje zbatimi i kontratës në zbatim të kuadrit rregullator të fushës. Mallrat dhe shërbimet e lidhura me to që do të furnizohen duhet të merren në dorëzim sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Procedurat e audituara për periudhën 01.01.2019-31.12.2019

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje objekte ndërtimore + lyerje për shkollat dhe objektet e Bashkisë Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 318, datë 22.08.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 316, datë 22.08.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 317, datë 22.08.2019
4. Lloji i Procedurës: Kërkesë për propozim	1. A.N., Kryetar 2. A.M., Anëtar 3. D.N., Anëtar	1. A.G., Kryetar 2. E.Ç., Anëtar 3. D.T., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,653,597 lekë	6. Oferta fituese: A. ShPK Oferta 5,613,842 lekë pa TVSh. Kontrata datë 25.09.2019, me afat 60 ditë nga data e fillimit të punimeve	7. Diferenca me fondin limit: 39,755 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 09.09.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019: 5,553,597 lekë Të ardhura 2019: 100,000 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Fondi limit: Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Mat me shkresën datë 22.08.2019 së bashku me preventivin e punimeve i hartuar nga ing. E.L. dhe ing. A.M. ka kërkuar zhvillimin e procedurës me objekt “Mirëmbajtje objekte ndërtimore + lyerje për shkollat dhe objektet e Bashkisë Mat”. Për hartimin e fondit limit nuk është ngritur urdhër i posaçëm nga titullari i Autoritetit Kontraktor dhe është hartuar nga inxhinierët z. E.L. dhe z. A.M. punonjës të Drejtorisë së Shërbimeve Bashkia Mat. Komisioni në bazë të punimeve të përlogaritura për procedurën e mësipërme ka përcaktuar vlerën e fondit limit 5,653,597 lekë i cili nga auditimi i kryer për zërat e preventivit punime janë përlogaritur në përputhje me VKM nr. 629 dt 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Pjesë e dosjes së bashku me preventivin duhet të jetë dhe grafiku i punimeve i cili nuk është përgatitur nga inxhinierët që kanë përlogaritur fondin limit në kundërshtim me nenin 26 pika 4 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014.

Hartimi i kriterëve: Më datë 27.08.2019 është mbajtur procesverbali nr. 1 “Për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe hartimin e kriterëve të veçanta”. DST nuk janë firmosur nga z. A.M..

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kriterë të paargumentuara e të pambështetura në ligj, konkretisht:

1. Pika 2.3.3. nuk është në përputhje me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.

2. Pika 2.3.4. nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton që specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e AK për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës. Në kundërshtim me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Licencat të cilat nuk janë në përputhje me objektin e kontratës janë:

- N.S.2 A (Impiante hidro - sanitare, kuzhina, lavanteri , mirëmbajtja e tyre)
- N.P.2 A (Ndërtime civile dhe industriale)

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, është skualifikuar OE “H.M.” ShPK për mosparaqitje dokumentash dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese OE “A.” ShPK me ofertën ekonomike **5,613,842 lekë pa Tvsh.**

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenet 64, 66 dhe 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

- Sipas kriterëve të veçanta në DST operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetet autobot uji (1 copë).

- Sipas kriterëve të veçanta në DST operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për mjetin kamion me targa AA967HU, i cili sipas lejes së qarkullimit është në pronësi të z. L.H.A. dhe jo të shoqërisë “A.” ShPK. Për mjetin nuk ka kontratë qiraje për përdorim nga shoqëria “A.”. Sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë prej z. A.G., z. E.Ç., znj. D.T..

Konkluzion: OE “A.” ShPK nuk plotëson kriteret e vendosura në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1 (a), dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 5,653,957 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Nga AK është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi një punësim mesatar minimumi prej 15 (pesëmbëdhjetë) persona duke përfshirë edhe stafin drejtues dhe teknik, **për periudhën janar 2019- korrik 2019**".

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 46, pika 1/b, si dhe VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Neni 26, pika 8. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat janë publikuar së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet/shërbimet që do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat e tenderit.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Periudha e kërkuar, përveç **besueshmërisë së operatorëve ekonomik**, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë subjekti ofertues. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E njëjta praktikë ndiqet nga të gjithë autoritetet kontraktore për prokurime të ngjashme. Bashkëngjitur procesverballi i argumentimit të kriterëve për procedurën me objekt "Rikonstruksioni në ambientet e brendshme në godinën e KLSH-së" ku argumentohet kriteri "Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik –shtator 2023.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e ngritura NjP e përbërë nga z. A.N., z. A.M. dhe z. D.N. ju bëjmë me dijeni se:

Në dijeninë e grupit të auditimit për verifikimin e dokumentave të tenderit apo ftesë për ofertë duhet një adresë (**Ilogari**) e hapur nga Agjencia e Prokurimit Publik për të vërtetuar pretendimin e ngritur nga Ju. Për më tepër nuk argumentohet mënyra se si nga ana Juaj janë verifikuar DT apo ftesa për ofertë e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Pretendimi Juaj ngrihet mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion në ambientet e brendshme në godinën e KLSH-së" për vitin 2023, ku argumentoni kriterin "Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërive për periudhën Korrik-Shtator 2023". Theksojmë se në observacion ngrihen pretendimet mbi një procedurë që edhe nga Ju vetë nuk përcaktoni çfarë procedure është me vlerë të ulët apo të lartë (pra nuk evidentohet fondi limit apo cili OE e ka fituar këtë procedurë). Për më tepër nuk paraqitet asnjë dokumentacion justifikues konkretisht DT apo ftesë për ofertë për të cilat ngrihen pretendimet nga Ju.

Gjithashtu vlen të theksohet se dokumentohet dhe argumentohet mënyra se si është përfituar ky informacion kofidencial kur jemi në kushtet kur, Ju nuk keni akses për verifikimin e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij observacioni grupi i auditimit me përgjegjësi maksimale dhe në mënyrë profesionale duke komunikuar dhe verifikuar regjistrin elektronik të publikuar në APP mbi planifikimin dhe realizimin për vitin 2023 për procedurat e prokurimit konstatohet se, procedura e cila pretendohet nga ju i për një procedure prokurimi me vlerë të vogël, ku referuar ftesës për ofertë kapaciteti i punonjësve për një periudhë 3 mujore nuk kërkohet si kriter.

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë fuqinë punëtore prej 15 punonjës për periudhën janar 2018-korrik 2019. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 19-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit:

2. Licenca N.S.2.A (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre).

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 46, pika 1/a; VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 8., si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

Sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtje e tyre. Konsiderohet, montimi, mirëmbajtja ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jete shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara nëpërmjet kësaj procedure pasi në preventiv parashikohen edhe punime riparimi dhe mirëmbajtje ullaqe shkarkimi ujërash etj., dhe jo vetëm lyerje. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z.A.N., z. A.M., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pabazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Pretendimi i subjektit:

3. Licenca N.P - 2 A Ndërtime civile e industriale.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 46, pika 1/a; VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 8., si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me nderhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshte ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Kjo liçencë nuk kërkohet vetëm për të riparuar strukturën e objektit.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara nëpërmjet kësaj procedure pasi punimet janë për mirëmbajtjen e objekteve ku zhvillohen aktivitetet njerëzore, shkolla, zyra etj., dhe punimet janë betonarme të thjeshta, punime plotësuese etj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z.A.N., z. A.M., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Pretendimi i subjektit:

4. Sipas kërkesave në DST kamioni vetëshkarkues është kërkuar sepse duhet të punojë për realizimin e punimeve në të gjitha objektet për transportimin dhe ngarkim -shkarkimin me vinxh të skelerive dhe materialeve të tjera të ndërtimit (tulla, çimento, rërën sipas preventivit) për secilin objekt në periudhën e zbatimit të punimeve, pasi vendndodhja e tyre është në disa njësi administrative.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Argumentat e përcjella në observacion nga njësia e prokurimit pranohen për kërkesën e mjetit kamion vetëshkarkues 4x4 me vinxh

Observacioni i paraqitur merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për kopshte Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 25, datë 25.01.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 25, datë 25.01.2019 1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 317, datë 22.08.2019 1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
4. Lloji i Procedurës: Kërkesë për propozim		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,916,666 lekë	6. Oferta fituese: A. ShPK Nuk ka	7. Diferenca me fondin limit: Nuk ka
8. Data e hapjes së tenderit: 11.02.2019	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Mat	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 2 OE , c) Kualifikuar 0 OE
11. Ankimime AK: N. ShPK, ankesë nr. 484 prot., datë 22.02.2019	12. Përgjigje ankesës nga AK: Urdhëri nr. 61 datë 25.02.2019	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Hartimi i fondit limit: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat nr. 24, datë 23.01.2019, me nr. 196 prot., është ngritur “Komisioni i përllogaritjes së fondit limit, testimit të tregut”, i përbërë nga z. N.P., znj. A.R. dhe z. A.N..

Komisioni për testimin e tregut sipas urdhërit të mësipërm ka marrë ofertat si më poshtë nga tregu:

- Testim tregu për çmimet e artikujve ushqimorë. Oferta është marrë nga operatori ekonomik A.T. me Nipt L.....E dhe S.Q. me Nipt K.....M.
- Testim tregu për çmimet e artikujve fruta-perime. Oferta është marrë nga operatori ekonomik S.D. me Nipt K.....H dhe X.A. me Nipt L.....P.
- Testimi i tregut për çmimet e artikujve bulmet dhe mish pule. Oferta është marrë nga operatori ekonomik S.D. me Nipt K.....H dhe A.M. me Nipt K.....P.
- Testimi i tregut për çmimin e artikullit mish viçi. Oferta është marrë nga operatori ekonomik S.D. me Nipt K.....H dhe I.L. me Nipt K.....P.
- Testim tregu për çmimin e artikullit bukë gruri. Oferta është marrë nga operatori ekonomik S.D. me Nipt K.....H dhe A.M. me Nipt K.....P.

Komisioni në bazë të testimit të tregut ka përcaktuar vlerën e fondit limit 4,916,658 lekë në përputhje me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Hartimi i kriterëve: Me urdhër prokurimi të Kryetarit të Bashkisë Mat nr. 25, datë 25.01.2019, me nr. 209 prot., është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. E.Ç., zj. A.G. dhe z. D.N. në procedurën “Kërkesë për propozim”, me fondin limit 4,916,666 lekë pa TVSh, nga të ardhurat Bashkia Mat+Grant.

- Në datë 29.01.2019 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kriterë të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1. Pika 2.3 (2). nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

2. Pika 2.3. nuk është në përputhje me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.

Vlerësimi i Ofertave: Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqime për kopshtet në Bashkinë Mat” i cili përbëhet nga z. P.M., z. E.B. dhe zj. D.T..

Në këtë tender ka marrë pjesë 2 OE, “4.” ShPK me Nipt L.....K me ofertë ekonomike 3,849,405 lekë dhe OE “N.” ShPK me Nipt J.....S me ofertë ekonomike 3,699,460 lekë.

Në datën 11.02.2019 është mbajtur procesverbal për hapjen dhe vlerësimin e ofertave me nr. 11/1 prot datë 1.02.2019. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi ka kryer vlerësimin ka skualifikuar të dy operatorët ekonomik për mosplotësim të kriterëve të veçanta.

Me shkresën nr. 433 prot datë 19.02.2019 nga njësia e prokurimit është hartuar formulari i njoftimit të anulimit dhe është firmosur nga titullari i AK.

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me pikën 5 të nenit 78 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhërin e brendshëm nr. 61 datë 25.02.2019 ka urdhëruar “Krijimin e komisionit të shqyrtimit të ankesës për tenderin me objekt blerje ushqimesh”, i përbërë nga A.N., Kryetar Komisioni; A.P. dhe A.M. Anëtarë.

Ankesa nga operatori N.: Operatori ekonomik i skualifikuar N. ShPK ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor me nr. 484 prot., datë 22.02.2019 për skualifikimin nga procedura e prokurimit “Blerje ushqime për kopshtet Bashkia Mat”.

Në datë 19.02.2019 KVO-ja ka njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik të APP vlerësimin e procedurës dhe skualifikimin me arsyet si më poshtë:

- Nuk keni paraqitur vërtetim xhiro për vitin 2018 nga administrata tatimore.
- Mungon lista e punonjësve për vitin 2017, si dhe nuk janë punësuar dy shofera.
- Mungon vërtetim nga AKU për thertoren brenda afatit tre mujor.
- Për mjetet e transportit mungon certifikata e transportit.

Kundërshtitë e operatorit ekonomik: 1. Xhiro e vitit 2018 del në sistemin e tatimeve pasi dorëzohet bilanci i vitit 2018. Xhiro e vitit 2016 ka qenë në vlerën 91,133,988 lekë, xhiro e vitit 2017 ka qenë në vlerën 89,734,477 lekë duke marrë në konsideratë xhiron e mëparshme subjekti e plotëson kufirin e xhiros së vendosur nga Autoriteti Kontraktor.

2. Sipas kërkesës së mësipërme për listën e punonjësve për vitin 2017 dhe numrin e shoferëve është dorëzuar vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë me nr. T00770955 datë

09.01.2019 për numrin mesatar të punonjësve nga periudha 01.02.2016-31.12.2018 gjithashtu kemi dorëzuar dhe patentat e dy drejtuesve të mjeteve.

3. Për kërkesën vërtetim nga AKU për thertoren brenda afatit 3 mujor. Në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/përdorim duhet që të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qartë lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: licencë, telefon, email, Website kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për verifikim.

4. Në lidhje me arsyen se për mjetet e transportit mungon certifikata e transportit, ju sqarojmë se në zbatim të nenit 28 të Udhëzimit nr. 15 datë 24.07.2007 *“Kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatat për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”* i ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 17.02.2011 përcaktohet qartë se kamionët me kapacitet transportues nën 1.500 kg nuk certifikohen për transport brenda vendit.

Automjeti me targa AA720GO është me kapacitet mbajtës 975 kg dhe automjeti me targa AA416DF është me kapacitet mbajtës 1,200 kg.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: **1.** Sipas formularit të ankesës nr. 484 datë 22.02.2019 observacioni i operatorit ekonomik duhet të merrej parasysh sepse operatori ekonomik e plotëson kërkesën e VKM 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 27, pika 5, gërma b.

2. Sipas formularit të mësipërm të ankesës Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ka vepruar drejtë sepse operatori ekonomik sipas listëpagesave të depozituara shofer me kodin përkatës në listëpagesat (E-Sig 025) është vetëm punonjësi G.M. kërkesa e Autoritet Kontraktor është për 2 punonjës të siguruar.

Kriteri për listëpagesat e vulosura nga Administrata Tatimore është plotësuar sepse ka dorëzuar të firmosura listëpagesat për periudhën 01.01.2018-31.12.2018. Pika 2 është plotësuar pjesërisht.

3. Sipas kërkesave të DST në pikën 2.3. *“Për kapacitetin teknik”*, është kërkuar të paraqitet vërtetim nga AKU lëshuar jo më vonë se tre muaj nga hapja e ofertave që thertorja është funksionale. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ka vepruar drejtë duke zbatuar kërkesat e DST pika 2.3 *“Kapacitetet teknike”*.

4. Sipas kërkesës në DST në pikën 2.3. (1) *“Për kapacitetin teknik”*, operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) mjete transporti frigoriferike ATV për të cilat duhet të paraqesë certifikatë transporti.

Sipas Udhëzimit nr. 5 datë 17.02.2011 *“Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”* neni 8 *“Kamionët me kapacitet nën 1,500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit”*.

Për të verifikuar peshën e ngarkesës se mjeteve Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave duhet të bazohet tek leja e qarkullimit në pikën 23 e cila përcakton peshën me ngarkesë maksimale dhe pika 24 peshën e mjetit.

Për mjetin me targa AA720GO pesha me ngarkesë maksimale është 2,800 kg ndërsa pesha e mjetit pa ngarkesë është 1,825 kg. Ky mjet nuk mund të pajiset me certifikatë sepse ngarkesa e këtij mjeti është 975 kg dhe nuk plotëson kërkesat e Udhëzimit nr. 5 datë 17.02.2011, si më sipër.

Për mjetin me targa AA416DF pesha me ngarkesë maksimale është 3,500 kg ndërsa pesha e mjetit pa ngarkesë është 2,300 kg. Ky mjet nuk mund të pajiset me certifikatë sepse ngarkesa e këtij mjeti është 1,200 kg dhe nuk plotëson kërkesat e udhëzimit nr. 5 datë 17.02.2011, si më sipër.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ka vepruar në përputhje me VKM 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* neni 78.

Operatori ekonomik i cili ka paraqitur ankesën nuk plotëson kriteret e veçanta të vendosura në DST.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë në stafin e tij teknolog ushqimor me jo më pak se 5 vjet pune i përfshirë në listpagesat e shoqërisë, për këtë duhet të paraqitet: kontratë pune, diplomë, cv, librezë pune.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit i Auditit të KLSH sqarojmë se kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 46, pika 1/b; VKM Nr. 914 date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Neni 28, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së mallrave që kërkohen është e nevojshme pasja e një stafi të kualifikuar. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës për realizimin e objektit. Operatori ekonomik duhet të disponojë një teknolog ushqimor për kryerjen e furnizimit/ shërbimit i cili ka një rol të rëndësishëm në kontrollin e ushqimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Me paraqitjen e dokumentacionit për **teknologun ushqimor** dhe me përvojën e kërkuar, Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet si dhe ushqimet janë të një cilësie të përshtatshme për të konsumuar **nxënësit në konviktit dhe fëmijët në kopësht dhe çerdhe**. Stafi i kërkuar duhet të jete i kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e objektit të prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit **z. E.Ç., z. A.G., z. D.N.**, me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Pretendimet e subjektit:

2. Pika 2.3 Operatori duhet të ketë jo më pak se 6 (gjashtë) persona të punësuar të siguruar për vitin 2017, nga këta 2 (dy) shofera të konfirmuar me kodin përkatës në listpagesat.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 46, pika 1/b, si dhe VKM Nr. 914 date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Neni 28, pika 5.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat janë publikuar së bashku me dokumentat e tenderit) si dhe furnizimin/shërbimet që do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat e tenderit.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Periudha e kërkuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë subjekti ofertues.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe

profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E njëjta praktikë ndiqet nga të gjithë autoritetet kontraktore për prokurime të ngjashme.

Bashkëngjitur procesverballi i argumentimit të kriterëve për procedurën me objekt “Rikonstruksioni në ambientet e brendshme në godinën e KLSH –së” ku argumentohet kriteri “Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik –shtator 2023.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e ngritura NjP e përbërë nga z. A.G., z. E.Ç. dhe z. D.N. ju bëjmë me dijeni se:

Në dijeninë e grupit të auditimit për verifikimin e dokumentave të tenderit apo ftesë për ofertë duhet një adresë (**llogari**) e hapur nga Agjencia e Prokurimit Publik për të vërtetuar pretendimin e ngritur nga Ju. Për më tepër nuk argumentohet mënyra se si nga ana Juaj janë verifikuar DT apo ftesa për ofertë e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Pretendimi Juaj ngrihet mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion në ambientet e brendshme në godinën e KLSH-së” për vitin 2023, ku argumentoni kriterin “Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërive për periudhën Korrik-Shtator 2023”. Theksojmë se në observacion ngrihen pretendimet mbi një procedurë që edhe nga Ju vetë nuk përcaktoni çfarë procedure është me vlerë të ulët apo të lartë (pra nuk evidentohet fondi limit apo cili OE e ka fituar këtë procedurë). Për më tepër nuk paraqitet asnjë dokumentacion justifikues konkretisht DT apo ftesë për ofertë për të cilat ngrihen pretendimet nga Ju.

Gjithashtu vlen të theksohet se dokumentohet dhe argumentohet mënyra se si është përfutur ky informacion kofidencial kur jemi në kushtet kur, Ju nuk keni akses për verifikimin e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij observacioni grupi i auditimit me përgjegjësi maksimale dhe në mënyrë profesionale duke komunikuar dhe verifikuar regjistrin elektronik të publikuar në APP mbi planifikimin dhe realizimin për vitin 2023 për procedurat e prokurimit konstatohet se, procedura e cila pretendohet nga ju i për një procedure prokurimi me vlerë të vogël, ku referuar ftesës për ofertë kapaciteti i punonjësve për një periudhë 3 mujore nuk kërkohet si kriter.

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë fuqinë punëtore prej 6 punonjës për vitin 2017. Vendosija e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar prej vitit 2017 kur procedura kryhet në vitin 2019, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

2/1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje ushqime për kopshte Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 53, datë 19.02.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 53, datë 19.02.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: 1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
4. Lloji i Procedurës: Kërkesë për propozim	1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,506,944 lekë	6. Oferta fituese: S.T. ShPK 4,500,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 25.07.2019	7. Diferenca me fondin limit: 6,944 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 07.03.2019	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë 1,583,333 lekë Grant 2,923,611 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 2 OE , c) Kualifikuar 0 OE
11. Ankimime AK: N. ShPK, ankesë nr. 484 prot., datë 02.04.2019; S.T. ShPK me datë 01.04.2019	12. Përgjigje ankesës nga AK: Urdhëri nr. 110 datë 04.04.2019 Vendimi nr. 136 datë 10.04.2019	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: Në datën 20.02.2019 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreun V, “*Zhvillimi i procedurave*”.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kriterë të paargumentuara e të pambështetura në LPP, konkretisht:

1. Pika 2.3. (2). nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

2. Pika 2.3. nuk është në përputhje me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.

Vlerësimi i Ofertave: Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje ushqime për kopshtet në Bashkinë Mat*” i cili përbëhet nga z. P.M., z. E.B. dhe zj. D.T..

Në këtë tender ka marrë pjesë 2 OE, “S.T.” ShPK me Nipt J.....H me ofertë ekonomike në vlerën 4,500,000 lekë dhe OE “N.” ShPK me Nipt J.....S me ofertë ekonomike në vlerën 3,699,460 lekë.

Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk është i plotë sepse mungojnë Urdhëri i Titullarit të Autoriteti Kontraktor për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave.

Nga verifikimi në sistemin SPE operatorët ekonomik S.T.” ShPK me Nipt J.....H me ofertë ekonomike në vlerën 4,500,000 lekë dhe OE “N.” ShPK me Nipt J.....S me ofertë ekonomike në vlerën 3,699,460 lekë, janë skualifikuar për mosplotësim kushtesh të veçanta të procedurës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se: OE “S.T.” ShPK i ka plotësuar kërkesat e DST dhe duhet të ishte kualifikuar për procedurën “*Blerje ushqime për kopshte*”.

Sa më sipër, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 66, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 3.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE “N.” ShPK, u konstatua se:

1. Autorizimi mjedisor i datës 03.01.2008 i paraqitur nga OE “N.” ShPK duhej konvertuar me leje mjedisore të tipit c sipas kërkesave të Ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011.

2. Sipas listëpagesave të gjeneruara nga Drejtoria Tatimore operatori ekonomik nuk disponon të regjistrua në listëpagesë 2 shofera me kodin përkatës. Patentat e dorëzuara nga OE nuk mund të konsiderohen nëqoftëse këta punonjës nuk janë të regjistruar në listëpagesë me kodin përkatës;

3. Kontrata e Furnizimit nuk është paraqitur e noterizuar sipas kërkesave të DST.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë prej z. P.M., z. E.B., znj. D.T.

Konkluzion: OE “S.T.” ShPK plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO duhej të kishte kualifikuar OE dhe duhej t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 55, “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, pika 1 (a), dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 66, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 3.

Pas mbylljes së procedurës së prokurimit pa fitues, operatorët ekonomikë OE “S.T.” ShPK dhe OE “N.” ShPK kanë dorëzuar ankesat në datë 02.04.2019 brenda afateve kohore të përcaktuara në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ngritja e komisionit të shqyrtimit të ankesave: Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhërin e brendshëm nr. 100 datë 04.04.2019 ka urdhëruar “Krijimin e komisionit të shqyrtimit të ankesës për tenderin me objekt blerje ushqimesh”, i përbërë nga: A.N., Kryetar; A.P. dhe J. K., Antarë.

Ankesa nga operatori N. ShPK: Operatori ekonomik i skualifikuar N. ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor me datë 02.04.2019 për skualifikimin nga procedura e prokurimit “Blerje ushqime për kopshtet Bashkia Mat”.

KVO-ja ka njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik të APP vlerësimin e procedurës dhe skualifikimin me arsyet si më poshtë:

1. Nuk keni paraqitur dokument për likuidimin e taksave vendore për vitin 2019;
2. Nuk keni paraqitur leje mjedisore me kodin përkatës për ambientet furrë buke;
3. Leje Higjeno-Sanitare për thertoren është jashtë afateve ligjore, pasi leja e paraqitur ka qenë me afat vjeçar me të drejtë ripërtëritje;
4. Kontrata e furnizimit për artikullin vezë jo noteriale;
5. Në kërkesat për kualifikim është kërkuar teknolog ushqimor ndërsa ju keni paraqitur merceolog;
6. Nuk keni paraqitur dy shofera me kodet përkatëse në listë pagesat e sigurimeve shoqërore.

Kundërshtitë e operatorit ekonomik: 1. Në lidhje me likuidimin e taksave vendore ne kemi paraqitur vërtetim për shlyerje taksave vendore për vitet 2016, 2017, 2018. Taksat vendore për vitin 2019 paguhen gjatë vitit 2019 sipas ligjit në fuqi nr. 9632 datë 30.10.2016, neni 14.

Në momentin që e kemi kërkuar, Bashkia Tiranë nuk kishte përcaktuar akoma nivelin e taksave nga Këshilli Bashkiak.

2. Për lejen mjedisore ne e kemi dorëzuar autorizimin mjedisor me nr. 17, datë 03.01.2008. Furra e Bukës është kompletuar me leje Higjeno- Sanitare, licencë, leje profesionale.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave: KSHA nuk e ka marrë në konsideratë observacionin e operatorit ekonomik duke mos pranuar asnjë nga argumentet e operatorit.

1. OE duhet të kishte paraqitur pagesën e kështit të parë.
2. Autorizimi mjedisor nuk është dokumentacion i kërkuar në DST por leja mjedisore kërkohet.
3. Leja Higjeno sanitare për thertoren është jashtë afateve ligjore, pasi leja e paraqitur ka qenë me afat 1 vjeçar me të drejtë rinovimi.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: 1. Taksat vendore nuk duhej të kërkoheshin për vitin 2019 sepse OE është brenda afatit për pagesën e taksave sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006. Procedura është hapur në datë 19.02.2019. OE ka detyrim ligjor të paguaj kështin e parë brenda datës 20.04.2019;

2. Autorizimi mjedisor i datës 03.01.2008 i paraqitur nga OE “N.” ShPK duhej konvertuar me leje mjedisore të tipit c sipas kërkesave të Ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011;

3. Leja Higjeno-Sanitare është jashtë afateve të kërkuara sipas legjislacionit por kontrata e furnizimit për të 2 OE “N.” dhe “S.T.” është me të njëjtet operatorë dhe duhet të konsiderohej e plotësuar kjo kërkesë;

4. Kontrata e Furnizimit nuk është paraqitur e noterizuar sipas kërkesave të DST;

5. Sipas listëpagesave të gjeneruara nga Drejtoria Tatimore nuk operatori ekonomik nuk disponon të regjistruar në listëpagesë 2 shofera me kodin përkatës. Patenta e dorëzuara nga OE nuk mund të konsiderohen nëqoftëse këta punonjës nuk janë të regjistruar në listëpagesë me kodin përkatës;

6. Skualifikimi i OE për paraqitjen e merceologut nuk qëndron sepse, Merceologjia është nëndegë e teknologjisë së prodhimit.

Ankesa merret parasysh pjesërisht.

Ankesa nga operatori S.T. ShPK: Operatori ekonomik i skualifikuar S.T. ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor me datë 01.04.2019 për skualifikimin nga procedura e prokurimit “Blerje ushqime për kopshtet Bashkia Mat”.

KVO-ja ka njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik të APP vlerësimin e procedurës dhe skualifikimin me arsyet si më poshtë:

- Nuk keni paraqitur dokument për likuidimin e taksave vendore për vitin 2019;

- Leja higjeno-sanitare për artikullin vezë është jashtë afatit.

Kundërshtitë e operatorit ekonomik: 1. Në lidhje me likuidimin e taksave vendore ne kemi paraqitur vërtetim për shlyerje taksave vendore për vitet 2016, 2017, 2018. Taksat vendore për vitin 2019 paguhen gjatë vitit 2019 sipas Ligjit në fuqi nr. 9632 datë 30.10.2016, neni 14.

2. Leja higjeno-sanitare e lëshuar pas vitit 2010 me emërtimin “Akt miratimi higjeno-sanitar” është 1 dokument pa afat, në ndryshim nga formati i vjetër i cili ka afat 1 vit nga data e lëshimit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave: KSHA ka marrë në konsideratë observacionin e operatorit ekonomik duke pranuar argumentet e operatorit.

1. OE ka paraqitur vërtetim për taksat vendore për vitin 2018, 2019 nga Bashkia Lushnjë;

2. Leja higjeno-sanitare për pularinë me nr. 85 datë 31.05.2011 nuk është me afat të caktuar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: 1. Taksat vendore nuk duhej të kërkoreshin për vitin 2019 sepse OE është brenda afatit për pagesën e taksave sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006. Procedura është hapur në datë 19.02.2019. OE ka detyrim ligjor të paguajë këstin e parë brenda datës 20.04.2019.

2. Leja higjeno-sanitare për pularinë me nr. 85 datë 31.05.2011 nuk është me afat të caktuar.

Me vendim Nr.136 datë 10.04.2019 KSHA ka pranuar ankesën nga OE “S.T.” ShPK dhe ka refuzuar ankesën e paraqitur nga operatori “N.” ShPK në përputhje me

VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78 “Shqyrtimi i ankesave”.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 4,500,000 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë në stafin e tij teknolog ushqimor me jo me pak se 5 vjet pune i përfshirë në listpagesat e shoqërisë, për ketë duhet të paraqitet: kontratë pune, diplomë, cv, librezë pune.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 46, pika 1/b; VKM Nr. 914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 28, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së mallrave që kërkohen është e nevojshme pasja e një stafi të kualifikuar. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës për realizimin e objektit. Operatori

ekonomik duhet te disponoje një teknolog ushqimor për kryerjen e furnizimit/ shërbimit i cili ka një rol të rëndësishëm në kontrollin e ushqimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Me paraqitjen e dokumentacionit për **teknologun ushqimor** dhe me përvojën e kërkuar, Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet si dhe ushqimet janë të një cilësie të përshtatshme për ti konsumuar **nxënësit në konviktit dhe fëmijët në kopësht dhe çerdhe**. Stafi i kërkuar duhet te jete i kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e objektit te prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z.E.Ç., z. A.G., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Pretendimet e subjektit:

2. Pika 2.3 Operatori duhet të ketë jo më pak se 6 (qjashtë) persona të punësuar të siguruar për vitin 2017, nga këta 2 (dy) shofera të konfirmuar me kodin përkatës në listpagesat.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 46, pika 1/b, si dhe VKM Nr. 914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 28, pika 5.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat janë publikuar së bashku me dokumentat e tenderit) si dhe furnizimin/shërbimet që do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat e tenderit.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per periudhen muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Periudha e kërkuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë subjekti ofertues.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E njëjta praktikë ndiqet nga të gjithë autoritetet kontraktore për prokurime të ngjashme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e ngritura NjP e përbërë nga z. A.G., z. E.Ç. dhe z. D.N. ju bëjmë me dijeni se:

Në dijeninë e grupit të auditimit për verifikimin e dokumentave të tenderit apo ftesë për ofertë duhet një adresë (**llogari**) e hapur nga Agjencia e Prokurimit Publik për të vërtetuar pretendimin e ngritur nga Ju. Për më tepër nuk argumentohet mënyra se si nga ana Juaj janë verifikuar DT apo ftesa për ofertë e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Pretendimi Juaj ngrihet mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikontruksion në ambientet e brendshme në godinën e KLSH-së” për vitin 2023, ku argumentoni kriterin “Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërive për periudhën Korrik-Shtator 2023”. Theksojmë se në observacion ngrihen pretendimet mbi një procedurë që edhe nga Ju vetë nuk përcaktoni çfarë procedure është me vlerë të ulët apo të lartë (pra nuk evidentohet fondi limit apo cili OE e ka fituar këtë procedurë). Për më tepër nuk paraqitet asnjë dokumentacion justifikues konkretisht DT apo ftesë për ofertë për të cilat ngrihen pretendimet nga Ju.

Gjithashtu vlen të theksohet se dokumentohet dhe argumentohet mënyra se si është përfituar ky informacion kofidencial kur jemi në kushtet kur, Ju nuk keni akses për verifikimin e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij observacioni grupi i auditimit me përgjegjësi maksimale dhe në mënyrë profesionale duke komunikuar dhe verifikuar regjistrin elektronik të publikuar në APP mbi planifikimin dhe realizimin për vitin 2023 për procedurat e prokurimit konstatohet se, procedura e cila pretendohet nga ju i për një procedure prokurimi me vlerë të vogël, ku referuar ftesës për ofertë kapaciteti i punonjësve për një periudhë 3 mujore nuk kërkohet si kriter.

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë fuqinë punëtore prej 6 punonjës për vitin 2017. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar prej vitit 2017 kur procedura kryhet në vitin 2019, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajt të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje automjet për shërbimin zjarrfikës”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 2923, datë 25.09.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 424, datë 25.09.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 422, datë 25.09.2019
4. Lloji i Procedurës: Kërkesë për propozim	1. A.N., Kryetar 2. A.M., Anëtar 3. D.N., Anëtar	1. E.Ç., Kryetar 2. A.D., Anëtar 3. D.T., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,375,000 lekë	6. Oferta fituese: OE C. ShPK me ofertë 2,370,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 04.11.2019, me afat 10 ditë nga firmosja e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit: 5,000 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 14.10.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019- 1,185,407 lekë Grant 2020- 1,189,593 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 0 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i fondit limit: Për hartimin e fondit limit nuk është ngritur urdhër nga titullari i Autoriteti Kontraktor dhe është zbatuar neni 59 pika 1 e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e Prokurimit ka administruar në dosjen e procedurës 3 oferta të paraqitura nga operatorët T.A.A., C. dhe U.M.. Komisioni për vlerësimin e çmimit të mallrave pjesë e kësaj procedure/komisioni i hartimit të fondit limit ka vepruar në përputhje me nenin 59 pika 2 germa (a) të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për llogaritja e vlerësimit të kontratës”.

Hartimi i kriterëve: Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kriterë të argumentuara:

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese OE “C.” ShPK me NIPT K.....J me ofertën ekonomike 2,370,000 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 66, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se: 1. Sipas kriterëve të përgjithshme në DST operatori ekonomik nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore.

2. Sipas kriterëve të përgjithshme në DST operatori ekonomik nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerjen e tatime.

Sa më sipër, mban përgjegjësi KVO i përbërë nga z. E.Ç., z. A.D., znj. D.T..

Konkluzion: OE “C.” ShPK nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1 (a) dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3.

Zbatimi i kontratës: Me urdhërin nr. 471 datë 10.10.2019 të titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve.

Objekti i prokurimit është bërë hyrje në magazinë sipas dokumentit flete-hyrje nr. 59, datë 11.11.2019. Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve i përbërë nga z. A.P., z. A.S., z. A.M., z. E.L. dhe znj. E.R. ka mbajtur procesverbalin në datë 13.1.2019 për marrjen në dorëzim të mjetit Mitsubishi L200.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 2,370,000 lekë pa TVSh.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje kanale vaditëse”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 140, datë 16.04.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 140, datë 16.04.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 422, datë 25.09.2019
4. Lloji i Procedurës: Kërkesë për propozim	1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,788,820 lekë	6. Oferta fituese: OE A. ShPK me ofertë 4,700,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 06.06.2019, me afat 20 ditë nga firmosja e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit: 88,820 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 07.05.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019- 3,624,554 lekë Të ardhura 2019- 1,164,266 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimin e fondit limit, përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i fondit limit: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Pyjeve i është drejtuar me shkresë në datë 08.04.2019 njesisë së prokurimit Bashkia Mat për kërkesë mirëmbajtje kanale vaditëse. Fondi limit është përlogaritur sipas preventivit të hartuar nga ing z. A.M. dhe teknik z. P.V..

Komisioni për përlogaritjen e fondit limit, hartimin e preventivit ka hartuar dokumentacionin për procedurën “Blerje materiale për mirëmbajtje të kanaleve vaditëse”. Dokumentacioni i mëposhtëm në dosje.

- Preventivi me çmime

Nuk është përgatitur grafiku i punimeve nga inxhinierët që kanë përlogaritur fondin limit në kundërshtim me nenin 26 pika 4 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014.

Hartimi i kriterëve: Me datë 24.04.2023 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”;

Nga auditimi konstatohet se nga NJP janë vendosur kriterë të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht Pika 2.3.4. nuk është në përputhje me pikën 8 gërma (b) të nenit 27 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë si dokument justifikues vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatime për mospasje detyrime në momentin e konkurrimit në procedurë. Mandat pagesat nuk janë dokument justifikues për të vërtetuar nëqoftëse operatori ekonomik nuk ka detyrime.

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, dhe është kualifikuar OE “A.” ShPK me ofertën ekonomike 4,700,000 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 2 dhe 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se: Operatori ekonomik “A.” ShPK:

1. Sipas kriterëve të veçanta në DST operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetet autobot uji (2 copë).

2. Sipas kriterëve të veçanta në DST operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për mjetin kamion me targa AA967HU i cili sipas lejes së qarkullimit është në pronësi të z. Luan H.A. dhe jo të shoqërisë “A.” për mjetin nuk ka kontratë qiraje për përdorim nga shoqëria “A.”. Operatori ekonomik “S.” ShPK:

1. Sipas kriterëve të veçanta në DST për artikujt të cilët janë objekt i procedurës nuk është paraqitur dëshmi të testimeve të produkteve.

2. Sipas kriterëve të veçanta në DST certifikata ISO e prodhuesit nuk është përkthyer në gjuhën shqipe.

3. Sipas kriterëve të veçanta në DST operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetet autobot uji (2 copë).

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë nga z. P.M., z. E.B., zj. D.T..

Konkluzion: OE “A.” ShPK nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, (a) dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara të situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **4,700,000 lekë** pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi nga administrata tatimorë (Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave) për punësimin mesatar jo më pak se 9 (nëntë) punonjës për periudhën Janar 2018-Mars 2019 ku përfshihet edhe stafi menaxherial i drejtuesve teknik:

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 46, pika 1/b, si dhe VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Neni 28, pika 5.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat janë publikuar së bashku me dokumentat e tenderit) si dhe furnizimin/shërbimet që do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat e tenderit.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Periudha e kërkuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë subjekti ofertues.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E njëjta praktikë ndiqet nga të gjithë autoritetet kontraktore për prokurime të ngjashme.

Bashkëngjitur procesverballi i argumentimit të kriterëve për procedurën me objekt "Rikonstruksioni në ambientet e brendshme në godinën e KLSH –së" ku argumentohet kriteri "Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik –shtator 2023.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e ngritura NjP e përbërë nga z. A.G., z. E.Ç. dhe z. D.N. ju bëjmë me dijeni se:

Në dijeninë e grupit të auditimit për verifikimin e dokumentave të tenderit apo ftesë për ofertë duhet një adresë (**logari**) e hapur nga Agjencia e Prokurimit Publik për të vërtetuar pretendimin e ngritur nga Ju. Për më tepër nuk argumentohet mënyra se si nga ana Juaj janë verifikuar DT apo ftesa për ofertë e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Pretendimi Juaj ngrihet mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion në ambientet e brendshme në godinën e KLSH-së" për vitin 2023, ku argumentoni kriterin "Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërive për periudhën Korrik-Shtator 2023". Theksojmë se në observacion ngrihen pretendimet mbi një procedurë që edhe nga Ju vetë nuk përcaktoni çfarë procedure është me vlerë të ulët apo të lartë (pra nuk evidentohet fondi limit apo cili OE e ka fituar këtë procedurë). Për më tepër nuk paraqitet asnjë dokumentacion justifikues konkretisht DT apo ftesë për ofertë për të cilat ngrihen pretendimet nga Ju.

Gjithashtu vlen të theksohet se dokumentohet dhe argumentohet mënyra se si është përfutur ky informacion kofidencial kur jemi në kushtet kur, Ju nuk keni akses për verifikimin e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij observacioni grupi i auditimit me përgjegjësi maksimale dhe në mënyrë profesionale duke komunikuar dhe verifikuar regjistrin elektronik të publikuar në APP mbi planifikimin dhe realizimin për vitin 2023 për procedurat e prokurimit konstatohet se, procedura e cila pretendohet

nga ju i për një procedure prokurimi me vlerë të vogël, ku referuar ftesës për ofertë kapaciteti i punonjësve për një periudhë 3 mujore nuk kërkohet si kriter.

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë fuqinë punëtore prej 9 punonjës për periudhën janar 2018-Mars 2019. Vendosija e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 15-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hidroizolim tarraca e muzeut”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 170, datë 15.05.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 170, datë 15.05.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 422, datë 25.09.2019
4. Lloji i Procedurës: Kërkesë për propozim	1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,889,000 lekë	6. Oferta fituese: OE P. ShPK me ofertë 1,878,277 lekë pa TVSh, me kontratë datë 06.06.2019, me afat 20 ditë nga firmosja e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit: 10,723 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 05.06.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimin e fondit limit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i fondit limit: Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Mat me shkresën datë 10.04.2019 ka kërkuar zhvillimin e procedurës me objekt “Hidroizolim tarraca e muzeut”. Për hartimin e fondit limit nuk është ngritur urdhër i posaçëm nga titullari i Autoriteti Kontraktor dhe nuk përcaktohet si është hartuar por është shprehur vetëm vlera e fondit limit. Vlera e fondit limit është përcaktuar 1,889,000 lekë. Kjo praktikë është në kundërshtim me nenin 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 26 pika 1 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Hartimi i kriterëve: Më datë 23.05.2019 është mbajtur procesverbali nr. 1 për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe hartimin e kriterëve të veçanta.

Nga auditimi u konstatua se nga NJP janë vendosur kriterë të paargumentuara e të pambështetura, konkretisht:

1. Pika 2.3.2. nuk është në përputhje me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punëtore, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.

2. Pika 2.3.6. nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton që specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e AK për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe

përbërësit e projektit të punës. Në kundërshtim me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Licencat të cilat nuk janë në përputhje me objektin e kontratës janë:

- N.P.1 A (Punime gërmimi në tokë)
- N.P.12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- N.S.1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)
- N.S.9 A (Punime strukturore speciale)
- N.S.18 A (Punime topogjeodezike)

Licencat e mësipërme nuk janë në përputhje me Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

3. Pika 2.3.4 nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton që specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e AK për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës. Në kundërshtim me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, është kualifikuar dhe shpallur fituese OE “P.” ShPK me ofertën ekonomike 1,878,277 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenet 64, 66 dhe 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Operatori ekonomik i shpallur fitues në procedurën e prokurimit “Hidroizolim tarraca e muzeut” ka dorëzuar dokumentacionin në përputhje me DST.

Konkluzion: Klasifikimi dhe shpallja e Ofertës fituese është bërë në përputhje me LPP.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 1,889,000 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi nga administrata tatimorë (Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave) për punësimin mesatar jo më pak se 20 (njëzetë) punonjës për periudhën Janar 2018-Maj 2019.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 46, pika 1/b, si dhe VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 28, pika 5.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat janë publikuar së bashku me dokumentat e tenderit) si dhe furnizimin/shërbimet që do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat e tenderit.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Periudha e kërkuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë subjekti ofertues.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. E njëjta praktikë ndiqet nga të gjithë autoritetet kontraktore për prokurime të ngjashme.

Bashkëngjitur procesverballi i argumentimit të kriterëve për procedurën me objekt “Rikonstruksioni në ambientet e brendshme në godinën e KLSH –së” ku argumentohet kriteri “Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik –shtator 2023.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e ngritura NjP e përbërë nga z. A.G., z. E.Ç. dhe z. D.N. ju bëjmë me dijeni se:

Në dijeninë e grupit të auditimit për verifikimin e dokumentave të tenderit apo ftesë për ofertë duhet një adresë (**Ilogari**) e hapur nga Agjencia e Prokurimit Publik për të vërtetuar pretendimin e ngritur nga Ju. Për më tepër nuk argumentohet mënyra se si nga ana Juaj janë verifikuar DT apo ftesa për ofertë e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Pretendimi Juaj ngrihet mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion në ambientet e brendshme në godinën e KLSH-së” për vitin 2023, ku argumentoni kriterin “Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërive për periudhën Korrik-Shtator 2023”. Theksojmë se në observacion ngrihen pretendimet mbi një procedurë që edhe nga Ju vetë nuk përcaktoni çfarë procedure është me vlerë të ulët apo të lartë (pra nuk evidentohet fondi limit apo cili OE e ka fituar këtë procedurë). Për më tepër nuk paraqitet asnjë dokumentacion justifikues konkretisht DT apo ftesë për ofertë për të cilat ngrihen pretendimet nga Ju.

Gjithashtu vlen të theksohet se dokumentohet dhe argumentohet mënyra se si është përfituar ky informacion kofidencial kur jemi në kushtet kur, Ju nuk keni akses për verifikimin e një procedure prokurimi të zhvilluar nga KLSH.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij observacioni grupi i auditimit me përgjegjësi maksimale dhe në mënyrë profesionale duke komunikuar dhe verifikuar regjistrin elektronik të publikuar në APP mbi planifikimin dhe realizimin për vitin 2023 për procedurat e prokurimit konstatohet se, procedura e cila pretendohet nga ju i për një procedure prokurimi me vlerë të vogël, ku referuar ftesës për ofertë kapaciteti i punonjësve për një periudhë 3 mujore nuk kërkohet si kriter.

Në pikën nr. 2.3.3, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë fuqinë punëtore prej 9 punonjës për periudhën janar 2018-maj 2019. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 17-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

Pretendimet e subjektit:

2. Licencat të cilat nuk janë në përputhje me objektin e kontratës:

N.P.1.A (Punime gërmimi në tokë)

N.P.12.A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

N.S.1.A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

N.S.9.A (Punime strukturore speciale)

N.S.18.A (Punime topogjeodezike)

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit të Auditit të KLSH sqarojmë se kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 46, pika 1/a; VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 8., si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

-N.P -1 A Punime gërmimi në tokë.

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij preventivi bazuar në elementet që duhet të respektohen.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara nëpërmjet kësaj procedure pasi në specifikime parashikohen edhe gërmimet shtese dhe jo vetëm hidroizolimi i taraces (faqja 5 e specifikimeve teknike, bashkëngjitur me observacionin).

-N.P - 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore.

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territorin për rivegjetizimin e skarpave rrugore, hekurudhor të karrierave dhe **mbejtjeve inerte**.

Meqënëse Muzeu është institucion i veçantë që mbart vlera historike, kulturore etnografike etj., është kërkuar licenca e mësipërme.

-N.S - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.

Me punime të tilla, referuar VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij preventivi bazuar në elementet që duhet të respektohen.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara nëpërmjet kësaj procedure pasi në specifikime parashikohen edhe **gërmime shtesë** dhe jo vetëm hidroizolimi i tarracës (faqja 5 e specifikimeve teknike, bashkëngjitur me observacionin).

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

-N.S.9.A (Punime strukturore speciale)

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij preventivi bazuar në elementet që duhet të respektohen dhe meqënëse Muzeu është institucion i veçantë që mbart vlera historike, kulturore etnografike etj., është kërkuar licenca e mësipërme. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

-N.S.18.A (Punime topogjeodezike)

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij preventivi bazuar në elementet që duhet të respektohen.

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga specialistët dhe dokumentacionin e objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave preferenciale dhe gjurmës së objekteve në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z.E.Ç., z. A.G., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit i Auditit të KLSH sqarojmë se kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar Neni 46, pika 1/b, si dhe VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 26, pika 8. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z.E.Ç., z. A.G., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 23, datë 23.01.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 23, datë 23.01.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: 1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,382,754 lekë	6. Oferta fituese: Ska	7. Diferenca me fondin limit: Ska
8. Data e hapjes së tenderit: 27.02.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019: 8,766,087 lekë Të ardhura 2019: 616,667 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) Skualifikuar 4 OE , c) Kualifikuar 0 OE
11. Ankimime AK: Ankesë OE “R.” ShPK, nr. prot 722 datë 20.03.2019	12. Përgjigje ankesës nga AK: Vendim nr. 722/1 datë 26.03.2019	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Vendim nr. 310/2019 datë 23.05.2019

Hartimi i fondit limit: Për procedurën e mësipërme nuk është argumentuar fondi limit. Hartimi i fondit limit duhet të mbështetet në kërkesat e drejtorive të institucionit dhe normat e konsumit të mjeteve. Hartimi i fondit limit është bërë në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014.

Hartimi i kriterëve: 1. Pika 2.3. (B). Kapaciteti teknik: nuk është në përputhje me nenin 20, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Pika 2.3. (F). Kapaciteti teknik: është vendosur në kundërshtim me Ligjin nr. 118/2012 “Për transportimin e mallrave të rrezikshëm”. Karburantet nuk konsiderohen mallra të rrezikshëm dhe nuk përfshihen në asnjë nga klasat e përcaktuara në nenin 23 të Ligjit nr. 118/2012 “Për transportimin e mallrave të rrezikshëm”.

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender kanë marrë pjesë 4 OE të cilët janë skualifikuar, me të dhëna sipas tabelës më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	O. Ekonomike (marzhi i fitimit)	Arsyet e skualifikimit, sipas Raportit Përmbledhës
1	OE D.O. ShPK	9%	Skualifikuar 1. Për mjetin bot dhe cisternë e lëvizshme, janë fotokopje dokumentacioni, dokumentacioni teknik jashtë afateve ligjore. 2. Polica e sigurimit ka përfunduar afati me datë 14.02.2019 jashtë afateve ligjore. 3. Certifikata e analizave (raport teknik) fotokopje. 4. Nuk është paraqitur liçencë për tregtim karburanti nga pushteti vendor për pikën e karburantit në qytetin e Burrelit.
2	OE R. ShPK	6.99%	Skualifikuar 1. Raport analiza e subjektit është jashtë afateve të përcaktuara. 2. Nuk keni paraqitur dokumentacion për mjetin bot dhe cisternë e certifikuar nga organet përkatëse. 3. Kontrata e lidhur me subjektin K. Sha nuk është lidhur para noterit.
3	OE J. ShPK	11%	Skualifikuar 1. Bilanc i vitit 2017 pa konfirmuar nga dega e tatimeve. 2. Për mjetin tip bot mungojnë dokumentacioni teknik dhe kontrata e dhënies me qera para noterit.
4	BOE B.O. & O. ShPK	7.3%	Skualifikuar 1. Nuk keni paraqitur vërtetim nga pushteti vendor për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore, ky dokument është lëshuar vetëm ku subjekti ka selinë, ndërsa aktiviteti juaj ka aktivitet në disa njësi të vetëqeverisjes vendore. 2. Në marrëveshjen e bashkëpunimit janë përcaktuar përqindja dhe jo sasitë dhe detaje të tjera të cilat siç përcaktohen në ligjin për prokurimet publike. 3. Nuk keni paraqitur licence për tregtim karburanti nga pushteti vendor për pikën e karburantit në qytetin e Burrelit.

Konkluzion: Asnjë nga operatorët ekonomik nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe KVO ka vepruar në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhërin e brendshëm nr. 101 datë 25.03.2019 ka urdhëruar “Krijimin e komisionit të shqyrtimit të ankesës për tenderin me objekt blerje ushqimesh”, i përbërë nga A.N., Kryetar Komisioni, A.P. dhe A.M., Antarë.

Ankesa nga operatori R. ShPK: Operatori ekonomik i skualifikuar R., ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor me nr. 722 prot., datë 20.03.2019 për skualifikimin nga procedura e prokurimit “Blerje karburant Bashkia Mat”.

KVO-ja ka njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik të APP vlerësimin e procedurës dhe skualifikimin me arsyet si më poshtë:

1. Raport analiza e subjektit është jashtë afateve të kërkuara;
2. Nuk keni paraqitur dokumentacion për mjetin bot dhe cisternë e certifikuar nga organet përkatëse;
3. Kontrata e lidhur me subjektin K. Sha nuk është lidhur para noterit.

Kundërshtitë e operatorit ekonomik: Pretendimi 1. OE “R.” ShPK ka lidhur kontratë në datën 03.01.2019 me shoqërinë “K.” ShA me objekt furnizimin me naftë. Kësaj kontrate i janë bashkëngjitur raport analiza para zhdoganimit për mallin “Gazoil standart SSH EN 590:2013 +A1 207”, të cilat janë kryer nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, të lëshuara në datën 08.02.2019 me numër 485/1.

Pretendimi 2. Sipas kontratës, shoqëria “K.” ShA merr përsipër me shpenzimet e veta të realizojë transportin e karburantit për llogari të shoqërisë “R.” ShPK përgjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Mjeti që do të transportojë mallin është me targa AA140ES.

Pretendimi 3. Sipas legjislacionit të Kodit Civil, kapitulli V, nenet 659-689, nuk specifikohet që kontratat e lidhura ndërmjet palëve marrin formë ligjore vetëm nëse janë të lidhura përpara noterit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me Vendimin nr. 722/1 datë 26.03.2019, nuk e ka marrë në konsideratë observacionin e operatorit ekonomik duke mos pranuar asnjë nga argumentet e operatorit.

1. OE “R.” ShPK ka paraqitur raport analiza të datës 10.04.2017 e cila nuk është në përputhje me DST e cila kërkohet të jetë brenda 2 muajve të fundit.

Raporti i analizave i paraqitur nga OE “K.” ShA nuk mund të merret në konsideratë sepse OE “R.” ShPK ka marrë pjesë në procedurë të vetëm dhe jo bashkim operatorësh me “K.” ShA.

2. Mjeti me targa AA140ES nuk mund të konsiderohet si përmbushje kriteri sepse nuk ka asnjë kontratë me subjektin “R.” ShPK për përdorimin e këtij mjeti.

3. Kontrata e furnizimit midis OE “R.” ShPK dhe “K.” ShA ju shërben vetëm palëve dhe ka forcën e ligjit vetëm për palët.

Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 592/1 prot., datë 05.04.2019 ka vendosur të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga OE “R.” ShPK.

Me vendimin e KPP nr. 310/2019 prot., datë 23.05.2019 është vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “R.” ShPK për procedurën e hapur me Ref. 0577-01-25-2019 me objekt “Blerje Naftë”.

6/1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 107, datë 01.04.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 107, datë 01.04.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: 1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,340,226 lekë	6. Oferta fituese: Ska	7. Diferenca me fondin limit: Ska
8. Data e hapjes së tenderit: 27.02.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019: 7,723,559 lekë Të ardhura 2019: 616,667 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 0 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Hartimi i fondit limit: Për procedurën e mësipërme nuk është argumentuar fondi limit. Hartimi i fondit limit duhet të mbështetet në kërkesat e drejtorive të institucionit dhe normat e konsumit të mjeteve. Hartimi i fondit limit është bërë në kundërshtim me nenin 59 të VKM 914 datë 29.12.2014.

Hartimi i kriterëve: 1. Pika 2.3. (B). Kapaciteti teknik, nuk është në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender ka marrë pjesë vetëm BOE “A.” ShPK dhe “O.” ShPK, i cili është skualifikuar.

Sipas vlerësimit të KVO-së nga verifikimi bashkimi i operatorëve ekonomik është skualifikuar pasi:

1. Nuk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e taksave vendore përcaktuar në DST, në kërkesat për kualifikim.

2. Në DST është kërkuar IQT, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se subjekti “O.” ShPK nuk e ka paraqitur këtë dokument.

3. Në kontratën e bashkëpunimit është ndarë në përqindje, por nuk është specifikuar sipas nenit 74 të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se: Bashkimi i operatorëve ekonomik i skualifikuar në procedurën e prokurimit “Blerje Karburanti” ka patur mangësi në dokumentacion si më poshtë:

1. Nga operatori ekonomik “O.” ShPK nuk është paraqitur vërtetim nga Pushteti Vendor për vitin 2019 për likuidimin e taksave vendore përcaktuar në DST në kërkesat për kualifikim.

Konkluzion: BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST.

Sa më sipër, KVO ka vepruar në përputhje me kërkesat e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Operatori të ketë minimumi 1 (një) pikë furnizimi me vendodhje në Bashkinë Mat: në Njesinë Administrative Burrel ose në një rreze jo me shumë së 3 (tre) kilometra nga kjo Njësi, këto të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë të lëshuar nga QKR .

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit i Auditit të KLSH sqarojme se ky kriter është vendosur për të siguruar furnizimin sipas nevojave të AK në një rreze të përshtatëshme sidomos për mjetet e rënda dhe meqënëse Njësia Administrative Burrel nga pozicioni gjeografik është pothuajse në qendër të njësive administrative të tjera ku shpërndahen mjetet edhe furnizimi është më efikas dhe ka më pak kosto lëvizjeje për furnizim.

Kriteri i vendosur në këte menyrejo vetëm që nuk është diskriminues por përfshin pothuajse të gjitha pikat e tregtimit të karburanteve në Bashkinë Mat. Në rast se nuk do të ishte ky kriter, ofertues të mundshëm mund të ishin edhe subjekte me pika tregtimi në qytete të largëta tek të cilët nuk mund të arrihet të realizohet furnizim i përditshëm nga mjetet e Bashkisë Mat.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z. E.Ç., z. A.G., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Pretendimet e subjektit:

2. Subjekti ofertues të deklarojë se merr persiper furnizimin me naftë me bot kur kerkohet nga Autoriteti Kontraktor. Mjeti çisterne duhet të jete i paisur me Çertifikaten e miratimit per mjetet qe transportojne mallra te rrezikshem.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit i Auditit të KLSH sqarojmë se pajisja me certifikatën për cisternën rregullohet sipas Ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004 “Për aderimin e republikës së shqipërisë në “marrëveshjen europiane” për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (adr)” dhe protokollin e nënshkrimit”; ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, të gazit dhe nenprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nenprodukteve të saj” si dhe Udhëzim nr. 6, datë 27.5.2015 “Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certificates së miratimit adr, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve adr dhe tarifat e shërbimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu janë përcaktuar në funksion të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së mallit objekt prokurimi, aftësisë dhe zotërimit të aseteve të nevojshme fizike (mjete transporti/autobot) të operatorit ekonomik për të realizuar furnizimin e mallit (karburant) në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Vetë natyra dhe rëndësia e veçantë e artikullit objekt prokurimi kërkon garancinë dhe vëmendjen e duhur si nga AK ashtu dhe nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Për pikën 2 të observacionit për të cilën subjekti duhet të ketë të pajisur mjetin e transportit me certifikatën e miratimit për mjete që transportojnë mallra të rrezikshëm.

Observacioni i mësipërm merret në konsideratë sepse është i argumentuar dhe i mbështetur ligjërisht.
Observacioni i paraqitur merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

6/2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 112, datë 04.04.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 112, datë 04.04.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: 1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
4. Lloji i Procedurës: Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,042,528 lekë	6. Oferta fituese: J. ShPK me ofertë ekonomike me marzh fitimi 15%. Kontrata datë 19.04.2019	7. Diferenca me fondin limit: Ska
8. Data e hapjes së tenderit: 17.04.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019: 7,723,559 lekë Të ardhura 2019: 616,667 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 0 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimin e fondit limit, përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i fondit limit: Për procedurën e mësipërme nuk është argumentuar fondi limit. Hartimi i fondit limit duhet të mbështetet në kërkesat e drejtorive të institucionit dhe normat e konsumit të mjeteve. Hartimi i fondit limit është bërë në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Hartimi i kriterëve: 1. Pika 2.3. (B). Kapaciteti teknik, nuk është në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender ka marrë pjesë vetëm OE “J.” ShPK, i cili është kualifikuar për plotësimin e kushteve sipas DST. Sipas vendimit nr. 1 datë 18.04.2018, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “J.” ShPK me ofertë ekonomike 15% me marzh fitimi.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se: Dokumentat e mëposhtëm të dorëzuara nga operatori fitues në procedurën “Blerje karburanti Bashkia Mat” nuk i përkasin operatorit “J.” ShPK me NIPT L.....T, por operatorit “G.V. PF” me NIPT K.....O, i cili sipas informacionit nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton biznes i çregjistruar që nga data 01.10.2018.

1. Bilancet e vitit 2016,2017 i përkasin operatorit “G.V. PF” me NIPT K.....O;

2. Polica e sigurimit i përket operatorit “G.V. PF” me NIPT K.....O.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë nga z. P.M., z. E.B., znj. D.T..

Konkluzion: OE “J.” ShPK nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe nuk duhet të ishte kualifikuar dhe shpallur fitues.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1 (a) dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën 1,042,528 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Shtesat e kontratës: Për procedurën e mësipërme janë firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor 2 shtesa kontrate, si më poshtë:

1. Kontratë shtesë furnizimi me nr. 1054/1 prot, datë 20.05.2019 në vlerën 2,085,056 lekë.
2. Kontratë shtesë furnizimi me nr. 1923, datë 16.07.2019 në vlerën 3,119,145 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 36 “Procedura me negocimin pa shpallje të njoftimit të kontratës” pika 2, gërma d.

Për shtesat e kontratës operatori ekonomik ka lëshuar faturat tatimore:

1. Faturë nr. 49, datë 30.06.2019 në vlerën 2,085,056 lekë pa TVSh dhe 2,502,062 me TVSh;
2. Faturë nr. 51, datë 29.07.2019 në vlerën 3,119,145 lekë pa TVSh dhe 3,742,974 me TVSh.

Nga verifikimi i pagesave për vitin 2019, nga ana e Bashkisë Mat nuk janë paguar këto fatura. Në datë 23.10.2019 me shkresën nr. 2322 Rep, nr. 775/1 Kol. është dërguar Bashkisë Mat kërkesa nga avokati i operatorit për likuidimin e faturave të papaguara sipas kontratave shtesë. Nga informacioni i Drejtorisë Juridike nuk kemi proces gjyqësor të hapur nga operatori për faturat e papaguara.

Përsa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Operatori të ketë minimumi 1 (një) pikë furnizimi me vendodhje në Bashkinë Mat: në Njesinë Administrative Burrel ose në një rreze jo me shumë së 3 (tre) kilometra nga kjo Njësi, këto të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë të lëshuar nga QKR .

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit i Auditit të KLSH sqarojme se ky kriter është vendosur për të siguruar furnizimin sipas nevojave të AK në një rreze të përshtatëshme sidomos për mjetet e rënda dhe meqënëse Njësia Administrative Burrel nga pozicioni gjeografik është pothuajse në qendër të njësive administrative të tjera ku shpërndahen mjetet edhe furnizimi është më efikas dhe ka më pak kosto lëvizjeje për furnizim.

Kriteri i vendosur në këte menyrejo vetëm që nuk është diskriminues por përfshin pothuajse të gjitha pikat e tregtimit të karburanteve në Bashkinë Mat. Në rast se nuk do të ishte ky kriter, ofertues të mundshëm mund të ishin edhe subjekte me pika tregtimi në qytete të largëta tek të cilët nuk mund të arrihet të realizohet furnizim i përditshëm nga mjetet e Bashkisë Mat.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z.E.Ç., z. A.G., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 219, datë 03.07.2019	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 219, datë 03.07.2019	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:
4. Lloji i Procedurës: Kërkese për propozim	1. E.Ç., Kryetar 2. A.G., Anëtar 3. D.N., Anëtar	1. P.M., Kryetar 2. E.B., Anëtar 3. D.T., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 7,999,553 lekë	6. Oferta fituese: J. ShPK me ofertë ekonomike me marzh fitimi 15%. Kontrata datë 19.04.2019	7. Diferenca me fondin limit: Ska
8. Data e hapjes së tenderit: 15.07.2019	9. Burimi i Financimit: Grant 2019: 7,723,553 lekë Të ardhura 2019: 276,000 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) Skualifikuar 0 OE ,

		c) Kualifikuar 5 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimin e fondit limit, përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i fondit limit: Për procedurën e mësipërme nuk është argumentuar fondi limit. Hartimi i fondit limit duhet të mbështetet në kërkesat e drejtorive të institucionit dhe normat e konsumit të mjeteve. Hartimi i fondit limit është bërë në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Hartimi i kriterëve: 1. Pika 2.3. (B). Kapaciteti teknik, nuk është në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. 3. Pika 2.3. Kapaciteti teknik, nuk është në përputhje me nenin 27 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 4.

Vlerësimi i Ofertave: Në këtë tender ka marrë pjesë 5 OE, të cilët janë kualifikuar: OE “E.-O.” sha me ofertën ekonomike 8.6% marzh fitimi, OE “R.” ShPK me ofertë ekonomike 6.4% marzh fitimi, OE “J.” ShPK me ofertë ekonomike 5.5% marzh fitimi, BOE “A. & O. ShPK” me ofertë ekonomike me 7.98% marzh fitimi dhe OE “G.O.” ShPK ofertën ekonomike 7% marzh fitimi.

Sipas Vendimit nr. 1 datë 29.07.2019 të KVO-së, operatorët ekonomikë janë kualifikuar për plotësimin e kushteve të DST dhe është shpallur fituese oferta e operatorit “J.” ShPK me ofertë ekonomike 5.5% marzh fitimi.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Dokumentat e mëposhtëm të dorëzuara nga operatori fitues në procedurën “Blerje karburanti Bashkia Mat”, nuk i përkasin OE “J.” ShPK me NIPT L.....T por operatorit “G.V. PF” me NIPT K.....O, i cili sipas informacionit nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton biznes i çregjistruar që nga data 01.10.2018.

1. Bilancet e viteve 2016 dhe 2017 i përkasin operatorit “G.V. PF” me NIPT K.....O;
2. Polica e sigurimit i përket operatorit “G.V. PF” me NIPT K.....O;
3. Fletët e analizave i përkasin operatorit “G.V. PF” me NIPT K.....O.

Sa më sipër mban përgjegjësi KVO, i përbërë nga z. P.M., z. E.B., zj. D.T..

Konkluzion: OE “J.” ShPK nuk i plotëson kriteret e vendosur në DST dhe nuk duhet të ishte kualifikuar dhe shpallur fitues.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 2, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën 7,999,553 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga njësia e prokurimit është paraqitur observacioni me pa nr. prot., datë 26.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/13 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Operatori të ketë minimumi 1 (një) pikë furnizimi me vendodhje në Bashkinë Mat: në Njesinë Administrative Burrel ose në një rreze jo me shumë se 3 (tre) kilometra nga kjo Njësi, këto të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë të lëshuar nga QKR .

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit i Auditit të KLSH sqarojme se ky kriter është vendosur për të siguruar furnizimin sipas nevojave të AK në një rreze të përshtatëshme sidomos për mjetet e rënda dhe meqënëse Njësia Administrative Burrel nga pozicioni gjeografik është pothuajse në qendër të njësive administrative të tjera ku shpërndahen mjetet edhe furnizimi është më efikas dhe ka më pak kosto lëvizjeje për furnizim.

Kriteri i vendosur në këtë menyre jo vetëm që nuk është diskriminues por përfshin pothuajse të gjitha pikat e tregtimit të karburanteve në Bashkinë Mat. Në rast se nuk do të ishte ky kriter, ofertues të mundshëm mund të ishin edhe subjekte me pika tregtimi në qytete të largëta tek të cilët nuk mund të arrihet të realizohet furnizim i përditshëm nga mjetet e Bashkisë Mat.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e protokolluar në KLSH me numër 768/13 prot., datë 29.01.2024, është observuar nga subjekti i audituar Bashkia Mat nga Njësia e Prokurimit z. E.Ç., z. A.G., z. D.N., me shkresën pa nr.prot., datë 26.01.2024. Observacioni është identik me observacionin nr. 4727/4 prot., datë 24.11.2023, për Akt-konstatimin nr. 2, të cilit grupi i auditimit i ka dhënë shpjegime/përgjigje në Projekt Raportin e Auditimit. **Për sa trajtuar më sipër observacioni juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.**

Pretendimet e subjektit:

2. Subjekti ofertues të deklarojë se merr persiper furnizimin me naftë me bot kur kerkohet nga Autoriteti Kontraktor. Mjeti çisterne duhet të jete i paisur me Çertifikaten e miratimit per mjetet qe transportojne mallra te rrezikshem.

Në lidhje me këtë konstatim të Grupit i Auditit të KLSH sqarojmë se pajisja me çertifikatën për cisternën rregullohet sipas Ligj nr. 9272, datë 16.9.2004 “Për aderimin e republikës së shqipërisë në “marrëveshjen europiane” për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (adr)” dhe protokollin e nënshkrimit”; ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, të gazit dhe nenprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nenprodukteve të saj” si dhe Udhëzim nr. 6, datë 27.5.2015 “Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certificates së miratimit adr, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve adr dhe tarifat e shërbimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu janë përcaktuar në funksion të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së mallit objekt prokurimi, aftësisë dhe zotërimit të aseteve të nevojshme fizike (mjete transporti/autobot) të operatorit ekonomik për të realizuar furnizimin e mallit (karburant) në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Vetë natyra dhe rëndësia e veçantë e artikullit objekt prokurimi kërkon garancinë dhe vëmendjen e duhur si nga AK ashtu dhe nga operatorët ekonomik pjesëmarrës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Për pikën 2 të observacionit për të cilën subjekti duhet të ketë të pajisur mjetin e transportit me çertifikatën e miratimit për mjete që transportojnë mallra të rrezikshëm.

Observacioni i mësipërm merret në konsideratë sepse është i argumentuar dhe i mbështetur ligjërisht.

Observacioni i paraqitur merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

Procedurat e audituara për periudhën 01.01.2020-31.12.2020

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të qytetit Burrel, të fshatrave të Njesisë Administrative Derjan dhe Rukaj, Loti 1”		
1. Urdhër Prokurimi:	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Nr. 563, datë 14.08.2020	Nr. 563, datë 14.08.2020	Nr. 564, datë 14.08.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur	1. E.A., Kryetar; 2. A.M., Anëtar; 3. D.R., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. E.L., Anëtar 3. E.R., Anëtar
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 561,354,044 lekë	6. Oferta fituese: BOE E. & E., me ofertë 557,546,953 lekë pa TVSh, me kontratë datë 09.10.2020, me afat 12 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit	7. Diferenca me fondin limit: 3,807,091 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 17.09.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Nga auditimi i dosjes së tenderit, rezultoi se **Fondi limit** ka qenë 561,354,044 lekë pa TVSh, ndarë 112,270,809 lekë pa TVSh për vitin 2020 dhe 449,083,235 lekë pa TVSh për vitet 2021-2023, nga buxheti i shtetit.

Hartimi i kriterëve: - Në pikën 2.3.1. në DT, janë kërkuar kategoritë e licensave profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT. Nga auditimi u konstatua se disa nga kategoritë e licensave janë të paargumentuara në kriteret e vendosura dhe skanë lidhje me zërat e punimeve në projekt-preventiv, si në vlerën e kategorisë apo dhe të punëve që do kryhen në terren, konkretisht licenca e kategorisë NP-12. “*Punime të inxhinierisë së mjedisit*” dhe licenca e kategorisë NS-18, “*Punime topogjeodezike*”.

- Në pikën 2.3.2. në DT, janë kërkuar certifikatat PAS 99 “*Sisteme të menaxhimit të integruar*”, ISO IEC 27001 “*Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit*”, ISO 50001 “*Sistemi i menaxhimit të Energjisë*”. Këto certifikata nuk janë në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duheshin vendosur si kriterë kualifikimi.

- Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 260 punonjës për periudhën korrik 2019-korrik 2020, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Kjo kërkesë nuk është në përputhje me pikën 8 germa (b) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar. Kjo dispozitë përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar fuqinë minimale punëtore që OE duhet të disponojnë për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar periudhën kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër punonjësish. Për AK duhet të jetë e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertës, OE të disponojë fuqinë minimale punonjëse, pa qenë e nevojshme që këto kapacitete të shtrihen në periudha më të hershme.

Nuk ka një analizë për përcaktimin e fuqisë punëtore, në lidhje me orët e punës për çdo zë punimi sipas manualit në fuqi, me volumet e punës sipas preventivit dhe me afatin e punimeve sipas grafikut të punimeve.

- Kërkesa që “...OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar ose të kontraktuar të paktën 1 Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme) dhe të pajisur me Çertifikatën përkatëse”, është një kusht i panevojshëm pasi, vlerësimi i ndikimit në mjedis është kryer që në hapat fillestarë të projektit të miratuar.

- Kërkesa që “...OE ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë i cili duhet të ketë eksperiencë pune minimum 15 vjet dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin...”, është kriter i ekzagjeruar dhe diskriminues. Kërkesa për eksperiencën e punës të inxhinierëve është e panevojshme dhe e paaplikueshme sepse eksperiencia e punës së stafit teknik të një OE që operon në sektorin e

ndërtimit rregullohet nga: VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

- Kërkesat për certifikata cilësie PAS 99 “Sisteme të menaxhimit të integruar”, ISO IEC 27001 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”, nuk janë në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duheshin vendosur në kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vendosura më sipër nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar. Për sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlerësimi i Ofertave: Për të vërtetuar punime të ngjashme, BOE E. & E. ka paraqitur 5 kontrata të realizuara në sektorin publik:

- Operatori ekonomik E. ShPK, ka kryer punë si nënkontraktor me kompaninë A. SRL në cilësinë e Kontraktorit kryesor, me objekt: “Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza (KUZ) Vlorë”. OE E. ShPK ka kryer punime me vlerë 2,233,148 euro, ose 17% të totalit të kontratës;

- E. ShPK ka kryer punime si nënkontraktor me kompaninë J.S. SRL & A. SPA, në cilësinë e Kontraktorit kryesor, me objekt “Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Ksamil, Kavajë dhe Shëngjin (Lezhë), Loti 2: Zgjerimi i impiantit të ujërave të ndotura Kavajë”, sa 20% e vlerës së kontratës (14,381,885.61 euro) me vlerë 2,876,377.12 Euro pa TVSh.

Sa më sipër, konstatohet se në preventivin e punimeve dhe në situacionet e paraqitura, llojet e punimeve nuk kanë ngjashmëri në llojin e punimeve të kryera. Vlera totale nuk mund të jetë tregues për sa kohë nuk përputhet dhe dëshmon ngjashmëri të punëve të kryera. Po ashtu mungojnë faturat tatimore për secilin prej situacioneve.

- OE, E. ShPK si pjesë e BOE, E. & K.K. ka kryer punime sipas kontratës nr. 97, datë 20 janar 2017 lidhur me AK Bashkia Fushë Arrëz, me objekt: “Rikonstruksion i fasadave dhe sheshit të qytetit Fushë Arrëz”. Vlera e kontratës ka qenë 88,836,310 lekë me TVSh, ku E. ShPK ka kryer 49% të punimeve.

- Kontratë pune nr. 269 prot., datë 11.05.2017, lidhur me AK Bashkia Kamëz, me objekt “Ndërtim Rruga “Abdi Bej Toptani””. Vlera e kontratës ka qenë 89,902,764 lekë me TVSh, ku E. ShPK ka kryer 100% të punimeve.

- Kontratë pune nr. 435 prot., datë 31.10.2016, lidhur me AK Bashkia Kamëz me objekt “Ndërtim rruga Demokracia II (Ura Paskuqan 1-Babrru Qendër)”. Vlera e kontratës ka qenë 89,902,764 lekë me TVSh, ku E. ShPK ka kryer 100% të punimeve.

Sa më sipër, konstatohet se në preventivin e punimeve dhe në situacionet e paraqitura, llojet e punimeve nuk kanë ngjashmëri, si në llojin e punimeve të kryera apo dhe në përqindjen e tyre në vlerë. Ky kriter është po aq i rëndësishëm për zbatueshmërinë e kontratës por është dhe një nga kriteret më të domosdoshëm për kualifikim në rastin e punëve publike. Anëtar i KVO, një nga të cilët është specialist i fushës me profesion inxhinier, nuk duhej të vlerësonte si kriter të plotësuar këtë pikë. Sa më sipër mban përgjegjësi drejtpërdrejt për këtë rast. Ky BOE duhej skualifikuar dhe duhej vazhduar me OE të radhës nëse do kishte.

- Nga auditimi, u kostatua se asnjëri nga OE nuk ka paraqitur certifikatën OHSAS 18001 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente me të, të njohur nga Standardet Shqiptare.

- OE i shpallur fitues nuk plotëson pikën 2.3.3. në DT, pasi ka paraqitur dëshmi trajnimi për dy persona, konkretisht nga subjekti A. ShPK, e cila nuk është e akredituar për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me Ligjin nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Certifikatat e trajnimit, lëshuar nga A. nuk

mund të konsiderohen se përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor për “*dëshmi profesionale të punonjësve*”, në dokumentet e tenderit.

- OE i shpallur fitues nuk plotëson pikën 2.3.5. në DT. Asnjëri nga OE pjesëmarrës në këtë procedurë, nuk ka paraqitur mandat pagesa bankare për automjetet e marra me qera.

Konkluzion: Nga Bashkia Mat, Njësia e Hartimit të Kritereve të Kualifikimit, rezulton se në mënyrë të paargumentuar janë hartuar dhe miratuar kriteret të ekzagjeruara të cilat njëkohësisht ulin ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kritereve për një OE thuasje të paracaktuar. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përlogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Gjithashtu vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk është e sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi, nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. Po ashtu, janë kërkuar mjete që nuk kanë lidhje me zërat e punimeve të parashikuara, si Rrul, Autobitumatriçe, Asfaltoshtuese, Prerëse Asfalti dhe Rimorkiator për transportimin e mjeteve të rënda me kapacitet min 20 ton, pasi në preventiv nuk kemi të bëjmë me shtrim asfalti. Relievi malor dhe mungesa e rrugës së përshtatshme për mjete si rimorkiatori, e bëjnë këtë kërkesë të panevojshme.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, KVO duhej të analizonte mirë dokumentacionin e paraqitur dhe në bazë të mangësive të skualifikonte dhe BOE të ngelur në garë dhe të rishpallte rishtaz procedurë të re për këtë objekt.

Kontrata është lidhur në papajtueshmëri me kërkesat LPP.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, neni 2, “*Parimet e përzgjedhjes*”, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 26, “*Kontratat për punë publike*” dhe neni 61, “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”.

Lidhur me mangësitë e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi, anëtarët e NJP z. A.M., specialist i fushës (Inxhinier), z. E.A. në cilësinë e personit përgjegjës për administrimin dhe përgatitjen e dokumenteve standarde të tenderit si dhe z. D.R. në cilësinë e specialistit të fushës, Ekonomist.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 8, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Lidhje kontrate me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën 561,354,044 lekë pa TVSh.

Shkaku: Vendosja e kritereve të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me kërkesat dhe kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5482, datë 14.12.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 5482, datë 14.12.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 5483, datë 14.12.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur	1. E.A., Kryetar; 2. A.M., Anëtar; 3. D.R., Anëtar Preventivi dhe specifikimet teknike janë hartuar nga S.I.	1. E.H., Kryetar 2. E.L., Anëtar 3. E.R., Anëtar
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 1,037,628,809 lekë	6. Oferta fituese: BOE L.O. & F., me ofertë 1,035,619,748 lekë pa TVSh, me kontratë nr.	7. Diferenca me fondin limit: 2,009,061 lekë pa TVSh

	848 prot., datë 19.02.2021, me afat 30 muaj nga njoftimi i fillimit të punimeve	
8. Data e hapjes së tenderit: 15.01.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimit të ofertave.

Situata: Etapa përgatitore: Me shkresën nr. 3038 prot., datë 27.11.2020 “Dërgohet miratimi i objektit për programin “Furizimi me ujë dhe kanalizime” të Sektorit të Planifikimit të Investimeve, Drejtoria e Planifikimit të Investimeve, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, protokolluar pranë Bashkisë Mat me nr. 5273 prot., datë 02.12.2020, përcaktohet se, AKUM ka miratuar projekt-zbatimin për objektin: “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat” me Vendimin e Këshillit Teknik nr. 50, datë 17.11.2020 me vlerë të plotë 1,245,154,571 lekë me TVSh, ku paraqitet dhe tabela me të dhënat e parashikuara në buxhet për investimin dhe supervizionin, ndërsa me shkresën nr. 3038/1 prot., datë 27.11.2020 “Tabela e ndarjes së fondit për objektin: “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat”, protokolluar pranë Bashkisë Mat me nr. 5274 prot., datë 02.12.2020, ka paraqitur tabelën me vlerat përkatëse të ndara për investimin, supervizionin dhe kolaudimin e objektit.

Me shkresën nr. 5415 prot., datë 10.12.2020 “Kërkesë për prokurim të objektit “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat” nga Drejtoria e Shërbimeve/Bashkia Mat, është kërkuar zhvillimi i kësaj procedurë prokurimi, kërkesë e cila është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat me shkresën nr. 5415/1 prot., datë 10.12.2020 “Miratim kërkesë për procedurë prokurimi me objek: “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat”.

Fondi limit: 1,037,628,809.16 lekë pa TVSh nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2021 në vlerën 207,525,761.66 lekë pa TVSh, për vitin 2022 në vlerën 103 762 880.83 lekë pa TVSh për vitin 2023 në vlerën 103,762,880.83 lekë pa TVSh dhe për vitin 2024 në vlerën: 622,577,285.84 lekë pa TVSh.

Në datën 15.12.2020 Njësia e Prokurimit ka hartuar dokumentat e tenderit, të cilat janë firmosur në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Me procesverbalin nr. 2, datë 15.12.2020, në zbatim të Udhëzimit nr. 04, datë 9.05.2017 “Për veprimet Njesisë së Prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik” të Agjensisë së Prokurimit Publik, Anëtarët e Njesisë së prokurimit, vendosën që z. E.A., anëtar i njesisë së prokurimit (personi përgjegjës) të jetë personi i autorizuar i cili do të kryejë veprimet në sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Më datë 15.12.2020 personi i autorizuar për kryerjen e veprimeve në sistem, ka proceduar me hedhjen e procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) të APP-së, procedurë e cila mori nr. REF-82287-12-15-2020, dhe u publikua në sistem më datë 16.12.2020.

Ankesa ndaj dokumentave të tenderit (kriterëve për kualifikim) nuk ka patur.

Hartimi i kriterëve: Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë nga E.A., (jurist), A.M., (inxhinier ndërtimi) dhe D.R., (Ekonomist), të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 15.12.2020, nga të cilat disa prej tyre janë të paargumentuara, si më poshtë:

- Kriteri “...për disponimin e kategorive të licencave profesionale për ndërtimin...”, nuk është në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit, duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së OE. Konkretisht, referuar

VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi”*, i ndryshuar, në Lidhjen nr. 4, është përcaktuar se niveli i shoqërisë (licencës/kategorisë) në raport me vlerën në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi është si më poshtë:

Niveli i Shoqërisë	Sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi
A	0-20 milion lekë
B	21-50 milion lekë
C	51-100 milion lekë
D	101-200 milion lekë
E	201-400 milion lekë
F	401-800 milion lekë
G	Mbi 800 milion lekë

Duke krahasuar kriteret e vendosura nga ana e NJP me tabelën si më sipër rezultojnë se 6 kategoritë e licencave: NP-1/G *“Punime gjurmimi në tokë”*, NP-2/E *“Ndërtime Civile dhe industriale”*, NP-3/D *“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje, godinash civile e industriale, veshje fasada”*, NP-5/E *“Punime nëntokësore, ura e vepra arti”* dhe NP-12/E *“Punime të inxhinierisë së mjedisit”* janë kërkuar për vlerë punimesh mbi 800,000,000 lekë.

Nga këto, përveç faktit se janë vendosur kategori për ndërtimet e përgjithshme licence me nivele shumë më të larta nga ato që nevojiten për kryerjen e punimeve, rezultojnë se kategoritë NP-1/G *“Punime gjurmimi në tokë”*, NP-3/D *“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje, godinash civile e industriale, veshje fasada”*, NP-5/E *“Punime nëntokësore, ura e vepra arti”* dhe NP-12/E *“Punime të inxhinierisë së mjedisit”* janë vendosur pavarësisht se referuar preventivit të punimeve nuk ka asnjë zë që lidhet me punimet e lidhura me këto kategori licence.

Në mënyrë të ngjashme, janë vendosur pa asnjë domosdoshmëri kategoritë e licencave për punimet speciale NS-1/C *“Punime për prishjen e ndërtimeve kur në fakt, referuar preventivit nuk ka asnjë zë të vetëm për prishje ndërtimesh”*, NS-6/D *“Sinjalistika rrugore jo ndriçuese”*, kur në fakt, referuar preventivit nuk ka asnjë zë të vetëm për sinjalistikë rrugore që përputhet me kategorinë dhe vlerën që përkon me të, NS-10 /F *“Shtresa dhe mbistruktura speciale”*, kur në fakt, referuar preventivit nuk ka asnjë zë të vetëm për ndërtim, mirëmbajtje dhe ristrukturimi i shtresave (dysHEMEVE) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale, NS-20/C *“Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë”*, kur në fakt, referuar preventivit nuk ka asnjë zë të vetëm për punime në lidhje me shpimet gjeologo inxhinierike;

Nga sa më sipër, rezultojnë se kategoritë e kërkuara nga ana e NJP janë krejtësisht të paargumentuara, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, situatë e cila, në gjykim të grupit të auditimit, ka ngushtuar konkurrencën.

- Kriteri: *“...Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, me eksperiencë pune minimumi 10 (dhjetë) vjet dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...”*, nuk është i argumentuar dhe i përshtatshëm, pasi vendosja e eksperiencës së inxhinierit nuk është e argumentuar teknikisht se përse duhet me të paktën 10 vite eksperiencë. Së pari duhet sqaruar fakti se VKM nr. 759, datë 12.11.2014 *“Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”*, i ndryshuar, ka përcaktuar qartë se cilat janë kriteret e dhënies së licencave profesionale në zbatim për drejtuesit teknik dhe në mënyrë të ngjashme ka diktuar edhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, për firmat sipërmarrëse.

Për rrjedhojë rezulton se edhe ky kriter nuk është i argumentuar dhe as në përputhje me nevojat e investimit.

- Kriteri: *“...OE duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 200 (dyqind) punonjës për periudhën dhjetor 2019-nëntor 2020, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik...”*, nuk është i argumentuar dhe i përshtatshëm, pasi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 200 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë.

- Kriteri: *“...OE duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse...”*, nuk është i argumentuar dhe i përshtatshëm, pasi nga auditimi nuk rezultoi ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër specialistësh si më sipër, pra përse 2 inxhinierë ndërtimi, 2 gjeodetë e kështu me rradhë. Gjithashtu, konstatohet se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe jo në përputhje me domosdoshmëritë që paraqet realizimi i punimeve, janë kërkuar inxhinierë gjeoteknikë dhe inxhinierë gjeologë, inxhinier mekanikë.

- Në lidhje me kërkesat për stafin si më sipër, nuk është e argumentuar arsyeja se përse stafi i mëparshëm është kërkuar të jetë në listëpagesa që prej dhjetorit 2019 dhe në rastin e fundit është kërkuar të jenë në listëpagesa prej shtatorit e deri në nëntor të vitit 2020. Së dyti, konstatohet se ashtu si edhe në rastin më sipër, edhe për këtë pjesë të stafit nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitetet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër specialistësh si më sipër, pra përse nevojiten 2 Inxhinierë Ndërtimi, nga të cilët 1 të jetë profili Transport; 2 Inxhinierë Gjeodetë/Topografë; 1 Inxhinier Mjedisi, profili Trajtimi i Ujrave, i pajisur me certifikatë *“Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit dhe të Mbetjeve”*, si dhe i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit;

- Kriteri: *“...OE duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën qershor-nëntor 2020, stafin mbështetës 2 Teknikë Gjeometër, 3 Teknikë Ndërtimi, 2 Mekanikë dhe 1 Elektriçist...; minimumi 75 punonjës të kualifikuar, nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin 10 Specialistë për Montim Tubash, 2 Teknikë Ndërtimi, 3 Specialistë për testimin e tubave nën presion, 2 Elektriçistë, 3 Pompistë, 7 Hidraulikë, 2 Mekanikë, 4 Saldatorë, 12 Karpentierë (marangozë), 7 Hekurkthyesa, 4 Hidroizolues, 3 Muratorë, 10 Specialistë ndërtimi, 3 Montatorë dhe 3 Bojaxhi, të pajisur me dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve në bazë të Ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit nr. 13/2013....; të paktën 9 punonjës manovratorë të mjeteve të rënda, nga të cilët 2 automakinistë dhe 7 eskavatoristë..... 2 punonjës, të cilët të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, 2 punonjës specialist si Ekspert zjarrefikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të certifikuar nga Drejtoria e MZSH-së, 1 Inxhinier Auditues i Energjisë (i pajisur me certifikatë për Auditimin e Energjisë), e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, 2 punonjës të certifikuar si “Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, 1 inxhinier “Përgjegjës për dëmet në mjedis” i pajisur me certifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, 1 inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001: 2015” i pajisur me certifikatë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë....”, nuk është i argumentuar, se përse këta specialistë*

duhet të jenë domosdoshmërisht edhe inxhinierë. Gjithashtu, konstatohet se në mënyrë të përsëritur, krejtësisht të paargumentuar dhe jo në përputhje me domosdoshmëritë që paraqet realizimi i punimeve.

- Kriteri: “...OE duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 15 punonjës të certifikuar për punime në lartësi, ku njëri prej të cilëve të jetë inxhinier, si dhe të të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën qershor-nëntor 2020...”, në mënyrë të ngjashme me si më sipër rezulton se është i paargumentuar kriteri i vendosur në lidhje me numrin prej 15 të punësuarve të certifikuar për punime në lartësi aq më tepër ku janë kërkuar nga këta që 1 të jetë edhe inxhinier ndërtimi;

- Kriteri “...OE duhet të jetë i pajisur me licencë III.2.A (1+2) “Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis, Ndikimi në mjedis Auditim Mjedisor”, Ndikim Mjedisor”, nuk është i argumentuar dhe i përshtatshëm, pasi licenca e mësipërme lëshohet nga QKL për subjektet e licencuara juridike ose fizike tregtare, për të kryer veprimtarinë e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimit mjedisor, si ekspertë të VNM-së dhe auditimit mjedisor, kjo pasi edhe raportet e thelluara edhe raportet paraprake të VNM-ve pranohen si të tillë vetëm kur janë nënshkruar nga një ekspertë i certifikuar apo nga subjekte juridike ose fizike tregtare, të licencuara nga QKL-ja, për veprimtarinë e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimit mjedisor.

Pra, nga sa më sipër rezulton se procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, është një fazë e cila ezaurohet përpara miratimit të Projektit dhe pasi Projekti është miratuar, marrë në dorëzim dhe nuk mundet kurrësi të vendoset si kriter për firmat sipërmarrëse që do të marrin pjesë. Ajo që duhet theksuar në këtë rast është fakti se një licencë e tillë nuk mund t’i kërkohej një firme sipërmarrëse për një projekt të miratuar gjatë fazës së zbatimit dhe aq më tepër duke u zbatuar nga vetë ajo firmë zbatimi pasi do të ishte në konflikt të hapur interesi.

- Kriteri “OE duhet të jetë i pajisur me Licencë Kodi I.2.A “Studimi e përgatitja e projekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri për ndërtesa të çdo lloji...”, nuk është i argumentuar dhe i përshtatshëm, pasi licenca e mësipërme është krejtësisht jashtë çdo domosdoshmërie, sepse aktualisht kontrata objekt prokurimi është kontratë për punime zbatimi (punime civile) dhe si e tillë ka patur një projekt të miratuar tashmë nga ana e AK. Për rrjedhojë ky kriter nuk duhet të ishte vendosur.

- Kriteri “...OE duhet të ketë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)...”, nuk është i argumentuar dhe i përshtatshëm, pasi sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër i tillë mjeteve në lidhje me këtë kontratë.

Gjithashtu, përveç mangësisë së argumentit në lidhje me numrin e mjeteve si më sipër rezulton se nga ana e NJP janë vendosur kërkesa për pajisje dhe mjete të cilat nuk kanë asnjë domosdoshmëri për realizimin e kontratës.

Vlen të theksohet në këtë rast se ka një disproporcion mes numrit të stafit të kërkuar (200 persona) me numrin e kokoreve (200 copë) si dhe numrin e fikseve prej 5 copësh apo 10 tabela paralajmëruese në një kantier me shtrirje si ajo e një rrjeti ujësjellësi.

Konkluzion mbi kriteret e kualifikimit: Nga Bashkia Mat, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, ka hartuar dhe miratuar kriterë diskriminues duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përlllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Gjithashtu vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk është e sqaruar në mënyrë

teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike” dhe neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

Për mangësitë e konstatuara mbi hartimin e kriterëve të kualifikimit, mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së Prokurimit dhe hartimit të DST si vijon: z. E.A., kryesisht specialisti i fushës z. E.L. me profesion (inxhinier) dhe z. D.R..

Vlerësimi i Ofertave: Për arsyet e mëposhtme janë skualifikuar 2 OE, si vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE E. ShPK, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/Kualifikimit, si më poshtë:

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “b” dhe “ç”/2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është e plotë “Deklarata mbi konfliktin e interesit sipas Shtojcës 7” dhe nuk është paraqitur “Deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10”;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4. “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, pasi nuk është paraqitur “Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2019 dhe 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, si dhe një vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Mat.”;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1. “Përvoja të mëparshme”, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon punë të ngjashme për një objekt të vetëm jo më të vogël se 50% e fondit limit ose punë të ngjashme ku vlera totale e punimeve të kryera gjatë 3 viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 200% e fondit limit. Kontratat e paraqitura nga OE kanë një vlerë më të vogël se vlerat e kërkuara në gërmën “a” dhe “b”;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2. “Për kapacitetin Teknik”, “...liçencat profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, për punimet e përgjithshme, nuk disponon klasifikimin E për Kategorinë NP-5, klasifikimin G për Kategorinë NP-7, klasifikimin E për Kategorinë NP-9, klasifikimin E për Kategorinë NP-12, për punimet speciale: klasifikimin D për Kategorinë NS-6, klasifikimin F për Kategorinë NS-9, klasifikimin C për Kategorinë NS-16, klasifikimin D për Kategorinë NS-18, dhe Kategorinë NS-20, të liçencës profesionale;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3. “Për kapacitetin Teknik”, “...liçencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për zbatimin e kontratës...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis, Kodi III.2.A., Liçencë për mbrojtjen nga zjarri, Kodi I.2.A., Leje mjedisore e tipit C për “Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”, Kodi III.1.A., (lëshuar nga QKB) dhe Liçencë për “Shpues profesionist për ujë”, Kodi III.7.B., (lëshuar nga QKB);

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4. “Për kapacitetin Teknik”, “...certifikatat ISO...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon certifikatat: ISO 3834-2; ISO 28001; ISO 1452-1; DS CEN 15128; BS EN 13331-1 2002 dhe Rregullore (EU) nr. 333/2011;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5. “Për kapacitetin Teknik”, “...Lista e mallrave/materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi...”, pasi në

dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për listën e mallrave/materialeve (*Autorizime, katalog, dëshmi testimave zyrtare etj.*);

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6. “Për kapacitetin Teknik”, “...kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtarë ose ndërkombëtarë...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “a”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon staf inxhinierik si drejtues teknik në liçencën e shoqërisë 1 Inxhinier Ndërtimi, profili Transport, 2 Inxhinierë Ndërtimi, profili Strukturist, 2 Inxhinierë Gjeodetë/Topografë, por vetëm 1 të tillë, 1 Inxhinier Ndërtimi, profili Gjeoteknik, 2 Inxhinierë Gjeologë, nga të cilët 1 të jetë profili Hidrogeologji;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “b”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar 2 Inxhinierë Ndërtimi, nga të cilët 1 të jetë profili Transport, 2 Inxhinierë Gjeodetë/Topografë, 1 Inxhinier Mjedisi, profili Trajtimi i Ujrave, i pajisur me certifikatë “Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit dhe të Mbetjeve”, si dhe i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit; 1 Inxhinier Elektrik/ Elektronik i pajisur me certifikatë për sistemin e SCADA, lëshuar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar kompetente për sistemet SCADA...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponohet staf inxhinierik si më sipër;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “d”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës 2 Teknikë Gjeometër, 3 Teknikë Ndërtimi, 2 Mekanikë, 1 Elektriçist...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon stafin mbështetës 2 Teknikë Gjeometër, 3 Teknikë Ndërtimi, por vetëm 1 të tillë dhe 2 Mekanikë. Për 1 Elektriçist nuk është paraqitur Dëshmi Aftësie e lëshuar nga subjektet e akredituar/Diplomë (Dëftesë);

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “e”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar minimumi 75 punonjës të kualifikuar, nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin: 10 Specialistë për Montim Tubash, 2 Teknikë Ndërtimi, 3 Specialistë për testimin e tubave nën presion, 2 Elektriçistë, 3 Pompistë, 7 Hidraulikë, 2 Mekanikë, 4 Saldatorë, 12 karpentierë (marangozë), 7 Hekurkthyesa, 4 Hidroizolues, 3 Muratorë, 10 Specialistë ndërtimi, 3 montator, dhe 3 Bojaxhinj, të pajisur me dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve në bazë të Ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit nr. 13/2013;...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon punonjësit e kualifikuar 10 Specialistë për Montim Tubash, por vetëm 3 të tillë, për të cilët nuk janë paraqitur dhe kontratat e punës, 2 Teknikë Ndërtimi, 3 Specialistë për testimin e tubave nën presion, 3 Pompistë, 7 Hidraulikë, por vetëm 5 të tillë, 2 Mekanikë, por vetëm 1 të tillë, 12 Karpentierë (Marangozë), por vetëm 5 të tillë, 7 Hekurkthyesa, por vetëm 4 të tillë, 10 Specialistë ndërtimi, por vetëm 3 të tillë dhe 3 Montatorë;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “f”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 9 punonjës manovratorë të mjeteve të rënda, nga të cilët 2 automakinistë dhe 7 eskavatoristë...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon 7 eskavatoristë, por vetëm 5 të tillë;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “g”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar, minimumi 2 punonjës, të cilët të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”..., 2 punonjës specialist si Ekspert zjarrfikës..., 1 Inxhinier Auditues i Energjisë (i pajisur me certifikatë për Auditimin e Energjisë)..., 2 punonjës të certifikuar si “Ekspert për ndihmën

e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”... , 1 inxhinier “Përgjegjës për dëmet në mjedis”... dhe 1 inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001:2015”...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon personel të çertifikuar 2 punonjës, të cilët të disponojnë çertifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, por vetëm 1 të tillë, 2 punonjës specialist si “Ekspert zjarrfikës”, por vetëm 1 të tillë, 2 punonjës të çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, por vetëm 1 të tillë, 1 inxhinier “Përgjegjës për dëmet në mjedis”... dhe 1 inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001:2015”...;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “h”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 15 punonjës të çertifikuar për punime në lartësi, ku njëri prej të cilëve të jetë inxhinier...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon në stafin e tij të paktën 15 punonjës të çertifikuar për punime në lartësi, por vetëm 5 të tillë, ku njëri prej të cilëve është inxhinier;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “i”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, me eksperiencë pune minimumi 10 vjet dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur deklaratë për përcaktimin e Drejtuesit Teknik.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10., “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të disponojë 1 njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon 1 njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.11., “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të disponojë duhet të disponojë 1 kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon 1 kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.12., “Për kapacitetin Teknik”, “...OE ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për materialet/ pajisjet..., autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar..., specifikimet teknike (referuar katalogëve dhe nr. i faqes së katalogëve për çdo pajisje/material etj.) kompaninë prodhuese dhe çertifikatën ISO 9001: 2008/2015 ose Çertifikatën e Konformitetit CE të prodhuesit së bashku me të dhëna të plota të shoqërisë prodhuese...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka dorëzuar skedën teknike për materialet/pajisjet e kërkuara në tabelën e paraqitur në DST, si dhe bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3., “Për kapacitetin Teknik”, “...Autoriteti Kontraktor do të organizojë një vizitë në kantier 7 ditë përpara datës së zhvillimit të tenderit, ku operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqiten pranë autoritetit kontraktor në orën 8.00, me mostrat e tubacioneve PE 100 RC..., Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues)...”, pasi OE nuk është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në vizitën e organizuar së bashku me mostrat e tubacioneve PE 100 RC të kërkuara, si dhe nuk ka deklaruar se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.13., “Për kapacitetin Teknik”, “...OE duhet të paraqesë Analizat e çmimeve të preventivit, Plan-organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, ...si dhe Grafikun e detajuar të punimeve të firmosur e vulosur nga përfaqësuesi i ofertuesit...”, pasi në dokumentacionin e ngarkuar për tender, nuk ka paraqitur Analizat e çmimeve të preventivit, Plan-organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, ...si dhe Grafikun e detajuar të punimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “Gj. K.” ShA, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 germa “b” dhe “ç”/2. “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1; ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5”. Ky kusht nuk përmbushet nga ana e OE, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në “Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur” nuk ka klikuar mënyrën e përgatitjes së ofertës, ndërsa “Deklarata mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike” nuk është sipas formatit të Shtojcës nr. 5.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.4. “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, “Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2019 dhe 2020 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, si dhe një vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Mat.”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka paraqitur vërtetimet nga Bashkia ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2020, si dhe nuk ka paraqitur vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Mat;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2. “Për kapacitetin teknik”, “...OE duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës..., Kategoria NS-3 (Implante ngritëse dhe transportuese), Klasifikimi C...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon klasifikimin C për Kategorinë NS-3, për punimet speciale në liçencën profesionale;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.3. “Për kapacitetin teknik”, “...OE duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për zbatimin e kontratës...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis, Kodi III.2.A., Liçencë për mbrojtjen nga zjarri, Kodi I.2.A., Leje mjedisore e tipit C për “Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane”, Kodi III.1.A (lëshuar nga QKB) dhe Liçencë për “Shpues profesionist për ujë”, Kodi III.7.B (lëshuar nga QKB);

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4. “Për kapacitetin teknik”, “...OE duhet të paraqesë Çertifikatat ISO...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk disponon çertifikatat ISO 1452-1; DS CEN 15128 dhe Rregullore (EU) nr. 333/2011;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5. “Për kapacitetin teknik”, “...Për Listën e mallrave/materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për listën e mallrave/ materialeve (Autorizime, katalog, dëshmi testimi zyrtar etj.);

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6. “Për kapacitetin teknik”, “...OE duhet të paraqesë një kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “a”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon

staf inxhinierik si drejtues teknik në liçencën e shoqërisë 2 Inxhinierë Ndërtimi, profili Strukturist, por vetëm 1 të tillë, 1 Inxhinier Ndërtimi, profili Gjeoteknik, 1 Inxhinier Hidroteknik, 1 Inxhinier Elektrik, 1 Inxhinier Gjeolog, profili Hidrogeologji dhe 1 Inxhinier Elektronik;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “b”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar 2 Inxhinierë Ndërtimi, nga të cilët 1 të jetë profili Transport, 2 Inxhinierë Gjeodetë/Topografë, 1 Inxhinier Mjedis, profili Trajtimi i Ujrave, i pajisur me certifikatë “Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit dhe të Mbetjeve”, si dhe i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit; 1 Inxhinier Elektrik/ Elektronik i pajisur me certifikatë për sistemin e SCADA, lëshuar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar kompetente për sistemet SCADA...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon stafin inxhinierik 1 Inxhinier Ndërtimi, të jetë profili Transport, për 2 Inxhinierë Gjeodetë/Topografë, mungojnë librezat e punës, Inxhinieri i Mjedisit, nuk është i profilin Trajtimi i Ujrave, i mungon librezat e punës dhe nuk është i certifikuar për sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe mbetjeve dhe 2 Inxhinierët Elektrikë nuk janë të pajisur me certifikatë për sistemin e SCADA;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “d”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës 2 Teknikë Gjeometër, 3 Teknikë Ndërtimi, 2 Mekanikë, 1 Elektriçist...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon stafin mbështetës 2 Teknikë Gjeometër dhe për 3 Teknikë Ndërtimi nuk janë paraqitur Dështimtë e Aftësisë të lëshuara nga subjektet e akredituar/Diplomë (Dëftesë);

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “e”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar minimumi 75 punonjës të kualifikuar, nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin: 10 Specialistë për Montim Tubash, 2 Teknikë Ndërtimi, 3 Specialistë për testimin e tubave nën presion, 2 Elektriçistë, 3 Pompistë, 7 Hidraulikë, 2 Mekanikë, 4 Saldatorë, 12 karpentierë (marangozë), 7 Hekurkthyesa, 4 Hidroizolues, 3 Muratorë, 10 Specialistë ndërtimi, 3 montator, dhe 3 Bojaxhinj, të pajisur me dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve në bazë të Ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit nr. 13/2013;...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon punonjësit e kualifikuar 10 Specialistë për Montim Tubash, 3 Specialistë për testimin e tubave nën presion, 3 Pompistë, 7 Hidraulikë, por vetëm 5 të tillë, 12 Karpentierë (Marangozë), por vetëm 5 të tillë, 7 Hekurkthyesa, por vetëm 1 të tillë, 4 Hidroizolues, 3 Muratorë, por vetëm 2 të tillë, 10 Specialistë ndërtimi, 3 Montatorë, dhe 3 Bojaxhinj;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “g”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar, minimumi 2 punonjës, të cilët të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”..., 2 punonjës specialist si Ekspert zjarrfikës..., 1 Inxhinier Auditues i Energjisë (i pajisur me certifikatë për Auditimin e Energjisë)..., 2 punonjës të certifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”..., 1 inxhinier “Përgjegjës për dëmet në mjedis”... dhe 1 inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001:2015”...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon 2 punonjës specialist si “Ekspert zjarrfikës”, por vetëm 1 të tillë dhe 1 inxhinier “Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001:2015”...;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8., germa “h”, “Për kapacitetin Teknik”, “...OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 15 punonjës të certifikuar për punime në lartësi, ku njëri prej të cilëve të jetë inxhinier...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon në stafin e tij të paktën 15 punonjës të certifikuar për punime në lartësi, por vetëm 4 të tillë, ku njëri prej të cilëve është inxhinier;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.9., “*Makineri, Pajisje*”, “...OE duhet të paraqesë automjetet, mjete dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon automjetet, mjetet dhe pajisjet 1 Makineri për shkullje pemësh, 1 Makineri speciale për hidrombjellje bari, 3 Autobotë uji, por vetëm 1 të tillë, 4 Kamionçina me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton për secilën kamionçinë, 3 Pompa uji zhytëse, 2000 m² Skela metalike, 1 Aparaturë për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metodë me goditje (me pjatë) duhet të plotësojë këto parametra: Forca e goditjes (ndikimit): 7070 N; Koha e ndikimit: 17ms; Lartësia e lëshimit: 720 mm; Memorie: 900 matje, 2 Skela kullë, 2000 m² Kallëperi metalike, 1 Pajisje prerëse hidraulike për struktura b/a (tip gërshërë), 1 Pajisje për largim ujërash nëntokësore me aksesoret përkatës dhe 1 Mikser Rrotullues 360° me goma;

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.10., “*Për kapacitetin Teknik*”, “...OE pjesëmarrës duhet të disponojë 1 njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon 1 njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve (të ndërtimit dhe inerteve) me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.12., “*Për kapacitetin Teknik*”, “...OE ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për materialet/ pajisjet..., autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar..., specifikimet teknike (referuar katalogëve dhe nr. i faqes së katalogëve për çdo pajisje/material etj.) kompaninë prodhuese dhe çertifikatën ISO 9001: 2008/2015 ose Çertifikatën e Konformitetit CE të prodhuesit së bashku me të dhëna të plota të shoqërisë prodhuese...”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka dorëzuar skedën teknike për materialet/pajisjet e kërkuara në tabelën e paraqitur në DST, si dhe bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3., “*Për kapacitetin Teknik*”, “...Autoriteti Kontraktor do të organizojë një vizitë në kantier 7 ditë përpara datës së zhvillimit të tenderit, ku operatorët ekonomik të interesuar duhet të paraqiten pranë autoritetit kontraktor në orën 8.00, me mostrat e tubacioneve PE 100 RC..., Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues)...”, pasi OE nuk është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në vizitën e organizuar së bashku me mostrat e tubacioneve PE 100 RC të kërkuara, si dhe nuk ka deklaruar se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit.

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.13., “*Për kapacitetin Teknik*”, “...OE duhet të paraqesë Analizat e çmimeve të preventivit, Plan-organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, ...si dhe Grafikun e detajuar të punimeve të firmosur e vulosur nga përfaqësuesi i ofertuesit...”, pasi në dokumentacionin e ngarkuar për tender, nuk ka paraqitur Analizat e çmimeve të preventivit, Plan-organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, ...si dhe Grafikun e detajuar të punimeve.

Konkluzion mbi Vlerësimin e Ofertave: Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë skualifikuar 2 OE dhe është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë BOE “L.O.” ShPK dhe “F.” ShPK, me vlerë të ofertuar: 1,035,619,748.95 lekë pa TVSh, dhe 1, 242,743,698.74 lekë me TVSh.

Grupi auditimit konstatoi se vlerësimi i mësipërm lidhur me skualifikimin ka rezultuar i drejtë për 2 OE në garë por ka pasur mangësi në vlerësimin e shpalljen fitues të BOE fitues, si më poshtë.

Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8. gërma “h” *OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 15 punonjës të certifikuar për punime në lartësi....*”, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se për punonjësit me profil për punime në lartësi, grupi i auditimit gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga BOE L.O. dhe F., për punonjësit me profesion “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit*”, “*Përgjegjës të punimeve në lartësi*” dhe “*Përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis*”, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pasi institucioni lëshues i certifikatave të trajnimit, konkretisht shoqëria A., nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me Ligjin nr. 15/2017, “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*” dhe për pasojë procedura e mësipërme nuk është në përputhje me kërkesat e LPP.

Në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe deklarin sipas shtojcës nr. 10, u konstatua se në deklarin e disponueshmërisë së pajisjeve dhe mjeteve, BOE L.O. & F., ka deklaruar në Shtojcën nr. 10, 5 mjete të cilat kanë të njëjtat karakteristika dhe të dhëna ku figurojnë në përdorim në një tjetër kontratë pune po në bashkinë Mat, konkretisht: mjeti fadromë me goma me targë ABMT-91; mjeti eskavator me goma me targë ACMT-17, paraqitur nga L.O. ShPK; mjeti kamion Volvo me targë AA472TI; mjeti kamionçinë Mercedes-Benz 906, Sprinter 511 CDI me targë AA839TA dhe mjeti kamion me Bot për spërkatje asfalti, lloji Mercedes-Benz, me targë AA840TA, të cilat rezultojnë të dhëna me qera nga OE F. ShPK dhe qiramarrës, subjekti E. ShPK, nëpërmjet kontratës me nr. 2816 rep dhe nr. 1866 kol, datë 12.09.2020, i cili është shpallur fitues në tenderin me objekt “*Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj-Loti 1*”, duke kryer deklarin e të dhëna jo të sakta mbi sa më sipër.

Sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se KVO nuk ka vlerësuar sipas parimit dhe kërkesave të LPP në garë, duke i dhënë më rëndësi çmimit më të ulët e për pasojë duke kaluar përciptazi dokumentet e paraqitura nga BOE i kualifikuar si fitues, veprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 46, “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika 1, gërma “b”; neni 53, “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, si dhe me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 26, “*Kontratat për punë publike*”, pika 8, neni 47 “*Raportimi i skualifikimit*”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të nenit 47 të LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 1,242,743,698 lekë me TVSh me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga z. E.H., z. A.M. dhe z. E.R..

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 8, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 1,035,619,748 lekë pa TVSh.

Shkak: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj, Loti II”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 804, datë 16.12.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 804, datë 16.12.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 564, datë 14.08.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur	1. E.A., Kryetar; 2. E.L., Anëtar; 3. D.R., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. A.M., Anëtar 3. E.R., Anëtar
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 281,831,671.67 lekë	6. Oferta fituese: BOE E. & E., me ofertë 279,860,372 lekë pa TVSh, me kontratë datë 24.02.2021, me afat 12 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit	7. Diferenca me fondin limit: 1,971,299.67 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 18.01.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimit të ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: Nga auditimi, u konstatua se për kërkesën “...OE duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liqensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës...”, disa nga kategoritë e licencave janë të paargumentuara dhe skanë lidhje me zërat e punimeve në projekt-preventiv, si në vlerën e kategorisë apo dhe të punëve që do kryhen në terren, konkretisht Kategoria NP-12. “Punime të inxhinierisë së mjedisit” dhe Kategoria N.S.-18. “Punime topogjeodezike”;
- Kërkesa për Certifikatat PAS 99 “Sisteme të menaxhimit të integruar”, ISO IEC 27001 “Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit” dhe ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të Energjisë”, nuk janë në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duheshin vendosur në kriteret e vlerësimit;

- Kërkesa që OE duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 240 punonjës për periudhën dhjetor 2019-nëntor 2020, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknikë nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet. Nuk ka një analizë për përcaktimin e fuqisë punëtore, në lidhje me orët e punës për çdo zë punimi sipas manualit në fuqi, me volumet e punës sipas preventivit dhe me afatin e punimeve sipas grafikut të punimeve;

- Kërkesa që OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, ose të kontraktuar të paktën 1 Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme) dhe të pajisur me Çertifikatën përkatëse, nuk është e argumentuar dhe kufizon pjesëmarrjen e OE në procedurë;

- Kërkesa që OE pjesëmarrës “...duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, minimuni 1 person që përmbush kriteret për të qenë “Përgjegjës për dëmet në mjedis” dhe minimuni 1 person që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”....”, nuk është e argumentuar dhe kufizon pjesëmarrjen e OE në procedurë;

- Kërkesa që OE ofertues “...duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liqencën e shoqërisë i cili duhet të ketë eksperiencë pune minimumi 15 vjet...”, është kriter i ekzagjëruar dhe diskriminues. Kërkesa e mësipërme për eksperiencën e punës të inxhinierëve është e panevojshme dhe e paaplikueshme sepse eksperiencia e punës të stafit teknik të një OE që operon në sektorin e ndërtimit rregullohet nga VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për Miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”;

Kriteret e vendosura më sipër, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

Për sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5.

Vlerësimi i ofertave: Nga auditimi i kriterëve të vlerësimit, u konstatua se për pikën 2.3. “Kapaciteti teknik, përvoja të mëparshme” është kërkuar “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% (që i korrespondon vlerës 140,915,835.8 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% (që i korrespondon vlerës 563,663,343 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet....”; BOE ka paraqitur 5 kontrata të realizuara në sektorin publik për të vërtetuar punime të ngjashme:

- Operatori ekonomik E. ShPK, ka kryer punë si nënkontraktor me kompaninë A. SRL në cilësinë e Kontraktorit kryesor, me objekt: “Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza (KUZ) Vlorë”. OE E. ShPK ka kryer punime me vlerë 2,233,148 Euro, ose 17% të totalit të kontratës;
- E. ShPK ka kryer punime si nënkontraktor me kompaninë J.S. SRL & A. SPA, në cilësinë e Kontraktorit kryesor, me objekt “Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve në Vlorë, Ksamil, Kavajë dhe Shëngjin (Lezhë), Loti 2: Zgjerimi i impiantit të ujërave të ndotura Kavajë”, sa 20% e vlerës së kontratës (14,381,885.61 Euro) me vlerë 2,876,377.12 Euro pa TVSh.

Sa më sipër, konstatohet se në preventivin e punimeve dhe në situacionet e paraqitura, llojet e punimeve nuk kanë ngjashmëri në llojin e punimeve të kryera. Vlera totale nuk mund të jetë tregues për sa kohë nuk përputhet dhe dëshmon ngjashmëri të punëve të kryera. Po ashtu mungojnë faturat tatimore për secilin prej situacioneve.

- OE E. ShPK si pjesë e BOE, E. & K.K. ka kryer punime sipas kontratës nr. 97, datë 20 janar 2017 lidhur me AK Bashkia Fushë Arrëz, me objekt: “Rikonstruksion i fasadave dhe sheshit të qytetit Fushë Arrëz”. Vlera e kontratës ka qenë 88,836,310 lekë me TVSh, ku E. ShPK ka kryer 49% të punimeve.

- Kontratë pune nr. 269 prot., datë 11.05.2017, lidhur me AK Bashkia Kamëz, me objekt “Ndërtim Rruga “Abdi Bej Toptani””. Vlera e kontratës ka qenë 89,902,764 lekë me TVSh, ku E. ShPK ka kryer 100% të punimeve.

- Kontratë pune nr. 435 prot., datë 31.10.2016, lidhur me AK Bashkia Kamëz me objekt “Ndërtim rruga Demokracia II (Ura Paskuqan 1-Babrru Qendër)”. Vlera e kontratës ka qenë 89,902,764 lekë me TVSh, ku E. ShPK ka kryer 100% të punimeve.

Sa më sipër lidhur si dëshmi për përvojën e mëparshme, konstatohet se: Në preventivin e punimeve dhe në situacionet e paraqitura, llojet e punimeve nuk kanë ngjashmëri si llojin e punimeve të kryera apo dhe në përqindjen e tyre në vlerë. Sa më sipër konstatohet se ky kriter është po aq i rëndësishëm për zbatueshmërinë e kontratës por është dhe një nga kriteret më të domosdoshëm për kualifikim në rastin e punëve publike. Anëtar i KVO, një nga të cilët është me profesion inxhinier nuk duhej të vlerësonte si kriter të plotësuar këtë pikë. Sa më sipër mban përgjegjësi drejtpërdrejt për këtë rast. Ky BOE duhej skualifikuar dhe duhej vazhduar me OE të radhës nëse do kishte.

- Asnjëri nga nga OE nuk ka paraqitur certifikatën OHSAS 18001 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente me të, të njohur nga Standardet Shqiptare;

- BOE nuk plotëson kërkesën për “...staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, ...për punonjës me specialitetin minimuni 1 person që përmbush kriteret për të qenë “Përgjegjës për dëmet në mjedis” dhe minimuni 1 person që përmbush kriteret për të qenë “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhjryjen ndaj Emergjencave”....”, pasi ka paraqitur dëshmi trajnimi për dy persona, nga shoqëria A. ShPK, e cila nuk është e licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse

trajnimi për formimin profesional në përputhje me Ligjin nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

- BOE nuk plotëson kërkesën për “...1 njësi magazinimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve me vendodhje në territorin e Bashkisë Mat...”, pasi njësi e magazinimit e paraqitur është dhënë me qira nga shoqëria U. ShPK për E. ShPK, me afat deri në perfundimin e kontratës së punimeve për procedurën “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj, Loti 1”, me kontratën nr. 2527 rep. dhe nr. 1706 kol., datë 31.08.2020;

- BOE nuk plotëson kërkesën që “...mjetet me qira... të jenë të shoqëruara detyrimisht dhe mandat pagesat bankare për secilin nga automjetet dhe/ose pajisjet e marra me qira...”, pasi në asnjë rast, nga OE nuk janë paraqitur mandat pagesa bankare për automjetet e marra me qera;

- BOE nuk plotëson kërkesën për “...1 kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera...”, pasi asnjëri nga OE nuk ka paraqitur disponueshmërinë e 1 kantieri për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera;

Anëtari i KVO, një nga të cilët është me profesion inxhinier nuk duhej të vlerësonte si kriter të plotësuar këtë pikë. Sa më sipër mban përgjegjësi drejtpërdrejt për këtë rast. Ky BOE duhej skualifikuar dhe duhej vazhduar me OE të radhës nëse do kishte.

Sa më sipër, grupi i auditimi konstaton se KVO nuk ka vlerësuar sipas parimit dhe kërkesave të LPP në garë, veprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, gërma “b”; nenin 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, pika 8, neni 47 “Raportimi i skualifikimit”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të nenit 47 të LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 281,831,672 lekë me TVSh me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 8, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 281,831,672 lekë pa TVSh.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i rrjetit të Kuz Blloku Drita nr. 1 dhe Drita nr. 2 dhe lagjia e re, qyteti Burrel”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 287, datë 29.04.2020	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 287, datë 29.04.2020	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 288, datë 29.04.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur	1. E.A., Kryetar; 2. E.M., Anëtar; 3. D.R., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. A.M., Anëtar 3. E.R., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 71,820,319 lekë	6. Oferta fituese: BOE C. & K., me ofertë 71,754,165 lekë pa TVSh, me kontratë datë 10.07.2020, me afat 6 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit	7. Diferenca me fondin limit: 66,154 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 08.06.2020	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 2 OE,

		c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimit të ofertave.

Situata: Fondi limit: Objekti i prokurimit është “Ndërtim i rrjetit të Kuz Blloku Drita Nr.1 dhe Drita nr. 2 dhe lagjia e Re, qyteti Burrel”, me fondin total: 71,820,319 lekë pa TVSh, ndarë për vitin 2020 në vlerën: 14,364,064 lekë pa TVSh nga granditë, ndërsa për vitin 2021 në vlerën: 25,000,000 lekë pa TVSh nga granditë, ndërsa për vitin 2020 në vlerën: 32,456 255 lekë pa TVSh nga buxheti i shtetit, me afat realizimi të punimeve: 6 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Faza përgatitore: Në shkresën nr. 411 prot., datë 11.02.2020 “Ndarja e fondit për objektin: “Ndërtim i rrjetit të kuz Blloku Drita nr. 1 dhe Drita nr. 2 dhe lagjia e re, qyteti Burrel” sqarohet se, në bazë të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” bëhet ndarja e fondit për objektin e mëposhtëm, ku është paraqitur “Tabela e ndarjes së fondit për objektin”; Me shkresën nr. 1674 prot., datë 29.04.2020 “Kërkesë për “Ndërtim i rrjetit të Kuz, Blloku Drita nr. 1 dhe Drita nr. 2 dhe lagjia e re, qyteti Burrel” nga Sektori i Urbanistikës, Planifikimit dhe Menaxhimit të Territorit/Bashkia Mat, është kërkuar zhvillimi i kësaj procedure prokurimi, kërkesë e cila u miratua nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Mat me shkresën nr. 1674/1 prot., datë 29.04.2020 “Miratim kërkesë për procedurë prokurimi”; - Në datën 29.04.2020 Njësia e Prokurimit ka përcaktuar kriteret e përgjithshme e të veçanta të kualifikimit dhe pranimit dhe ka miratuar Dokumentat e Tenderit të cilat janë firmosur në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe më pas është vendosur vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit;

- Me procesverbalin nr. 2, datë 29.04.2020, në zbatim të Udhëzimit nr. 04, datë 9.05.2017 “Për veprimet Njesisë së Prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik” të Agjensisë së Prokurimit Publik, Anëtarët e Njesisë së prokurimit, vendosën që z. E.A., anëtar i njesisë së prokurimit (personi përgjegjës) të jetë personi i autorizuar i cili do të kryejë veprimet në sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) për procedurën e prokurimit të sipërcituar;

- Në datën 30.04.2020 personi i autorizuar për kryerjen e veprimeve në sistem, procedoi me hedhjen e procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) të APP-së, procedurë e cila mori nr. REF-57219-04-30-2020, dhe është publikuar në sistem më datë 04.05.2020;

- Ankesa ndaj dokumentave të tenderit (kriterëve për kualifikim) nuk ka patur;

- Agjencia e Prokurimit Publik nëpërmjet postës elektronike (email) më datë 06.05.2020, ka dërguar email-in me subjekt: “Bashkia Mat në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrjetit të Kuz, Blloku Drita nr. 1, Drita nr. 2 dhe lagjia e re, qyteti Burrel”, ku ka parashtruar rekomandimet për ndryshimin e disa prej kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit (DST) për këtë procedurë prokurimi;

- Autoriteti Kontraktor, në kuadër të shqyrtimit të rekomandimeve të dërguar nga APP, me Urdhërin nr. 348, datë 28.05.2020 “Për Pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i rrjetit të Kuz Blloku Drita Nr.1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagjia e Re, qyteti Burrel” ka pezulluar procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE), faqja zyrtare e APP-së;

- Mbi bazën e rekomandimeve të APP-së për këtë objekt prokurimi, në zbatim të pikës 2 të nenit 42, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 62 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Mat, për këtë procedurë, vendosi që referuar konstatimeve të APP-së, Njësia e Hartimit të Dokumentave të mblidhet në datë 28.05.2020 për

modifikimin/ndryshimin e disa prej kriterëve për të cilat kishte rekomanduar dhe APP-ja në dokumentat standarte të tenderit, duke hartuar dhe miratuar Shtojcën nr. 2028 prot., datë 28.05.2020, ku krahas të tjerave është vendosur edhe zgjatja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave me 5 ditë, përkatësisht më datë 08.06.2020, ora 10⁰⁰;

- Më tej në mbështetje të përcaktimeve të rregullave të prokurimit publik dhe në zbatim të Urdhërit nr. 349, datë 28.05.2020 *“Për nxjerrjen nga pezullimi të procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i rrjetit të Kuz Blloku Drita Nr.1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagjia e Re, qyteti Burrel”* është proceduar me ngarkimin e shtojcës në procedurën e objekt prokurimi të krijuar në sistemin elektronik të prokurimit (SPE), faqja zyrtare e APP-së.

Hartimi i kriterëve: Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1. E.A., (jurist) 2. A.M., (inxhinier ndërtimi), 3. D.R., (Ekonomist), të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 29.04.2020 nga të cilat disa prej tyre janë të paargumentuara, konkretisht si më poshtë:

- Kriteri në pikën 2.3.1. *“...Liçensa profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës..., Kategoria NP-12/B “Punime të inxhinierisë së mjedisit”, Kategoria NS-1/B “Punime për prishjen e ndërtimeve”, Kategoria NS-7/B “Barrierra dhe mbrojtje rrugore” dhe Kategoria NS-4/A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to”...”,* nuk janë të argumentuara dhe në përputhje me objektin që prokurohet;

- Kriteri në pikën 2.3.4. *“...Çertifikatat ISO... PAS 99 “Sisteme të menaxhimit të integruar”, ISO 27001 “Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit”, ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të Energjisë” dhe ISO 3834-2 “Për menaxhimin e kushteve të cilësisë për shkrirjen e metaleve””,* nuk janë të argumentuara dhe në përputhje me objektin që prokurohet;

Për sa më sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën, duke krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë, thuajse të caktuar. Për sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me LPP, neni 1, *“Objekti dhe qëllimi”*, neni 2, *“Parimet e përzgjedhjes”*, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar neni 26 *“Kontratat për punë publike”*, pika 5, neni 61, *“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”*

Lidhur me mangësitë e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi, kryesisht anëtari i NJP z. A.M., specialist i fushës (Inxhinier), si dhe z. E.A. në cilësinë e personit përgjegjës për administrimin dhe pregatitjen e dokumenteve të tenderit.

Vlerësimi i ofertave: Në listën e shfaqur nga hapja elektronike rezultoi se kishin marrë pjesë 3 OE, të cilët janë: BOE C. ShPK & K. ShPK, BOE S. ShPK & E.K. ShPK dhe OE A.S.G. ShPK;

Vlerat e Ofertuara janë: BOE C. ShPK & K. ShPK ka ofertuar 71,754,165 lekë pa TVSh, dhe 86,104,998 lekë me TVSh; BOE S. ShPK & E.K. ShPK ka ofertuar 49,316,925 lekë pa TVSh dhe 59,180,310 lekë me TVSh; OE A.S.G. ShPK nuk ka paraqitur ofertë ekonomike;

- Në datën 22.06.2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave dhe dokumentacionit administrativo-ligjor të paraqitur nga OE pjesëmarrës, ka mbajtur procesverbalin nr. 4, datë 22.06.2020 *“Për Vlerësimin e procedurës...”*, nga ku ka rezultuar:

- KVO ka konstatuar se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës A.S.G., nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (sipas Shtojcë 1 të DST-së) si dhe dokumentat e kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka vendosur të skualifikojë këtë OE pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës;

- KVO ka vlerësuar sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës e në dosjen e ofertës të dorëzuar (ngarkuar në SPE) nga BOE S. ShPK & E.K. ShPK, nga ku rezultoi se dosja përmbante dokumentacionin e cituar në Procesverbalin e Vlerësimit;

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE S. ShPK & E.K. ShPK, për pjesëmarrje në tender, ka rezultuar se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe Veçanta të Pranimi/Kualifikimit, si më poshtë:
- Nuk është përmbushur përcaktimi i Kriereve të Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit: *“...nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen: a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme...”*, pasi në Kontratën e Bashkëpunimit (marrëveshje e noterizuar) nuk janë përcaktuar pjesët e punimeve të preventivit objekt prokurimi që kanë marrë përsipër secili, por vetëm % (përqindja) e pjesëmarrjes, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 dhe 2 të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar);
- Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “a” të pikës 2.3.1. *“Përvoja të mëparshme”*, ku përcaktohet *“...Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% (që i korrespondon vlerës 35,910,160 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë sëbashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% (që i korrespondon vlerës 143,640,640 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet...”*, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, OE S., nuk përmbush kushtin e punimeve të ngjashme në raport me përqindjen e punimeve që ka marrë përsipër në bazë të preventivit të ofertuar, si dhe Faturat Tatimore Shitje për kontratat e paraqitura për përmbushjen e këtij kriteri, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor, pasi janë të pafirmosura nga ana e investitorit (blerësit) dhe 2 prej tyre janë të pavulosura nga shitësi, si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria E.K., konstatohet se faturat tatimore Shitje për kontratat e paraqitura të cilat kanë zëra punimesh të ngjashme, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor, pasi janë të pafirmosura nga ana e investitorit (blerësit) dhe shitësit si dhe të pavulosura nga ky i fundit;
- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4. *“...Certifikatat ISO...”*, pasi referuar natyrës së punimeve të cilat kanë marrë përsipër, OE S., nuk disponon Certifikatën OHSAS 18001 *“Për kushtet e sigurisë dhe të shëndetit të punonjësve”*, e përditësuar, ndërsa OE E.K., nuk disponon Certifikatat DS CEN/TR 15128:2005 *“Sistemi i menaxhimit për shqyrtimin e standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit”* e përditësuar, dhe BS EN 13331-1:2002 *“Sistemi i menaxhimit për sistemet për veshjet e kanaleve, specifikimet e produkteve”* e përditësuar;
- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5. *“...Certifikatat ISO...”*, pasi referuar natyrës së punimeve të cilat kanë marrë përsipër, në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, OE S. nuk disponon dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për materialet *“Tubacione Plastike”*, të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi, ku konkretisht për materialet: Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=250 mm dhe Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=600 mm, ndërsa OE E.K., nuk ka paraqitur dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera për materialet *“Tubacione Plastike”* të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi;
- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6. *“...Certifikatat ISO...”*, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, OE S., nuk ka paraqitur Mandat pagesën bankare të FDP-së për muajin prill 2017;
- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6./b. *“Për kapacitetin teknik”*, pasi referuar natyrës së punimeve të cilat ka marrë përsipër, OE S. nuk ka paraqitur Kartelat personale përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme) për punonjësit me specialitetin: Teknik ndërtimi, Murator, Punëtor ndërtimi, Manovratore dhe Shofer mjeteve, ndërsa OE E.K., nuk disponon punonjës me specialitetin Punonjes per punime PVC dhe Gome;
- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7. *“...Certifikatat ISO...”*, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se, kantieri i paraqitur nuk është në një distancë jo më shumë se 25 km nga Njësia Administrative Burrel, si dhe nuk është i pajisur me Leje Mjedisi nga QKL, (Kodi III.1.B), përkatësisht për poligon prodhimi dhe nyje larëse;

Për këto arsye: KVO unanimisht ka vendosur të skualifikojë BOE S. ShPK & E.K. ShPK, pasi nuk përmbushin të gjitha kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

Mbi skualifikimin e më sipërm KVO ka vepruar drejt.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më tej ka vijuar me vlerësimin e ofertës të dorëzuar (ngarkuar në SPE) nga BOE C. ShPK & K. ShPK, nga ku ka vlerësuar se dosja përmban dokumentacionin e cituar në Proçesverbalin e Vlerësimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE C. ShPK & K. ShPK, për pjesëmarrje në tender, rezulton se: Sipas vlerësimit të KVO, përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimi/ Kualifikimit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht ka vendosur të kualifikojë BOE C. ShPK & K. ShPK, pasi përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, rezultoi se nga KVO ka pasur një vlerësim jo të drejtë të ofertës BOE C. ShPK & K. ShPK, pasi:

- Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3. “Për kapacitetin teknik”, sepse OE C. ShPK, ka kryer punë si kontraktor me AK Bashkia Kamëz, me objekt “Ndërtimi rruga Bajram Curri +rruga Macukull, Bathore Kamëz. Vlorë”. OE C. ShPK ka kryer punime me vlerë 14,800,3230, lekë ose 100% të totalit të kontratës.

Në preventivin e punimeve dhe në situacionet e paraqitura, llojet e punimeve nuk kanë ngjashmëri si llojin e punimeve të kryera apo dhe në përqindjen e tyre në vlerë. Ky kriter është po aq i rëndësishëm për zbatueshmërinë e kontratës por është dhe një nga kriteret më të domosdoshëm për kualifikim në rastin e punëve publike. Anëtari i KVO, z.A.M., i cili është me profesion inxhinier nuk duhej të vlerësonte si kriter të plotësuar këtë pikë, kriter ky i detyrueshëm për kualifikim. Sa më sipër mban përgjegjësi drejtpërdrejt për të gjitha rastet e trajtuara. Ky BOE duhej skualifikuar dhe duhej vazhduar me OE të radhës nëse do kishte.

Sa më sipër, kontrata është lidhur në papajtueshmëri me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, gërma “b” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Për sa më sipër mban përgjegjësi KVO, e përbërë nga E.H., A.M. dhe E.R..

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 8, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 71,820,319 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 4727/13 prot., datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Pas shqyrtimit të materialit të Projekt-Raportit të Auditimit, ne, punonjësit dhe ish-punonjësit e Bashkisë Mat, caktuar në Njësinë e prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, Bashkia Mat, duke mosqënë dakort me konstatimet Tuaja të pasqyruara në ProjektRaporin e Auditimit për proçedurat e prokurimit të zhvilluara në periudhën, vitet 2020, po ju paraqesim kundërshtimet tona të bazuara në aktet ligjore dhe provat shkresore të cilat gjenden në dosjet e proçedurave të prokurimit objekt auditimi 1. Në lidhje me proçedurën e prokurimit “E Hapur – Punë” me mjete elektronike, me Nr. REF-68803-08-16-2020, me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj –Loti 1” kundërshtojmë konstatimet tuaja, si më poshtë parashtrijmë:

Në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.3.1 (Përvoja të mëparshme)/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ju shpreheni se ky kriter nuk është përmbushur nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, shoqëritë “E.” ShPK, dhe “E.” ShPK, dhe të kualifikuar për këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin se, citojmë: për anëtarin “E.” ShPK “-Sa më sipër lidhur si dëshmi për përvojën e mëparshme, konstatohet se: Në preventivin e punimeve dhe në situacionet e paraqitura, llojet e punimeve nuk kanë ngjashmëri në llojin e punimeve të kryera. Vlera totale nuk mund të jetë tregues për sa kohë nuk përputhet dhe dëshmon ngjashmëri të punëve të kryera. Po ashtu mungojnë faturat tatimore për secilin prej situacioneve.” Për anëtarin “E.” ShPK, shpreheni se, - “Sa më sipër lidhur si dëshmi për përvojën e mëparshme, konstatohet se: Në preventivin e punimeve dhe në situacionet e paraqitura, llojet e punimeve nuk kanë ngjashmëri si llojin e punimeve të kryera apo dhe në përqindjen e tyre në vlerë. Sa më sipër konstatohet se ky kriter është po aq i rëndësishëm për zbatueshmërinë e kontratës por është dhe një nga kriteret më të domosdoshëm për kualifikim në rastin e punëve publike...”

Në lidhje me konstatimin Tuaj, rezulton të jetë një konstatim i gabuar, pasi edhe pse në argumentimin tuaj shprehni fjalën “ngjashmëri” në fakt do të shkonte përshtat fjala “e së njëjtës natyrë”, pasi mund të thuhet që punimet e mëparshme të paraqitura nga B.O.E. nuk janë të së njëjtës natyrë (ujësjellësa), por kurrësesi nuk mund të thuhet se nuk janë punime të ngjashme. Ligjvënësi për vërtetimin e përvojës së mëparshme ka kërkuar që kontratat të jenë të ngjashme, ku sipas praktikës tashmë të konsoliduar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Komisionit të Prokurimit Publik, me të drejtë është kundërshtuar arsyetimi se punët e mëparshme duhet të jenë të së njëjtës natyrë, pasi në këtë rast do të kishim kufizim të rrethit të operatorëve ekonomik që do të kishin interes të merrnin pjesë në tender, pasi do të merrnin pjesë vetëm operatorët ekonomikë të cilët do të kishin punë të ngjashme vetëm për ujësjellësa. Ndërsa në lidhje me punët e mëparshme të ngjashme, ngjashmëria e tyre del pas analizimit të karakteristikave në natyrë, kompleksitetit dhe metodologjisë të kontratës së ngjashme, ku në rastin konkret kontratat e paraqitura nga “E.” ShPK, si nënkontraktor në kontratën me objekt “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në Vlorë, Faza 2, Loti 1-Refabilitimi i impiantit ekzistues të trajtimit të ujërave të ndotura, Vorë, Loti 2 – Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve në Vlorë, zona C2” dhe kontratën me objekt: “Ndërtimi i Sistemit të Kanalizimeve në Vlorë, Ksamil, Kavajë dhe Shëngjin (Lezhë), Loti 2: Zgjerimi i Impiantit të Ujrave të Ndotura Kavajë”, referuar të 3 (tre) komponentëve që duhet të përmbush kontrata e mëparshme e ngjashme në rastin konkret përmbushet, pasi referuar punimeve objekt prokurimi me ato të punëve të ngjashme të kryera, në të dyja rastet kemi gërmime, mbushje, betonime, punime asfalti, tuba KUZ etj. Ku e njëjta situatë është dhe në rastin e punëve të ngjashme të kryera nga O.E. “E.” ShPK, ku si përvojë të ngjashme ka paraqitur kontratat me objekt: “Rikonstruksion i fasadave dhe sheshit të qytetit Fushë Arrëz”, “Ndërtim rruga Demokracia Loti II (Aksi Ura Paskuqan 1 – Babrru Qendër”, dhe “Ndërtim rruga “Abdi Bej Toptani” ku dhe në këtë rast kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve, betonime, ndërtim pusesh, punime asfalti, tuba KUSH etj. Ndërsa në lidhje me faturat tatimore shitje për secilin prej situacioneve, mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën devijim të vogël në kuptim të përcaktimeve të rregullave të prokurimit publik, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur si shkresat e miratimit për nënkontraktorin “E.” ShPK, në të cilat përcaktohen punimet dhe vlerat që do të kryejë nënkontraktori, kontratat, Formularët e Vlerësimit dhe situacionet e paraqitura vërtetojnë katërçipërisht se këto punime janë kryer nga nënkontraktori. Dhe se shprehja e përdorur “Kontrata është lidhur në kundërshtim me LPP” është e pabazuar, pasi LPP-ja i ka të përcaktuar rastet kur kontrata është nënshkruar në kundërshtim me ligjin.

Për sa më lart, duke qënë se ky konstatim nuk qëndron, kërkojmë që të hiqet.

3. Në lidhje me vendosjen e kategorive dhe niveleve të klasifikimit të licencës që duhet të disponojnë/ përmbushin operatorët ekonomikë, nga ana e njësisë së prokurimit, në kriterin 2.3.2 / 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ju shpreheni se, citojmë shkurtimisht: “Sa më sipër konstatohet se disa nga kategoritë e licencave janë të paargumentuara në kriteret e vendosura dhe skanë lidhje me zërat e punimeve në projekt - preventiv, si në vlerën e kategorisë apo dhe të punëve që do të kryhen në terren. 1. Kategoria NP-12... 2. Kategoria NS-18...”

Në lidhje me përmbajtjen se si duhet të kryhet argumentimi nuk kemi patur një model të miratuar nga agjencitë/organet të cilat kanë të drejtë nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit apo VKM-së, me qëllim që të kemi një rregullim në praktikë, ku si rrjedhojë jemi përpjekur të japim argumentim referues dhe jo shterues dhe nga ana teknike, por nuk mund të thuhet se nuk është kryer. Ndërsa konstatimi se kategoritë e punimeve të përgjithshme NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit) dhe

speciale NS-18 (Punime topogjeodezike) nuk kanë lidhje me zërat e punimeve në projekt është i pavërtetë dhe i pabazuar, ku parashtrojmë se, është kërkuar kategoria NP-12, pasi referuar natyrës së investimit objekt prokurimi, duke qënë se kjo vepër po zhvillohej në terren të pyllëzuar, disponimi i kësaj kategorie ka të bëjë me ruajtjen dhe eliminimin e prishjes së ekuilibrave ekologjike në terrenin ku do të kryhen punimet objekt prokurimi si nga procesi i kryerjes së punimeve ashtu dhe mbetjeve inerte, në përputhje kjo dhe me punimet që përfshihen në këtë kategori liçencë sipas VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008. Po ashtu, në mënyrë të gabuar argumentohet që nuk nevojitet disponimi nga O.E. pjesëmarrës të kategorisë NS-18, pasi edhe pse në preventivat për punë publike nuk kemi të përcaktuar në mënyrë konkrete vlerën e shërbimit të topografisë, ky shërbim është i përfshirë në punimet që kanë natyrë topogjeodezike, ku në rastin konkret kemi punime ku është mëse e nevojshme disponimi i kësaj kategorie, pasi gjatë implementimit të investimit duhet të kryhen piketime të linjës, depove, puseve etj., sipas terrenit dhe lartësisë së tij, ku gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të duhet që të bëhet nga ana e kontraktorit azhurnimi faktit i objektit. Ndërsa kërkesa për klasifikimin B, është kërkuar referuar rëndësisë (ujësjellës) që paraqet investimi objekt prokurimi, pasi klasifikimi A merret edhe vetëm për faktin e disponimit të drejtuesit teknik në liçencë, edhe pse shoqëria e liçencuar mund të mos ketë fare eksperiencë në këto punime.

Për sa më lart, duke qënë se ky konstatim nuk qëndron, kërkojmë që të hiqet.

4. Në lidhje me vendosjen e certifikatave ISO që duhet të disponojnë/ përmbushin operatorët ekonomikë, nga ana e njësisë së prokurimit, në kriterin 2.3.4 / 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ju shpreheni se, citojmë shkurtimisht: “Sa më sipër asnjëri nga operatorët ekonomik nuk ka paraqitur OHSAS 18001 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare.

Janë kërkuar certifikata cilësie PAS 99 (Sisteme të menaxhimit të integruar), ISO IEC 27001 (Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit), ISO 50001 (Sistemi i menaxhimit të Energjisë). Këto certifikata nuk janë në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.”

Referuar konstatimeve Tuaja, ndryshe nga sa ju dispononi rezultoni se të 2 (dy) shoqëritë pjesëmarrëse “E.” ShPK, dhe “E.” ShPK, disponojnë Çertifikatën ISO 45001: 2018 (Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) të vlefshme, të cilat janë ekuivalente me Çertifikatën OHSAS 18001, dhe të njohura nga Standartet Shqiptare, konkretisht, shoqëria “E.” ShPK, disponon çertifikatën me Nr.1710AL329OHS, lëshuar datë 16.07.2020, ndërsa shoqëria “E.” ShPK, disponon çertifikatën me Nr.AQS/S/52702020, lëshuar datë 05.05.2020. (Bashkëlidhur observacionit të 2 (dy) çertifikatat e cituara)

Ndryshe nga sa ju konstatooni, siç kemi argumentuar dhe në Proçesverbalin Nr.1 për hartimin e dokumentave të mbajtur nga njësia e prokurimit, Çertifikatat ISO 27001 (Për menaxhimin e sigurisë së informacionit) dhe PAS 99 (Për sistemin e menaxhimit të integruar), janë kërkuar në zbatim të parashikimeve të nenit 46 pika 2 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet se, citojmë: “2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.” si dhe nenit 30 “Kërkesat e Cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit, dhe në përputhje me natyrën e kontratës objekt prokurimi, ku është kërkuar certifikata ISO 27001 (Për menaxhimin e sigurisë së informacionit) – me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me garantimin e ruajtjes së informacioneve financiare e personale ndaj humbjes, vjedhjes, dhe dëmtimit nëpërmjet një kuadri sistematik, si dhe përputhshmëria me kërkesat ligjore statutoe, rregullatore dhe kontraktuale, ku kjo i jep siguri autoritetit kontraktor për ofertuesit, se këto të fundit kanë marrë masat e nevojshme në mbrojtjen e të dhënave të tyre dhe parandalimin e situatave kërcënuese me qëllim sigurimin e vazhdimësisë të aktivitetit të tyre, si dhe certifikata PAS 99 (Për sistemin e menaxhimit të integruar) është kërkuar me qëllim vërtetimin se, operatorët ekonomik pjesëmarrës në veprimtarinë që

ushtron (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) përmbush të gjitha përgjegjësitë e tij ndaj klientëve, furnizuesve dhe investitorëve, në rastin konkret ndaj A.K., duke përforcuar besimin në mirëorganizimin e tij si sipërmarrës për përfundimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Ky çertifikimi konfirmon faktin që ofertuesi ka një qasje të saktë ndaj zhvillimit dhe zbatimit të sistemit të saj të menaxhimit të integruar. Për sa parashtroam, ndryshe nga sa ju shpreheni, këto çertifikata janë kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit, pasi disponimi i të 2 (dy) çertifikatave kanë lidhje me garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë të operatorëve ekonomikë në realizimin e punimeve të kontratës objekt prokurimi, pasi në të kundërt mund të cënohet realizimi i saj.

Për sa më lart, duke qënë se konstatimet Tuaja nuk qëndrojnë, kërkojmë heqjen e tyre.

5. Në lidhje me vendosjen e numërit mesatar prej jo më pak se 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) punonjës që duhet të disponojnë/ përmbushin operatorët ekonomikë, nga ana e njësisë së prokurimit, në kriterin 2.3.7 / 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ju shpreheni se, citojmë shkurtimisht: “Përsa më sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

Së pari, kriteri i vendosur për disponimin e një numëri mesatar prej jo më pak se 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) punonjës nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, siç kemi argumentuar dhe në Proçesverbalin Nr.1 për hartimin e dokumentave të mbajtur nga njësia e prokurimit (faqja 16), numri i tyre është përlllogaritur në përputhje me natyrën e kontratës, bazuar në përmasat/ volumin e preventivit të punimeve, afatit të kryerjes së punimeve përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe mundësisë së mobilizimit të punonjësve me orare të caktuara sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi. Konstatimi Juaj se kriteri i vendosur nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, është një konstatim apriori, pasi nuk na paraqitet një analizë e juaja teknike ku jeni mbështetur për një konstatim të tillë. Ndryshe nga sa ju parashtrooni analiza për përcaktimin e fuqisë punëtore, në lidhje me orët e punës për çdo zë punimi sipas manualit në fuqi, me volumet e punës sipas preventivit dhe me afatin e punimeve sipas grafikut të punimeve, kryhet nga ana e projektuesit që në fazën e projektit si dokument bashkëlidhur projektit, ndërsa mospasqyrimi i përlllogaritjeve aritmetike në proçesverbal nga njësia e prokurimit, nuk do të thotë se nga kjo e fundit nuk është kryer një analizë për përcaktimin e fuqisë punëtore nga specialisti i fushës, pasi siç kemi parashtuar dhe më lart nuk kemi patur një model të miratuar sesi duhet të kryhet argumentimi në Proçesverbalin e mbajtur për hartimin e dokumentave të proçedurës.

Së dyti, ndryshe nga sa ju keqinterpretoni se është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, kjo kërkesë e autoritetit kontraktor është në përputhje me përcaktimet e LPP-së, konkretisht në nenin nenit 46 pika 1 gërma “b” e tij, pasi stafi i punonjësve i kërkuar i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës.

Së treti, ndryshe nga sa ju konkludoni në mënyrë të gabuar, në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk mund të favorizojë operatorë ekonomikë të caktuar nëpërmjet kriterëve për kualifikim, pasi ato janë publike dhe se në rast se ato nuk janë në përputhje me ligjin, çdo operatorë ekonomik i interesuar që mendon se mund të dëmtohet ose kufizohet nga pjesëmarrja në tender ka në dorë mjetin proçedural (ankesë) për të kundërshtuar vendosjen e kriterit/ kriterëve në rast se nuk është/janë në zbatim të parashikimeve ligjore apo në përputhje me natyrën e objektit të kontratës. Ky ka qënë dhe qëllimi i ligjvënësit që ka sanksionuar të drejtën e operatorëve ekonomik për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret nuk rezulton që të ketë patur ankesë ndaj kriterëve për kualifikim nga ndonjë operator ekonomik i interesuar, dhe se në tregun shqiptar ka mjaft operatorë ekonomik që ushtrojnë aktivitet në fushën e ndërtimit dhe që disponojnë një numër më të lartë punonjësish, ku fakt tjetër është dhe mundësia e përmbushjes së këtij kriteri nëpërmjet pjesëmarrjes të shoqërive që nuk kanë numër të konsiderueshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës objekt prokurimi si bashkim operatorësh ekonomik.

Për sa më lart, duke qënë se ky konstatim nuk qëndron, kërkojmë që të hiqet.

6. Në lidhje me kërkesat për disponim si pjesë të stafit mbështetës të punonjësve me specialitetin Minimuni 1 (një) person që përmbush kriteret për të qënë “Përgjegjës për dëmet në mjedis” dhe Minimuni 1 (një) person që përmbush kriteret për të qënë “Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen

ndaj Emergjencave ” në kriterin 2.3.7 gërma “g” / 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ju shpreheni se, citojmë: “Për sa më sipër cituar, grupi i auditimit të KLSH gjykon se, në kushtet kur shoqëria A. nuk është e licencuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Çertifikatat e Trajnimit, lëshuar nga A. nuk mund të konsiderohen se përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “dëshmi profesionale të punonjësve”, në dokumentet e tenderit”.

Referuar kriterit të mësipërm rezulton se gjykimi juaj është i gabuar dhe i pabazuar, ku më hollësisht sqarojmë, është i gabuar pasi në kriterin e sipërcituar nuk është kërkuar që çertifikatat/ dëshmit e trajnimit të jenë të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, por duhen të jenë të akredituar sipas ligjit, ku referencë ligjore kanë dhe marrëveshjet e lidhura kombëtare apo ndërkombëtare, ndërsa fakti se, nëse shoqëria A. ka të drejtë t’i lëshojë këto çertifikata (pasi në rastin konkret për përmbushjen e kushtit janë paraqitur çertifikata trajnimi) nuk është detyrë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) të hetojë në lidhje me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit në fjalë, por është detyrë e struktura ligjzbatuese kompetente në Republikën e Shqipërisë për kontrollin e këtyre subjekteve, ku ky konstatim nëse është i bazuar (pasi referuar konstatimit Tuaj nuk shpreheni ku bazoheni) mund t’u adresohet atyre nga ana Juaj, detyra e KVO-s është që të kërkojë sqarime dhe dokumenta shtesë operatorëve ekonomik në rast se konstaton parregullsi në lidhje me përmbajtjen dhe formën e paraqitur të dokumentave.

Për sa më lart, duke qënë se ky konstatim nuk qëndron, kërkojmë që të hiqet.

7. Në lidhje me kërkesën për përcaktimin e Drejtuesit Teknik të punimeve, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) vite përcaktuar në kriterin 2.3.7 gërma “h”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ju shpreheni se, citojmë: “Kriter i ekzagjeruar dhe diskriminues. Kërkesa e mësipërme për eksperiencën e punës të inxhinierëve është e pa nevojshme dhe e pa aplikueshme sepse eksperiencia e punës të stafit teknik të një operatori ekonomik që operon në sektorin e ndërtimit rregullohet nga Vendimi Nr.42, datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”.

Ndryshe nga sa ju konkludoni, kërkesa që drejtuesi teknik duhet të ketë një eksperiencë pune minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) vite nuk është aspak e ekzagjeruar dhe diskriminues, pasi siç është argumentuar dhe në Proçesverbalin Nr.1 për hartimin e dokumentave të mbajtur nga njësia e prokurimit (faqja 18), kjo kërkesë është vendosur bazuar kompleksitetin dhe rëndësisë që ka ky objekt investimi, pasi kemi të bëjmë me punime që do të kryhen për ujësjellës, me një shtrirje me gjatësi të konsiderueshme, ku përvoja e drejtuesit teknik është e rëndësishme për drejtimin e punimeve në kantier. Ndërsa me VKM-në që iu i referoheni, kjo kërkesë nuk vjen as në kundërshtim me këtë VKM, dhe as dublohet si kërkesë, pasi në këtë VKM trajtohen rregullat në lidhje me procedurat e dhënies së licencave subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, ku përvoja për drejtuesit teknik në lidhje me nivelet e klasifikimit të licencës trajtohet vetëm si një prej kriterëve, pasi është dhe përvoja e punimeve të kryera të shoqërisë etj. Pra, përmbushja e kërkesës së autoritetit nuk përmbushet referuar rregullimeve të VKM-së, por ka të bëjë me përvojën individuale të inxhinierit, pasi 15 vitet e kërkuara të eksperiencës jo domosdoshmërisht mund të jenë kryer në shoqërinë pjesëmarrëse në prokurim.

Për sa më lart, duke qënë se ky konstatim nuk qëndron, kërkojmë që të hiqet.

8. Në lidhje me konstatimin tuaj për vendosjen dhe përmbushjen e kriterit 2.3.10 gërma “h”/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ku shpreheni se, citojmë: “Në asnjë rast, nga operatori ekonomik nuk është paraqitur mandat pagesa bankare për automjetet me qera. a) Sa më sipër në këtë procedurë, disa nga kriteret e vendosura janë të pa argumentuara dhe të panevojshme për realizimin e kësaj kontrate. b) Komisioni i vlerësimit të ofertave duhej të analizonte mirë dokumentacionin e paraqitur dhe në bazë të mangësive të skualifikonte dhe BOE të ngelur në garë dhe të rishpallte rishtaz procedurë të re për këtë objekt.”

Në përmbajtje të kriterit, ndër të tjerash është përcaktuar se, citojmë: “Shënim: Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira, të paraqiten: 1. Kontratë noteriale qiraje/ huapërdorje me emër objekti dhe me afate të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve dhe/ ose; 2. Kontrate noteriale qiraje/ huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht dhe mandat pagesat bankare për secilin nga automjetet dhe/ ose pajisjet e marra me qira.”

Referuar sa më lart, rezulton se konstatimi Juaj, se në asnjë rast nuk është paraqitur mandat pagesa nuk qëndron, pasi të gjitha mjetet e marrë me qira në kontratat e paraqitura është përcaktuar objekti i prokurimit dhe afati i kontratës, ku operatori ekonomik pjesëmarrës nuk ka patur detyrimin që të paraqesë mandat pagesat, pasi këto të fundit janë kërkuar në rast se kontrata do të ishte pa afat të përcaktuar.

Po ashtu, i pabazuar është dhe konstatimi se, disa nga kriteret janë të pa argumentuara dhe të panevojshme për realizimin e kontratës, pasi argumentimet e nevojshme janë dhënë në Proçesverbalin Nr.1 për hartimin e dokumentave të mbajtur nga njësia e prokurimit (faqja 22-23), ndërsa në lidhje me nevojën e këtyre kriterëve, korrekte nga ana juaj do të ishte të specifikohet se cili kriter ju duket i panevojshëm dhe arsyetimi juaj, pasi të gjitha automjetet/ mjetet dhe pajisjet janë kërkuar në përputhje me punimet e parashikuara në preventiv dhe që do të kryhen në objekt.

Gjithashtu, ndryshe nga sa ju konkludoni në mënyrë të pabazuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka analizuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur, në të cilin nuk ka konstatuar asnjë mangësi në përmbushjen e kriterëve për kualifikim, ku në zbatim të parashikimeve të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik ka disponuar me kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës "E." ShPK, dhe "E." ShPK

Për sa më lart, duke qënë se konstatimet Tuaja nuk qëndrojnë, kërkojmë heqjen e tyre.

Në lidhje me proçesin e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, ju shpreheni se, citojmë: " Në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe deklarin sipas shtojcës nr.10. Është konstatuar se në deklarin e disponueshmërisë së pajisjeve dhe mjeteve, BOE, ka deklaruar në shtojcën nr.10, pesë (5) mjete të cilat kanë të njëjtat karakteristika dhe të dhëna ku figurojnë në përdorim dhe në një tjetër kontratë pune po në bashkinë Mat.

1. Mjeti fadromë me goma me targë ABMT-91

2. Mjeti eskavator me goma me targë ACMT-17, paraqitur nga L.O. shpk.

3. Mjeti kamion Volvo me targë AA472TI;

4.Mjeti kamioncinë Mercedes-Benz 906, Sprinter 511 CDI me targë AA839TA

5. Mjeti kamion me Bot për spërkatje asfalti, lloji Mercedes-Benz, me targë AA840TA, rezultojnë të dhëna me qera nga OE F. shpk dhe qiramarrës, subjekti E. shpk, nëpërmjet kontratës me nr.Rep: 2816, dhe nr.Kol: 1866, datë 12.09.2020 i cili është shpallur fitues në tenderin. Numri i referencës së procedures: REF-68803-08-16-2020 me objekt: "Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel, të fshatrave të njësish administrative Derjan dhe Rukaj-Loti 1".

Sa më sipër grupi i auditimi gjykon se KVO nuk ka vlerësuar sipas parimit të barazisë në garë, duke i dhënë më rëndësi çmimit më të ulët e për pasojë duke kaluar përciptazi dokumentet e paraqitura nga OE. Veprime që bien ë kundërshtim me kërkesat e ligjit si më poshtë: Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar.

Konstatimi Juaj është krejtësisht i gabuar, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Pjesëmarrës disponojnë automjete dhe mjete më shumë se numri i kërkuar i tyre në kriteret për kualifikim.

Lidhur sa më sipër për këtë pretendim, sqarojmë se: Në procedurën "Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat", në asnjë rast nuk jemi shprehur që nuk ka mjete të mjaftueshme në dispozicion nga peratorët ekonomikë të shpallur fitues. Ne sqarojmë dhe një herë se deklarimi nga OE F. shpk është i pasaktë për sa kohë mjetet e paraqitura, janë dhënë me qera te një operator tjetër ekonomik dhe janë në dispozicion deri në përfundimin e kontratës në një objekt tjetër. Kjo është përgjegjësi direkte e Operatorëve Ekonomikë por dhe një mangësi nga KVO gjatë verifikimit të dokumentacionit në procedurat e vlerësimit.

Për sa më lart, duke qënë se ky konstatim nuk qëndron, kërkojmë që të hiqet.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Në nenin 81 të UMF nr.9 datë 20.03.2018 është përcaktuar qartë se: "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

2. Referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Grupi i auditimit gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “E.” ShPK & “E.” ShPK, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “E.” ShPK nuk e plotëson kërkesën për kontratat e ngjashme sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “E.” ShPK & “E.” ShPK në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor.

Lidhur me lidhjen e kontratës në kundërshtim me LPP, grupi i auditimit gjykon se duke u nisur nga kërkesat e paraqitura në DST, mosplotësimi i tyre sidomos në kushtet e vecanta të kualifikimit dhe vlerësimi i gabuar nga KVO, ka sjellë që kontrata nuk është lidhur në frymën e LPP dhe jo atë të Kodit Civil.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

3. Konstatimet tona të gjetura gjatë auditimit, janë të bazuara në kriterë ligjore dhe jo baza hipotetike apo subjektive.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

4. Merr në konsideratë pjesërisht observacionin tuaj, vetëm për certifikatat **ISO 27001** (Për menaxhimin e sigurisë së informacionit) dhe **PAS 99** (Për sistemin e menaxhimit të integruar) por jo për **ISO 27001** (Për menaxhimin e sigurisë së informacionit), pasi nuk kemi të bëjmë me investime në sisteme IT apo ato të rëndësishme të veçantë, si në infrastrukturë ushtarake etj.

Për sa më sipër grupi i merr parasysh pjesërisht kundërshtimet tuaja.

5. Përsa sipër fakti që nuk ka patur ankesa as nga operatorët ekonomikë as nga APP-ja, nuk përjashton mundësinë e vendosjes së kriterëve të pa nevojshme dhe të ekzagjeruara nga ana e NJP. Bazuar në konstatimet e mësipërme, kundërshtimet tuaja nuk merren parasysh.

Në lidhje me kërkesën për disponin si pjesë të stafit të punësuar, ose të kontraktuar të paktën 1 (një) Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kriterin 2.3.7 gërma “f” / 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 12 në DST, ju shpreheni se, citojmë: “Kërkesa për ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis është një kusht i panevojshëm pasi, vlerësimi i ndikimit në mjedis është kryer që në hapat fillestar të projektit të miratuar” duke përcaktuar qartë kushtet dhe nevojat.

Ndryshe nga sa ju konstatoni se ky kusht është i panevojshëm, referuar dispozitave ligjore të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar), dhe ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis” (i ndryshuar), mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përbën një përparësi kombëtare, ku të gjithë personat fizikë dhe juridikë duhet të marrin masat e nevojshme për mosdëmtimin e tij gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, ku në rastin konkret duke qënë se investimi objekt prokurimi shtrihet në një zonë mjaft të pasur me burime natyrore, njësia e prokurimit ka vlerësuar të domosdoeshëm vendosjen e kësaj kërkesë, me qëllim që punimet të mbikqyren vazhdimisht nga një ekspert që është i aftë/ certifikuar që të vlerësojë ndikimet negative që mund t’i vijnë mjedisit nga përdorimi i mjeteve, mënyra e kryerjes së punimeve, duke propozuar dhe ndryshime në rastet kur rrezikohet seriozisht mjedisi. Pra, referuar vendodhjes së objektit të investimit dhe rëndësisë që paraqet mjedisi është vlerësuar e nevojshme prezenca e këtij eksperti edhe gjatë fazës së kryerjes së punimeve.

Për sa më sipër grupi i auditimit merr parasysh observacionin tuaj.

6. Për sa më sipër pretendimeve tuaja, sqarojmë se: Grupi i auditimit, është bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik (K.P.P.238/2021). Nga ku KPP vëren se certifikatat e trajnimit të lëshuar për punonjësit nga kompania A., referuar korrespondencës së Komisionit të Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk mund të konsiderohen të vlefshme. Konkretisht me shkresën nr. 944/3 prot., datë 25.09.2020. Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke i kërkuar informacion si më poshtë vijon: “Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës është konstatuar se nga operatori ekonomik, në përmbushje të kriterëve

kualifikuese, janë paraqitur Certifikata Trajnimi, lëshuar nga shoqëria A. për profesione të ndryshme të ndërtimit. Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, nenit 28, pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, KPP ju drejtohet ju si institucion kompetent për një sqarim lidhur me faktin nëse shoqëria A. është e akredituar për të ofruar kurse trajnimi për formim profesional për kualifikime në përputhje me Ligjin Nr.15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, dhe nëse po cilat janë profesionet e certifikuar që trajnohen prej saj.” III.1.9. Në datën 06.10.2020, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 944/5 prot., shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe të Aftësimit Profesional, me nr. 17969/1 prot., datë 05.10.2020 me objekt “Kthim përgjigjeje”, ku thuhet shprehimisht se: “Në përgjigje të shkresës tuaj nr.944/3 prot, datë 25.09.2020, protokolluar me tonën me nr.17969 prot., datë 28.09.2020 me objekt "Kërkesë për informacion" ju bëjmë me dije se pas verifikimeve të kryera rezulton se, shoqëria A., nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë". III.1.10.

Duke marrë parasysh faktin se: Vendimet e KPP janë (quasi gjyqësore) si vendime gjyqësore, vlerësojmë se: Pretendimet tuaja mund të qëndrojnë vetëm për mos pasjen dijeni të këtij fakti. Nga ana tjetër kjo i bën të pavlefshme certifikatat e lëshuara nga A., e për pasojë zhvlerëson si plotësimin e kriterit të kërkuar në KVK. Ky argumentim vlen dhe për Procedurën “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës së qytetit të Burrel (Faza I + Faza II), Bashkia Mat” ku janë kërkuar një numër prej 15 punonjësish në lartësi, të cilët kanë si dëshmi vetëm certifikatë trajnimi nga A..

Për sa më sipër grupi i auditimit nuk merr parasysh kundërshtimet tuaja.

7. Pikërisht në VKM 42/2008, në LPP apo çdo akt tjetër rregullator, nuk ka një referencë për përcaktimin e eksperiencës me vite pune për drejtuesit teknik, nga ana juaj përcaktimi 15 vite eksperiencë është kriter subjektiv dhe diskriminues.

Për sa më sipër grupi i auditimit nuk merr parasysh kundërshtimet tuaja.

8. Në procedurat e mësipërme për të gjitha mangësitë e konstatuara është dhënë shpjegimi dhe arsyetimi për secilin kriter dhe mangësitë e konstatuara. Kjo bazuar në kriteret dhe kërkesa ligjore. Shpjegimet dhe kundërshtimet tuaja nuk kanë argumente shtesë apo të bazuara të cilat do ndyshonin qëndrimin e grupit të auditimit.

Sa më sipër nuk merr në konsideratë pretendimet tuaja.

Procedurat e audituara për periudhën 01.01.2021-31.12.2021

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 437, datë 20.08.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 437, datë 20.08.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar	1. E.L., Kryetar; 2. D.R., Anëtar; 3. E.A., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. E.D., Anëtar 3. E.B., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 10,699,137 lekë	6. Oferta fituese: OE R., me ofertë 10,640,108 lekë pa TVSh, me kontratë datë 13.10.2021, me afat 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit	7. Diferenca me fondin limit: 59,029 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 27.09.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) Skualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Fondi limit 10,699,137 lekë pa TVSh, ndarë për vitin 2021 në vlerën: 4,881,952 lekë pa TVSh, nga buxheti i shtetit në vlerën: 3,812,037 lekë pa TVSh,

dhe nga grandit e bashkuar në vlerën: 1,069,914 lekë pa TVSh, dhe për vitin 2022 në vlerën: 5,817,186 lekë pa TVSh, nga buxheti i shtetit, me afat realizimi 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me vlerësimin e ofertave.

Situata: Në këtë procedurë tenderimi janë skualifikuar 5 OE dhe është shpallur fitues OE R. ShPK. Klasifikimi i ofertave është sipas tabelës më poshtë:

Operatori ekonomik	Oferta Ekonomike në lekë	Klasifikimi
A.K.	7,854,297	Skualifikuar
2.	8,111,824	Skualifikuar
S.	8,415,636	Skualifikuar
A.	8,923,204	Skualifikuar
V.K.	10,157,293	Skualifikuar
R.	10,640,108	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga shqyrtimi i raportit përmbledhës të vlerësimit të ofertave rezulton se KVO ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë OE “2.” ShPK me ofertë më të ulët, ndonëse i plotëson kriteret e DST dhe të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe duke përdorur argumentime që nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Vlerësimi i OE “2.” ShPK me vlerë 8,111,824 lekë:

Vlerësimi i KVO nr. 1: Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 germa “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit në seksionin B “Deklarata për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” pika 8, 9 dhe 10 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka patur konsultim, komunikim... me ndonjë konkurrent tjetër, si dhe në seksionin D, Deklarata “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës” pika 3, nuk ka deklaruar se nuk ka masë efektive ligjore të vendosur nga ISHPSSH, ku bazuar në nenin 76 pika 3, germa “a” duhet të skualifikohet.

Nga auditimi rezultoi se OE i ka plotësuar duke u shprehur “Jo”, në vend të “Po” në rubrikat 8, 9, 10 të formularit të vetëdeklarimit. Duke qenë se këto rubrika përmbajnë fjali mohuese “nuk”, si përgjigje është dhënë “Jo”, për të shprehur nga ana kuptimore pikërisht objektin e deklaratës se nuk ka patur konsultime me ndonjë konkurrent tjetër, etj. Marrë shkas nga natyra deklarative e këtij formulari, kuadri ligjor parashikon të drejtën e AK që të kërkojë sqarime lidhur me formularin e vetëdeklarimit, gjë që nuk është zbatuar sipas Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 2.

Vlerësimi i KVO nr. 2: Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 germa “a”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, për inxhinierin elektrik, paga e përcaktuar në kontratën e punës (noteriale) vjen në kundërshtim me VKM nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Nga auditimi, rezultoi se argumentimi i KVO, mbi vlerësimin se paga e inxhinierit elektrik e paraqitur prej 26,000 lekë nuk është në përputhje me VKM nr. 1025 datë 16.12.2020, tejkalon tagrin e shqyrtimit për vlerësimin e ofertave, pikë së pari për arsyen se nuk është e përcaktuar në DST një parashikim i tillë. Sipas listëpagesave të paraqitura, rezulton se paga e inxhinierit elektrik është 35,000 mijë lekë, në përputhje me VKM nr. 1025 datë 16.12.2020.

Vlerësimi i KVO nr. 3. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se: Nuk vërtetohet disponimi i 2 (dy) matrapikëve, por vetëm 1 (një) të tillë, pasi nuk është paraqitur foto për të 2 (dy) pajisjet matrapik, sipas pikës 3 të kushtit 2.3.7.

Nga auditimi rezultoi se për disponimin e 2 matrapikëve, OE ka paraqitur faturën tatimore me nr. 85446529 serial, datë 20.01.2020, për dy matrapikë dhe dy trapanë shoqëruar me 1 foto të matrapikut. Sipas pikës 3 të kushtit, lidhur me foton është përcaktuar “të paktën 1 foto”.

Argumentimi i KVO-së bie në kundërshtim me nenin 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Sa më sipër, për këto 3 arsye të cilat janë vlerësuar në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe me kriteret e përcaktuara në DST, të cilat operatori ekonomik “2.” ShPK i plotëson, rezulton një diferencë mes ofertës së OE fitues “R.” ShPK dhe ofertës së skualifikuar “2.” ShPK, në vlerën 2,528,284 lekë.

Vlerësimi i OE “A.K.” ShPK me vlerë 7,854,297 lekë:

Vlerësimi i KVO nr. 1: Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1 gërma “a” / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në “Formularin Përmbledhës” të vetëdeklarimit nuk është deklaruar i gjithë informacioni që kërkohet, si dhe në seksionin A Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit nuk është e plotësuar saktë sipas kërkesave që përmban.

Nga auditimi rezultoi se KVO nuk shprehet qartë se çfarë konkretisht nuk ka zbatuar, ndërkohë që i gjithë dokumentacioni që kërkohet nga seksioni A është pjesë e ofertës së dorëzuar si pagesa e detyrimeve për taksat etj., dhe ka qenë i administruar nga vet KVO.

Vlerësimi i KVO nr. 2: Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, për vërtetimin e punëve të ngjashme me entin publik, nuk janë paraqitur të gjitha faturat tatimore shitje për punimet e kryera.

Nga auditimit rezultoi se ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. 5079 datë 30.10.2020 për “Rikonstruksionin e tregut Shupenzë” me Bashkinë Bulqizë në cilësinë e BOE “A.C. & E.”, ku A.C. zotëron 95% të punimeve, me vlerë 24,769,650 lekë, me akt kolaudimi, faturë fiskale me Bashkinë në vlerën 11,190,375 dhe formular vlerësimi nga Bashkia Bulqizë që provon kapacitetin teknik për kryerjen e punëve të ngjashme.

Vlerësimi i KVO nr. 3. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5 gërma “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Nuk janë paraqitur kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme) për punonjësën me specialitetin e kërkuar. Punonjësi i deklaruar me specialitetin Bojaxhi, nuk figuron në listëpagesat për periudhën korrik 2021 e në vazhdim. Nga verifikimi i dokumentacionit specialisti Bojaxhi nuk figuron në listëpagesat e muajit korrik. Për punonjësit me specialitetin Teknik Ndërtimi, Murator dhe Bojaxhi, paga e përcaktuar në Kontratat Individuale të punës vjen në kundërshtim me VKM nr.1025, datë 16.12.2020 “Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se:

- Tekniku i ndërtimit zotëron dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik;
- Punonjësi hidraulik, elektrikist, murator, pllakashtrues, suvatues, bojaxhi, kanë paraqitur kontrata punë të vlefshme dhe kanë certifikime të sigurimit teknik nga A. ShPK;
- Specialisti i profesionit “bojaxhi” nuk figuron në listat e muajit korrik;

Vlerësimi i KVO nr. 3: Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit: Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se:

- Faturat tatimore për blerjen e pajisjes depozitë uji 5000 litra, është paraqitur fotokopje.
- Për pajisjet: Depozitë uji 5000 litra, Vinç 0,5 ton, Skeleri Betoniere 0.25 - 0.5 m3, Gjenerator, Matrapik, si dhe mjetet dhe pajisjet mbrojtëse në punë, rezulton se nuk janë paraqitur foto për këto pajisje, sipas pikës 3 të kushtit 2.3.7.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për pajisjet motor saldimi, skeleri dhe bot uji është paraqitur fatura tatimore nr. 6424765 serial datë 11.01.2004, e cila është fotokopje.

Vlerësimi i OE “R.” ShPK me vlerë 10,640,108 lekë:

Për subjektin “R.” ShPK, për kritere që KVO i ka konsideruar skualifikuese për OE-të “2.” ShPK dhe A.K.” ShPK, si ofertat më të ulëta, konstatohet se ky operator ekonomik nuk përmbush:

- Kriterin e pikës 2.3.5 germa “a”/ 2.3 Kapaciteti teknik, pasi Inxhinieri elektrik ka pagën prej 22,000 lekë nën kufirin minimal të përcaktuar në VKM nr.1025, datë 16.12.2020 “Për Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”;

- Kriterin e pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik, pasi KVO ka skualifikuar ndër arsye të tjera, operatorin ekonomik “A. ShPK” me arsyetimin se ““Nuk vërtetohet disponimi i 2 (dy) kamionëve të kërkuar, por vetëm 1 (një) të tillë”, pasi referuar certifikatës datë 06.01.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” lëshuar nga Bashkia Vlorë, për Kamionin e marrë me qira, marka BENZ, me targa VL4863B, rezulton se është në përdorim të personit juridik “L.” ShPK, dhe jo në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës “A.” ShPK dhe se ky i fundit nuk ka paraqitur një të tillë”. Nga auditimit rezultoi se e njëjta gjë konstatohet edhe për kontratën fituese, ku rezulton se certifikata për transport mallrash rezulton në emër të një të treti “A.A.” ShPK, por KVO nuk e ka përmendur si kriter skualifikues.

- Kriterin e pikës 2.3.5, germa C “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, 1 (një) person që përmbush kriteret për të qenë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se inxhinieri B.M., si përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, nuk është certifikuar nga një subjekt i akredituar. Konkretisht, subjekti “R.” nuk është i akredituar.

Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Përgjegjësia për sa më sipër është e KVO, e përbërë nga E.H., E.D. dhe E.B..

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 5, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 10,640,108 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga z. A.P. është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. ... Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) në vendimin interpretues nr.718/2023, datë 03.08.2023, vetëm për shkak se një operator ekonomik nuk kishte paraqitur Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas formatit të miratuar në DST ka mbajtur qëndrimin se formulari i paraqitur ishte i parregullt, dhe nuk plotësonte kriterin sipas shtojcës 8, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Së fundmi, por jo nga rëndësia, rezulton se shoqëria “2.” ShPK,

ka qenë dakord me mangësitë e konstatuara që kanë pasjell s'kualifikimin e ofertës së tyre, pasi në të kundërt (nëse do të konsideronin të padrejtë) do të kishin ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të KVO-s, Nuk vërtetohet disponimi i pajisjeve kokore, komplet i ndihmës së shpejtë dhe Tabela paralajmëruese..., pasi nuk është paraqitur foto për këto pajisje, sipas pikës 3 të kushtit 2.3.7. 3. Për pajisjen: Vinç 0,5 rezulton se Faturat tatimore shitje për blerjen e tij, nuk është e plotësuar sipas legjislacionit tatimor në të gjitha elementët e tyre, si dhe nuk paraqitet pesha ngritëse e vinçit. Pra, vërtetohet fakti i provuar se OE pjesëmarrës shoqëria "2." ShPK, ka patur mangësi dhe në vërtetimin e disponimit të mjeteve dhe pajisjeve në punë të kërkuar, si dhe në disponimin e pajisjes "Vinç 0,5 ton", ku nuk kuptohet fakti se përse nga ana Juaj nuk janë pasqyruar të gjitha arsyet e skualifikimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Observacioni nuk merret në konsideratë, sikurse trajtuar, pasi është në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit".

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi i Aneksit të Stadiumit"		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 79, datë 19.02.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 79, datë 19.02.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: 1. E.H., Kryetar 2. E.M., Anëtar 3. E.R., Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur	1. E.L., Kryetar; 2. D.R., Anëtar; 3. E.A., Anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 29,999,999.9 lekë	6. Oferta fituese: BOE K. & 2., me ofertë 28,230,508 lekë pa TVSh, me kontratë datë 21.04.2021, me afat deri në datën 30.09.2021	7. Diferenca me fondin limit: 1,769,492 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.03.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Fondi limit 29,999, 999.9 lekë pa TVSh nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2021 në vlerën: 2,500,000 lekë pa TVSh, nga granditë: 1,666,666.6 lekë pa TVSh, dhe nga të ardhurat: 833,333.3 lekë pa TVSh, për vitin 2022 në vlerën: 16,250,000 lekë pa TVSh, nga granditë, dhe për vitin 2023 në vlerën: 11,250,000 lekë pa TVSh, nga granditë.

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimit të ofertave.

Situata: Në këtë procedurë ka marrë pjesë BOE "2.P." ShPK, (16.82%) dhe "K." ShPK (83.18%) me ofertë 28,230, 07.8 lekë pa TVSh dhe OE "E.V." ShPK, i cili nuk ka paraqitur ofertë.

Hartimi i kriterëve: Nga auditimi i konstatua se njësia e prokurimi ka përcaktuar kriterë të veçanta që nuk lidhen me objektin e kontratës, si më poshtë:

- Për kriterin 2.3.6 "Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar të paktën 1 (një) Inxhinier Auditues i Energjisë, të vërtetuar me Kontratë Noteriale Pune (të vlefshme), Diplomë, CV dhe të pajisur me Certifikatën përkatëse", Njësia e prokurimit ka argumentuar përfshirjen e këtij kriteri në bazë të ligjit nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave", me qëllim që ky objekt të jetë në përputhje me kërkesat e performancës së energjisë.

Kriteri i mësipërm i vendosur nuk lidhet me objektin e kontratës dhe nuk është pjesë e fushëzbatimit të Ligjit nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë", pasi:

Së pari, shërbimi i audituesit të energjisë është i bazuar në Ligjin nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë", që rregullon marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe personave fizikë dhe /ose juridikë, publikë ose privatë, që ushtrojnë veprimtari në sektorët rezidencialë, të shërbimeve, industrisë, transportit, bujqësisë, si dhe të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë,

për nxitjen e përdorimit me efikasitet të energjisë dhe për zhvillimin e tregut për shërbimet energjetike. Fushat sportive, sikurse është objekti i tenderit, nuk janë pjesë e këtij ligji.

Së dyti, në përkufizimin ligjor, “*Auditim energjetik*” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/ose instalimi industrial, në pronësi ose përgjegjësi administrimi të një personi juridik, publik ose privat, me qëllim identifikimin dhe përlllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. Në përkufizimin ligjor, “*ndërtesa është një konstruksion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm*”, ndërkohë në rastin konkret objekt i prokuruar është një aneks stadiumi (fushë futbollit), që nuk ka ambient të brendshëm të mbuluar dhe nuk përfshihet në përkufizimin e termit “ndërtesë”.

Së treti, në bazë të nenit 16, pika 4, auditimi energjetik është i detyrueshëm për çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie, të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efikasitetin e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efikasitetit. Në rastin objekt prokurimi, për “aneks stadiumi”, ligji nuk e parashikon auditimin si të detyrueshëm pasi ky objekt është jashtë fushës së Ligjit nr. 124/2015 “*Për efikasitetin e energjisë*”.

Së katërti, në DST është kërkuar që audituesi i energjisë të jetë i punësuar nga subjekti me kontratë noteriale pune, ndërkohë që sipas Ligjit nr. 124/2015 “*Për efikasitetin e energjisë*”, neni 17, pika 5 germa (b), auditimi energjetik nuk mund të kryhet nga një auditues energjetik, i cili është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi apo është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin.

- Për kriterin 2.3.6/c: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) Ekspert zjarrfikës, të vërtetuar me Kontratë Noteriale Pune (të vlefshme), Diplomë, CV dhe të pajisur me Certifikatën përkatëse. Njësia e prokurimit e ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri se operatori ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër të tjerat të jenë edhe rastet e zjarrit*”, konstatohet se në bazë të Ligjit nr. 152/2015 “*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*”, neni 3, “*Ekspert zjarrfikës privat*” është personi fizik dhe juridik, i certifikuar, i cili harton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kryen aktin e ekspertizës për zjarrin e rënë, kryen trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas dispozitave të këtij ligji. Ky kriter dublon kriterin tjetër, konkretisht disponimin e një “eksperti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen e emergjencave”.

- Për kriterin 2.3.5. “*Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 30 (tridhjetë) punonjës për periudhën Tetor 2020-Shkurt 2021, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik*.”, konstatohet se nga njësia e prokurimit nuk argumentohet, sipas proceseve të punës së ndërtimit, përfshirë grafikun e punimeve, etj, se pse është përcaktuar niveli minimal prej 30 punonjësish, ndërkohë që sa i përket objektit të kontratës, e cila është një fushë futbollit dhe referuar preventivit të punimeve, shumica e punimeve kanë gërmime dhe mbushje me makineri.

- Për kriterin 2.3.1., “*Përvoja të mëparshme*”, “*a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% (që i korrespondon vlerës 15,000,000 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% (që i korrespondon vlerës 60,000,000 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet*”, konstatohet se për këtë kriter, Njësia e Prokurimit ka kërkuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në intervalin 50% e lart të fondit limit ose punë ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marra së bashku në intervalin 200% e lartë, në kundërshtim me pikën 7 të nenit 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar e cila përcakton se në procedurat e prokurimit me vlerë nën

kufirin e ulët monetar, “vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 50% të vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Përgjegjësia për sa më sipër është e Njesisë së prokurimit, e përbërë nga E.L., D.R. dhe E.A..

Vlerësimi i ofertave: Në lidhje me plotësimin e kriterit që “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar të paktën 1 (një) Inxhinier Auditues i Energjisë, të vërtetuar me Kontratë Noteriale Pune (të vlefshme), Diplomë, CV dhe të pajisur me Certifikatën përkatëse”, rezulton se :

- Në kundërshtim me nenin 17, pika 1 të Ligjit nr. 124/2015 “Për eficientësin e energjisë”, Audituesi energjetik, z. O.I. nuk është i pajisur me certifikatë nga Agjencia për Eficientësin e Energjisë, e cila mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të audituesve energjetikë. Si rrjedhojë, OE fitues nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST në lidhje me audituesin e energjisë.

Përgjegjësia për sa më sipër është e KVO, e përbërë nga E.H., E.M. dhe E.R..

Shtesë kontrate: Me shkresën nr. 5544 prot., datë 17.12.2021, hartuar nga z. E.A. dhe nënshkruar nga Titullari i AK, z. A.M., është miratuar relacioni mbi arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës së sipërmarrjes të investimit me objekt “Ndërtimi i aneksit të stadiumit”, përmes së cilës është bërë një shtesë prej 19.94 % të vlerës së ofertës prej 5,630,044.11 lekë. Në lidhje me shtesën e kontratës, konstatohet si më poshtë:

- Me shkresën nr. 4290 prot., datë 29.09.2021 është dërguar relacioni teknik nga mbikëqyrësi i punimeve, Ing. I.K., ku është arsyetuar se për shkak se gjysma e fushës në anën perëndimore ka disnivel, duhet ndërtuar një mur mbajtës, ku vlera e punimeve është përcaktuar 6,333,977.94 lekë:

- Deri në datën 11.10.2021 është situacionuar vlera 11,640,266 lekë:

- Me shkresën nr. 12 datë 13.10.2021, shoqëria 2. ShPK ka njoftuar Bashkinë Mat se “...bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e punimeve shtesë të realizuar në ndërtimin e aneksit të stadiumit të Burrelit, shoqëruar edhe me foto të punimeve të kryera”, ndërkohë në tabelën e punimeve përfundimtare rezulton se shuma e punimeve të paparashikuara është 7,296,23.79 lekë:

- Me shkresën nr. 13 datë 18.10.2021 Bashkia Mat është njoftuar “...siç jeni dijeni në seksionin perëndimor të fushës është ndërtuar një mur mbajtës i paparashikuar në projekt...”, për të cilën është kërkuar shtyrje e kontratës për një periudhë 5-6 muaj:

- Me relacionin nr. 5544 prot, datë 17.12.2021, nga Titullari i AK është miratuar relacioni mbi arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës së sipërmarrjes të investimit me objekt “Ndërtimi i aneksit të stadiumit”, përmes së cilës është bërë një shtesë prej 19.94 % të vlerës së ofertës prej 5,630,044.11 lekë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 5, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 29,999,999.9 lekë pa TVSh.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga z. A.P. është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. ...Nga Bashkia Mat është përcjellë observacioni se “kërkesa për disponimin e 1 (një) punonjësi që përmbush kriteret për të qenë “Auditues i Energjisë, në profilin Auditimi Energjitik në ndërtesa”, shërben për kontrollin dhe marrjen e masave që produktet dhe pajisjet që do të vendosen në objekt gjatë zbatimit të punimeve, të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në konsumin e energjisë, të përmbushin kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë, kërkesë kjo në zbatim të ligjit nr. 124/2015 “Për Efikasitetin e Energjisë”, ligjit nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” dhe akteve në zbatim të tyre, duke garantuar në këtë mënyrë zbatimin e kërkesave minimale për performancën e energjisë së sistemeve teknike të ndërtesës.

1.1. ...Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.537, datë 08.07.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave” (i cili ka dalë në zbatim të ligjit nr.116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”) në pikën 4 të tij përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat e këtij vendimi zbatohen për ndërtesat publike dhe jorezidenciale, sipas tipologjisë dhe funksionalitetit të stokut të këtyre ndërtesave në përputhje me pikën 7, neni 5, të ligjit nr. 116/2016: ...e) objektet sportive, përfshirë objektet e mbyllura, përveç shesheve me akull të brendshëm, të shënuara me kodin JR6S.”, pra rezulton se objekti sportiv, fushë sporti nuk përjashtohet nga objektet të cilat duhet të kenë kërkesat minimale të performancës së energjisë. Në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6, germa “d” kërkohet Inxhinier Auditues i Energjisë, dhe jo Auditues i Energjisë i certifikuar, si dhe përcaktohet që duhet të paraqesë Certifikatën përkatëse, pa e specifikuar llojin dhe se nga cili organ e lëshon.

2. Nga Bashkia Mat është përcjellë observacioni se “Kriteri i vendosur për disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se 30 (tridhjetë) punonjës nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, siç kemi argumentuar dhe në Procesverbalin Nr.1 për hartimin e dokumenteve të mbajtur nga njësia e prokurimit (faqja 14), numri i tyre është përllogaritur në përputhje me natyrën e kontratës, bazuar në përmasat/ volumin e preventivit të punimeve, afatit të kryerjes së punimeve përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe mundësisë së mobilizimit të punonjësve me orare të caktuara sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi. Konstatimi Juaj se kriteri i vendosur nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, është një konstatim apriori, pasi nuk na paraqitet një analizë e juaja teknike ku jeni mbështetur për një konstatim të tillë. Ndryshe nga sa ju parashtroni analiza për përcaktimin e fuqisë punëtore, në lidhje me orët e punës për çdo zë punimi sipas manualit në fuqi, me volumet e punës sipas preventivit dhe me afatin e punimeve sipas grafikut të punimeve, kryhet nga ana e projektuesit që në fazën e projektit si dokument bashkëlidhur projektit, ndërsa mospasqyrimi i përllogaritjeve aritmetike në procesverbal nga njësia e prokurimit, nuk do të thotë se nga kjo e fundit nuk është kryer një analizë për përcaktimin e fuqisë punëtore nga specialisti i fushës, pasi siç kemi parashtruar dhe më lart nuk kemi patur një model të miratuar sesi duhet të kryhet argumentimi në procesverbalin e mbajtur për hartimin e dokumenteve të procedurës”.

3. Nga Bashkia Mat është përcjellë observacioni se “kërkesa e vendosur për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së kontratës, është në përputhje me përcaktimet e dispozitës, pasi është kërkuar brenda kufirit të lejuar 50 % të vlerës së kontratës objekt prokurimi, ku në rast se, siç cituam më lart, do të vendosej togfjalëshi “sa 50 % e vlerës së kontratës objekt prokurimi” do të sillte keqinterpretime dhe konfuzion në vlerësimin e ofertave, pasi padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin do të skualifikoheshin OE që kanë punë të ngjashme në një vlerë më të lartë, të cilët plotësojnë kërkesën e vendosur, në rast se do të vendosej togfjalëshi “jo më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës” do të kualifikoheshin dhe operatorët ekonomikë që sdo kishin punë të ngjashme, ose në vlera të papërfillshme, të cilat nuk përmbushnin qëllimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik në lidhje me vërtetimin e përvojës së duhur, si rrjedhojë formulimi i kriterit është në përputhje masën e lejuar nga dispozita nënligjore, dhe nuk krijon konfuzione për OE dhe komisionin e vlerësimit të ofertave. Për sa i përket masës së % që duhet të vendoset brenda kufirit të shprehur, dispozita e lë në diskrecion të autoritetit kontraktor. I njëjti argument vlen dhe për formulimin dhe masën e përcaktuar (%) kur paraqiten punë të ngjashme për më shumë se 1 (një) objekt të realizuar”.

4. Nga Bashkia Mat është përcjellë observacioni se “ndryshe nga sa ju konstatoni, rezulton që z.O. Islami ka Çertifikatë kualifikimi pasuniversitar “Auditim Energjie” Nr. Çertifikate. “AE-35”, Nr.rregj.32, datë 15.10.2014, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, pra audituesi e tejkalon

kërkesën e Autoritetit Kontraktor të vendosur në DST, sepse sipas dokumentacionit të paraqitur, ai është kualifikuar si Auditues Energjie”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Observacioni nuk merret në konsideratë, sikurse trajtuar, pasi është në kundërshtim me Ligjin nr. 124/2015 “Për eficiencien e energjisë”.

2. Observacioni nuk merret në konsideratë, sikurse është trajtuar, pasi nga njësia e prokurimit nuk argumentohet, sipas proceseve të punës së ndërtimit, përfshirë grafikun e punimeve, etj, se pse është përcaktuar niveli minimal prej 30 punonjës.

3. Observacioni merret pjesërisht në konsideratë. Kuadri ligjor përcakton se AK vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet. Në rastin konkret, Njësia e Prokurimit ka kërkuar 50% e lartë.

4. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi z. I. nuk është i akredituar, sikurse e kërkon kuadri rregullator.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kamion spërkatës (autobot) dhe minieskavator”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 411 datë 04.08.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 411 datë 04.08.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: 1. E.H., Kryetar 2. D.N., Anëtar 3. D.T., Anëtar
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar	1. E.D., Kryetar; 2. D.R., Anëtar; 3. E.A., Anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,932,166 lekë	6. Oferta fituese: OE T., me ofertë 9,910,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 06.10.2021	7. Diferenca me fondin limit: 22,166 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.08.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Fondi limit në vlerën: 9,932,166.6 lekë pa TVSh, nga granditë në vlerën: 666,666.6 lekë pa TVSh, nga të ardhurat në vlerën: 1,000,000 lekë pa TVSh, dhe nga fonde të tjera në vlerën: 8,265,500 lekë pa TVSh.

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimit të ofertave.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se në këtë procedurë kanë marrë pjesë:

- OE “T.” ShPK në vlerën 9,910,000 lekë pa TVSh;
- Operatori Ekonomik: “G.H.” P. Fizik (nuk ka paraqitur ofertë).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka konstatuar se OE “G.H.” P. Fizik, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike (sipas Shtojcës 1 të DST-së) në zbatim të nenit 29 të Vendimit Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe dokumentat e kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Nga auditimi u konstatua se operatori ekonomik “T.” i shpallur fitues, rezultoi me të njëjtin administrator me OE “T.”, shoqëri kjo që me vendimin nr. 04 datë 12.01.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik me 18 muaj (tetëmbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 12.01.2021-12.07.2022).

Në bazë të nenit 76, pika 3, germa (g), të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit.

Për sa më sipër, KVO duhet të kishte skualifikuar OE T. dhe të kishte anuluar procedurën e prokurimit. Përgjegjësia është e KVO, e përbërë nga E.H., D.N. dhe D.T..

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 5, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 9,932,166 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga z. A.P. është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. ...në rastin konkret nuk është e mundur nga ana Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, që të kontrollojë nëse administratori i Operatorit Ekonomik të shpallur fitues është përjashtuar nga APP apo jo, për shoqëri të tjera ku mund të jetë administrator/e.

1.1. ... mund të jetë e vërtetë, por Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka qenë në pamundësi për ta ditur këtë fakt, pasi në Buletin e Njoftimeve Publike që publikohet çdo fillim jave nga APP-ja, në Kreun “Operatorët ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike” pasqyron informacionin vetëm për të dhënat: emrin, nr. nipt-i, dhe periudhën e përjashtuar të operatorëve ekonomik, dhe nuk pasqyron të paktën dhe emrat e administratorëve, apo ortakëve të personit juridik.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi qenia apo jo e një OE i skualifikuar nga prokurimi publik përbën një kusht detyrues, sipas nenit 76, pika 3, germa (g), të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i ambienteve të brendshme të konviktit faza II, Bashkia Mat”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 673, datë 22.12.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 673, datë 22.12.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 564, datë 14.08.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar	1. E.D., Kryetar; 2. D.R., Anëtar; 3. E.A., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. D.N., Anëtar 3. R.K., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,377,199 lekë	6. Oferta fituese: BOE V.N.M.P. & U., me ofertë 8,980, 900 lekë pa TVSh, me kontratë datë 03.03.2022	7. Diferenca me fondin limit: 396,299 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.03.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Fondi limit 9, 337,199 lekë pa TVSh, nga grandit, ndarë për vitin 2021 në vlerën: 3,147,018.2 lekë pa TVSh, për vitin 2022 në vlerën: 3,250,000 lekë pa TVSh dhe për vitin 2023 në vlerën: 2,940,180.8 lekë pa TVSh.

Në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm BOE “V.N.M.P.” ShPK (89%), dhe “U.” ShPK (11%), me ofertë 8,980,900 lekë pa TVSh.

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimin e fondit limit, përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave: Nga auditimi rezultoi se:

- Kontrata nr. 181 rep., nr. 87 kol., datë 14.01.2022 për krijimin e BOE parashikon se “...të gjitha veprimet dhe punimet shoqëritë do t’i kryejnë së bashku duke bërë regjistrimin e mjeteve financiare, të punës dhe personelin...”, parashikim ky që vjen në kundërshtim me pikën 1 të nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” se “...në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. Në dokumentet e tenderit është përcjellë një preventiv i punëve të ndara, që nuk është pjesë e kontratës së bashkëpunimit të noterizuar.

- BOE “V.N.M.P. & U.” nuk përmbush kriterin 2.3.6., në lidhje me stafin ku në DST duhet të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar (tetor-dhjetor), konkretisht:

- Kontrata e punës mes “V.N.M.P.” ShPK dhe muratorit z. Y.L. lidhur me datë 01.01.2021 është e panoterizuar dhe z. L. nuk figuron në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajt tetor-nëntor 2021;
- Kontrata e punës me hidraulikun z. B.K. lidhur me datë 01.01.2021 është e panoterizuar dhe z. K. nuk figuron në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajt tetor-nëntor 2021;

- Inxhinieri hidraulik znj. F.X., me kontrate pune 19.02.2020 nuk figuron në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajt tetor-nëntor 2021;

- Elektriciteti z. K.G. nuk figuron në listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajt tetor-nëntor 2021;

- Bazuar në vërtetimin nr. T05344353 datë 12.01.2022 nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër rezulton se subjekti “V.N.M.P.” ka për të paguar gjithsej 153,554 lekë detyrime.

- OE “U.” ShPK nuk ka sjellë listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore për muajin dhjetor;

- BOE V. & U. nuk përmbush kriterin 2.3.6. c, në lidhje me disponimin e certifikatës/dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, për të qenë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, konkretisht, punonjësi i ngarkuar me këtë detyrë ka një certifikatë nga subjekti “A.”, i cili nuk rezulton në listën e organeve të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, për periudhën e zhvillimit të procedurës së tenderit;

Sa më sipër, në bazë të nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, tenderi duhej anuluar pasi operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, që në bazë të nenit 76, pika 2 përbën kriter detyrues për skualifikim.

Përgjegjësia është e KVO, e përbërë nga E.H., D.N. dhe R.K..

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 5, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 9,377,199 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga z. A.P. është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Nga bashkia Mat, për kontratën e bashkëpunimit, është përcjellë observacioni se “për sa ju argumentoni në mënyrë të gabuar, në rastin konkret Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet shoqërive është marrëveshje e noterizuar, por në kushtet e përgjithshme të DST nuk është kërkuar që preventivi i punëve të ndara, që do i bashkëngjitet kontratës së bashkëpunimit, të jetë i noterizuar”.

2. Nga Bashkia Mat, në lidhje me mospërbushjen e kriterëve, është përcjellë observacioni se “ndryshe nga sa ju konstatoni, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka kryer shkelje në vlerësimin e procedurës, pasi referuar konstatimeve nga ana juaj klasifikohen si devijime të vogla, të cilat nuk cenojnë realizimin e kontratës. Në lidhje me konstatimin tuaj se: “Bazuar në vërtetimin Nr.T05344353, datë 12.01.2022, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër, rezulton se subjekti “V.N.M.P.” ka për të paguar gjithsej 153,554 lekë detyrime”. Procedura e Prokurimit me objekt “Rehabilitimi i ambienteve të brendshme të konviktit faza II, Bashkia Mat”, është publikuar nga APP më datë 31.12.2021. Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit është data 17.01.2022, ora 10.00. Ndryshe nga sa ju citoni, referuar dokumentacioni të paraqitur në sistemin elektronik (SPE) të APP, nga ana e shoqërisë “V.N.M.P.” ShPK është ngarkuar në sistem Vërtetimi “Për pagim detyrimesh” Nr.T05282569, datë 30.12.2021, ku rezulton se kjo shoqëri nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datë 30.12.2021 ora 10:03:18.

Në lidhje me konstatimin tuaj se: “OE “U.” ShPK ka sjellë një kontratë pune për suvatues datë 03.05.2019, ku administrator i kompanisë z.N.S. punëson si suvatues z.N.S., ky konstatim nga ana juaj është i gabuar, pasi pavarësisht se ka nënshkruar kontratë me veten, nuk përbën kusht për skualifikim. -Referuar parashtrimin Tuaj, ku pohoni se shoqëria “A.” nuk është e akredituar për trajnimin e punonjësve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka patur dijeni për këtë fakt, por edhe nëse do të kishte dijeni përsëri nuk mund të merrte vendim për skualifikimin e operatorit ekonomik pjesëmarrës si pasojë e pavlefshmërisë absolute të këtyre akteve (çertifikatave) pa patur në dispozicion një vendim gjykatë të formës së prerë ku të ishte vendosur pavlefshmëria e këtyre akteve të lëshuara nga subjekti/trupi certifikues A..

2.1.... vërtetohet se administrator i shoqërisë “U.” ShPK, është z. N.S., i cili në listëpagesa ka nr. personal: G90508066W, ndërsa punonjësi me profesion Suvatues është z. N.S. dhe në listëpagesa ka të shënuar nr. personal: G10330155M (cituar dhe në kontratë). Pra, vërtetohet se nuk është i njëjti person, edhe pse nga ana juaj është konstatuar si i tillë për shkak se emrat janë të përafërt dhe mbiemri është i njëjtë.

2.2... Në dijeninë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton se subjekti/ trupi certifikues A. është një organizëm i akredituar dhe i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Konstatimi nuk ka të bëjë me noterizimin e marrëveshjes, por me faktin që nuk ka ndarje të zërave të punimeve që do të realizojë secili anëtar i bashkimit të operatorëve. Një ndarje e tillë, sikurse kërkohet nga kuadri ligjor, është e rëndësishme për të vlerësuar përbushjen e kriterëve të secilit anëtar, në përputhje me zërat e punimeve që do të kryejnë.

2. **Observacioni nuk merret në konsideratë**, sikurse trajtuar, pasi operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, që në bazë të nenit 76, pika 2 përbën kriter detyrues për skualifikim. Bazuar në vërtetimin Nr. T05344353, në datë 12.01.2022 rezulton debitor ndërsa vërtetimi nr. Nr. T05282569 ka datë 30.12.2021, çka nënkupton se vërtetimi i datës 12.01.2022 është më i freskuar mbi gjendjen e detyrimeve. Në lidhje me kontratën e z. Sh., observacioni do të merret në konsideratë.

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i segmenteve të rrugës kryesore të fshatit Frankth, të rrugës të shkollës së fshatit Frankth, të rrugës fshatit Shëlli”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 26 datë 22.01.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 26 datë 22.01.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: 1. E.H., Kryetar
--	---	--

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Negociim pa shpallje	1. E.A., Kryetar; 2. E.L., Anëtar; 3. D.R., Anëtar	2. A.M., Anëtar 3. E.R., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,252,237 lekë	6. Oferta fituese: BOE D.& C., me ofertë 3,250,767 lekë pa TVSh, me kontratë datë 04.02.2021	7. Diferenca me fondin limit: 1,470 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 29.01.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Prokurimi me objekt “*Rehabilitimi i segmenteve të rrugës kryesore të fshatit Frankth, të rrugës të shkollës së fshatit Frankth, të rrugës fshatit Shëlli*”, është përzgjedhur për shkak të riskut që bart procedura me negociim pa shpallje të njoftimit.

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me hartimin e fondit limit, përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Në bazë të Procesverbalit nr. 1 datë 24.01.2021, nënshkruar nga z. E.A., përgjegjës i njësies së prokurimit, z. E.L. dhe z. D.R. anëtarë, përshkruhet se “...njësia e prokurimit pasi shqyrtoi listën e shoqërive të regjistruara në QKR dhe studioi objektin e një numri të madh prej tyre për të përzgjedhur shoqëritë që do të propozohen të ftohen, ...me unanimitet vendosi që t’u dërgojë ftesë për pjesëmarrjen shoqërive 1. “D.”, (shpallur fitues në formë BOE me “C.” ShPK); 2. “H.G.C.”, nuk ka paraqitur ofertë dhe 3. E.E., nuk ka paraqitur ofertë.”

Nga auditimi u konstatua se:

- AK ka ftuar 2 OE, “H.G.C.” dhe “E.E.”, themeluar respektivisht në 04.04.2018 dhe 11.01.2019, të cilat apriori nuk plotësojnë kriteret e DST. Konkretisht, për kapacitetin ekonomik dhe financiar, pika 2.2.1. kërkohej “*kopje të vërtetuar të balanceve, (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (2017, 2018 dhe 2019)*”. Këto dy subjekte, duke iu referuar vitit të themelimit nuk e plotësojnë kriterin përkatës pasi “H.G.C.” nuk ka balance të vitit 2017, ndërsa “E.E.” është në pamundësi për të dorëzuar bilanci të viteve 2017-2018;

- Në lidhje me kapacitetin teknik, nga të dhënat e thesarit, rezulton se “H.G.C.” dhe “E.E.” nuk rezultojnë me punë të ngjashme për periudhën 2019-2021, në lidhje me rehabilitimin e segmenteve të rrugëve dhe të urave;

- Konstatohet se është shpallur fitues BOE “C.” ShPK & “D.” ShPK, ku operatori që është ftuar “D.” ka 30% të punimeve ndërsa operatori që s’është ftuar “C.” ShPK ka 70% të punimeve sipas akt marrëveshjes nr. 190 rep. nr. 58 kol.;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 4 të nenit 36 të VKM nr. 914/2014 i ndryshuar, “*Rregullat e prokurimit publik*”.

Përgjegjësia është e Njësies së Prokurimit, e përbërë nga E.A., E.L. dhe D.R..

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 5, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 3,252,237 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në përzgjedhjen e OE, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga z. A.P. është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. ... " nuk është kërkuar që punimet e mëparshme të jenë kryer vetëm me ente publike, por edhe në sektorin privat, pasi në rast se secili nga këto operatorë ekonomikë do të merrnin pjesë në këtë procedurë prokurimi, dhe do të ishin në pamundësi për të paraqitur bilanci e viti 2017, apo 2017-2018, ato nuk mund të skualifikoheshin nga pjesëmarrja për këtë arsye, pasi arsyeja e mospërbushja vjen si rezultat pamundësisë objektive (mosekzistencës së personit juridik në atë kohë), qëndrim ky i konsoliduar dhe nga vendimet e KPP-së për raste të tilla. (Vendimi Nr.K.P.P.633/2017, ankesa e OE "N." ShPK ndaj vendimit të KVO-s për kualifikimin e OE "S.S." ShPK Njësia e prokurimit në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik që kërkojnë ka patur parasysh faktin që OE të ftuar të kenë në fushën e veprimtarisë, atë të punimeve të ndërtimit civil, rrugë, ura etj., dhe të jenë operatorë ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitetin në bashkinë Mat, me qëllim mobilizimin e kapaciteteve punëtore, pajisjeve, dhe sigurimin e materialeve sa më shpejt të jetë e mundur pasi gjendeshim në një situatë emergjente për ndërhyrjen e menjëhershme në rehabilitimin e infrastrukturës rrugore objekt prokurimi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. **Observacioni nuk merret në konsideratë**, sikurse është trajtuar, pasi veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 4 të nenit 36 të VKM nr. 914/2014 i ndryshuar, "Rregullat e prokurimit publik".

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Lis, Ambulancës Zenisht, dhe Ambulancës Mallunxë"		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 508 datë 04.10.2021	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 508 datë 04.10.2021	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 564, datë 14.08.2020
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar	1. E.A., Kryetar; 2. E.L., Anëtar; 3. D.R., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. E.D., Anëtar 3. E.B., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 11,199,324 lekë	6. Oferta fituese: OE C., me ofertë 11,000,314 lekë pa TVSh, me kontratë datë 18.11.2021	7. Diferenca me fondin limit: 199,010 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 22.10.2021	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Fondi limit 11,199,324 (lekë pa TVSh), ndarë për vitin 2021 në vlerën 10,462,686 lekë pa TVSh, nga granditë në vlerën 2,717,500 lekë pa TVSh dhe nga të ardhurat në vlerën 7,745,186.75 lekë pa TVSh dhe për vitin 2022 në vlerën: 736,637.25 lekë pa TVSh, nga granti.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë:

"A." ShPK me ofertë 9,845,167 lekë (skualifikuar)

"C." ShPK me ofertë 11,000,314 lekë (shpallur fitues)

Vlerësimi i ofertave: Nga auditimi, u konstatua se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar se "A." ShPK me ofertën më të ulët në vlerën 9,845,167 lekë nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

Vlerësimi i KVO nr. 1: "Nuk është plotësuar saktë seksioni A "Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit"; seksionin B "Deklarata "Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura" pika 8, 9 dhe 10 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka patur konsultim, komunikim... me ndonjë konkurrent tjetër, edhe pse në pikën 6 të saj ka deklaruar se ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pra, rezulton të jetë kontradiktore në deklaratimet e kryera. Si dhe në seksionin D "Deklarata "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës" pika 3 e saj, nuk ka deklaruar se nuk ka masë efektive ligjore të vendosur nga ISHPSHSH, ku bazuar në nenin 76 pika 3, gërma "a" duhet të s'kualifikohet".

Nga auditimi rezultoi se OE i ka plotësuar duke u shprehur "Jo", në vend të "Po" në rubrikat 8, 9, 10 të formularit të vetëdeklarimit. Duke qenë se këto rubrika përmbajnë fjali mohuese "nuk", si përgjigje është dhënë "Jo", për të shprehur nga ana kuptimore pikërisht objektin e deklaratës se nuk ka patur konsultime me ndonjë konkurrent tjetër, etj. Marrë shkas nga natyra deklarative e këtij formulari, kuadri ligjor parashikon të drejtën e AK që të kërkojë sqarime lidhur me formularin e vetëdeklarimit, gjë që nuk është zbatuar sipas Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", pika 2.

Vlerësimi i KVO nr. 2: Konstatohet se deklarata e paraqitur për caktimin e Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt, nuk është nënshkruar nga drejtuesi teknik i punimeve, por vetëm nga administratori i shoqërisë, si dhe nuk ka një deklaratë të tillë nga vetë drejtuesi teknik.

Nga auditimi rezultoi se vlerësimi nuk është në përputhje me DST. Konkretisht, sipas pikës 2.3.5., germa "d" kërkohet që "...kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë dhe vetë Drejtuesi Teknik)". Në rastin konkret, është përcjellë deklarata për drejtuesin teknik, nënshkruar nga Administratori, sikurse e kërkon kriteri.

Vlerësimi i KVO nr. 3: Në preventivin e ofertës së paraqitur, vlera e ofertuar e përllogaritur është gabim, pasi në preventivin për rikonstruksionin e Qendrës shëndetësore Lis, tek shuma totale (Shuma II-Pajisje) nuk është kryer përllogaritja e të 2 (dy) shumave të ofruara për "Pajisje Elektrike" në vlerën 315,650 lekë dhe "Pajisje ngrohje" në vlerën 1,110,000 lekë, ku shuma totale e tyre rezulton në vlerën: 1 425 650 lekë, por është lënë shuma totale 1 110 000 lekë pa TVSh, që është vlera e pajisjeve ngrohëse. Referuar përllogaritjeve të kryera, rezulton se shuma absolute e korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, ku bazuar në nenin 82 pika 3 germa "c" e VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, oferta refuzohet.

Nga auditimi u konstatua se në preventivin e posaçëm për rikonstruksionit të Qendrës Shëndetësore Lis, rezulton se ndonëse vlera prej 315,650 lekë është përfshirë si nëntotal ajo nuk është përllogaritur në shumën totale për "Pajisje ngrohje" (1,110,000+315,650). Shuma totale për "Pajisje ngrohje" është lënë 1,110,000 lekë, por nga verifikimi i preventivit rezulton se shumatorja e të gjithë nëntotaleve është 5,798,475 lekë (përfshirë 315,650 si nëntotal) ndërkohë që vlera totale e preventivit për rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore Lis është lënë vlera 6,357,390 lekë me TVSh. Si rrjedhojë, në rastin konkret ka një mospërputhje mes çmimit total dhe vlerave të nëntotalit. Në nenin 82 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, germa "b" të VKM nr. 285/2021, përcaktohet se "Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij".

Ndërkohë në germen "c", parashikohet se ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar, ku është bazuar edhe vlerësimi i KVO ($0.02 \times 9,845,167 = 196903.34$). Si konkluzion, vlera 315,650 është më e madhe se 2%.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga z. A.P. është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. ...Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit, ndryshe nga sa konstatohet në mënyrë të gabuar nga ana Juaj, vërtetohet se vlerësimi i Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është në zbatim të përcaktimeve të nenit 76 pika 3 germa "a" dhe nenit 82 të LPP-së, si dhe nenit 26 pika 2 germa "f" dhe "g" të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, referuar deklarimeve të kryera nga ana e OE pjesëmarrës, shoqëria "A." ShPK, në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST. Nuk është detyrë e KVO-s në kuptim të ligjit që të kërkojë sqarime në lidhje me deklaratimet e kryera dhe të kryejë korrigjimet e

saj, pasi plotësimi gabim i deklaratave (në rast se jemi përpara këtij rasti) është përgjegjësi e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe jo e autoritetit kontraktor.

2.Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit, vërtetohet se vlerësimi i KVO-s ka qënë i drejtë dhe në përmbushje të kërkesës për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.5, gërma “d”/ 2.3 Kapaciteti teknik, pasi është kërkuar që deklarata për caktimin e drejtuesit teknik të jetë nënshkruar nga administratori dhe vetë drejtuesi teknik, ndërsa dokumenti i paraqitur “Deklaratë për drejtuesin teknik” është nënshkruar vetëm nga administratori i shoqërisë, dhe jo nga drejtuesi teknik, gjë e cila pranohet edhe nga ana Juaj (se e ka nënshkruar vetëm administratori), por nuk kuptohet pse jeni kontradiktor kur shpreheni “...sikurse e kërkon kriteri”, pasi në kërkesën për kualifikim është përcaktuar, citojmë: “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë dhe vetë Drejtuesi Teknik) Drejtuesin Teknik të punimeve...”

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Observacioni merret në konsideratë vetëm për arsyen e skualifikimit në lidhje me ofertën me gabime aritmetike, e cila refuzohet kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Procedurat e audituara për periudhën 01.01.2022-31.12.2022

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Mustafa Gjestila”, Burrel”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 569, datë 10.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 569, datë 10.08.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 570, datë 10.08.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur, punë	1. E.A., Jurist 2. R.K., Inxhinier 3. D.R., Ekonomist	1. E.H., Kryetar 2. K.X., Anëtar 3. E.R., Anëtar
5. Fondi Limit pa TVSh: 100,192,722.5 lekë	6. Oferta fituese: OE “U.” ShPK, me ofertë 98,447,456 lekë pa TVSh, me kontratë datë 14.10.2022, me afat 9 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.	7. Diferenca me fondin limit: 1,745,266.5 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 12.09.2022, ora: 10. ⁰⁰	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e veta	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Nga auditimi, u konstatua si më poshtë:

- Dosja e prokurimit nuk është dorëzuar në arkivën e institucionit, nuk është e inventarizuar dhe dokumentet janë të panumërtuara, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 21.
- Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

Fondi limit: Miratimi i fondeve për këtë objekt është dërguar nga MAS në Bashkinë Mat me shkresën nr. 4367 prot., datë 28.06.2022, me objekt “Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuar pranë MAS, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin”.

Bashkëlidhur shkresës, është detajuar mënyra e financimit të këtij objekti, si më poshtë:

Vlera e plotë e objektit:	120,231,267 lekë;
Financimi nga MAS për vitin 2022:	22,005,368 lekë;
Financimi nga Bashkia Mat:	18,034,690 lekë;
Financimi nga MAS për vitin 2023:	80,191,209 lekë;

Me shkresën nr. 4254/4 prot., datë 18.07.2022 me objekt *“Dërgohet çelja e fondeve në grupin e shpenzimeve kapitale për vitin 2022-2023”* nga MAS, bashkëlidhur shkresën nr 12451/2 prot., datë 12.07.2022, nga MFE është bërë transferimi i fondit 22,005,368 lekë për vitin 2022 dhe 80,191,209 lekë për vitin 2023, për shpenzime kapitale në llogarinë ekonomike të Bashkisë Mat.

Projekti i rikonstruksionit, Raporti teknik dhe Specifikimet teknike janë hartuar nga ing. A.M., me nr. licence K.1784/1 dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Mat, z. A.M..

Projekti elektrik është hartuar nga ing. E.M., me nr. licence E.1296/1.

Raporti i auditimit të energjisë është hartuar nga shoqëria D. ShPK dhe nënshkruar në mënyrë elektronike nga ing. V.B..

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është hartuar nga ing. A.H., me nr. licence 429.

Në dosjen e prokurimit nuk disponohet Oponenca teknike, detyra e projektimit dhe kontrata apo aktmarrëveshja e Bashkisë Mat me projektuesin.

Leja e ndërtimit është miratuar nr. 327, datë 21.12.2022.

Kriteret e vlerësimit: Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbal datë 25.08.2022, i cili është i paprotokolluar.

- Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet *“...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.”*. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 43, *“Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”*, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.2.3. në DT, është kërkuar që *“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2022 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar....”*. Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifatat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në mospërputhje me LPP, neni 76 *“Kriteret detyruese për skualifikim”*, pika 2;

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet *“Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% e fondit limit të kontratës që prokurohet”*.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 39, *“Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”*, pika 5.

- Në pikën 2.3.2. në DT, krahas të tjerave kërkohet kategoria e licencës NS-18C, *“Punime topogjeodezike”* e cila nuk është e argumentuar, pasi në preventiv nuk parashikohen punime topogjeodezike, aq më tepër në një vlerë 51-100 milion lekë, e cila është vlera korresponduese e kategorisë “C” të licencës;

- Në pikën 2.3.4. në DT, kërkohen licencat me kodin III.2.B., *“Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”* dhe me kodin 1.2.A *“Shërbime ekspertize “Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga Zjarri të ndërtesave të çdo lloji”*, të cilat nuk janë të argumentuara, pasi licenca me kodin III.2.B. nuk përfshin mbetjet inerte të përfutuara

nga prishja e ndërtimeve dhe licenca me kodin 1.2.A., është e nevojshme në momentin e projektimit, i cili ka përfunduar;

- Në pikën 2.3.5. në DT, për pajisjet “*hidrosanitare dhe hidraulike, elektrike, hidroizoluese dhe termoizoluese dhe bojën hidroplastike*”, kërkohet autorizim ose aktmarrëveshje nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, katalogu i prodhuesit, si dhe të jenë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001. Kjo kërkesë nga grupi i auditimit konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar, pasi sasi të dhe vlerat e artikujve që kërkohen, mund të gjenden në çdo kohë në çfarëdo dyqan materialesh ndërtimi, hidrosanitarësh apo artikujsh elektrikë;

- Në pikën 2.3.6. në DT, kërkohet që OE duhet të disponojë jo më pak se 100 punonjës për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Duke pasur parasysh edhe që më poshtë, në pikën 2.3.7. kërkohet një total punonjësish prej 33 punonjësish të stafit inxhinierik dhe teknik, si dhe 10 shoferë/manovratorë të llojeve të ndryshme, nga grupi i auditimit numri i punonjësve nuk konstatohet të jetë zërthyer sipas zërave të preventivit, ndërsa kërkesa për tre muajt e fundit konsiderohet e papërshtatshme, sepse OE i cili do të shpallet fitues duhet të ketë një numër të përafërt me numrin e nevojshëm të punonjësve të paktën muajin e fundit para hapjes së ofertave;

- Në pikën 2.3.7. a dhe b në DT, krahas të tjerave kërkohen 1 Inxhinier Ndërtimi i profilit strukturist, 2 Arkitektë dhe 1 Inxhinier gjeofizike/sizmiologji inxhinierike, të cilët nga grupi i auditimit konsiderohen të tepërt dhe të paargumentuar sipas preventivit të punimeve;

- Në pikën 2.3.7.c. në DT, kërkohet që “*OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 10 (dhjetë) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për përdorim dhe punime në skela*”, të cilët nga grupi i auditimit konsiderohen të tepërt dhe të paargumentuar, pasi ky lloj certifikimi nuk është i mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor;

- Në pikën 2.3.7.e. në DT, kërkohet që “*OE ofertues duhet të disponojë 1 mjek të përgjithshëm*”, kërkesë e cila është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 “*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*”, pika 1;

- Në pikën 2.3.7.f. në DT, kërkohet një inxhinier “*...që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe jo në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, neni 10 “*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*”, pika 5;

- Në pikën 2.3.7.g. në DT, kërkohet një inxhinier “*...1 specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe nuk është e mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor;

- Në pikën 2.3.7.h. në DT, kërkohet një inxhinier “*...1 përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë për riskun e lartë gjatë realizimit të punimeve*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe nuk është e mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor; Kjo kërkesë është e dubluar me kërkesën në pikën 2.3.7.f.

- Në pikën 2.3.8., në DT, është kërkuar që shoferët e mjeteve të rënda dhe manovratorët/automakinistët të disponojnë “*Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar)*”. Kjo kërkesë është e tepërt dhe e paargumentuar, pasi ligji në fjalë kërkon pajisjen me këtë lloj dëshmie vetëm për punonjësit të cilët përdorin pajisje elektrike;

- Në pikën 2.3.9., në DT, është kërkuar disponimi i “*...jo më pak se 2 kamionë me kapacitet mbi 15 Ton, 2 kamionë me kapacitet 10-15 Ton, 2 kamionçina me kapacitet 3.5-10 Ton, 2 kamionë me vinç dhe 3 kamionçina me kapacitet deri në 3 Ton*”. Nga grupi i auditimit këto

kërkesa konsiderohen të tepërta, të paargumentuara dhe të pazbërthya sipas zërave të punimeve në preventiv;

- Në pikën 2.3.9., në DT, është kërkuar disponimi i “...jo më pak se 2 ekskavatorë me goma”. Nga grupi i auditimit kjo kërkesë konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar, pasi në preventiv nuk ka asnjë zë punimesh për ekskavator;

- Në pikën 2.3.10., në DT, është kërkuar kantier për prodhimin e betonit, në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi, me leje mjedisi me kod III.1.B., e cila nga grupi i auditimit konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar sipas zërave të preventivit;

Këto kritere, janë të tepërta, të paargumentuara, kufizojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë dhe nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.A., R.K. dhe D.R..

Vlerësimi i ofertave: - Hapja e ofertave është dokumentuar nga KVO me procesverbalin nr. 3, datë 12.09.2022, nga ku konstatohet pjesëmarrja e dy OE ofertues. i cili është i paprotokolluar.

- Në tender kanë marrë pjesë 2 OE, nga të cilët është skualifikuar BOE E.S. & B.I., me ofertë 99,731,998.42 lekë pa TVSh dhe është kualifikuar OE U., me ofertë 98,447,456 lekë pa TVSh, me diferencë 1,745,266.5 lekë nga fondi limit.

- Vlerësimi i ofertave është dokumentuar nga KVO me procesverbalin nr. 4, datë 23.09.2022, pa numër protokoll, nga ku konstatohet se është kualifikuar si fitues OE U., i cili ka dhënë edhe ofertën më të ulët.

- Formulari i njoftimit të fituesit është me nr. 4084 prot., datë 29.09.2022, nënshkruar nga titullari i institucionit.

- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO me shkresën nr. 4247 prot., datë 07.10.2022, është miratuar prej tij dhe është hartuar në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik.

- Me urdhërin nr. 722, me nr. 4390 prot., datë 14.10.2022, nga titullari i institucionit është caktuar z. R.K. si person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës.

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Mat dhe OE “U.” ShPK është lidhur me nr. 4392 prot., datë 14.10.2022, me afat 9 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	BOE E.S. & B.S.	99,731,998.42	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: 1. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk kanë paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3. 2. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, anëtar i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, shoqëria “E.S.” ShPK, nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas gërmës “a” dhe “b” për vërtetimin e punimeve të kryera nga ana e saj me ente publike, dhe në sektorin privat. 3. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pasi nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë: - Pajisje hidrosanitare dhe hidraulike - Pajisje elektrike - Pajisje hidroizoluese dhe termoizoluese - Bojë hidroplastike 4. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “a” dhe “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në deklaratat sipas Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të paraqitur nga të 2 (dy) shoqëritë në bashkim, nuk kanë deklaruar se disponojnë minimumi 1 (një) inxhinier Ndërtimi (Profili Strukturist), si drejtues teknik, dhe minimumi 1 (një)

			Inxhinier Gjeofizike /Sizmiologji inxhinierike të punësuar si staf ndihmës për kryerjen e punimeve objekt kontrate. 5. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “c”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në deklaratat sipas Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të paraqitur nga të 2 (dy) shoqëritë në bashkim, nuk kanë deklaruar se disponojnë punonjësit e specializuar/ kualifikuar si: Teknik hidraulik – jo më pak se 1 (një) punonjës, Specialist elektronik – jo më pak se 2 (dy) punonjës, dhe Specialist kondicionimi – jo më pak se 2 (dy) punonjës. 6. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 gërma “d”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në deklaratat sipas Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të paraqitur nga të 2 (dy) shoqëritë në bashkim, nuk kanë deklaruar se disponojnë të paktën 10 (dhjetë) punonjës të specializuar dhe certifikuar për përdorim dhe punime në skela.
2	U.	98,447,456	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- Katalogët e pajisjeve hidrosanitare, të kontraktuara me shoqërinë “B.”, nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe, në kundërshtim me DT dhe LPP;
- Katalogët e pajisjeve elektrike, të kontraktuara me shoqërinë “A.E.”, nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe, në kundërshtim me DT dhe LPP;
- OE U. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7.f. në DT pasi certifikata e trajnimit e ing. A.S. është lëshuar nga shoqëria A., e cila nuk është e akredituar për trajnimin e punonjësve;
- OE U. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7.h. në DT, pasi certifikata e trajnimit e ing. S.B. është lëshuar nga shoqëria A., e cila nuk është e akredituar për trajnimin e punonjësve;³
- OE U. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.8. në DT, pasi dëshmitë e kualifikimit për sigurimin teknik janë nga shoqëria H., e cila është e akredituar vetëm për trajnimin e punonjësve të cilët janë përdorues të pajisje elektrike;⁴

Gjithashtu, punonjësit e mëposhtëm kanë mangësi në dokumentacion:

- S.M., është deklaruar si hekurkthyes dhe si manovrator/automakinist;
- A.F., është deklaruar si saldator dhe si shofer për mjete të rënda;

Konkluzion: Sa më sipër OE U. ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE U. ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE U. ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën 98,447,456 lekë pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga E.H., Kryetar, K.X. dhe E.R., Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 16, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 98,447,456 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

³ <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

⁴ <https://dpa.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/HVAT-perfundimtar.pdf>

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1.Në lidhje me konstatimin Tuaj se: “Në preventiv, seksioni VI, një përdorur marka, si “G.” dhe “T.”, të cilat nuk janë shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, në mospërputhje me LPP, neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 4, ku përcaktohet:...” rezulton se ky konstatim është i pabazuar pasi njësia e prokurimit në setin e Dokumentave Standarte të Tenderit, përkatësisht në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” ndër të tjerash ka vendosur shënimin citojmë:

“Shënim:

Në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik¹”, sqarojmë operatorët ekonomik pjesëmarrës, se në rastet kur për punimet (përfshirë materialet/ produktet) objekt prokurimi është kërkuar që:

Të jenë sipas një standarti ndërkombëtar EN..., në rastet kur ato nuk ekzistojnë, do të pranohen dhe ekuivalentet e tyre të njohura sipas standarteve kombëtare S SH...

Në çdo fjali ku kemi referim të markës/ prodhuesit, dhe në ato raste, ku është përcaktuar që produkti/ materiali të jetë “Importi”, “Cilësi e I-rë” etj., pas emërimit të tyre shtohet fjalia “...ose ekuivalente me të”. ”

Për sa më lart, duke qënë se ky konstatim nuk qëndron, kërkojmë që të hiqet.

2.Në lidhje me katalogët e papërkthyer, ndryshe nga sa ju konstatoi, katalogu është një dokument i cili përmban më shumë të dhëna fotografike, skema të pajisjeve, si dhe të dhëna në numra, dhe është një dokument i cili nuk kërkohej në asnjë rast që të jetë i përkthyer si për shkak të të dhënave që përmban, ashtu dhe volumit që ka si dokument. Qëndrim ky i mbajtur nga A.K. Bashkia Mat në çdo procedurë prokurimi të shpallur, ku katalogët asnjëherë nuk janë kërkuar që të jenë të përkthyer në rastet kur janë kërkuar.....

3. ...Observacionet e tjera parashtrajnë të njëjtat argumente dhe kanë bashkëlidhur të njëjtin dokumentacion si për Aktin e konstatimit.....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Argumenti juaj qëndron, pavarësisht mënyrës së të shprehurit e cila nuk është në përputhje literalisht me LPP.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit pranohet.

2. Në LPP përcaktohet shprehimisht që “Të gjitha dokumentet e tenderit duhet të jenë në gjuhën shqipe”. Duke qënë se edhe katalogët, manualët, etj janë pjesë e dokumenteve të tenderit, edhe ato duhet të jenë në gjuhën shqipe.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit nuk pranohet.

3. Duke qënë se nga subjekti i atakuar nuk janë paraqitur fakte, argumente dhe dokumente të tjera shtesë, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren apo shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura për Aktin e Konstatimit, kjo pjesë e observacionit nuk pranohet.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Gjimnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 567, datë 10.08.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 567, datë 10.08.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 568, datë 10.08.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur, punë	1. E.A., Jurist 2. R.K., Inxhinier 3. D.R., Ekonomist	1. E.H., Kryetar 2. K.X., Anëtar 3. E.R., Anëtar
5. Fondi Limit pa TVSh: 95,678,607.5 lekë	6. Oferta fituese: B.O.E: “E.S.” dhe “B.S.” ShPK, me ofertë 94,182,418.3 lekë pa TVSh, me kontratë datë 10.10.2022, me afat 6 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.	7. Diferenca me fondin limit: 1,496,189.2 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 07.09.2022, ora: 10. ⁰⁰	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e veta	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE

		c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe vlerësimit të ofertave.

Situata: Nga auditimi, u konstatua si më poshtë:

- Dosja e prokurimit nuk është dorëzuar në arkivën e institucionit, nuk është e inventarizuar dhe dokumentet janë të panumërtuara, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 21.
- Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

Fondi limit: Miratimi i fondeve për këtë objekt është dërguar nga MAS në Bashkinë Mat me shkresën nr. 4367 prot., datë 28.06.2022, me objekt “*Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuar pranë MAS, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin*”.

Bashkëlidhur shkresës, është detajuar mënyra i financimit të këtij objekti, si më poshtë:

Vlera e plotë e objektit:	114,814,329 lekë;
Financimi nga MAS për vitin 2022:	34,711,569 lekë;
Financimi nga Bashkia Mat:	17,222,149 lekë;
Financimi nga MAS për vitin 2023:	62,880,611 lekë;

Me shkresën nr. 4254/4 prot., datë 18.07.2022 me objekt “*Dërgohet çelja e fondeve në grupin e shpenzimeve kapitale për vitin 2022-2023*” nga MAS, bashkëlidhur shkresën nr 12451/2 prot., datë 12.07.2022, nga MFE është bërë transferimi i fondit 34,711,569 lekë për vitin 2022 dhe 62,880,611 lekë për vitin 2023, për shpenzime kapitale në llogarinë ekonomike të Bashkisë Mat.

Projekti dhe Specifikimet teknike janë hartuar nga shoqëria “I.”, me administratore ing. F.V. dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Mat, z. A.M..

Në dosjen e prokurimit nuk disponohet Oponenca teknike, detyra e projektimit dhe kontrata apo aktmarrëveshja e Bashkisë Mat me projektuesin.

Leja e ndërtimit është miratuar nr. 312, datë 20.09.2022.

Kriteret e vlerësimit: - Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 15.08.2022, i cili është i paprotokolluar.

- Me shkresën nr. 3545 prot., datë 19.08.2022 janë bërë ndryshime në DT, pas rekomandimeve nga APP. Afati i hapjes së ofertave nuk ka ndryshuar.

- Me shkresën nr. 3640 prot., datë 26.08.2022 janë bërë ndryshime në DT, ku krahas të tjerave, afati i hapjes së ofertave ka ndryshuar nga data 31.08.2022, në datën 07.09.2022.

- Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet “*...vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet*”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa b.

- Në pikën 2.2.3. në DT, është kërkuar “*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2022 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar*”. Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifatat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve

me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet “a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit.... ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% e fondit limit të kontratës që prokurohet”.

Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5.

- Në pikën 2.3.2. në DT, krahas të tjerave kërkohet kategoria e licencës NP-12A, “*Punime të inxhinierisë së mjedisit*” e cila, duke pasur parasysh që në preventiv nuk ka zëra punimesh të cilat i përkasin kësaj kategorie;

- Në pikën 2.3.4. në DT, kërkohen licencat me kodin III.2.B., “*Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme*” dhe me kodin 1.2.A “*Shërbime ekspertize “Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga Zjarri të ndërtesave të çdo lloji”*”, të cilat nuk janë të argumentuara, pasi licenca me kodin III.2.B. nuk përfshin mbetjet inerte të përfutuara nga prishja e ndërtimeve dhe licenca me kodin 1.2.A., është e nevojshme në momentin e projektimit, i cili ka përfunduar;

- Në pikën 2.3.5. në DT, për pajisjet “*hidrosanitare dhe hidraulike, elektrike, hidroizoluese dhe termoizoluese dhe bojën hidroplastike*”, kërkohet autorizim ose aktmarrëveshje nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, katalogu i prodhuesit, si dhe të jenë të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001. Kjo kërkesë nga grupi i auditimit konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar, pasi sasi të dhe vlerat e artikujve që kërkohen, mund të gjenden në çdo kohë në çfarëdo dyqan materialesh ndërtimi, hidrosanitare apo artikujsh elektrikë;

- Në pikën 2.3.6. në DT, kërkohet që OE duhet të disponojë jo më pak se 90 punonjës për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Duke pasur parasysh edhe që më poshtë, në pikën 2.3.7. kërkohet një total punonjësish prej 35 punonjësish të stafit inxhinierik dhe teknik, si dhe 10 shoferë/manovratorë të llojeve të ndryshme, nga grupi i auditimit numri i punonjësve nuk konstatohet të jetë zbrëthyer sipas zërave të preventivit, ndërsa kërkesa për tre muajt e fundit konsiderohet e papërshtatshme, sepse OE i cili do të shpallet fitues duhet të ketë një numër të përafërt me numrin e nevojshëm të punonjësve të paktën muajin e fundit para hapjes së ofertave;

- Në pikën 2.3.7.d. në DT, kërkohet që “*OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 6 (gjashtë) punonjës të specializuar dhe certifikuar për përdorim dhe punime në skela*”, të cilët nga grupi i auditimit konsiderohen të tepërt dhe të paargumentuar, pasi ky lloj certifikimi nuk është i mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor;

- Në pikën 2.3.7.e. në DT, kërkohet që “*OE ofertues duhet të disponojë 1 mjek të përgjithshëm*”, kërkesë e cila është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 “*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*”, pika 1.

- Në pikën 2.3.7.f. në DT, kërkohet një inxhinier “*...që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe jo në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, neni 10 “*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*”, pika 5.

- Në pikën 2.3.7.g. në DT, kërkohet një inxhinier “...1 specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe nuk është e mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor;
 - Në pikën 2.3.7.h. në DT, kërkohet një inxhinier “...1 përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë për riskun e lartë gjatë realizimit të punimeve”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe nuk është e mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor; Kjo kërkesë është e dubluar me kërkesën në pikën 2.3.7.f.
 - Në pikën 2.3.8., në DT, është kërkuar që shoferët e mjeteve të rënda dhe manovratorët/automakinistët të disponojnë “Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar)”. Kjo kërkesë është e tepërt dhe e paargumentuar, pasi ligji në fjalë kërkon pajisjen me këtë lloj dëshmie vetëm për punonjësit të cilët përdorin pajisje elektrike;
 - Në pikën 2.3.9., në DT, është kërkuar disponimi i “...jo më pak se 2 kamionë me kapacitet mbi 15 Ton, 1 kamion me kapacitet 10-15 Ton, 2 kamionë me kapacitet 10-15 Ton, 1 kamionçinë me kapacitet 3.5-10 Ton, 2 kamionë me vinç dhe 3 kamionçina me kapacitet deri në 3 Ton”. Nga grupi i auditimit këto kërkesa konsiderohen të tepërta, të paargumentuara dhe të pazbërthya sipas zërave të punimeve në preventiv;
 - Në pikën 2.3.9., në DT, është kërkuar disponimi i “...jo më pak se 2 ekskavatorë me goma”. Nga grupi i auditimit kjo kërkesë konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar, pasi në preventiv nuk ka asnjë zë punimesh për ekskavator;
 - Në pikën 2.3.10., në DT, është kërkuar kantier për prodhimin e betonit, në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi, me leje mjedisi me kod III.1.B., e cila nga grupi i auditimit konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar sipas zërave të preventivit;
- Këto kritere, janë të tepërta, të paargumentuara, kufizojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë dhe nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.
- Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.A., R.K. dhe D.R..
- Vlerësimi i ofertave:** - Hapja e ofertave është dokumentuar nga KVO me procesverbalin nr. 3, datë 07.09.2022, nga ku konstatohet pjesëmarrja e dy OE ofertues. i cili është i paprotokolluar.
- Në tender kanë marrë pjesë 2 OE, nga të cilët është skualifikuar OE U., me ofertë 95,240,450 lekë pa TVSh dhe është kualifikuar BOE E.S. & B.I., me ofertë 94,182,418.3 lekë pa TVSh, me diferencë 1,496,189.2 lekë nga fondi limit.
 - Vlerësimi i ofertave është dokumentuar nga KVO me procesverbalin nr. 4, datë 20.09.2022, pa numër protokolli, nga ku konstatohet se është kualifikuar si fitues BOE E.S. & B.I., i cili ka dhënë edhe ofertën më të ulët.
 - Formulari i njoftimit të fituesit është me nr. 4001 prot., datë 23.09.2022, nënshkruar nga titullari i institucionit.
 - Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO me shkresën nr. 4134 prot., datë 03.10.2022, është miratuar prej tij dhe është hartuar në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik.
 - Me urdhërin nr. 698, me nr. 4270 prot., datë 10.10.2022, nga titullari i institucionit është caktuar z. R.K. si person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës.
 - Kontrata ndërmjet AK Bashkia Mat dhe BOE “E.S. & B.I.” është lidhur me nr. 4272 prot., datë 10.10.2022, me afat 6 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.

- Me urdhërin nr. 05, me nr. 36 prot., datë 05.01.2023, nga titullari i institucionit është zëvendësuar z. R.K. si personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës dhe është caktuar znj. M.Ç..

Rezultatet e vlerësimit janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	U. ShPK	95,240,450	Skualifikuar për arsyet e mëposhtme: Në Listën e çmimeve të ofertës së paraqitur (Preventivi i punimeve), konstatohet se nga ana e Operatorit Ekonomik nuk është kryer përlogaritje mbi sasi të përcaktuar në preventivin e punimeve objekt kontrate (Shtojca 2 e DST-së), por është proceduar me ndryshimin/ uljen dhe rritjen e sasive të zërave të punimeve, veprime këto, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45 pika 3 e e VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), pasi i vetmi element i ndryshueshëm është vetëm çmimi që oferton, dhe jo elementët e tjerë të ofertës ekonomike.
2	BOE E.S. & B.I.	94,182,418.3	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- BOE E.S. & B.I. në pikën 6. të formularit të vetëdeklarimit, në lidhje me përgatitjen e ofertës së pavarur, ka deklaruar [Jo], duke mos përmbushur kriterin e pikës 1, germa gj), si më poshtë:

6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo [✓]
--	---------------

- BOE E.S. & B.I. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3., pasi certifikatat ISO të paraqitura nga OE E.S., janë lëshuar nga shoqëritë R.C. dhe B.C., të cilat nuk janë të akredituara në Shqipëri;⁵
- BOE E.S. & B.I. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7., germa d), pasi ka deklaruar se disponon 3 “punonjës të specializuar dhe certifikuar për përdorim dhe punime në skela”, nga 6 që kërkohen në DT; gjithashtu, certifikatat e kualifikimit për këta punonjës janë lëshuar nga shoqëria A., e cila nuk është e akredituar në Shqipëri;
- BOE E.S. & B.I. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7., germa f), pasi nuk ka deklaruar disponimin e një inxhinieri “që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve”;
- OE B.I. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7., germa h), pasi certifikatat e paraqitura për “përgjegjës për sigurinë dhe shëndetit në punë për riskun e lartë gjatë realizmit të punimeve” dhe “certifikata për përdorim dhe punime në skela”, janë lëshuar nga shoqëria A., e cila nuk është e akredituar në Shqipëri⁶, ndërsa certifikata “për sigurimin teknik”, është lëshuar nga shoqëria H., e cila është e akredituar vetëm për certifikimin dhe trajnimin e punonjësve të cilët operojnë me pajisje elektrike;
- BOE E.S. & B.I. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7., germa c), pasi certifikatat e kualifikimit të paraqitura “për sigurimin teknik”, për OE B.I. janë lëshuar nga shoqëria H., ndërsa për OE E.S. janë lëshuar nga shoqëria H., të cilat janë të akredituara vetëm për certifikimin dhe trajnimin e punonjësve të cilët operojnë me pajisje elektrike, ndërsa një pjesë e certifikatave të kualifikimit profesional janë lëshuar nga shoqëria A., e cila nuk është e akredituar në Shqipëri për trajnimin e personelit;
- OE E.S. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.9., pasi nuk ka deklaruar kapacitetin e kamionave/kamionçinave;

⁵ <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

⁶ <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

Konkluzion: Sa më sipër BOE E.S. & B.I. nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE E.S. & B.I., si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues BOE E.S. & B.I., i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën 94,182,418.3 lekë pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga E.H., Kryetar, K.X. dhe E.R., Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 16, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 94,182,418.3 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Ndryshe nga sa ju parashtroi për mungesë dokumentacioni, rezulton se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, shoqëria “E.S.” ShPK, dhe shoqëria “B.S.” ShPK, kanë paraqitur dokumentacionin, si më poshtë citojmë:

Ndryshe nga sa konstatoni në mënyrë të gabuar, se “BOE E.S. & B.I. në pikën 6. të formularit të vetëdeklarimit, në lidhje me përgaditjen e ofertës së pavarur, ka deklaruar (jo), duke mos përmbushur kriterin e pikës 1, gërma gj, si më poshtë:...” , vërtetohet se të dy anëtarët e B.O.E. me të drejtë kanë deklaruar “jo” në pikën 6 të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pasi kanë paraqitur ofertën pjesëmarrëse si Bashkim Operatorësh Ekonomik, përcaktim i cili sqarohet në pikën 7 të Formularit për paraqitjen e ofertës “...(në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit)”.

2. ...Në lidhje me konstatimet Tuaja për përmbushjen e kërkesave për kualifikim të përcaktuara në pikën 2.3.3, dhe 2.3.7 gërma “d”, “f” dhe “h” të Kriterëve të Veçanta për kualifikim në DST, ku shpreheni se:....

Referuar formulimit të kriterit 2.3.3, në DST, rezulton se ndryshe nga sa citohet nga ana Juaj, nuk është kërkuar paraqitja e çertifikatave ISO të lëshuar nga subjekte të akredituar vetëm nga organizmi kombëtar i akreditimit, por edhe nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ku subjekti “R.C.” rezulton të jetë një organizëm ndërkombëtar akreditues, i cili mund të jetë njohur nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet marrëveshjet e lidhura kombëtare apo ndërkombëtare, duke qënë se është një shoqëri që operon në territorin e Rep. së Shqipërisë. Nuk është detyrë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) të hetojë në lidhje me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit në fjalë, por është detyrë e struktura ligjzbatuese kompetente në Republikën e Shqipërisë për kontrollin e këtyre subjekteve, ku ky konstatim nëse është i bazuar (pasi referuar konstatimit Tuaj nuk shpreheni ku bazoheni) mund t’u adresohet atyre nga ana Juaj, detyra e KVO-s është që të kërkojë sqarime dhe dokumenta shtesë operatorëve ekonomik në rast se konstaton parregullsi në lidhje me përmbajtjen dhe formën e paraqitur të dokumentave.

Ndryshe nga sa konstatohen nga ana Juaj në mënyrë të gabuar, vërtetohet se B.O.E. shoqëria “B.I.” ShPK, dhe “E.S.” ShPK, përmbush kriterin për disponimin kanë deklaruar disponimin e të paktën 6 (gjashtë) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për përdorim dhe punime në skela, ku kanë paraqitur

çertifikatat e kërkuara për punonjësit: 1) D.M., 2) B.T., 3) X.T., 4) K.M., 5) I.K., dhe 6) H.I. (Bashkëlidhur observacionit çertifikatat për 6 punonjësit)

Po ashtu, dhe konstatimet Tuaja në lidhje me subjektin "A.", ku pohoni se ky subjekt nuk është i akredituar për lëshimin e çertifikatave të kualifikimit për "punonjës të specializuar dhe çertifikuar për përdorim dhe punime në skela", dhe "përgjegjës për sigurinë dhe shëndetit në punë", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka patur dijeni për këtë fakt, por edhe nëse do të kishte dijeni përsëri nuk mund të merrte vendim për skualifikimin e operatorit ekonomik pjesëmarrës si pasojë e pavlefshmërisë absolute të këtyre akteve (çertifikatave) pa patur në dispozicion një vendim gjykatë të formës së prerë ku të ishte vendosur pavlefshmëria e këtyre akteve të lëshuara nga subjekt/trupi çertifikues A.. Në rast se ky konstatim do të rezultonte i provuar, atëherë nga ana Juaj duhet të merren masa për vënien në dijeni të struktura ligjzbatuese kompetente në Republikën e Shqipërisë për kontrollin dhe marrjen e masave ndaj këtyre subjekteve. Nuk është detyrë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) të hetojë në lidhje me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit në fjalë. Po ashtu, ndryshe nga sa ju dispononi në mënyrë të gabuar, referuar kriterëve në dokumentat e tenderit, nuk është kërkuar që këto çertifikata të jenë lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", por është kërkuar që këto çertifikata të jenë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe në dijenin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton se subjekt/trupi çertifikues A. është një organizëm i akredituar dhe i njohur nga Republika e Shqipërisë.

3. ...Ndryshe nga sa konstatoni në mënyrë të gabuar "OE E.S. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.9., pasi nuk ka deklaruar kapacitetin e kamionave/kamionçinave", rezulton se anëtari i B.O.E., shoqëria "E.S." ShPK, ka deklaruar disponimin e kamionçinave me qera në Seksionin C "Deklaratë "Për disponimin e mjeteve/ pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate" të Formularit Përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe ka paraqitur dokumentacionin për disponimin e tyre si më poshtë citojmë:

Kamionçinë vetshkarkuese "FORD" (AA 327 TK) – dokumentacioni: Kontratë Qeraje Nr.Rep. 4603, Nr.Kol. 1872, datë 19.08.2022 lidhur ndërmjet qeradhënësit: shoqëria "E." ShPK, dhe qeramarrësit: shoqëria "E.S." ShPK, me afat të pacaktuar, Leje Qarkullimi, Çertifikatë e Pronësisë së mjetit, Çertifikatë e Kontrollit Teknik (e vlefshme deri dt. 25.02.2024), Policë Sigurimi (e vlefshme deri dt. 23.02.2023), Faturë për pagesën e taksave vjetore dt.24.02.2022 dhe foto (2-copë). (noterizuar) (fletë 7)

Kamionçinë vetshkarkuese (deri 3.5 ton) "Mercedes Benz" (AA 193 SA) – dokumentacioni: Kontratë Qeraje Nr.Rep. 4603, Nr.Kol. 1872, datë 19.08.2022 lidhur ndërmjet qeradhënësit: shoqëria "E." ShPK, dhe qeramarrësit: shoqëria "E.S." ShPK, me afat të pacaktuar, Leje Qarkullimi, Çertifikatë e Pronësisë së mjetit, Çertifikatë e Kontrollit Teknik (e vlefshme deri dt. 15.12.2023), Policë Sigurimi (e vlefshme deri dt. 14.09.2022), Çertifikatë Nr.178/3, datë 15.12.2021 "Për Transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit" (e vlefshme), Çertifikatë Teknike e Tahogرافit (dt.26.11.2021), Faturë për pagesën e taksave vjetore dt.13.12.2021, Ekstrakt i regjistrit tregtar në emër të shoqërisë "E." ShPK, Ekstrakt i regjistrit tregtar në emër të shoqërisë "E.S." ShPK, dhe foto (2-copë). (noterizuar) (fletë 13)

(Bashkëlidhur observacionit dokumentacioni i cituar)....

Gjithashtu, ndryshe nga sa konstatoni në mënyrë të gabuar "-BOE E.S. dhe B.I. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.9. në DT për mjetet e mëposhtme:

Mjeti me targë AA356SF "kamion me vinç", nuk është deklaruar nga OE B.I.;

Mjeti me targë AA848BN "kamion me vinç", marrë me qera nga shoqëria E., nuk ka bashkëlidhur lejen e transportit;

Mjeti me targë TR4239M, "autobot", marrë me qera nga A.I., nuk është autobot uji, por makinë teknologjike për pastrimin dhe transportin e ujrave të zeza. Gjithashtu nuk ka bashkëlidhur lejen e transportit;" rezulton se:

Për përmbushjen e kriterit të pikës 2.3.9, gërma "a" është kërkuar ndër të tjerash disponimi i automjetit **"Kamion me Vinç"** – jo më pak se 2 copë, për përmbushjen e këtij kriteri rezulton se anëtari i B.O.E "E.S." ShPK, ka deklaruar 2 (dy) automjete të cilat janë kamion me vinç, përkatësisht me targat: **AA 848 BN**, dhe **AA 834 KN**, po ashtu anëtari tjetër "B.S." ShPK, pavarësisht faktit se nuk e ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka paraqitur dokumentacionin në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) për automjetin Kaminon me Vinç me targa **AA356SF**. Pra, edhe nëse anëtari "B.S."

ShPK, nuk do të kishte sjellë dokumentacionin për kamionin e tij, përsëri ky kriter vlerësohet i përmbushur, pasi anëtari i B.O.E “E.S.” ShPK, ka deklaruar dhe disponon 2 (dy) kamiona me vinç. Po ashtu, edhe pse se nuk e ka deklaruar shoqëria “B.I.” ShPK, kamionin me vinç që disponon, **përderisa ai ka paraqitur dokumentacionin e disponimit të tij që në fazën e parë të kualifikimit**, vërtetohet se ai e disponon këtë automjet, dhe mosdeklarimi në rastin konkret është devijim i vogël.

Në lidhje me kamionin me vinç me targa AA 848 BN, ndryshe nga sa konstatohen nga ana Juaj, vërtetohet se është paraqitur Çertifikata Nr.66/2, datë 20.04.2022 “Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit” lëshuar në emër të shoqërisë “E.” ShPK (Bashkëlidhur observacionit dokumentacioni i automjetit bashkë me certifikatën)

Po ashtu, në lidhje me përmbushjen e kriterit të pikës 2.3.9, gërma “a”, ku është kërkuar ndër të tjerash disponimi i automjetit “Autobot uji” – jo më pak se 1 copë, rezulton se krahas automjetit që citohet nga ana Juaj, nga anëtari i B.O.E “B.S.” ShPK, është deklaruar në Seksionin C “Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/ pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” të Formularit Përmbledhës të vetëdeklarimit, dhe është paraqitur dokumentacioni për automjetin “Autobot Uji” me targa: AA 095 VO. Pra, vërtetohet përmbushja e këtij kushti, pasi autoboti disponohet nga anëtari i B.O.E “B.S.” ShPK (Bashkëlidhur observacionit dokumentacioni i automjetit Autobot)

4. ...Observacionet e tjera parashtrajnë të njëjtat argumente dhe kanë bashkëlidhur të njëjtin dokumentacion si për Aktin e konstatimit.....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Sa më sipër pranohet dhe nuk paraqitet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Në LPP dhe në aktet nënligjore në zbatim, cilësohet qartë se të gjitha certifikatat e paraqitura duhet të jenë të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat A. për punonjësit nuk e kanë logon “IAF”, e cila i përket Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit, e njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në lidhje me certifikatat ISO të lëshuara nga R.C. dhe B.C., cilësojmë se certifikatat R.C. e kanë logon “IAF”, ndërsa certifikatat B.C. nuk e kanë logon “IAF”.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit pranohet vetëm për certifikatat R.C..

3. Dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj është i rregullt.

Sa më sipër, kjo pikë e observacionit pranohet.

4. Duke qenë se nga subjekti i atakuar nuk janë paraqitur fakte, argumente dhe dokumente të tjera shtesë, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren apo shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura për Aktin e Konstatimit, **kjo pjesë e observacionit nuk pranohet.**

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Naftë Diesel (D1) dhe Benzine pa plumb”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 260, datë 12.04.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 260, datë 12.04.2022 1. E.A., Jurist 2. F.S., Juriste 3. D.R., Ekonomist	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 261, datë 12.04.2022 1. E.H., Kryetar 2. D.N., Anëtar 3. E.D., Anëtar
4. Lloji i Procedurës: “E hapur - Mallra” prokurim elektronik - M. Kuadër		
5. Fondi Limit: 25,358,313 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: O.E: “R.” ShPK, me vlerë të ofertuar për normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute për litër: 12 lekë pa TVSh/ litër (për të gjithë vlerën e M. Kuadër: 25,358,313 lekë pa TVSh), me M. Kuadër datë 12.05.2022, me afat 24 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: Nuk ka (Është ofertuar për të gjithë vlerën e F. Limit)
8. Data e hapjes së tenderit: 29.04.2022, ora: 10. ⁰⁰	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë (Grand + të Ardhura)	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Nga auditimi, u konstatua si më poshtë:

- Dosja e prokurimit nuk është dorëzuar në arkivën e institucionit, nuk është e inventarizuar dhe dokumentet janë të panumërtuara, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 21.

- Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

Fondi limit: Miratimi i fondeve për këtë prokurim është me VKB nr.130, datë 17.12.2022, “*Për miratimin e buxhetit të vitit 2022*”.

Fondi limit është përlllogaritur nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, i përbërë nga A.P., D.N. dhe F.M..

Relacioni për llogaritjen e fondit limit është mbajtur me nr. 208/1 prot., datë 20.01.2022.

Urdhëri i prokurimit është nënshkruar nga Dega e Thesarit.

Për llogaritjen e fondit limit është përdorur metoda “Studim i tregut”, duke marrë tre oferta. Për llogaritjen e sasisë së nevojshme është marrë për bazë kërkesa nga njësitë e varësisë dhe sasisë e konsumuara në periudhat e mëparshme.

Kriteret e vlerësimit: Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 13.04.2022, i cili është i paprotokolluar.

- Në pikën 2.2.3. në DT, është kërkuar “*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2021 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR*”. Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, pika 2;

- Në pikën 2.3.1. në DT, kërkohet “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 40 % të vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet*”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 40, “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 4.

Këto kriterë, janë të tepërta, të paargumentuara, kufizojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë dhe nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 39 “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.A., F.S. dhe D.R..

Vlerësimi i ofertave: - Procesverbali për vlerësimin e ofertave është me nr. 5, datë 06.05.2022, pa numër protokolli;

- Me nr. 2019 prot., datë 11.05.2022 është hartuar Formulari i njoftimit të OE të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, nga ku u konstatua se në tender ka marrë pjesë 1 OE, “R.”, i cili është kualifikuar dhe është shpallur fitues, me ofertë 25,358,313 lekë pa TVSh.

- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO me shkresën nr. 2038 prot., datë 12.05.2022, është miratuar prej tij dhe është hartuar në përputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik.

- Marrëveshja kuadër ndërmjet AK Bashkia Mat dhe OE "R." është lidhur me nr. 2041 prot., datë 12.05.2022, me afat 24 muaj, përkatësisht për vlerën 25,108,313 lekë naftë Diesel D1 dhe 250,000 lekë për benzinë pa plumb;

- Me urdhërin nr. 339, me nr. 2060 prot., datë 13.05.2023, nga titullari i institucionit është zëvendësuar z. E.R. si personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës;

- Minikontrata e parë është hartuar me nr. 2061 prot., datë 13.05.2022, për vlerën 14,000,000 lekë pa TVSh;

- Minikontrata e dytë është hartuar me nr. 155 prot., datë 12.01.2022, për vlerën 11,358,312.5 lekë pa TVSh;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE R. nuk ka plotësuar shtojcën 8, pika 1.dh) në lidhje me deklarin për shlyerjen e detyrimeve vendore;

- OE R. nuk plotëson pikën 2.3.6. në DT, pasi nuk ka paraqitur Vërtetim Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar;

- Certifikata e pronësisë për objektin 64.3 m², nuk është në emër të shoqërisë R. ShPK, me NUIS K.....G, por në emër të z. A.R. dhe nuk ka akt marrëveshje apo kontratë ndërmjet tyre;

Konkluzion: Sa më sipër OE R. nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE R., si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 2.

Duke shpallur fitues OE R., i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **25,358,313 lekë** pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga E.H., Kryetar, D.N. dhe E.D., Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 16, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 25,358,313 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

...Observacionet e paraqitura parashtrojnë të njëjtat argumente dhe kanë bashkëlidhur të njëjtin dokumentacion si për Aktin e konstatimit....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Duke qenë se nga subjekti i atakuar nuk janë paraqitur fakte, argumente dhe dokumente të tjera shtesë, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren apo shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura për Aktin e Konstatimit, **kjo pjesë e observacionit nuk pranohet.**

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale të ndryshme ndërtimi”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 495, datë 30.06.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 495, datë 30.06.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 496, datë 30.06.2022
4. Lloji i Procedurës: “E hapur - Mallra” <i>prokurim elektronik</i> - M. Kuadër	1. E.A., Jurist 2. E.D., Inxhinier 3. D.R., Ekonomist	1. E.H., Kryetar 2. R.K., Anëtar 3. D.T., Anëtare
5. Fondi Limit: 20,833,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: B.O.E: “S.” dhe “S.G.” ShPK, me ofertë: 20,723,092 lekë pa TVSh, me M. Kuadër datë 05.08.2022, me afat 24 muaj.	7. Diferenca me fondin limit: 110,241 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 21.07.2022, ora: 10. ⁰⁰	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë (<i>Grand + të Ardhura</i>)	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Nga auditimi, u konstatua si më poshtë:

- Dosja e prokurimit nuk është dorëzuar në arkivën e institucionit, nuk është e inventarizuar dhe dokumentet janë të panumërtuara, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 21.

- Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

Fondi limit: Miratimi i fondeve për këtë prokurim është me VKB nr. 130, datë 17.12.2022, “*Për miratimin e buxhetit të vitit 2022*”.

Fondi limit është përlllogaritur nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, i përbërë nga E.L., M.S. dhe F.M..

Nevoja për këtë blerje është nisur nga Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Mat, me shkresën nr. 893 prot., datë 24.02.2022.4

Relacioni për llogaritjen e fondit limit është mbajtur me nr. 2526/1 prot., datë 28.06.2022.

Urdhëri i prokurimit është nënshkruar nga Dega e Thesarit.

Nga shqyrtimi i listës së mallrave, u konstatua se ka artikuj të cilët nuk janë “*materiale ndërtimi*”, por “*pajisje, vegla pune dhe materiale të ndryshme konsumi*”, të cilat duhet të prokurroheshin me procedurë të posaçme;

Për llogaritjen e fondit limit është përdorur metoda “*Studim i tregut*”, duke marrë tre oferta.

Për llogaritjen e sasisë së nevojshme është marrë për bazë kërkesa nga njësitë e varësisë.

Kriteret e vlerësimit: Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 05.07.2022, i cili është i paprotokolluar.

- Në pikën 2.2.1., në DT, kërkohet “*Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë sa 100% e vlerës së përlllogaritur e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurrohet*”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa c.

- Në pikën 2.2.3. në DT, është kërkuar “*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin 2021 për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR*”. Sa më sipër nuk është formuluar drejt, pasi në LPP dhe në rregullat e prokurimit publik janë të përcaktuara qartë se në cilat raste lejohet përjashtimi nga detyrimi për të paguar

taksat, tarifat, sigurimet shoqërore, shëndetësore, etj. AK duhet të kërkojë vërtetime për shlyerjen e të gjitha llojeve të detyrimeve me organet tatimore vendore apo qendrore, pa u kufizuar me vitin aktual apo me selinë e OE, duke pasur parasysh se OE operojnë edhe jashtë vendit ku kanë selinë dhe kanë historik shumëvjeçar. Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2.

- Në pikën 2.3.4. në DT, kërkohet që “Operatori ekonomik pjesëmarrës me qëllim magazinimin e materialeve objekt prokurimi, duhet të disponojë 1 (një) njësi magazinimi në pronësi ose me qera/ huapërdorje, me vendndodhje jo më larg se 15 (pesëmbëdhjetë) km nga qendra e Njesisë Administrative Burrel/ Bashkia Mat...”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe e paargumentuar, pasi AK do të blejë mallra, të cilët do të transportohen nga OE dhe nuk ka pse të disponojë një ambient brenda territorit të Bashkisë Mat. Nëpërmjet kësaj kërkesë, AK ka përjashtuar nga konkurrenca OE të cilët nuk janë të licencuar në Bashkinë MAT;

- Në pikën 2.3.6. në DT, kërkohet që “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimitse ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 3 (tre) shoferë të mjeteve të rënda....”. Po kështu është kërkuar në pikën 2.3.7., që të vetëdeklarohen edhe automjetet. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe e paargumentuar, pasi OE është i detyruar nga LPP dhe Rregullat e prokurimit publik që të deklarojë në Shtojcën 8 personelin dhe mjetet e punës;

Këto kritere, janë të tepërta, të paargumentuara, kufizojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë dhe nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.A., E.D. dhe D.R..

Vlerësimi i ofertave: Procesverbali për hapjen dhe zhvillimin e procedurës është me nr. 3, datë 21.07.2022, pa numër protokolli;

- Procesverbali për vlerësimin e procedurës është me nr. 4, datë 27.07.2022, pa numër protokolli;

- Me nr. 3329 prot., datë 02.08.2022 është hartuar Formulari i njoftimit të OE të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, nga ku u konstatua se në tender ka marrë pjesë 1 OE, “BOE S. dhe S.G.”, i cili është kualifikuar dhe është shpallur fitues, me ofertë 20,723,092 lekë pa TVSh;

- Raporti përmbledhës është përcjellë titullarit nga KVO me shkresën nr. 3362 prot., datë 04.08.2022, është miratuar prej tij dhe është hartuar në përpunje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik;

- Marrëveshja kuadër ndërmjet AK Bashkia Mat dhe BOE S. dhe S.G. është lidhur me nr. 3374 prot., datë 05.08.2022, me afat 24 muaj, për vlerën 20,723,092 lekë pa TVSh;

- Me urdhërin nr. 582, me nr. 3516 prot., datë 17.08.2023, nga titullari i institucionit është zëvendësuar z. E.R. si personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës;

- Minikontrata e parë është hartuar me nr. 3517 prot., datë 17.08.2022, për vlerën 7,916,052 lekë pa TVSh, me afat deri në datën 31.12.2022;

- Me shkresën nr. 5628/2 Prot., datë 30.12.2022, afati i minikontratës së parë është shtyrë deri në datën 30.06.2023 dhe me shkresën nr. 2463/2 Prot., datë 27.06.2023, afati i minikontratës së parë është shtyrë deri në datën 17.07.2023;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- Asnjë nga partnerët e BOE S. dhe S.G. nuk ka plotësuar shtojcën 8, pika 1.dh) në lidhje me deklarinimin për shlyerjen e detyrimeve vendore;

- Asnjë nga partnerët e BOE S. dhe S.G. nuk plotëson pikën 2.1.1. në DT, për certifikatën ISO 9001, pasi certifikatat e paraqitura janë nga shoqëria B. V., e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë;⁷
- OE S. nuk plotëson pikën 2.2.1. në DT, pasi xhiro e paraqitur për asnjë nga vitet nuk është në vlerën e kërkuar. Për vitin 2019 është 7,169,285 lekë, për vitin 2020 është 2,975,135 lekë dhe për vitin 2021 është 1,113,426 lekë;
- Asnjë nga partnerët e BOE S. dhe S.G. nuk plotëson pikën 2.2.2. në DT, pasi nuk ka paraqitur Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, për bilancet;
- OE S.G. nuk plotëson pikën 2.2.3. në DT, pasi nuk ka paraqitur vërtetime për pagesat e taksave vendore nga të gjithë vendet ku ushtrojnë aktivitetet. OE S.G. ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Tiranë dhe Klos, por nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Burrel, për adresën “Diber Komsi GERMAN Shesh depozitimi prane ish –UFK Burrel, Fshati German, Koms, zona kadastrale 1705 dhe numer pasurie 238/33”;

Miruar nga V.K.M Nr. 519, Datë 7.11.1994 **KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME**

Vol. 20 Fq. 44
--> Vijn nga: Vol. 17 Fq. 104

A- SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 1326 NR.PASURISE 7/243 --> Vijn ne: Vol. Fq. deri ne Vol. Fq.

Indeksi i Hartes : BU-G-3 **PERFUNDIMTARE (data)** 04/03/2011

Adrea e pasurise : Rrethi MAT Q BURREL P Sh K Ap.

B – SEKSJONI I PERSHKRIMIT TE PAURISE

Lloji i pasurise: TRUALL Brenda V.K.N. : Jo-> (Po), Ref: PL.RREG.

Sip.Totale e Pasuris	Nga Sip.Totale:sa truall	Nga Sip.Totale:sa ndertes	Per pjesen e perbashket:
1 <u>1657</u> m2	1 <u>1657</u> m2	1 <u>812</u> m2	<u>PALLAT</u>
Ref <u>07756</u>	Ref <u>07756</u>	Ref <u>07756</u>	Kuota e pjesmarries

Pershkrim i Veçante
NE KETE PASURIBEN PJESE DHE PAS
7/105 VOL 17 FQ 104
ME DATE 13/03/2012 U KRYE
RIVLERESIMI I PASURISE NE
VLEFTEN 44'640'749 LEKE ME NR
.0008216 REF

- OE S. nuk plotëson pikën 2.3.1. në DT, për punë të ngjashme në një vlerë sa 30% të vlerës së fondit limit, pasi vlera e mallrave të cilët do të mbulohen nga kjo shoqëri është 20% e totalit, vlerë e cila nuk mbulohet me faturat e paraqitura sipas kërkesës në DT;
- BOE S. dhe S.G. nuk plotëson pikën 2.3.4. në DT, pasi prona e paraqitur si magazinë, me nr. pasurie 7/243, në zonën kadastrale nr. 1326, volumi 20, faqe 44, nuk është magazinë, por e llojit “pasuri e përbashkët, pallat”

Konkluzion: Sa më sipër BOE S. dhe S.G. nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE S. dhe S.G., si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues BOE S. dhe S.G., i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën 20,723,092 lekë pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga E.H., Kryetar, R.K. dhe D.T., Anëtarë.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 16, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 20,833,333 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP dhe anëtarët e KVO.

Rëndësia: E lartë.

⁷ <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

...Observacionet e paraqitura parashtrojnë të njëjtat argumente dhe kanë bashkëlidhur të njëjtin dokumentacion si për Aktin e konstatimit.....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Duke qenë se nga subjekti i atakuar nuk janë paraqitur fakte, argumente dhe dokumente të tjera shtesë, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren apo shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura për Aktin e Konstatimit, **kjo pjesë e observacionit nuk pranohet.**

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje makinerie teknologjike për pastrim”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 262, datë 12..04.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 262, datë 12..04.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 263, datë 12.04.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur e thjeshtuar	1. E.A., Kryetar; 2. F.S., Anëtar; 3. D.R., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. R.K., Anëtar 3. D.N., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,833,000 lekë	6. Oferta fituese: OE 'L., me ofertë 4,833,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 24.05.2020, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës	7. Diferenca me fondin limit: 3,807,091 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 09.05.2022	9. Burimi i Financimit: Grant 2022- 3,750,000 lekë Të ardhurat 2022- 1,083,000lekë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për marrjen në dorëzim.

Situata: Hartimi i fondit limit: Për hartimin e fondit limit nga titullari i Autoriteti Kontraktor është ngritur urdhëri nr. 202 prot., datë 24.03.2022. Komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike është i përbërë nga E.R., Drejtor/Drejtorja e Shërbimeve, Kryetar, A.P., specialist/ sektori i infrastrukturës dhe F.M., specialiste/ sektori juridik dhe PP, Anëtarë.

Komisioni për përcaktimin e fondit limit ka mbajtur relacionin për përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Makineri teknologjike për pastrim”. Gjithashtu është bazuar në 3 oferta konkretisht nga subjektet: “G.”, me Nipt: K.....G; “A.K.”, me Nipt: K.....B; dhe “I.M.”, me Nipt : K.....G.

Njësia e Prokurimit ka administruar në dosjen e procedurës 3 oferta të paraqitura nga operatorët ekonomik. Komisioni për vlerësimin e çmimit të mallrave pjesë e kësaj procedure komisioni i hartimit të fondit limit ka vepruar në përputhje me nenin 13 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Studimi paraprak i tregut”.

Hartimi i kriterëve: Me urdhër prokurimi të Kryetarit të Bashkisë Mat nr. 262, datë 12.04.2022, me nr. 1608 prot., është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. E.A., z. F.S. dhe z. D.R. në procedurën “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fondin limit 4,833,000 lekë pa TVSh, nga grant dhe të ardhurat 2022.

Me urdhërin nr. 263, datë 12.04.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Makineri teknologjike për pastrim”, i cili përbëhet nga E.H., R.K. dhe D.N..

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues, OE L. ShPK me NIPT K.....L me ofertën ekonomike 4,833,000 lekë pa TVSh.

Zbatimi i kontratës: Me urdhërin nr. 441 datë 20. 06. 2022 të titullarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve.

Objekti i prokurimit është bërë hyrje në magazinë sipas dokumentit flete-hyrje nr. 29 datë 13.07.2022. Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve i përbërë nga z. A.P., z. G.B., z. S.M., ka mbajtur procesverbalin në datë 13.07.2022 dhe proces verbalin 16.06.2022 për marrjen në dorëzim të mjeteve Makineri teknologjike për pastrim me kapacitet 11 (ton) dhe 21 (ton).

- Marrja në dorëzim e kontratës nuk është bërë në përputhje me objektin e furnizimit të kontratës, neni 7, ku thuhet se , mallrat dhe shërbimet e lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në certifikatën e marrjes në dorëzim të mallit komisioni i marrjes në dorëzim të mjeteve është shprehur se ka konstatuar se makineria teknologjike e lëvruar nga kontraktuesi është në përputhje me specifikimet teknike dhe sasitë e përcaktuara në kontratën e furnizimit, por pa i dokumentuar ato në kundërshtim me nenin 7 të kontratës nr. 2196 prot., datë 24.05.2022, kontratë e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Mat dhe OE L. ShPK Grupi i auditimit kërkoi vendosjen në dispozicion të lejeve të qarkullimit të mjeteve të cilat nuk ishin të bashkangjitura në certifikatën e marrjes në dorëzim, ku nga shqyrtimi i dokumentacionit u krahasua Aneksi nr. 3 i kontratës me nr. 2196 prot., datë 24.05.2022, (specifikimet teknike) me lejet e qarkullimit, ku rezultoi se në lejen e qarkullimit të mjetit me kapacitet 20 ton fuqia motorike është 163 kë, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar fuqia motorike 210-230 kë.

Sa më sipër janë veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 prot., datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 42, 47 dhe 50.

Gjithashtu janë veprime në kundërshtim me nenin 7 nënpika 7.1 e kontratës nr. 2196 prot., datë 24.05.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Mat dhe OE L. ShPK

- Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 11, datë 17.11.2023

Kriteri: UMF nr. 30 prot., datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 42, 47 dhe 50.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 7,622,920 lekë pa TVSh.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor në marrjen në dorëzim, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e komisionit për marrjen në dorëzim.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga strukturat e Bashkisë Mat të mbahet në vëmendje zbatimi i kontratës në zbatim të kuadrit rregullator të fushës. Mallrat dhe shërbimet e lidhura me to që do të furnizohen duhet të merren në dorëzim sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të automjeteve”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 175, datë 09.03.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 175, datë 09.03.2022	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Nr. 176, datë 09.03.2022
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Marrëveshje Kuadër	1. E.A., Kryetar; 2. E.D., Anëtar; 3. D.R., Anëtar	1. E.H., Kryetar 2. R.K., Anëtar 3. D.N., Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,916,666 lekë	6. Oferta fituese: OE I.M., me ofertë 8,916,666 lekë pa TVSh, me kontratë datë 09.10.2020, me afat 12 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit	7. Diferenca me fondin limit: ska
8. Data e hapjes së tenderit: 07.04.2022	9. Burimi i Financimit: Grant + të ardhura 2022	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK: Jo	13. Përgjigje Ankesës nga KPP: Jo

Titulli i gjetjes: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik, në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit.

Situata: Hartimi i fondit limit: Për hartimin e fondit limit, nga titullari i Autoriteti Kontraktor është ngritur urdhëri nr. 175, datë 09.03.2022. Komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike është i përbërë nga E.A. Drejtor/Përgjegjës Prokurimesh Publike, Kryetar, E.D., specialist dhe D.R., Anëtarë.

Hartimi i kriterëve: Me urdhër prokurimi të Kryetarit të Bashkisë Mat nr. 175 prot., datë 12.04.2022, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. E.A., z. E.D. dhe z. D.R. për procedurën “Procedurë Marrëveshje Kuadër”, me fondin limit 8,916,666 lekë pa TVSh, nga granti dhe të ardhurat 2022.

Nga auditimi konstatohet se nga NJP, kriteret nuk janë vendosur sipas Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006, neni 4, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e prokurorimit, e përbërë nga E.A., Kryetar, E.D., dhe D.R., Anëtarë.

Vlerësimi i Ofertave: Me urdhërin nr. 176, datë 09.03.2022 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të automjeteve”, i cili përbëhet nga z. E.H., z. R.K. dhe z. D.N..

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues, OE I.M. PF, me NIPT K37721967G me ofertë ekonomike 8,916,666 lekë pa TVSh.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 16, datë 17.11.2023

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, të trajtuara te situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Prokurim i fondeve publike në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik për vlerën 8,916,666 lekë pa TVSh.

Shkak: Moszbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJP.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga personat e atakuar është paraqitur observacioni i protokolluar në Bashkinë Mat me nr. 4727/13, datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/14 prot., datë 29.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

... Në lidhje me procedurën e prokurimit: “E Hapur - Shërbime”, prokurim elektronik – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj, me Nr. REF-21936-03-15-2022, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të automjeteve” dhe me fond limit të marrëveshjes kuadër, në vlerën: 8 916 666.6 (tetë milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 07.04.2022, ora: 10.⁰⁰, ju keni konstatuar se, citojmë: “Nga auditimi konstatohet se nga NP, kriteret nuk janë vendosur sipas ligjit nr.9573, datë 03.07.2006, neni 4, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to.” Ndryshe nga sa ju parashtroni, ky nen përcakton detyrimin e subjekteve juridike të cilët ushtrojnë veprimtari autoriparim, që të regjistrohen pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor ku subjekti ka selinë, dhe nuk i shtrin efektet ndaj të tretëve. Njësia e Prokurimit ka kërkuar që OE ekonomik duhet të disponojë leje nga QKL për pikë servisi, pra për vërtetimin se OE ushtron aktivitet në riparimin e automjeteve dhe disponon pikë servisi. Fakti se në kërkesat për kualifikim të DT, nuk është kërkuar i gjithë dokumentacioni që duhet të disponojë një subjekt i cili ushtron veprimtarinë e riparimeve të automjeteve, nuk do të thotë që njësia

e prokurimit ka përgjegjësi, por e rëndësishme është që të jenë kërkuar ato kërkesa për kualifikim, që nëpërmjet plotësimit të tyre të vërtetohet se një operator ekonomik pjesëmarrës vërtet ka aftësitë profesionale dhe kapacitetet për kryerjen e shërbimit objekt kontrate.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Argumentet e paraqitura nuk përmbajnë fakte dhe dokumente të tjera shtesë, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë fazës së auditimit në terren apo shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura për Aktin e Konstatimit.

Sa më sipër, kjo pjesë e observacionit nuk pranohet.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Në zbatim të kësaj nënpike të Programit të auditimit, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë, nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2022.

Nga grupi i auditimit, në bazë të nivelit të materialitetit, riskut cilësor dhe kohës në dispozicion, u gjykuan për t'u audituar kontratat për punë publike, pasqyruar në Aneksin Z1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit, me vlerë totale 1,299,423,634 lekë pa TVSh ose 1,559,308,361 lekë me TVSh, mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimin, zbatimin e afateve të kontratave si dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”.		
Zbatimi i kontratës		Mbikëqyrja
Lidhja e kontratës: Nr. 848 prot, datë 19.02.2021	Afati: Fillon ditën e dorzimit të sheshit të ndërtimit dhe përfundon pas 30 muajve.	Kontrata: Nr. 1326 prot., datë 19.03.2021
Vlera e kontratës: 1,242,743,699 lekë me TVSh	Periudha e garancisë: 24 muaj.	Mbikëqyrës: I. ShPK me licencë profesionale MK 2406/1 dhe administrator L.L.
Kontraktori: BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK	Punimet kanë filluar me datë 17.03.2022	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 9,950,400 lekë me TVSh
	Punimet kanë përfunduar	

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në punimet e ndërtimit të kryera në objektin “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit, Bashkia MAT”.

Situata: Nga kontrolli i punimeve në terren, u konstatua se:

1. Nga kontrolli i situacionit për ndërtimin e seksionit “Depo e re kullë”, u konstatua se janë situacionuar kallëpe për soletë. Ky zë pune është përfshirë në çmimin e betonit dhe nuk duhet të llogaritet dy herë.

- Kallëpe për soleta b/a 530 m² x 1,500 lekë/ m² = 795,000 lekë

- Kallëpe për kollona b/a 10 m² x 1,500 lekë/m² = 15,000 lekë

Nga kontrolli në kantier tek depo kullë, është situacionuar skelë metalike h=35 m. Kjo skelë nuk u konstatua në terren.

- Skelë metalike me tubo h=35m 992 m² x 19,392 lekë/m² = 19,236,864 lekë

- Shuma 20,046,864 lekë

2. Nga kontrolli i projektit të ndërtimit, bazuar mbi profilet gjatësorë të linjave të shpërndarjes, u konstatuan diferenca në disa linja. Janë librezuar dhe situacionuar tubacione më shumë se sa është në projektin e përditësuar, konkretisht:

➤ **F.V. tub PE 100 RC Pn 10 DN 50 mm.** Janë situacionuar 9205 ml. Në profilet gjatësorë rezulton se këto gjatësi janë 8200 ml. Diferenca e gjatësisë është 1005 ml e cila duhet t'i zbritet situacionit, së bashku me paketën gjërmim, mbushje.

- F.V. tub PE 100 RC Pn 10 DN 50 mm 1005 ml x 850 lekë/ml =	854,250 lekë
- Gjërmim 1000 ml x 0.6m x 1m x 500 lekë/m ³ =	300,000 lekë
- Transport 1000 ml x 0.6m x 1m x 400 lekë/m ³ =	240,000 lekë
- Mbushje me gurë kave 1000 ml x 0.6m x 1m x 1,169 lekë/m ³ =	701,400 lekë
- Shuma =	2,095,650 lekë

➤ **F.V. tub PE 100 RC Pn 10 DN 355 mm.** Në situacion 790 ml, sipas projektit 475 ml. Diferenca 315 ml

- F.V tub PE 100 RC Pn 10 DN 355 mm 315 ml x 24,200 lekë/ml =	7,623,000 lekë
- Gjërmim 315 ml x 0.6 x 1.1 x 500 lekë/m ³ =	103,950 lekë
- Gjërmim dheu me krah 315 x 0.6 x 0.1 x 1,000 lekë/m ³ =	18,900 lekë
- Transport 315 x 0.6 x 1.1 x 400 lekë/m ³ =	83,160 lekë
- Mbushje me gurë kave 315 x 0.6 x 1.1 x 1,169 lekë/m ³ =	243,035 lekë
- Shuma =	8,072,045 lekë

➤ **F.V. tub PE 100 RC Pn 10 DN 125 mm.** Në situacion 2180 ml, sipas projektit 2087 ml. Diferenca 93 ml.

- F.V tub PE 100 RC Pn 10 DN 125 mm 93 ml x 2,900 lekë/ml =	269,700 lekë
- Gjërmim, mbushje, transport 93 ml x 0.6x 2,069 =	115,450 lekë
- Shuma =	385,150 lekë

➤ **F.V. tub PE 100 RC Pn 10 DN 110 mm.** Në situacion 2815 ml, sipas projektit 2765 ml. Diferenca 50 ml.

- F.V tub PE 100 RC Pn 10 DN 110 mm 50 ml x 1,422 lekë/ml =	71,100 lekë
- Gjërmim, mbushje, transport 50 ml x 0.6m x 2,069 lekë =	62,070 lekë
- Shuma =	133,170 lekë

➤ **F.V. tub PE 100 RC Pn 10 DN 90 mm.** Në situacion 10670 ml, sipas projektit 9034 ml. Diferenca 1636 ml.

- F.V tub PE 100 RC Pn 10 DN 90 mm 1636 ml x 1,000 lekë/ml =	1,636,000 lekë
- Gjërmim, mbushje, transport 1636 ml x 0.6 m x 2,069 lekë/m ³ =	2,030,930 lekë
- Shuma =	3,666,930 lekë

➤ Nga kontrolli i situacionit dhe i librezave të masave, u konstatua se gjërmim për tubacion DN 50 janë situacionuar 11922.3 ml, ndërkohë që gjatësia e tubacioni DN 50 është 9989 ml. Kjo situatë është nuk është e saktë pasi këto gjatësi duhet të ishin të barabarta. Diferenca 1933 ml.

- Gjërmim me eksakvator DN 50 1933 ml x 0.6 m x 500 lekë/m ³ =	579,900 lekë
- Gjërmim me eksakvator DN 63 1063 ml x 0.6m x 500 lekë/m ³ =	318,900 lekë
- Shuma =	898,800 lekë

➤ **Zëri i punës F.V tub PE 100 RC Pn 16 DN/OD 63 mm SDR 17** nuk u konstatua në projektin e zbatimit me 960 ml x 1,122 lekë/ml = 1,109,658 lekë. |

- Gjërmim, mbushje, transport 960 ml x 0.6 x 2,069 lekë/m ³ =	1,191,744 lekë.
- Shuma =	2,301,402 lekë

Vlera totale e punimeve të pakryera për pikën 3 është **17,553,147 lekë**

3. Nga kontrolli në terren për seksionin “Ndërtimi i linjave dhe vendosja e matësave të ujit”, u konstatua se në pallatet ku ishin vendosur matësat, nuk ishin lyer muret ashtu si janë situacionuar si dhe zëri i punës veshje me pllaka majolike nuk rezultonte i kryer.

- Lyerje me bojë hidroplastike cilësi e parë 40 m² për një pallat. 40 m² x 350 lekë/m² = 14000 lekë për një pallat.

- Sipas situacionit janë 260 pallate: 14,000 lekë x 260 pallate = 3,640,000 lekë

- Veshje pllaka majolike 0.6 m² x 2,500 lekë/m² x 260 = 390,000 lekë

- Totali = 4,030,000 lekë

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 14, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 848 prot., datë 19.02.2020; Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve, nr. 1326 prot., datë 19.03.2021.

Ndikimi/Efekti: Shuma 41,630,011 lekë (20,046,864 + 17,553,147+ 4,030,000) lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Mat.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **41,630,011 lekë** (20,046,864 + 17,553,147+ 4,030,000) nga BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 848 prot, datë 19.02.2021, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga Mbikëqyrësi I. ShPK është paraqitur observacioni datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/11 prot., datë 26.01.2024 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. ... nga observacionet e radhës të vëna në dispozicion të grupit të auditimit janë paraqitur disa foto për të tre linjat si për diametrin 400 mm, atë 300 mm dhe 200 mm.

2. ... bazuar mbi VKM 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave të tyre të publikuara në fletoren zyrtare janë publikuar Manualet 1 deri në 4 për cmimet e materialeve të ndërtimit. Kjo VKM nuk ka të publikuar asnjë analizë zërit 3.248 të punimeve me qëllim se çfarë përfshihet në cmimin e zërit të punës. Referuar qëndrimin të grupit të auditimit pika 2 bëjmë me dije se si duket VKM nr.629 në foto nuk përmban analizë të detajuar cmimi por njësinë, cmimin, shpërgjithshme, fitim dhe total.

3. ... skela me lartësi 35 m ka qënë e ndërtuar përeth gjithë objektit dhe pas përfundimit të strukturës kjo skelë është cmontuar për arsye se pengon proceset e tjera të punimeve si lyerje etj. Skela në kohën e auditimit nga ana juaj ka qënë e cmontuar pasi ishin në fazën e lyerjes së depos dhe pengonte në procesin e lyerjes.

4. ... për sa argumentojmë kundërshtojmë konstatimet e grupit të auditimit për pikën III të projekt-raportit. Të gjitha tubacionet e zbatuara në terren janë sipas planimetrisë në projektin ,preventivit të punimeve ,kërkesës të autoritetit kontraktor për furnizimin me ujë të shtëpive periferike dhe preventivit të punimeve të rishikuar dhe janë zbatuar në terren. Shpresojmë që librezat e masave dhe vizatimeve të paraqitura të jenë të mjaftueshme për të pranuar kundërshtimet e bëra nga ana jonë.

5. ... punimet e montimit të kasetave kanë përfunduar në dhjetor të vitit 2022 dhe pas këtij procesi është bërë suvatimi dhe lyerja me bojë. Nga dhjetori 2022 deri në nëntor 2023 janë disa muaj dhe smund të jetë si ditën e parë si dhe është dëmtuar nga banorët dhe agjentët atmosferikë. Përsa i përket pllakave majolike e kanë kundërshtuar banorët pasi kërkojnë pllaka si ato ekzistuese por është e pamundur sepse nuk ka në treg të tilla pasi janë model i vjetër. Punimet janë në proces dhe do riparohen defektet që do konstatohen. Në observacionin e radhës janë vënë në dispozicion disa foto të punimeve të lyerjes së shkallëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Observacioni merret në konsideratë dhe reflektohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
2. Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë koment pasi në Manualin nr. 3 për zërin e punës 3.248 “*Struktura monolite betoni*” nënzhëri i fundit për llogaritjen e çmimit është “Kallëpe”, që tregon se në çmimin total është llogaritur edhe ky nënzë dhe nuk mund të situacionohet edhe si zë më vete.
3. Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë koment pasi çmontimi i skelës është procesi i fundit në radhën e punimeve të ndërtimit si dhe ajo është e nevojshme dhe për zërin e punës lyerje. Si mund të realizohet lyerja në lartësi të mëdha pa ndihmën e skelës?! Gjithashtu nuk është vënë në dispozicion asnjë imazh që të vërtetojë se përreth gjithë objektit ka qënë e montuar dhe skela 35 m e lartë. Grupi i auditimit kërkon që këto prova t’i vihen në dispozicion nëse ekzistojnë. Fotot e vëna në dispozicion nga ana juaj nuk faktojnë zërin e punës “F.V skelë metalike më tubo h-35m”.
4. Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë kundërshti, pasi edhe nga ana jonë ato diferenca në gjatësi linjash për tubacione më seksion tërthor të ndryshëm kanë dalë si ballafaqim i planimetrisë, profileve gjatësorë dhe tërthorë me sasi të situacionuara. Ashtu si ju edhe grupi i auditimit është bazuar tek projekti duke e krahasuar me situacionin nr. 7. Për më tepër, këto sasi edhe në librezat e masave janë hedhur vetëm si sasi totale dhe jo sipas piketave. Nëse këto diferenca në gjatësitë e tubacioneve nuk saktësohen se ku janë vendosur, nga cila piketë deri tek cila piketë, sipas seksioneve përkatëse, grupi i auditimit nuk do të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit. Ju shtoni se janë bërë disa linja shtesë me kërkesë të autoritetit kontraktor për disa shpi në periferi .Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë pretendim pasi këto punime shtesë janë jasht projektit të miratuar ose duhet të reflektoheshin në projekt të ndryshuar duke rimodeluar dhe sasi të që do të ndryshonin për zërat e punimeve shtesë.
5. Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë kundërshti, për arsye se lyerja e pjesës së suvatimit të ri dallohej qartë që nuk ishte realizuar. Nëse ju keni ndonjë provë ose imazh që të vërtetojë se ato janë lyer dhe janë dëmtuar me kalimin e kohës, mund ta vini në dispozicion. Përsa i përket zërit “*Veshje me pllaka majolike*” është situacionuar 0.6m² në 260 pallate gjë e cila nuk u konstatua në terren.Me fotot e vëna në dispozicion në observacionin e radhës grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë pasi u konstatua që ato shkallë pallatesh në momentin e kontrollit ishin të palyera ndërkohë si zë pune ishte situacionuar.

2. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Ndërtimi i rrjetit të KUZ blloku “Drita 1”, “Drita 2” dhe Lagjia e re, qyteti Burrel”.

Zbatimi i kontratës		Mbikëqyrja
Lidhja e kontratës: Nr. 2875 prot, datë 10.07.2020	Afati: Fillon ditën e dorzimit të sheshit të ndërtimit dhe përfundon pas 6 muajve.	Kontrata: Nr. 3702 prot., datë 03.09.2020
Vlera e kontratës: 86,104,998 lekë me TVSh	Periudha e garancisë: 12 muaj.	Mbikëqyrës: B.O.E. “A.S.” ShPK dhe H.C. me nr. Licence MK 2692/2 dhe 2720/2 Administrator A.N. dhe G.P..
Kontraktori: BOE C. ShPK dhe K. ShPK	Punimet kanë filluar me datë 15.09.2020 Punimet kanë përfunduar	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 1,627,320 lekë me TVSh.

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në punimet e ndërtimit të kryera në objektin “Ndërtimi i rrjetit të KUZ blloku “Drita 1”, “Drita 2” dhe Lagjia e re, qyteti Burrel”.

Situata: Nga kontrolli i dosjes teknike dhe kontrollet e realizuara në terren për objektin “Ndërtimi i rrjetit të KUZ blloku “Drita 1”, “Drita 2” dhe Lagjia e re, qyteti Burrel”, u konstatua se për zërin e punës “F.V. tuba të brinjëzuar HDPE SN 8 Dn=250 mm”, në situacionin përfundimtar janë situacionuar 661.7 ml. Nga profilet gjatësorë dhe planimetritë, duke iu referuar edhe zbatimit në terren, u konstatua se gjatësia e këtij tubacioni është 621.7 ml. Diferenca është 40 ml për tubacion të brinjëzuar Dn = 250 mm.

- F.V. Tub i brinjëzuar Dn = 250 mm, 40 ml x 1,500 lekë/ml = 60,000 lekë;

- Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m^3 , me kanale deri në 2 metër tokë e zakonshme, kategoria e III me shkarkim në mjet $(1.16) \times 1.2 \text{ m} = 1.4 \text{ m}^2 \times 40 \text{ ml} = 56 \text{ m}^3 \times 350 \text{ lekë/m}^3 = 19,600 \text{ lekë}$;
- Gërmim me krahë, tokë e zakonshme + transport 5 km, $1.16 \text{ m} \times 0.5 \text{ m} \times 40 \text{ m} = 23.2 \text{ m}^3 \times 1,000 \text{ lekë/m}^3 = 23,200 \text{ lekë}$;
- Transport dheu deri në 5 km $(23.2 \text{ m}^3 + 56 \text{ m}^3) \times 250 \text{ lekë/m}^3 = 19,800 \text{ lekë}$;
- Shtresë rere $1 \text{ m} \times 0.7 \text{ m} \times 40 \text{ m} = 28 \text{ m}^3 \times 1,500 \text{ lekë} = 42,000 \text{ lekë}$;
- Nënshtrësë zhavorri $1 \text{ m} \times 0.4 \text{ m} \times 40 \text{ m} = 16 \text{ m}^3 \times 1,300 \text{ lekë/m}^3 = 20,800 \text{ lekë}$;
- Mbushje dhe ngjeshje me zhavorr $1 \text{ m} \times 1.1 \text{ m} \times 40 \text{ m} = 44 \text{ m}^3 \times 1,080 \text{ lekë/m}^3 = 47,520 \text{ lekë}$;
- Shtresë cakëlli mbeturinë kave $t = 20 \text{ cm}$ me kanale deri në 2 m përhapur dhe ngjeshur me makineri $1 \text{ m} \times 1 \text{ m} \times 40 \text{ m} = 40 \text{ m}^3 \times 900 \text{ lekë/m}^3 = 36,000 \text{ lekë}$.

- Totali = 268,920 lekë

Nga kontrolli i dosjes teknike rezulton se zëri i punës “Shtresë cakëlli mbeturinë kave $t=20 \text{ cm}$ përhapur e ngjeshur me makineri” nuk konstatohet në imazhet fotografike apo dokumentacionin përkatës që të justifikojë këtë zë pune, konkretisht për Bllokun Drita 1 janë situacionuar $5,992.7 \text{ m}^2$, me vlerë $5,393,400 \text{ lekë}$, për Bllokun Drita 2 janë situacionuar 2950.8 m^2 , me vlerë $2,655,720 \text{ lekë}$ dhe për Bllokun Lagjia e re janë situacionuar 2413 m^2 , me vlerë $2,171,700 \text{ lekë}$.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 15, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 2875 prot., datë 10.07.2020; Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve, nr. 3702 prot., datë 03.09.2020.

Ndikimi/Efekti: Shuma 268,920 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Mat.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **268,920 lekë** nga BOE C. ShPK dhe K. ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 2875 prot, datë 10.07.2020, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”. Përsa i përket zërit “Shtresë çakulli, mbeturinë kave $t = 20 \text{ cm}$, përhapur e ngjeshur me makineri”, imazhet e vëna në dispozicion duhet të saktësohen nëse janë pjesë e planimetrisë së këtij projekti.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga Mbikëqyrësi A.S. ShPK është paraqitur observacioni pa numër dhe datë, i administruar në KLSH me nr. 768/10 prot., datë 25.01.2024 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

... Subjekti pretendon se zëri i punës se mesiperm “Shtresë cakëlli mbeturinë kave $t=20\text{cm}$ përhapur e ngjeshur me makineri” është realizuar gjatë ndërtimit sipas dimensioneve, specifkimeve të projektit dhe preventivit të kontratës në objekt gjë e cila e verifikojnë fotografite që do të bashkelidhim të cilat nuk ju janë vënë në dispozicion me dosjen e punimeve, procesverbalet ,certifikatat e cilesisë se materialeve gjë për të cilën sipërmarrësi i punimeve edhe është likujduar por dua të argumentoj se realizimi i ndërtimit të këtij objekti është në vitin 2021 gjë e cila ka një kohë relativisht të gjatë gjë e cila ka sjelle dhe rindertimin e disa objekteve të tjera me shtresa asfaltike sic konstatohen dhe në terren aktualisht. Nga observacioni i radhës është vënë në dispozicion Referuar qëndrimin të grupit të auditimit i cili nuk merr në konsideratë komentin e mësipërm nëse nuk faktohet nga ana jonë që këto imazhe janë pjesë e planimetrisë së projektit më poshtë po ju paraqesim fotografitë e dërguara të pozicionuara sipas gjurmës së linjave të projektit.



Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit merr në konsideratë pjesërisht pretendimin e subjektit pasi për imazhet e vëna në dispozicion për zërin e punës “Shtresë cakëlli mbeturinë kave $t=20\text{ cm}$ e përhapur dhe ngjeshur me makineri” duhet të verifikohet nëse gjurma e planimitrise së projektit të miratuar përputhet me këto imazhe. Nga observacioni i radhës, me kërkesë të grupit të auditimit është vënë në dispozicion pozicionimi i të gjitha fotove sipas planimetrisë së projektit të miratuar.

Ky argumentim merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

3. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstrukcion shkolla 9 vjecare “Mustafa Gjestila”, Burrel”.

Zbatimi i kontratës		Mbikëqyrja
Lidhja e kontratës: Nr. 4392 prot, datë 14.10.2022	Afati: Fillon ditën e dorzimit të sheshit të ndërtimit dhe përfundon pas 9 muajve.	Kontrata: Nr. 4994 prot., datë 16.12.2022
Vlera e kontratës: 117,440,762 lekë me TVSh	Periudha e garancisë: 12 muaj.	Mbikëqyrës: B.O.E. “D.” me nr. Licence MK 1767/12, me Administrator V.T..
Kontraktori: OE U. ShPK	Punimet kanë filluar me datë 21.12.2022 Punimet kanë përfunduar	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 1,466,588 lekë me TVSh

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në punimet e ndërtimit të kryera në objektin “Rikonstrukcion shkolla 9 vjecare “Mustafa Gjestila”, Burrel”.

Situata: Nga kontrolli i dosjes teknike dhe kontrollet e realizuara në terren për objektin “Ndërtimi i rrjetit të KUZ blloku “Drita 1”, “Drita 2” dhe Lagjia e re, qyteti Burrel”, u konstatua se për zërat e punës:

- An F.V. paketë për furnizimin e naftës e kompletuar copë 1 me vlerë 67,000 lekë nuk është në objekt pasi kaldaja është me peletë dhe jo me naftë.

- F.V. enë zgjerimi për kaldajën me karakteristika teknike nuk është në objekt me vlerë 56,600 lekë.

Sipas specialistit që vuri në punë kaldajën është vetëm një enë zgjerimi dhe jo dy si janë situacionuar. Ena ka të dhënat e mëposhtme:

Autoklavë me membranë, Presion min/max 3/10 bar, Kapacitet 24 litra, De = 325 mm, H = 420 mm.

- Çati vendi e zakonshme me HD 8 m, tjegulla vendi. Nga matjet rezulton se çatia në planin e rrafshët ka një sipërfaqe 960 m^2 . Duke marrë parasysh edhe faktin se nuk jemi në plan të rrafshët por në plane të pjerrëta, kjo sipërfaqe duhet jetë më e madhe se ajo e rrafshët. Nqs kjo sipërfaqe zmadhohet me 20%, sipas nivelit të pjerrësisë, rezulton një koeficient 1.2., pra $960\text{ m}^2 \times 1.2 = 1152\text{ m}^2$. Janë situacionuar $1,202\text{ m}^2$ Diferenca është 50 m^2 .

$50\text{ m}^2 \times 5,600\text{ lekë/m}^2 = 280,000\text{ lekë}$

- Totali = 280,000 lekë

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 13, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve, nr. 4392 prot., datë 14.10.2022; Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve, nr. 4994 prot., datë 16.12.2022.

Ndikimi/Efekti: Shuma 280,000 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Mat.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **280,000 lekë** nga OE U. ShPK.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga Mbikëqyrësi D. ShPK është paraqitur observacioni nr. 6 prot., datë 25.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 768/12 prot., datë 26.01.2024 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Pretendimet e paraqitura janë të njëjta me ato të paraqitura për Akt Konstatimin.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Sa më sipër, duke qenë se nuk janë paraqitur fakte dhe dokumente të reja, Grupi i auditimit **nuk e merr në konsideratë këtë observacion.**

4. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksioni i gjimnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat”.

Zbatimi i kontratës		Mbikëqyrja
Lidhja e kontratës: Nr. 4272 prot, datë 10.10.2022 Kontraktori: “U.” ShPK	Afati: Fillon ditën e dorzimit të sheshit të ndërtimit dhe përfundon pas 6 muajve.	Kontrata nr. 4993 prot., datë 16.11.2022
Vlera e kontratës: 113,018,902 lekë me TVSh	Periudha e garancisë: 12 muaj.	Mbikëqyrës: I. ShPK me licencë profesionale MK 1706/12 me administrator F.V.
Kontraktori: BOE E.S. ShPK & B.I. ShPK	Punimet kanë filluar me datë 18.11.2022	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 1,430,762 lekë me TVSh
	Punimet kanë përfunduar	

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në punimet e ndërtimit të kryera në objektin “Rikonstruksioni i gjimnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat”.

Situata: Nga kontrolli i punimeve të kryera në objektin “Rikonstruksioni i gjimnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat”, rezultoi se:

- Janë situacionuar veshje fasade me polisterol kompakt jeshil $t = 5 \text{ cm} + \text{rrjetë} + \text{suva}$ 1055 m²
Sipërfaqja e fasadave të objektit është 942.5 m², zbriten sipërfaqet e dritareve 123.5 m² dhe sipërfaqja neto e fasadave është 817 m. Diferenca 1055 m² – 817 m² = 238 m x 2800 lekë/m² = 666,400 lekë.

- Lyerje fasade me bojë hidroplastike importi cilësi e I. Diferenca që rezultoi tek polisteroli do të llogaritet edhe për zërin lyerje: 238 m² x 431 lekë/m²=102,578 lekë.

- Veshje e terreneve sportive me tartan (këndi gjimnastikor). Nga matjet rezultoi se këndi gjimnastikor ka një sipërfaqe 350 m². Janë situacionuar 413 m². Diferenca 63 m² x 6800 lekë/m² = 428,400 lekë.

- Totali = 1,077,831 lekë

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 12, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; Kontrata e sipërmarrjes

së punimeve, nr. 4272 prot., datë 10.10.2022; Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve, nr. 4993 prot., datë 16.11.2022.

Ndikimi/Efekti: Shuma 1,077,831 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Mat.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **1,077,831 lekë** nga BOE E.S. ShPK & B.I. ShPK.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Mbikëqyrësi I. ShPK është paraqitur observacioni me nr. 212 prot., datë 22.11.2023, i administruar në KLSH me nr. 768/3 prot., datë 23.11.2023 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Subjekti pretendon se Pas shqyrtimit të informacionit dhe verifikimit të matjeve, konstatojmë se ka një pasaktësi në llogaritjen e sipërfaqes së veshjes së fasadës, pasi sipërfaqja e veshjes me polisterol është 1056 m² sipas librezes se paraqitur dhe matjeve faktike ne terren. Jane zbritur sipërfaqet e dritareve ne volume 80 %. Dhe jane shtuar ne sipërfaqe volume te punimeve per dekoret e dritareve. Te cilat paraqesin veshitresi ne pune dhe konsumim material.

2. Pas një rishikimi të kujdesshëm të informacionit dhe llogaritjeve tona, konstatojmë se ka një pasaktësi në llogaritjen e sipërfaqes së tartanit. Në lidhje me shpjegimin e situatës në terren, ka një pasaktësi në përcaktimin e sipërfaqes së shtuar me tartan dhe strukturave të tjera sportive. Sipas llogarive tona dhe matjeve të bëra në terren, sipërfaqja e përgjithshme e realizuar është 407 m², jo 350 m² siç është raportuar.

Sipërfaqja e shtruar me tartan përfshin fushën e jashtme sportive me dimensione 24.3 x 14.9 = 362 m², pistën e vrapimit me dimensione 6 x 1.5 = 9 m² dhe këndin e paraleleve 6 x 6 = 36 m². Kjo bën një total të realizuar prej 407 m², Diferenca 413 m² - 407 m² = 6 m², e cila llogaritet me një vlerë prej 6800 lek/m², rezulton në 40,800 lek, me shume e situacionuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Grupi i auditimit merr pjesërsisht në konsideratë këtë koment, duke pranuar që në llogaritjen e polisterolit të fasadave duhet të shtohen dhe sipërfaqet e dekorit të dritareve. Sipërfaqja e dritareve është 123.5 m². Sipërfaqja e kontureve dekorative është 0.3 e sipërfaqes së dritareve, që llogaritet 0.3*123.5 = 37 m². Kjo sipërfaqe duhet ti zbritet diferencës së sipërfaqes e cila është mbajtur në Akt Konstatim: 238 m² -37 m² = 201 m². Për zërin “Veshje me polisterol” kemi 201 m² * 2800 lekë/m² = 562,800 lekë. Për zërin “lyerje fasade me bojë” 201 m² * 431 lekë/m² = 86,631 lekë.

2. Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë këtë koment, pasi në observacionin e vënë në dispozicion duket vetëm fusha e shtruar njëtrajtësisht me tartan, ndërsa në fotot e tjera të vëna në dispozicion tregon vetëm dy pjesë të vogla të trajtuara me tartan, të cilat nuk kuptohen. Ju pretendoni se janë shtruar pista e vrapimit dhe këndi i paraleleve. Ju lutemi na vini në dispozicion prova të cilat tregojnë që janë shtruar 36 m² për këndin e paraleleve dhe 9 m² për pistën e vrapimit.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;

2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Përzgjedhja e lejeve ndërtimit për auditim është bërë në bazë risku duke u bazuar në kriteret si më poshtë:

- Leje ndërtimi me sipërfaqe mbi 250 m²;

- Kategoria e funksionit “shërbime”, të cilat në rastin e Bashkisë Mat janë kryesisht në sektorin e bujqësisë.

Viti 2019

Në vitin 2019 janë miratuar gjithsej 5 leje ndërtimi, nga të cilat dy janë me funksion social-ekonomike dhe 3 janë me funksion banimi. Për këto leje ndërtimi, janë lëshuar certifikata përdorimi për 4 subjekte. Në formë tabelore janë paraqitur në Aneksin LN1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

1. Për lejen e ndërtimit me nr. 100 datë 30.04.2019 në emër të z. A.S. për objektin me funksion thertore rezulton se:

- Me vendimin nr. 90, datë 22.02.2019 është miratuar leja e zhvillimit për pasurinë me nr. 468/25, zona kadastrale 1325, në pronësi të z. A.S. dhe A.S., me sipërfaqe 6849 m² e llojit “arë”;
- Me shkresën nr. 1123 datë 02.05.2018, AZHT ka kërkuar që të merret mendimi i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave sipas VKM nr. 283/2018 dhe të vendoset kusht në “*Lejen e Zhvillimit*”, ku të përcaktohet detyrimi i konvertimit të tokës para lëshimit të dokumentit të lejes së ndërtimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Me shkresën nr. 158 prot., datë 14.02.2019, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është shprehur për përputhshmërinë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të vitit 2019 është përlogaritur në 5% të vlerës së preventivit 25,340,535 lekë, si kategori “objekte/njësi shërbimi”;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është shprehur për parregullsi dhe mangësi në dokumentacionin e ngarkuar në platformën “e-leje”.

Në këto rrethana, miratimi i lejes së zhvillimit është bërë me kushtin që aplikimit për lejen e ndërtimit t’i bashkëngjiten:

- Leja Mjedisore nga Ministria e Mjedisit;
- Projekti Teknik i Zbatimit;
- Të plotësohen kushtet e zbatimi sipas VKM-së nr. 283 datë 01.04.2015 “*Për përcaktimin e tipave rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësorë dhe blegtorale, në tokë bujqësore*”, i ndryshuar, lidhur me distancën nga rruga, distancën nga banesa më e afërt e veçuar nga qendra urbane, si dhe me lartësinë e objektit.

Nga auditimi rezultoi se:

- Certifikata e përdorimit nr. 196, datë 19.03.2021 nënshkruar nga z. A.G. dhe z. A.M. është miratuar pa administruar lejen mjedisore të subjektit dhe në mungesë të akteve të kontrollit për realizimin e punimeve, veprime në kundërshtim me nenin 42 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, ku përcaktohet se “*certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor*”.
- Certifikata e pronësisë datë 24.07.2018 është shoqëruar me kartelat e pasurisë të cilat rezultojnë të parifreskuara, për të paktën 3 muajt e fundit nga aplikimi për leje.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të vitit 2019 është përlogaritur në masën 5% të vlerës së preventivit 25,340,535 lekë, si kategori “objekte/njësi shërbimi” dhe jo në masën 1%. Si rrjedhojë, subjekti duhet të paguante shumën prej 253,405 lekë dhe jo 1,267,030 lekë.

2. Për lejen e ndërtimit me nr. 115, datë 14.06.2019, për zhvilluesin O.N., për objektin “*Strukturë 1 kat, me destinacion thertore*”, me sipërfaqe ndërtimi 463.1 m², rezulton se:

- Certifikata e pronësisë datë 09.04.2019, me sipërfaqe trualli 1200 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 427 m² është e pa rifreskuar. Sikurse rezulton në truallin përkatës ka objekt ekzistues, përfituar me leje legalizimi;
 - Në sistemin e-leje administrohet leja zhvillimore nr. 109, datë 06.05.2019, në bazë të së cilës është miratuar leja e ndërtimit nr. 115, që ka rezultuar e pavlefshme sipas Drejtorisë së Urbanistikës së Bashkisë Mat, për arsye se zhvilluesi nuk ka filluar punimet e ndërtimit brenda afatit një vjeçar, bazuar në nenin 40 të Ligjit nr. 107/2017 “Për planifikimin e territorit”;
 - Zhvilluesit përkatës i është miratuar një leje ndërtimi e re nr. 150 datë 02.08.2020 për të njëjtin objekt, strukturë 1 kat, destinacion thertore me sipërfaqe trualli 1,200 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 463.1 m²;
 - Me shkresën nr. 3510 prot., datë 30.04.2019, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural shprehet se meqenëse objekti po ndërtohet në tokë truall dhe jo në tokë bujqësore, nuk përbën objekt shqyrtimi për VKM nr. 283/2015,
 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit shprehet se aplikimi duhet t’i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
 - Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, me Urdhërin nr. 320 datë 15.05.2020 “Për likuidimin e vendimit të komisionit të apelimit tatimor Bashkia Mat”, subjektit i është kthyer shuma prej 1,626,249 lekë (ka paguar 2,032,810 lekë e përlogaritur gabimisht në masën 5% nga 1%), paguar më tepër për lejen e ndërtimit nr. 115.
- Nga auditimi u konstatua se:
- Gjurma e ndërtimit bie mbi një objekt ekzistues me sipërfaqe 427 m², përfituar me leje legalizimi. Në dokumentacionin e administruar në sistemin e-leje, në aplikimin nr. 212 datë 22.04.2021 “Për fillimin e punimeve”, nuk administrohet akti teknik për prishjen e objektit ekzistues, veprim në kundërshtim me pikën 8 të kushteve të lejes së ndërtimit ku përcaktohet se “zhvilluesit i vihet kusht që me njoftimin e punimeve të dorëzojë aktin teknik të prishjes të objektit ekzistues nga eksperti i licencuar”;
 - Me aplikimin nr. 277 datë 17.03.2022 është miratuar certifikata e përdorimit nga z. A.G. dhe z. A.M. në mungesë të aktit teknik të prishjes së objektit ekzistues nga eksperti i licencuar dhe në mungesë të akteve të kontrollit, veprime në kundërshtim me nenin 42 pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”.

Viti 2020

Për vitin 2020, rezulton se janë bërë gjithsej 12 aplikime për leje ndërtimi, për të cilat janë lëshuar certifikata përdorimi vetëm për 3 aplikime, me sipërfaqe më të vogël se 250 m² dhe që janë të natyrës “rikonstruksion+shtesë”, si dhe aplikime për ndryshim funksioni. Në formë tabelore janë paraqitur në Aneksin LN2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Viti 2021

Për vitin 2021, janë bërë gjithsej 18 aplikime për leje ndërtimi dhe janë lëshuar certifikata përdorimi për 7 aplikime, nga të cilat 6 janë të natyrës “rikonstruksion+shtesë kati” dhe vetëm 1 aplikim është objekt i ri me funksion stallë për gjedhë me sipërfaqe gjurme ndërtimi 1003 m². Në formë tabelore janë paraqitur në Aneksin LN3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për lejen e ndërtimit me nr. 202, datë 12.05.2021 në emër të zhvilluesit z. I.M., për objektin “Stallë për gjedhë 1 kat + hangar 1 kat + zyra administrate 2 kate + mur rrethues”, me sipërfaqe totale ndërtimi 1,003 m², rezultoi se:

- Me vendimin nr. 177, datë 31.12.2020 është miratuar leja e zhvillimit për pasurinë me nr. 139/12, ZK 3959, në pronësi të zhvilluesit, me sipërfaqe 5000 m² arë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë është përlogaritur sipas paketës fiskale të vitit 2021, në masën 3% për objektet bujqësore;
- Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Agjencisë për Eficencën e Energjisë nuk është dhënë konfirmimi për miratimin e lejes, në

zbatim të VKM nr. 283 datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”;

- Me shkresën nr. 11518 datë 29.12.2020, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka dhënë vlerësimin e përputhshmërisë me arsyetimin se projektpropozimi përfshihet pjesërisht në tipologjinë e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e objekteve bujqësore dhe ka kërkuar kryerjen e korrigjimeve;
- Me shkresën nr. 1358 prot., datë 14.04.2021, për miratimin e lejes së ndërtimit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka kërkuar pritjen e konfirmimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar;
- Me shkresën nr. 2991 prot., datë 12.04.2021, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është refuzuar sërish dhënia e pëlqimit me arsyetimin se objekti “zyra dhe muri rrethues” nuk përfshihet në tipologjinë e objekteve sipas VKM-së dhe se nuk plotësohet kushti i pikës (a) se distanca minimale nga kufiri i pronës duhet të jetë 20 m;
- Me shkresën nr. 589 prot., datë 06.04.2021, Agjencia e Eficencës së Energjisë shprehet se përsa i përket godinës për zyra administrative ajo duhet të pajiset detyrimisht edhe me certifikatën paraprake të performancës së Energjisë, ndërsa për hangarin dhe stallën domosdoshmëria e certifikatës paraprake të performancës së Energjisë do të përcaktohet në bazë të raportit të auditimit.
- Për sa më sipër, Agjencia për Efiçencën e Energjisë i ka sugjeruar Bashkisë Mat refuzimin e lejes së ndërtimit pasi është në kundërshtim me Ligjin nr. 124/2015 “Për efiçencën e energjisë”, Urdhërin nr. 5, datë 12.01.2021, Ligjin nr. 116/2016 “Për efiçencën e energjisë në ndërtesa” dhe VKM nr. 536, datë 08.07.2020;
- Leja e ndërtimit është dhënë në njësinë strukturore 8/82, e cila sipas pasaportës së kësaj njësie të përcaktuar në Planin Vendor të Bashkisë Mat lejon vetëm ndërtime të llojit “bujqësi kultivuese”;
- Mungon leja mjedisore për ushtrimin e aktivitetit;
- Certifikata e përdorimit nr. 368, datë 23.05.2023 është lëshuar në mungesë të akteve të kontrollit, veprime në kundërshtim me nenin 42 pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”.

Viti 2022

Për vitin 2022 janë miratuar gjithsej 20 leje ndërtimi, nga të cilat 8 u përkasin ndërtimeve në kuadër të investimeve të kryera nga Bashkia Mat ndërsa 12 nga subjektet private. Në formë tabelore janë paraqitur në Aneksin LN4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Për lejen e ndërtimit me nr. 309 datë 14.09.2022 për “B.M.” me sipërfaqe 1091m², në emër të subjektit “V.” ShPK, rezultoi se:

- Objekti pozicionohet në pasurinë nr. 410/7 me sipërfaqe 3,090 m² truall dhe 72 m² ndërtesë. Kartelat e pasurisë së paluajtshme për seksionin “D” të qirave/përdorimit dhe “E” të kufizimeve/vendimeve të gjykatave nuk janë të rifreskuara 3 muajt e fundit (26.10.2021) nga data e aplikimi për leje ndërtimi (01.07.2022);
- Në kundërshtim me pikën 8.4., të VKM-së nr. 22, datë 12.1.2018 “Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, subjekti nuk ka marrë miratimin paraprak të projektidesë nga komisioni vlerësues, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin;
- Planvendosja e objektit bujtinë prek pjesërisht një objekt ekzistues dhe leja e ndërtimit nuk ka përfshirë si kusht prishjen e objektit të vjetër, veprim në kundërshtim me nenin 11, germa ç) të VKM-së nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Titulli i gjetjes: Mbi procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit.

Situata: Në katër raste, miratimi i lejeve të ndërtimit është bërë pa administruar dokumentacionin detyrues dhe pa marrë konfirmimin nga institucionet përgjegjëse për planifikimin e territorit, si më poshtë:

- Për lejen e ndërtimit me nr. 100 datë 30.04.2019, për zhvilluesin “A.S.” për objektin me funksion thertore, rezulton se mungon leja mjedisore, kartelat e pasurisë të janë parifreskuara, për të paktën 3 muajt e fundit nga aplikimi për leje;
- Për lejen e ndërtimit me nr. 150, datë 02.08.2020 për zhvilluesin “O.N.”, për objektin “*Strukturë 1 kat, me destinacion thertore*”, me sipërfaqe ndërtimi 463.1 m², rezulton se gjurma e ndërtimit bie mbi një objekt ekzistues me sipërfaqe 427 m², përfituar me leje legalizimi. Në aplikimin nr. 212 datë 22.04.2021 “*Për fillimin e punimeve*”, nuk administrohet akti teknik për prishjen e objektit ekzistues, veprim në kundërshtim me pikën 8 të kushteve të lejes së ndërtimit;
- Për lejen e ndërtimit me nr. 202, datë 12.05.2021 në emër të zhvilluesit “I.M.”, për objektin me sipërfaqe totale ndërtimi 1003 m² rezulton se nuk është dhënë konfirmimi për miratimin e lejes nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Agjencisë për Eficencën e Energjisë;
- Për lejen e ndërtimit me nr. 309 datë 14.09.2022 për “B.M.” me sipërfaqe 1091 m² në emër të subjektit “V.” ShPK, rezultoi se subjekti nuk ka marrë miratimin paraprak të projektidesë nga komisioni vlerësues, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin. Planvendosja e objektit bujtinë prek pjesërisht një objekt ekzistues.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 6, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 107/2014 “*Për planifikimin e territorit*”. VKM nr. 408/2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, VKM nr. 22/2018 “*Për miratimin e kriteve të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij*”.

Ndikimi/Efekti: Miratimi i lejeve të ndërtimit në mungesë të dokumentacionit ligjor, sjell si pasojë cënimin e kushteve të zhvillimit të territorit.

Shkaku: Moszbatimi i dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Mat, sektori i urbanistikës, të marrë masa që kartelat e pasurive të paluajtshme të jenë të rifreskuara, për të paktën 3 muaj para datës së aplikimit si dhe për lejet e ndërtimit në fushën e agroturizmit, të cilat prekin objekte ekzistuese, të verifikojë në terren procesin e shembjes.

Titulli i gjetjes: Mbi procedurat e lëshimit të certifikatave të përdorimit.

Situata: Në tre raste, për lejet e ndërtimit me sipërfaqe mbi 250 m² për subjektet “O.N.”, “I.K.” dhe “A.S.”, janë lëshuar certifikatat e përdorimit në mungesë të akteve të kontrollit.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 6, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 42 pika 3.

Ndikimi/Efekti: Lëshimi i certifikatave të përdorimit pa akte kontrolli sjell si pasojë mungesën e verifikimeve nëse objekti ka respektuar kushtet e lejes dhe projektin përkatës të ndërtimit.

Shkaku: Moszbatimi i dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Mat, sektori i urbanistikës dhe IMTV, të marrin masa për kryerjen e akteve të kontrollit periodik për lejet e ndërtimit mbi 250 m², si parakusht për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

2.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Mat është i organizuar në nivel qendër dhe Njësie Administrative sipas tabelës së mëposhtme:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV)	Emër Mbiemër	Profesioni/Arsimi
Kryeinspektor	S.D.	Jurist
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	V.B.	Inxhinierë mjedisi
Inspektor i Mbrojtjes së Territorit	B.F.	Arsim i Mesëm + Akademia e Sigurisë së Rendit Publik

Sa më sipër konstatohet se:

Arsimimi i kryeinspektorit të IMTV Bashkia Mat është në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, ndërsa arsimimi i Inspektorit B.F. nuk është konform kërkesës së nenit 11 të këtij ligji, sipas të cilit kërkohet që kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të ndryshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

Nga të dhënat e IMTV, Bashkia Mat, vënë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se: Në total shuma e gjobave rezulton në vlerën 5,170,325 lekë, nga e cila janë arkëtuar gjithsej 400,000 lekë.

Lidhur me praktikat ligjore të mbajtura nga IMTV, paraqiten rastet specifike të praktikave (procesverbale konstatimi, vendim i dënimit me gjobë, vendim i prishjes së objektit) dhe arsytet e mospërputhjes.

Aktet e mbajtura (procesverbale të kundërvajtjes, vendime të gjobave, vendime të prishjeve të objekteve të kundërligjshëm), të vëna në dispozicion nga IMTV Bashkia Mat janë paraqitur në Aneksin IMTV1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Vlerat e arkëtuara dhe të palikuiduara, për të cilat janë bërë kërkesa në Gjykatën Administrative për lëshimin e titullit ekzekutiv me qëllim vjeljen e gjobave, janë paraqitur në Aneksin IMTV2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

Janë mbajtur proves-verbale konstatimi dhe masa administrative për rastet e konstatuara në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar.

2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor nga ky inspektorat dhe nuk ka evidence shpresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve. Mosmarrja e masave nga IMTV është në kundërshtim me përcaktimet e të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 52, germa “e” dhe neni 53, pika 6.

Titulli i gjetjes: Mangësi gjatë kryerjes së detyrave funksionale nga IMTV dhe mos përputhshmëria e emërimit të inspektorëve për shkak të arsimit.

Situata: 1. Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Bashkia Mat, u konstatua se formimi arsimor i një inspektori nuk është konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Konkretisht nga të dhënat e marra nga drejtoria e burimeve njerëzore, është konstatuar se z. B.F. është diplomuar në Akademinë e Sigurisë dhe Rendit Publik dhe është emëruar si inspektori i IMTV. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, neni 11.

2. Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV-së Bashkia Mat, u konstatua se puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m², të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijojnë aktivitetin e ndërtimit në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare, të ndaluara ose të mbrojtura. Mosmbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Mosmarrja e masave nga IMTV është në kundërshtim me përcaktimet e të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 17.11.2023

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 “Inspektimi”, dhe Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, neni 11.

Ndikimi/Efekti: Vijueshmëria e fenomenit të ndërtimeve jashtë lejeve të miratuara dhe atyre pa leje ndërtimi, e cila ka sjellë dhe mund të sjellë pasoja sociale, ekonomike, po ashtu në kundërshtim me planet e miratuara urbanistike e mjedisore.

Shkaku: Mosmarrja në kohë e masave me qëllim parandalimin e fenomenit të ndërtimeve pa leje. Rekrutimi i punonjësve (inspektorë) pa formimin e duhur arsimor sipas kërkesave të ligjit. Mosbashkëpunimi ndërsektorial me DPZHKT për aplikantët për leje zhvillimore e ndërtimore.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: 1. Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masa që IMTV të ketë bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepaq apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare, pyje, lumenj apo zona të mbrojtura, si dhe të marrë masa për parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe monitorimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

2. Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masa që plotësimi i pozicioneve të punës për inspektorët e IMTV-së, të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, lidhur me arsimin përkatës.

Sa më sipër, për mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi z. S.D., me detyrë Kryeinspektor i IMTV për periudhën 24.10.2019 deri më datë 31.12.2022 dhe z. A.M., me detyrë Kryetar Bashkie, për emërimin në pozicionin e Inspektorit të IMTV pa arsimin përkatës.

2.7. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit

1. Në lidhje me ankesën e Federatës Shqiptare të Futbollit, administruar në KLSH me nr. 531/8 datë 07.06.2023, me objekt zbatimin e detyrimit të Ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin”, sipas të cilit “Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi”, nga Bashkia Mat rezulton se janë ndjekur procedurat ligjore për shitjen e klubit sportiv, si më poshtë:

- Në muajin shtator 2022 ka filluar procedurat për kontraktimin e një eksperti vlerësues të licencuar për vlerësimin e asetëve të klubit;
- Në muajin mars 2023, pas përgatitjes së materialeve, është paraqitur në Këshillin Bashkiak projektvendimi për shitjen e klubit, ku për shkak të mungesës së kuorumit nuk u miratua në atë datë, por në mbledhjen pasardhëse në prill, me VKB nr. 28 datë 25.04.2023;
- Në datën 31.07.2023 është zhvilluar ankandit për shitjen e klubit, por ka dështuar, pasi nuk është paraqitur asnjë ofertues.

Më hollësisht, në lidhje me procedurat dhe ecurinë e tyre, në rend kronologjik rezulton se:

- Në bazë të Urdhërit të Ankandit nr. 286, datë 03.07.2023, shkresa nr. 2575 prot., datë 03.07.2023 të Titullarit të Autoritetit Shitës, është ngritur Njësia e Ankandit për procedurën e Hapur të Ankandit Publik, me objekt “Shitja e kuotave në masën 100% të kapitalit të bashkisë Mat në shoqërinë “K.B.” ShPK”, me REF-Nr. UA. 286, datë 03.07.2023;
- Vlera fillestare e ankandit prej 9,163,939 lekë pa TVSh, u bazua në llogaritjen e kryer nga Komisioni i Posaçëm i Vlerësimit për llogaritjen e vlerës fillestare të Ankandit për shitjen e 100% të kuotave, në zbatim të Urdhërit të Brendshëm nr. 263, datë 21.06.2023. Ky komision, me shkresën nr. 2416/1 prot., datë 30.06.2023 “Relacion mbi vlerësimin/përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit publik me objekt: “Shitja e kuotave në masën 100% të kapitalit të bashkisë Mat në shoqërinë “K.B.” ShPK”” miratuar nga Titullari i Autoritetit Shitës, përcaktoi vlerën fillestare të Ankandit;
- Dokumentet e ankandit u hartuan dhe miratuan nga anëtarët e Njesisë së Ankandit sipas Procesverbalit të mbajtur më datë 05.07.2023, duke caktuar datën 31.07.2023 ora 11:00 si datë të hapjes dhe zhvillimit të ankandit;
- Njoftimi për Ankandin Publik u botua në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 61, të datës 10 Korrik 2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), në zbatim të nenit 23 të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të Ankandit Publik”, i ndryshuar, Kreu I, pika 1.2., germa “a”, dhe Kreu III, pika 3.3.1., gërma “a”.
- Deri në datën 31.07.2023 ora 11:00 nuk ishte paraqitur asnjë kandidat blerës i interesuar për të marrë dokumentet e ankandit sipas njoftimit të kryer.

2. Nga ana e banorëve të fshatit Madhesh është përcjellë një ankesë, administruar në mënyrë elektronike në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ku shprehet shqetësimi mbi çështjet si:

- Mungesa e investimeve në infrastrukturë, ujë vaditës, rrugë;
- Mungesa e mbështetjeve me subvencione për fermerët;
- Refuzimi i dhënies së lejeve për investim në turizëm dhe agro-turizëm, si pjesë e AZHBR-së;
- Përfshirja e fshatit Madhesh në taksat e gjelbërimit, pastrimit, tokës, ndërkohë që sipas pretendimit të banorëve, nuk ofrohet asnjë shërbim në këtë drejtim;
- Mungesa e investimeve në peshkim dhe konflikti me organizatën e peshkimit, që sipas pretendimit funksion prej vitit 2019 dhe nuk e njeh si të tillë;
- Mospërfshirja e banorëve të Madheshit në takime dhe dëgjesa publike;

Në lidhje me këto pretendime të banorëve të fshatit Madhesh, nga auditimi rezultoi se:

- Për çështjet e subvencioneve për fermerët, dhënien e lejeve për agroturizëm dhe mungesën e investimeve për peshkim, vendimmarrja u përket institucioneve në nivel qendror, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AZHBR etj.;
- Përjashtimi i fshatit Madhesh nga taksat e tokës, gjelbërimit dhe pastrimit apo mungesa e investimeve në infrastrukturë është pjesë e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak;
- Në lidhje me mospërfshirjen e banorëve të fshatit Madhesh në takime dhe dëgjesa publike, nga ana e Bashkisë Mat njoftimet për të marrë pjesë në dëgjesa publike publikohen në faqen e saj të internetit dhe pjesëmarrja është e hapur.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, përfshirë funksionimin e auditimit të brendshëm, rezulton se Bashkia Mat ka shfaqur mangësi në drejtim kryesisht të menaxhimit të riskut dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, duke mos zbatuar plotësisht Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”:

- Rregullorja e brendshme është e papërditësuar dhe mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive;
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut për vitin 2022 (është hartuar për vitin 2023), si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut;
- Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT, për pasojë mungon gjurma e auditimit;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm, e përbërë nga dy punonjës, është në pamundësi për të ushtruar një punë audituese me efektivitet për të mbuluar fushat me risk të aktivitetit në Bashkinë Mat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 12-22 të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të re për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Mat në lidhje me objektivat dhe ndarjen e detyrave për çdo punonjës dhe drejtori. Në veçanti të plotësohet Njësia e Auditit të Brendshëm me një numër punonjësish të mjaftueshëm për rritjen e numrit dhe cilësisë së auditimeve. Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit, Njësia e Audit të Brendshëm të hartojë një regjistër të veçantë për operatorët ekonomikë të skualifikuar, duke rakorduar me të dhënat e Agjencisë së Prokurimit Publik. Po ashtu, të marrë masa për zbatimin e programeve elektronike të licencuara për menaxhimin e financave të bashkisë, me qëllim mbrojtjen nga ndërhyrje të paautorizuara. Në veçanti, për menaxhimin e riskut të krijohet një plan menaxhimi i posaçëm lidhur me riskun e mashtrimit.

Brenda vitit 2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

- Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA-së për periudhën 2022, por në dosje administrohet vetëm VKB nr. 28, datë 26.03.2021 për miratimin e tavaneve përgatitore për PBA 2022-2024, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 34, pika 6.

- Për hartimin e PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mat, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, shkronja “ç”;
- Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 37, pika 1;
- Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Nuk dokumentohet në dosje dokumenti për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm;
- Pjesë e dokumentacionit të Projekt-dokumentit të PBA 2022-2024 që duhet dërguar në MFE si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet *output*, të cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar. Këto formate duhen dërguar të printuara/nënshkruara nga Kryetari i NJVQV-së dhe DEMP (sipas rastit). Konkretisht në dosje mungon Formatu B2 dhe Formatu F16, gjithashtu formatet nuk rezultojnë të printuara sikurse përcaktohet në UMF nr. 7, datë 07.26.2021. pika 24, “Formatet e kërkuara për raportim”.
- Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, neni 23, pika 5, në fuqi deri më datë 12.06.2020, si dhe në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 13, pika 3, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020. Për vitin 2022 nga Bashkia Mat janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit 4 mujorin e parë me nr. 2226 prot, datë 26.05.2022, raporti i monitorimit për 8 mujorin 2022 me nr. 3897 prot, datë 16.09.2022 dhe për 12 mujorin 2022 me nr. 875 prot., datë 23.02.2023. Nga auditimi rezultoi se, raportet e monitorimit janë paraqitur në Këshillin Bashkiak në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Në dosjet të cilat përmbajnë raportet e monitorimit mungon Aneksi nr. 3, Aneksi nr. 4 dhe Aneksi nr. 5. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, pikat 10, 48 dhe 59. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik të Bashkisë Mat.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Mat, të marrë masa për plotësimin e raporteve të monitorimit sipas kërkesave rregullatore.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 nga Bashkia Mat janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit 4 mujorin e parë me nr. 2226 prot, datë 26.05.2022, raporti i monitorimit për 8 mujorin 2022 me nr. 3897 prot, datë 16.09.2022 dhe për 12 mujorin 2022 me nr. 875 prot., datë 23.02.2023. Nga auditimi rezultoi se, raportet e monitorimit janë paraqitur në Këshillin Bashkiak në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2

“Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”. Në dosjet të cilat përmbajnë raportet e monitorimit mungon Aneksi nr. 3, Aneksi nr. 4 dhe Aneksi nr. 5.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, pikat 10, 48 dhe 59. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Mat, të marrë masat që Raportet e monitorimit të plotësohen sipas Kuadrit rregullator të fushës, ku të jenë të pasqyruar Raporti i shpenzimeve sipas programeve, Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve buxhetorë, Raporti i realizimit të produkteve të programit, Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 1,944,338 lekë. Konstatohet se detyrimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2022 nuk janë pasqyruar në Raportin e Monitorimit dërguar në MFE.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Mat ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se:

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 545 prot., të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “R.K.” në vlerën 1,790,338 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim, ndërkohë që në fund të vitit 2021, Bashkia Mat ka pasur disponibilitete në thesar, të cilat mund t’i përdorte për likuidimin e detyrimit ndaj subjektit të mësipërm;

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 1116 të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat, është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “Z.P.M.” në vlerën 112,000 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 nuk është kryer asnjë likuidim, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Bashkia Mat i detyrohet subjektit “Z.P.M.” në vlerën 112,000 lekë. Për më tepër konstatohet se, në vitin 2022 ndaj këtij subjekti nuk është kryer asnjë likuidim, ndërkohë që rezulton se, në vitin 2021 Bashkia Mat ka kryer likuidime ndaj subjekteve të tjera për detyrime të krijuara nga vendimet gjyqësore, të cilat kanë dalë më vonë në kohë në krahasim me vendimin e gjykatës për subjektin e mësipërm, pra pa e respektuar rradhën e likuidimit sipas paraqitjes së detyrimit;

- Si rrjedhojë e Vendimit nr. 631 prot., datë 04.02.2019 të Gjykatës së Apelit ndaj Bashkisë Mat është krijuar detyrimi për kryerjen e pagesës në favor të subjektit “F.E.G.” në vlerën 42,000 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2022 janë kryer likuidime pjesore në vlerën 300,000 lekë, ndërkohë në fund të çdo viti buxhetor siç e kemi cituar edhe më sipër Bashkia Mat ka pasur fonde në dispozicion, të cilat mund t’i përdorte për likuidimin e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pikat 8 dhe 60, UMF nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” dhe UMFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mat, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë mënyrën dhe kronologjinë e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin gjatë zbatimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 132,851,614 lekë dhe janë realizuar në vlerën 118,859,136 lekë ose 89%. Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk është planifikuar arkëtim, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime. Për vitin 2022 nuk është planifikuar arkëtim nga sektori i pyjeve dhe kullotave, tarifa e shkollimit apo të ardhura nga gjocat e policisë Bashkiake.

Gjithashtu, nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar. Nuk ka dokumentacion nëse Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore të ketë dërguar kërkesë për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2022.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton që metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 113, datë 06.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mat, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022” dhe me Rregulloren e brendshme neni 90 pika e) “Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë, me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultoi se nga inventari i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 764,697,889 lekë, objektet nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, si më poshtë: llog 210 “Toka troje terrene”, elementë në vlerën neto 28,625,929 lekë; llog. 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, elementë në vlerën neto 10,550,203 lekë; llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 103 objekte me vlerën neto 758,603,832 lekë. Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa të menjëhershme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Deri në 30 qershor 2024

7. Gjetje nga auditimi: Aktivitet Afatgjata Financiare në fund të viteve 2021 dhe 2022

rezultojnë në vlerën 0 lekë.

- Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të “K.B.” ShPK, me NUIS L.....K, e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit*”. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 100,000 lekë.

- Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “T.M.” Sh.A., me NUIS M.....G, e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim të tregjeve me qëllim tregtimin e produkteve bujqësore ose tregjeve të kafshëve*”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 30,211 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 30,211,950 lekë.

- Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 13.86% të aksioneve të “*Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër*” Sh.A., me NUIS M.....L, e cila është shoqëri aksionare me objekt “*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve*”. Numri i aksioneve është 13,860 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 1,386,000 lekë.

Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022, më konkretisht në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”, në kundërshtim me Urdhërin nr. 64 datë 22.07.2014 i Ministrit të Financave, “*Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*” pikat 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “*Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje*”.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 31,697,950 lekë dhe investori është Bashkia Mat.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 31,697,950 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemit në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar me vlerë kontabël 31,697,950 lekë në debi të llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Deri në 30 qershor 2024

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 296,286,548 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 217,797,446 lekë, e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash, etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë. Këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, por mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

Në llogarinë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” janë regjistruar 57 fatura tatimore me vlerë 37,289,295 lekë për të cilat u ka kaluar afati 60 ditor për t’u paguar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndojë shpenzimet e vitit pasardhës, Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, të marrin masa të

menjëhershme për pagesën e faturave të palikuiduara në vlerën totale 37,289,295 lekë, si dhe të paraqesin në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojnë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për rradhën e pagesave.

Deri në 30 qershor 2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, u konstatua Vendimi nr. 631 datë 04.02.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për detyrimin që Bashkia Mat ka ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit, për vlerën 5,125,862 lekë. Ky vendim gjyqësor i vitit 2019, është regjistruar në shumën 42,000 lekë në llogarinë 401-408, duke e nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 5,083,862 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës dhe të ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, si dhe të merren masa që Drejtoria e Financës të rakordojë çdo muaj, në mënyrë sistematike, me Drejtorinë Juridike mbi balancat e llogarisë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, në lidhje me detyrimet që vijnë nga vendimet gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, u konstatua se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Përfundimisht për vitin 2022, Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është mbivlerësuar për 7,426,072 lekë, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga totali prej rreth 2123 pasuri që i janë transferuar Bashkisë Mat (490), përfshirë pasuritë e paluajtshme të ish-komunave Komsj (921), Baz (185), Ulëz (427) Rukaj (45) dhe Derjan (55), vetëm 69 pasuri janë certifikuar dhe regjistruar në ASHK. Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Mat nuk është rakorduar me Zyren Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37 të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Mat, në bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Dega Mat, të marrë masa për përditësimin e inventarit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik të gjendjes së pronës (evidentim në terren).

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mat ka në inventar 35,160.43 ha pyje/kullota dhe nuk ka miratuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore, me qëllim mbrojtjen e fondit pyjor, rritjen e të ardhurave nga pyjet dhe nxitjen e investimeve, përfshirë përfitimin e fondeve IPA. Për lëndën drusore të sekuestruar në sasinë 486.78 mst, konstatohet se nuk është bërë hyrje në magazinë e materialit drusor. Nga ana e bashkisë Mat ndonëse nuk ka “fletëhyrje”, administrohen vetëm disa fatura “fletë dalje” të parregullta, dorëzuar shkollave dhe kopshteve, pa nënshkrimet e magazinierit dhe pa firmë llogaritari, për pasojë nuk ka gjurmë auditimi mbi mënyrën e shpërndarjes së lëndës drusore nëpër shkolla, kopshte apo institucione të tjera në varësi të bashkisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa që të miratojë plane mbarështimi për ekonomitë pyjore si dhe të bëjë hyrje në magazinë lëndën drusore të sekuestruar, duke dokumentuar të gjithë procesin e shpërndarjes nëpër shkolla, kopshte dhe institucione të tjera.

13. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste janë lidhur kontrata qiraje me subjekte që operojnë në fushën e HEC-eve, të cilët rezultojnë debitorë dhe nuk kanë përmbushur detyrimin e rehabilitimit të sipërfaqes që është hequr nga fondi pyjor, si vijon:

- Kontrata e qirasë nr. 3598 prot., datë 23.08.2022 mes Bashkisë Mat dhe qiramarrësit “A.A.” ShPK është lidhur pa kryer shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, si dhe nuk është rehabilituar sipërfaqja pyjore 0.156 ha për HEC-et “Guri i Zi”, “Daznjanë” dhe “Shell”, sipas Urdhërit të Ministrit nr. 108 datë 12.04.2018.

- Kontrata e qirasë nr. 1522 prot., datë 07.04.2023 mes Bashkisë Mat dhe qiramarrësit shoqëria “D.E.” ShPK, është lidhur pa kryer shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, si dhe nuk është rehabilituar sipërfaqja pyjore 0.156 ha. Për këtë subjekt, rezulton se i është dhënë me qira nën/ngastra pyjore 48/b, e cila nuk përfshihet në raportin teknik dhe në projektin e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit në bazë të Vendimit nr. 08 datë 10.11.2017.

Për të dyja praktikat e mësipërme, nuk administrohet në dosje dokumentacioni i detyrueshëm, si leja e ndërtimit, hartat topografike etj.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet”, VMK nr. 537 datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e kostove për pyllëzimin kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”, Udhëzimin nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 48-65 të Projekt Raportit të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Bashkia Mat, të marrë masa për të lidhur me të gjitha subjektet që operojnë në fushën e HEC-eve një marrëveshje ku të përcaktohen kostot e pyllëzimit kompensues, vlera e së cilës të përfshihet si aneks i kontratave të qirave, duke monitoruar zbatimin e tyre. Në rast të moszbatimit të këtij detyrimi, Bashkia Mat të anulojë të gjitha kontratat e qirasë për subjektet që kanë shkelur kushtet, duke njoftuar Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si agjenci përgjegjëse për monitorimin e HEC-eve.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 23 procedurave me fond limit 2,311,627,866 lekë pa TVSh, u konstatuan shkelje të LPP, legjislacionit të fushës sipas natyrës së objekteve të prokuruarra dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

➤ **Për aktivitetin e vitit 2019,** nga auditimi i 7 procedurave me fond limit 28,760,314 lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:

- Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me hartimin e fondit limit, për vlerën totale të kontraktuar 15,620,358 lekë pa TVSh;
 - Në 6 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 25,734,200 lekë pa TVSh;
 - Në 6 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 26,225,923 lekë pa TVSh;
 - **Për aktivitetin e vitit 2020**, nga auditimi i 4 procedurave, me fond limit **1,952,634,844** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:
 - Në 4 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh;
 - Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 1,944,781,239 lekë pa TVSh;
 - **Për aktivitetin e vitit 2021**, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit **74,420,064** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:
 - Në 2 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 31,481,275 lekë pa TVSh;
 - Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 57,761,516 lekë pa TVSh;
 - **Për aktivitetin e vitit 2022**, nga auditimi i 6 procedurave, me fond limit **255,812,996** lekë pa TVSh, u konstatuan me shkelje të LPP dhe akteve nënligjore, si më poshtë:
 - Në 5 procedura u konstatuan shkelje në lidhje me kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE, për vlerën totale të kontraktuar 247,627,945 lekë pa TVSh;
 - Në 4 procedura, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Mat, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, për vlerën totale të kontraktuar 238,711,279 lekë pa TVSh;
 - Në 1 procedurë, u konstatuan probleme në lidhje me marrjen e mallit në dorëzim, i cili kishte mospërputhje me ST të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, për vlerën totale të kontraktuar 4,698,000 lekë pa TVSh;
- Vendosja e kriterëve të vlerësimit në mënyrë të paargumentuar apo të papërshtatshme dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, rrjedhimisht në mospërputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik, shkel qëllimin dhe parimet kryesore të LPP, siç është nxitja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së shoqërive të vogla e të mesme, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, etj., konkretisht neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh); neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2; neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3; neni 76, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4; neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5; dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5;
- Duke shpallur fitues OE/BOE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni

45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2. Vlerësimi i gabuar i ofertave, ka shkaktuar që AK Bashkia Mat, gjatë periudhës 2019-2022, të lidhë kontrata në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **2,267,479,957 lekë** pa TVSh.

Mangësitë në vendosjen e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave për procedurat e vitit 2020 dhe një pjesë të vitit 2021, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 20, 23, 24, 46, 47, 53, 55, 58 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61, aktualisht të shfuqizuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 65-188 të Projekt Raportit të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, në cilësinë e Titullari të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që:

- Në komisionet e ngritura për hartimin e fondit limit të vendosen specialistë të fushës të mirëtrajnuar, të përdoren metodat e parashikuara me akte ligjore dhe eksperiencat më të mira të fushës, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike dhe minimizimin e shpenzimeve të cilat nuk janë të domosdoshme.
- Në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.
- Të gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Mat dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.
- Të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.
- Të mbahet në vëmendje zbatimi i kontratës në zbatim të kuadrit rregullator të fushës. Mallrat dhe shërbimet e lidhura me to që do të furnizohen duhet të merren në dorëzim sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në katër raste, lejet e ndërtimit janë miratuar pa administruar dokumentacionin detyrues dhe pa marrë konfirmimin nga institucionet përgjegjëse të planifikimit të territorit, si më poshtë:

- Për lejen e ndërtimit me nr. 100 datë 30.04.2019 për zhvilluesin “A.S.”, për objektin me funksion thertore rezultoi se mungon leja mjedisore, kartelat e pasurisë të janë parifreskuara, për të paktën 3 muajt e fundit nga aplikimi për leje;
- Për lejen e ndërtimit me nr. 150, datë 02.08.2020 për zhvilluesin “O.N.”, për objektin “Strukturë 1 kat, me destinacion thertore”, me sipërfaqe ndërtimi 463.1 m², rezultoi se gjurma e ndërtimit bie mbi një objekt ekzistues me sipërfaqe 427 m², përfituar me leje legalizimi. Në aplikimin nr. 212 datë 22.04.2021 “Për fillimin e punimeve”, nuk administrohet akti teknik për prishjen e objektit ekzistues, veprim në kundërshtim me pikën 8 të kushteve të lejes së ndërtimit;
- Për lejen e ndërtimit me nr. 202, datë 12.05.2021 në emër të zhvilluesit I.M., për objektin me sipërfaqe totale ndërtimi 1003 m² rezultoi se nuk është dhënë konfirmimi për miratimin e lejes nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Agjencisë për Eficencën e Energjisë;
- Për lejen e ndërtimit me nr. 309 datë 14.09.2022 për “B.M.” me sipërfaqe 1091m² në emër të

subjektit “V.” ShPK, rezultoi se subjekti nuk ka marrë miratimin paraprak të projektidesë nga komisioni vlerësues, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin. Planvendosja e objektit bujtinë bie pjesërisht mbi gjurmën e një objekt ekzistues.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 22/2018 “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 188-193 të Projekt Raportit të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Bashkia Mat, sektori i urbanistikës, të marrin masa që kartelat e pasurive të paluajtshme të jenë të rifreskuara, për të paktën 3 muaj para datës së aplikimit si dhe për lejet e ndërtimit në fushën e agroturizmit, të cilat prekin objekte ekzistuese, të verifikojë në terren procesin e shembjes.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste, për lejet e ndërtimit me sipërfaqe mbi 250 m² për subjektet “O.N.”, “I.K.” dhe “A.S.” janë lëshuar certifikatat e përdorimit në mungesë të akteve të kontrollit, veprime në kundërshtim me nenin 42 pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”. Lëshimi i certifikatave të përdorimit pa akte kontrolli sjell si pasojë mungesën e verifikimeve nëse objekti ka respektuar kushtet e lejes dhe projektin përkatës të ndërtimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 188-193 të Projekt Raportit të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Bashkia Mat, sektori i urbanistikës dhe IMTV, të marrin masa për kryerjen e akteve të kontrollit periodik për lejet e ndërtimit mbi 250 m², si parakusht për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Bashkia Mat, u konstatua se formimi arsimor i një inspektori nuk është konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Konkretisht nga të dhënat e marra nga drejtoria e burimeve njerëzore, është konstatuar se z. B.F. është diplomuar në Akademinë e Sigurisë dhe Rendit Publik dhe është emëruar si inspektori i IMTV. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, neni 11. Gjithashtu, puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m², të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijojnë aktivitetin e ndërtimit në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare, të ndaluara ose të mbrojtura. Mosmbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasojë jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Mosmarrja e masave nga IMTV është në kundërshtim me përcaktimet e të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 193-195 të Projekt Raportit të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masa që plotësimi i pozicioneve të punës për inspektorët e IMTV-së, të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, lidhur me arsimin përkatës.

Gjithashtu, nga Bashkia Mat, të merren masa që IMTV të bashkëpunojë rregullisht me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepleqtë

apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare, pyje, lumenj apo zona të mbrojtura, si dhe të marrë masa për parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe monitorimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronjat b dhe c, Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Bashkisë Mat, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit. Nëpunësi Zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **43,256,762 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit, Bashkia MAT”, me vlerë 1,242,743,699 lekë me TVSh, fituar nga BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **41,630,011 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 848 prot., datë 19.02.2020 të lidhur ndërmjet Bashkisë Mat dhe BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **41,630,011 lekë** (20,046,864 + 17,553,147 + 4,030,000) nga BOE L.O. ShPK dhe F. ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 848 prot, datë 19.02.2021, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”.

Brenda datës 15.09.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të KUZ blloku “Drita 1”, “Drita 2” dhe Lagjia e re, qyteti Burrel”, me vlerë 86,104,998 lekë me TVSh, fituar nga BOE C. ShPK dhe K. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **268,920 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve 2875 prot., datë 10.07.2020, të lidhur ndërmjet Bashkisë Mat dhe BOE C. ShPK dhe K. ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **268,920 lekë** nga BOE C. ShPK dhe K. ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën nr. 2875 prot, datë 10.07.2020, me objekt “Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”. Përsa i përket zërit “Shtresë çakulli, mbeturinë kave t = 20

cm, përhapur e ngjeshur me makineri”, imazhet e vëna në dispozicion duhet të saktësohen nëse janë pjesë e planimetrisë së këtij projekti.

Brenda datës 15.09.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës Mustafa Gjestila, Burrel”, me vlerë 117,440,762 lekë me TVSh, fituar nga OE U. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **280,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4392 prot., datë 14.10.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Mat dhe OE U. ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **280,000 lekë** nga OE U. ShPK.

Brenda datës 15.09.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksioni i gjimnazit “28 Nëntori”, Bashkia Mat”, me vlerë 113,018,902 lekë me TVSh, fituar nga BOE E.S. ShPK & B.I. ShPK, rezultuan punë të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën totale **1,077,831 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4272 prot., datë 10.10.2022, të lidhur ndërmjet Bashkisë Mat dhe OE U. ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 82-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Mat të merren masat administrative apo ligjore për të arkëtuar vlerën **1,077,831 lekë** nga BOE E.S. ShPK & B.I. ShPK.

Brenda datës 15.09.2024

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Mat, gjendja e bizneseve debitoare gjatë vitit 2022 për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, infrastrukturës arsimore, etj., është 409 subjekte, për vlerën 46,531,158 lekë.

Për debitorët, konstatohet se nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për moslikuidim të detyrimit tatimor.

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, nga bizneset, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifa Vendore, janë dërguar njoftim detyrimet për subjektet debitorë dhe më pas janë dërguar disa shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, barrë hipotekore në pasuritë e paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës/Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, por nuk ka pasur mbulim të mjaftueshëm në krahasim me numrin e debitorëve të rezultuar brenda vitit. Sektori i Taksave dhe Tarifave

Vendore për vitin 2022, ka marrë masa vetëm për “Njoftim dhe kërkesë për për pagesë debie” dhe “Bllokimi i llogarive bankare”. Si rezultat i masave të marra është mbledhur borxhi në vlerën 11,085,638 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestro e mallrave të debitorëve e deri në kallëzim penal.

Sa më sipër, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, nenet 76 dhe 114; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, pikat 1 dhe 2, neni 9, pikat 1 dhe 2, neni 20, pika 1, neni 22, neni 22/5, neni 24, neni 27, pika 3, shkronja “c”, neni 34 dhe neni 35; Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1/1.3, neni 27, pika 1, neni 35, pika 2 dhe neni 64; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, shkronja “a”, neni 7, pika 2, neni 12, pika 1, neni 14, neni 40 dhe neni 42, pika 2; VKB nr. 113 prot., datë 06.12.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokimi i llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj.), për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën **46,531,158 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Mat dhe NJA, gjendja e familjeve debitoare gjatë vitit 2022 për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, si dhe tarifën e infrastrukturës arsimore, është 9,719 familje.

Vlera debitoare totale për taksat dhe tarifat për familjarët është 36,597,002 lekë. Vlera debitoare e krijuar gjatë vitit 2022 për taksat dhe tarifat për familjarët është 13,533,270 lekë. Debia progresive në fund të vitit 2022 është 50,130,272 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB nr. 113 prot., datë 06.12.2021 nenet 17, 19.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK Sh A., Mat (në rolin e agjentit tatimor) për taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e përgjegjësisë ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

2.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **50,130,272 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Vlera debitoare gjithsej për taksën e tokës bujqësore, krijuar përgjatë periudhës deri në vitin 2022 është 2,397,189 lekë. Sipërfaqja e tokës bujqësore të takson, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë

bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore, detyrë e Specialistit të Kadastrës dhe Menaxhimit të Tokës. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermere që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitore në vlera të konsiderueshme debitore. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë.

Sa më sipër, janë veprime në kundërshtim me VKB nr. 113 prot., datë 06.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, neni 7.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Tokës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren. Gjithashtu të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **2,397,189 lekë**.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Mat, u konstatua se nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje, të pajisura me leje legalizimi nga ZVASHK Mat konkretisht:

Vlera debitore në datën 31.12.2021 është 2,726,502 lekë, nga të cilat krijuar në vitin 2022 në vlerën prej 307,827 lekë dhe vlera progresive deri në 31.12.2022 është 3,034,329 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Për debitorët e mësipërm nuk janë marrë masat e nevojshme të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, nenet 90-91. Theksojmë se nga sektori i urbanistikës janë bërë njoftimet për pagesën e taksës, por në vijimësi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e kësaj takse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale, në vlerën **3,034,329 lekë**.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tarifës së pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fondet publike rezultoi se kanë kryer punime ndërtimi tetë subjekte, nga të cilat 2 subjekte nuk kanë paguar detyrimin për vitin 2022. Konkretisht subjekti E. ShPK & E. ShPK për vlerën 150,000 lekë dhe 5.K. ShPK për vlerën 82,500 lekë, nga të cilët BOE E. ShPK & E. ShPK kanë paguar detyrimin në vitin 2023. Për subjektin 5.K. nuk ka dalë asnjë njoftim vlerësimi dhe nuk ekziston dokumentacion i cili të vërteton korespondencën midis sektorit të taksave e tarifave vendore dhe zyrës juridike. Për më shumë nuk dokumentohet puna e kryer në terren, nga strukturat e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 82,500 lekë. Këto veprime, janë në kundërshtim me VKB nr. 113 datë 06.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, neni 18.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Sektori i taksave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërim, ndriçimit në vlerën **82,500 lekë** nga subjekti 5.K. ShPK.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për subjektet të cilat tregtojnë karburante dhe lëndë djegëse për konsumatorët fundorë, u konstatua se:

3 subjekte të cilët kanë ushtruar aktivitetet për tregtimin e karburanteve gjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2022, nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, konkretisht:

- J., është pajisur me licencë për periudhën 31.12.2020-31.12.2021, pa rinovuar licencën për vitet në vazhdim;

- P.O., është pajisur me licencë për periudhën 31.12.2019-31.12.2020, pa rinovuar licencën më tej.

- M.M., nuk rezulton të jetë pajisur me licencë.

- A.A. është pajisur me licencë, por nuk ka bërë pagesën e tarifës, sipas kuadrit rregullator të fushës.

Për këto subjekte nuk administrohet dosje me dokumente, si dhe për ato subjekte që administrohen dosjet përkatëse, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e tyre për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit ose në të kundërt njoftimin e Inspektoratit përkatës, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Si pasojë e situatës së sipërpërmendur rezultojnë detyrime të papaguara në vlerën 1,500,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2 dhe neni 5, shkronja “ç” pikat i-vi; Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3., shkronjat “a” dhe “b”, neni 35, pika 5, shkronja “c”; Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 29, pika 1, neni 69, pika 1 dhe neni 89, pikat 1 dhe 2; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 12 dhe 14; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, Kreu II, pikat 15.1. dhe 15.2.; VKM nr. 344, datë 19.04.2017; dhe VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, neni 25.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet sektorit të licencimit dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masat e nevojshme, për identifikimin dhe pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve dhe lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, subjektet të cilat nuk janë pajisur. Gjithashtu të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve J.; P.O.; M.M. dhe A.A. të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë kryer pagesën për tarifën përkatëse, në vlerën **1,500,000 lekë**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri në datën 31.12.2022 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 1,693,000 lekë, nga të cilat në vitin 2022 janë vendosur 1732 gjoba në vlerën 1,025,000 lekë. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse, gjithashtu nuk janë të kontabilizuara. Nuk rezulton në asnjë rast të jetë bërë kërkesë për titull ekzekutiv, sipas përcaktimit në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.201 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrin masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **1,693,000 lekë**, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit në dispozicion, kryqëzimi i të dhënave me kontratat e qerave për sipërfaqet pyjore, ekstraktet e regjistrimit të subjekteve në QKB, licencimet nga ERE për subjektet me aktivitet prodhimin dhe tregëtimin e energjisë elektrike, u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme përlllogaritjet e bëra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimeve (pastrim, gjelbërim, ndriçim) për subjektet “Biznes VIP”, “Biznes i Madh”

Nga ky vlerësim u konstatua se, për vitin 2022 është përlllogaritur gabim ose janë përjashtuar nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit disa subjekte, konkretisht: për taksën e ndërtesës 3 subjekte “biznes i madh”, për tarifën e shërbimit 5 subjekte “biznes i madh” dhe 4 subjekte me aktivitet HEC për tarifën e shërbimit, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 4,154,110 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat.

Sa më sipër, është në kundërshtim me VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2022”, neni 5 dhe neni 18.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacioni (kontratë qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), duke kryer verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës **4,154,110 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bërë në bazë të analizës së riskut, grupi i auditimit konstatoi se në regjistrin e bizneseve “VIP”, subjekti A. ShPK me aktivitet përpunim mineral kromi, ishte i përjashtuar nga taksa e ndërtesës dhe e truallit. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore, marrë nga Agjensia shtetërore e kadastrës Mat, rezulton se prona me nr. pasurie 240/1, ka një sipërfaqe totale truallit 154,000 m² dhe sipërfaqe ndërtese 14,000 m², pra vlera për vitet 2016- 2017 duhet ishte 1,680,000 lekë dhe për vitet 2018 dhe 2019 detyrimi për taksën e ndërtesës duhet të ishte 1,400,000 lekë, pra në total 3,080,000 lekë, me një diferencë prej 2,200,000 lekësh të llogaritur me shumë nga sektori i taksave.

Ndërsa taksa e truallit është llogaritur për 57,000 m², ndërkohë që duhet të ishte llogaritur për 154,000 m², nga viti 2016-2019 duhej llogaritur në total në vlerën 7,392,000 lekë, pra në total një diferencë prej 4,485,000 lekë më pak nga llogaritja e gabuar.

Përsa i përket viteve 2020-2022, nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore shoqëria A. ShPK ka marrë njoftim vlerësimi dhe fatura për arkëtim, por pa përfshirë taksat e ndërtesës dhe atë të truallit.

Sipas paketave fiskale 2020, 2021 dhe 2022, ku treguesit për nivelin e taksës sipas kategorive janë të përcaktuara, konkretisht shoqëria A. bën pjesë në Biznesin “VIP”, i cili e ka të përcaktuar nivelin e taksës së ndërtesës me 170 lekë për m², për taksën e pasurisë është përcaktuar 0.15 lekë m².

Nga auditimi arrihet në konkluzion se për sa na është vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe i Tarifave në Bashkinë Mat, nga strukturat përgjegjëse të bashkisë Mat nuk dokumentohet korespondenca shkresore me Ministrinë e Energjitikës dhe Infrastrukturës (MIE) ku të saqrohet e gjithë situata e sipërpërmendur. Nga shqyrtimi i dosjes, rezultoi se nga ana e Sektorit të

Taksave dhe Tarifave Vendore janë dërguar njoftime për vlerësim dhe fatura për arkëtim, pa llogaritur taksën e pasurisë, e cila nuk është e argumentuar.

Nga grupi i auditimit u kërkuar që të vihet në dispozicion një kopje e kontratës koncensionare e lidhur ndërmjet (MIE) dhe A., kontratë e cila nuk gjendej në dosjen e subjektit, kështu që në këto kushte grupi i auditimit i referohet Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 20, neni 22, pikat 1 dhe 6, VKB nr. 113, datë 06.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale të vitit 2022” neni 4 pika 9 “a” neni 8 pika 2. Nga mospagesa e taksës së pasurisë, është krijuar detyrimi 10,472,000 lekë, vlerë e cila i përket periudhës 2016-2019 dhe detyrimi prej 14,070,000 lekë i cili është krijuar për periudhën 2020-2022. Në total, detyrimi nga mospagesa e taksës së pasurisë për vitet 2016-2022 rezulton të jetë 24,542,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ financiar për buxhetin e bashkisë Mat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 22-48 të Projekt Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Sektori i taksave Bashkia Mat të sqarojë situatën ndërmjet Autoritetit kontraktor në rastin e mësipërm Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe subjektit A. ShPK, pasi të sqarohet situata se kujt i takon detyrimi për taksën e ndërtesës dhe truallit, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mat të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **24,542,000 lekë**.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mat**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

a) Vërejtje me paralajmërim, deri në largim nga shërbimi civil për punonjësin:

1. Z. E.H., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit të KVO, pasi në 14 raste, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

2. Znj. D.T., me detyrë Drejtor i Financës, pasi në 6 raste, në cilësinë e anëtarit të KVO, ku vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik dhe në 1 rast nuk ka kryer verifikime për operatorët ekonomikë që rezultojnë të përjashtuar nga procedurat e prokurimit, bazuar në buletin publik të Agjencisë së Prokurimit Publik;

3. Z. E.A., me detyrë Kryetar i Njesisë së Prokurimit në 7 raste dhe si Anëtar i Njesisë së Prokurimit në 4 raste, pasi ka miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar, dhe në 1 rast, në cilësinë e anëtarit të KVO, ku vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

4. Z. R.K., me detyrë specialist, në 2 raste, në cilësinë e anëtarit të KVO, ku vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

5. Z. E.R., si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 5 procedura, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

Për veprime/mosveprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, nenet 39, 40 dhe 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat...”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a), si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit, etj.

b) Vërejtje, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. A.G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, për mangësi të konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 22/2018 “Për miratimin e kriterëve të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”, si dhe në pozicionin e Kryetarit të Njesisë së Prokurimit,

2. Z. A.P., me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë e Shërbimeve, për moszbatim të pikave 15.1 dhe 15.2 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017;

3. Z. A.H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, për moszbatim të VKB-së nr. 113 prot., datë 06.12.2021, neni 7, pika 11, “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2022”, si dhe për mangësi të konstatuara në procedurat e shqyrtimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor;

4. Znj. F.S., me detyrë Specialiste Prokurimesh, për veprime/mosveprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, nenet 39, 40 dhe 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat...”, etj.

E. 2. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1. Z. E.Ç., si Kryetar i Njesisë së Prokurimit në 5 procedura, si Kryetar i Komisionit për vlerësimin e Ofertave në 1 procedurë dhe si Anëtar i Komisionit për vlerësimin e Ofertave në 2 procedura;

2. Z. D.N., si Anëtar i Njesisë së Prokurimit në 5 procedura, ku janë miratuar kriteret të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedura, ku vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

- 3. Z. A.N.**, si Kryetar i Njesisë së Prokurimit në 5 procedura, ku janë miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 1 procedurë, ku vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;
- 4. Z. A.M.**, si Anëtar i Njesisë së Prokurimit në 9 procedura, ku janë miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar;
- 5. Z. A.D.**, si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 1 procedurë, ku vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;
- 6. Z. P.M.**, si Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedura, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;
- 7. Z. E.B.**, si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedura, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;
- 8. Z. B.B.** me detyrë ish përgjegjës i taksave dhe i tarifave vendore për vitin 2019, për parregullsi dhe probleme në krijuara në sektorin e taksave dhe i tarifave vendore për vitin 2019;
- 9. Z. E.B.**, me detyrë ish përgjegjës, i taksave dhe i tarifave vendore për periudhën 22.11.2019-21.01.2022, për parregullsi dhe probleme në krijuara në sektorin e taksave dhe i tarifave vendore për periudhën 22.11.2019-21.01.2022, si dhe si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedura, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;
- 10. Z. D.R.** me detyrë drejtor Ekonomik, përgjegjës për sektorin e taksave nga data 21.01.2022-31.12.2022, për parregullsi dhe probleme në krijuara në sektorin e taksave dhe i tarifave vendore për periudhën 21.01.2022-31.12.2022, si dhe Anëtar i Njesisë së Prokurimit në 10 procedura, ku janë miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar;
- 11. Z. E.L.**, si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 4 procedura, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik, si Kryetar i Njesisë së Prokurimit në 2 procedura dhe si Anëtar i Njesisë së Prokurimit në 2 procedura, ku janë miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar;
- 12. Z. E.D.**, si Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedura, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik dhe si Kryetar i Njesisë së Prokurimit në 1 procedurë, ku janë miratuar kritere të veçanta kualifikuese që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar;
- 13. Znj. E.M.**, si Anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedura, vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik;

Punonjësit të cilët kanë qenë pjesëmarrës në komisionet e ndryshme për prokurimin publik, ngarkohen me përgjegjësi për moszbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, me pasojë mosmarrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit 236,557 mijë lekë, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3., nenin 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”,

Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, si dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj

Punonjësit të cilët kanë qenë të angazhuar me taksat dhe tatimet vendore, ngarkohen me përgjegjësi për veprime/mosveprime në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Qëllimi”, pikat d) dhe dh), neni 3 “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa a), si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, pika 2, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit, etj.

F. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Mat, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecuresë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

G. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7, nenin 8, nenin 15, pika 1 dhe pika 5, Kreu III, neni 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 14/8, pika 1, germa d dhe Udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës dhe masa disiplinore “Heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit” për shoqërinë zbatuese: Kontraktori: B.O.E “L.O.” ShPK dhe “F.” ShPK dhe shoqërinë mbikëqyrëse të punimeve “I.” ShPK, me licencë MK2406/1, si më poshtë:

1. Znj. L.L., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, drejtues ligjor dhe teknik i shoqërisë “I.” ShPK dhe licencë MK2406/1, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratën: *“Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”*, Bashkia Mat, me sipërmarrës punimesh “L.O.” ShPK dhe “F.” ShPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 41,630,011 lekë si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, duke hartuar situacione fiktive.

2. Shoqërisë “L.O.” ShPK dhe “F.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në Kontratën e zbatimit me nr. 848 prot., datë 19.02.2021 me objekt: *“Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Burrelit”*, Bashkia Mat, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik “L.O.” ShPK dhe “F.” ShPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 41,630,011 lekë, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, duke hartuar fatura dhe situacione fiktive.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

J.P.

S.D.

R.L.

K.H.

R.A.

E.R.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B.D.